



FAKULTETI I MËSUESISË
DEPARTAMENTI I GJUHËS DHE I LETËRSISË

KONFERENCA SHKENCORE “AKADEMIKU JANI THOMAI NË 75- VJETORIN E LINDJES”

(PËRMBLEDHJE MATERIALESH)
Korçë, 20-21 maj 2010

**Kjo përmbledhje botohet nën kujdesin e Rektorit të Universitetit “Fan S.Noli” të Korçës,
prof.as.dr. GJERGJI MERO**

**FAKULTETI I MËSUESISË
DEPARTAMENTI I GJUHËS DHE I LETËRSISË**

**KONFERENCA SHKENCORE “AKADEMIKU JANI THOMAI NË 75-
VJETORIN E LINDJES”**

**(Përmbledhje materialesh)
Korçë, 20-21 maj 2010**

**Botim i posaçëm i Universitetit “Fan S. Noli”
Përgatitën për botim: Prof.dr. ALI JASHARI, Dr. ELONA BIBA**

**ISBN: 978992805
Shtypur në maj 2011
Tirazhi 150 copë**

KRONIKË	5
Fjala e hapjes. Prof. as. dr. Gjergji MERO. Rektor i Universitetit “Fan S. Noli”, Korçë.....	6
Përshëndetje. Kryetari i Bashkisë Fier, z. Baftijar ZEQAJ	9
REFERAT	
Prof. dr. Ali JASHARI, Prof. as. dr. Begzad BALIU, Prof. as. dr. Dhimitri BELLO	
AKADEMIKU JANI THOMAI NË 75-VJETORIN E LINDJES	10
Dr. Elona ÇEÇE (BIBA) .Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë	
VEPRA E AKADEMIKUT JANI THOMAI NË HAPËSIRËN SOCIOLOGJISTIKE	33
Prof. dr. Valter MEMISHA. Qendra e Studimeve Albanologjike	
AKADEMIK JANI THOMAI DHE LEKSIKOGRAFIA SHQIPE E SHEK. XXI	40
Prof. dr. Shefkije ISLAMAJ. Instituti Albanologjik i Prishtinës	
PREJ FJALËS TE FJALORI.....	47
Prof. as. dr. Hasan MUJAJ. Universiteti i Prishtinës	
ARRITJET E AKAD. JANI THOMAI NË GJUHËSINË KONTRASTIVE E PRAGMATIKE	52
Nuri PLAKU. Specialist në Muzeun Historik, Fier	
E FOLMJA MYZEQARE MIDIS GJUHËTARIT JANI THOMAI DHE SHKRIMTARIT JAKOV XOXA.....	56
Prof. as. dr. Aleksandra PILURI,Universiteti i Korçës	
Niko DAKO, SHBA	
PERSONALITETI I AKAD. JANI THOMAI NË FUSHËN E ARSIMIT	62
Dr. Anyla (MAXHE) SARAÇI. Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë	
TRAJTESA BASHKËKOHORE TË AKADEMIKUT JANI THOMAI PËR SEMANTIKËN LEKSIKORE.....	64
Prof. as. dr. Thoma DHIMA. Universiteti “E. Çabej”, Gjirokastrë	
PROBLEME TË GJUHËSISË SË PËRGJITHSHME NË VEPRËN E AKADEMIK JANI THOMAIT.....	68
Prof. dr. Agron DURO. Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë	
MARRËDHËNIET FJALË/KUPTIM DHE TERM/KONCEPT NË KËNDVËSHTRIMIN E AKADEMIKUT JANI THOMAI.....	73
Prof. as. dr. Abdulla BALLHYSA. Universiteti “A. Xhuvani”, Elbasan	
AKAD. JANI THOMAI PËR ANALIZËN LEKSIKOLOGJIKE TË TEKSTIT	79
Prof. as. dr. ARTUR LAMAJ. Universiteti “E. Çabej”, Gjirokastrë	
DISA VËSHTRIME TË PROF. JANI THOMAIT MBI MOTIVIMIN E NJËSIVE LEKSIKORE NË GJUHËN SHQIPE	84

Prof. dr. Qemal MURATI. Instituti Albanologjik i Prishtinës

PRIRJE E TIPARE TË LEKSIKUT TË SHQIPES GJATË ZHVILLIMIT TË TIJ HISTORIK... 89

Prof. as. dr. Xheladin ZYMBERAJ. Fakulteti i Edukimit - Prizren

ÇËSHTJE TË HOMONIMISË DHE TË POLISEMISË NË VEPRËN E AKADEMIK JANI THOMAIT..... 95

Dr. Raqi BELLO. Universiteti „Sv.Kiril i Metodij” Veliko Tërnovo, Bullgari

NDIHMESE TË AKAD. JANI THOMAI NË FUSHËN E FJALËFORMIMIT 99

Prof. as. dr. Bahtiar KRYEZIU

Fakulteti i Edukimit, Gjiilan, Kosovë

PASTRIMI DHE PASURIMI I GJUHËS SHQIPE NË SYNORIN E AKADEMIK JANI THOMAIT..... 106

Prof. as. dr. Asllan HAMITI

Universiteti “Shën Qirili e Metodi”, Shkup, Maqedoni

NDIHMESE TË AKAD. JANI THOMAI NË FUSHËN E LEKSIKUT DIALEKTOR..... 114

Dr. Nora MALAJ, Tiranë

Prof. dr. Vehbi BEXHTI, Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë, Maqedoni

FJALORI FRAZEOLOGJIK I AKADEMIK JANI THOMAI - PJESË E NDRYSHIMEVE SOCIOLOGJISTIKE NË PËRDITSHMËRINË E KOMUNIKIMIT 122

Prof. as. dr. Vehbi KADRIU. Universiteti i Shkupit

RRETH PIKËPAMJEVE DHE QËNDRIMEVE TË AKADEMIK JANI THOMAIT PËR FRAZEOLOGJINË E GJUHËS SHQIPE 127

Dr. Dhori Q. QIRJAZI. Universiteti “Aristoteli”, Selanik

RRUGË TË ÇELURA E SHITIGJE TË PASHKELURA: I PARI FJALOR FRAZEOLOGJIK BALLKANIK, HARTUAR NËN DREJTIMIN E AKAD. JANI THOMAI..... 133

Prof. as. dr. Hamit XHAFAERI. Universiteti i Evropës Juglindore – Tetovë, Maqedoni

LEKSIKU ETNOFOLKLORIK NË SHPREHJET FRAZELOGJIKE TË FJALORIT FRAZEOLOGJIK TË JANI THOMAIT 141

Prof. as. dr. Mustafa IBRAHIMI. Universiteti i Evropës Juglindore – Tetovë, Maqedoni

FRAZEMAT SOMATIKE BAZUAR NË GJESTE DHE MIMIKË, SI BURIM I FRAZELOGJIZMAVE TË JANI THOMAIT 150

Dr. Përparim FAKAJ. Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë

AKADEMIK JANI THOMAI PËR BALLKANIZMAT NË FUSHËN E FRAZELOGJISË..... 156

FALËNDERIM NGA AKAD. JANI THOMAI 165

KRONIKË

Në datat 20 dhe 21 maj 2010, në sallën e konferencave të Universitetit “Fan S. Noli”, në Korçë, zhvilloi punimet Konferenca Shkencore Ndërkombëtare “Akademiku Jani Thomai në 75-vjetorin e lindjes”.

Konferenca u organizua nga Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë i Fakultetit të Mësuesisë të Universitetit të Korçës.

Në këtë konferencë morën pjesë studiues nga Universiteti “Kirili e Metodi” i Shkupit, Universiteti “Aleksandër Xhuvani” i Elbasanit, Universiteti i Tiranës, Universiteti i Evropës Juglindore në Tetovë, Universiteti i Prishtinës, Universiteti “Eqrem Çabej” i Gjirokastrës, Universiteti “Aristoteli” i Selanikut, Universitetet e Veliko Tërnovos e Sofjes (Bullgari).

Fjalën e hapjes e mbajti rektori i Universitetit të Korçës, prof. Gjergji Mero, i cili i dhuroi akad. Jani Thomait emblemën e Universitetit “Fan S.Noli” të Korçës.

Më pas përshëndeti prefekti i Qarkut të Korçës, z. Andrea Mano, duke e vlerësuar lart jetën dhe veprën e akad. Jani Thomai. Ai tha se figura të tilla i bëjnë nder qytetit dhe qarkut të Korçës, ndaj dhe ne duhet t’i kemi herë pas here në gjirin tonë. Veprat e akad. Jani Thomai, vazhdoi më tej z. Andrea Mano, janë një shembull i gjallë i përkushtimit për shkencat albanologjike, një model domethënës për thellësinë shkencore dhe karakterin kombëtar.

Prefekti i Qarkut të Korçës, në fund të përshëndetjes së tij, vlerësoi drejtuesit e Universitetit të Korçës dhe stafin akademik për organizimin e veprimtarive të tilla, të cilat e ngrenë atë nga ana cilësore dhe e bëjnë me të vërtetë një qendër të rëndësishme shkencore në rajonin e Korçës dhe më gjerë.

Më pas u lexua përshëndetja e kryetarit të Bashkisë së qytetit të Fierit, z. Baftijar Zeqaj, drejtuar Konferencës.

Pas fjalëve përshëndetëse për pjesëmarrësit u shfaq dokumentari “Akademiku Jani Thomai në 75-vjetorin e lindjes”, realizuar nga regjisori Irvin Muçaj dhe operatori Klejdi Kapexhiu.

Konferenca i vazhdoi punimet më tej e leximin e referatit kryesor dhe kumtesave kushtuar anëve të ndryshme të veprës së akad. Jani Thomai.

Në përfundim të Konferencës përshëndeti akad. Jani Thomai, i cili i dhuroi Rektorit të Universitetit të Korçës nga një kopje të veprave të botuara deri tani.

Punimet e kësaj konference i përcollën edhe mediat televizive lokale dhe kombëtare.

Fjala e hapjes

Prof. as. dr. Gjergji MERO

Rektor i Universitetit “Fan S. Noli”, Korçë

I nderuar zoti prefekt i qarkut të Korçës,
Të nderuar pedagogë, studentë dhe të ftuar,
Të nderuar pjesëmarrës në këtë konferencë,
I nderuar miku ynë, profesor Jani Thomai!

Kam nderin që t’ju përshëndes të gjithëve dhe t’i uroj punime të mbara konferencës ndërkombëtare me temë: “Akademiku Jani Thomai në 75-vjetorin e lindjes”, që Universiteti i Korçës po organizon në bashkëpunim dhe me ndihmën e çmuar të profesorëve të Universiteteve të tjera brenda dhe jashtë vendit. Dua t’i përshëndes veçanërisht këta profesorë për gatishmërinë dhe përkushtimin që treguan, për të kontribuar në këtë konferencë që ne po organizojmë sot, duke i falenderuar për bashkëpunimin e vazhdueshëm që ne kemi me ta.

Siç dihet nga të gjithë, akademiku Jani Thomai është një nga personalitetet më në zë që kemi sot në gjuhësinë shqiptare dhe më gjerë.

Nga shumë studiues e pedagogë të gjuhës shqipe, si dhe nga studentë, mësues, intelektualë të fushave të ndryshme, albanologë etj., njihen kontributet që ai ka dhënë, sidomos në fushën e semantikës, të leksikologjisë, të leksikografisë, të dialektologjisë, të fjalëformimit, të frazeologjisë, të semantikës leksikore, të kulturës së gjuhës etj.

Shënimi i këtij përvjetori të përbashkët në Universitetin e Korçës lidhet me disa fakte: Profesor Jani Thomai është pedagog i ftuar në Universitetin tonë qysh prej katër vjetësh. Ai ka marrë pjesë aktive dhe ka ndihmuar në organizimin e veprimtarive shkencore, është pjesë e stafit tonë akademik të programit të doktoraturës për gjuhësi të aplikuar dhe kontrastive që ne do të çelim së shpejti, ka qenë pedagog dhe udhëheqës shkencor i disa prej pedagogëve tanë të gjuhësisë, por mbi të gjitha, është miku ynë i përbashkët, pavarësisht nga profesioni.

Të gjitha këto na dhanë shtysën për të organizuar këtë konferencë shkencore, në bashkëpunim me kolegë e bashkëpunëtorë të tij nga vendi dhe nga rajoni.

Tashmë Universiteti i Korçës ka krijuar një traditë në organizimin e tubimeve shkencore mbarëkombëtare: më 14 nëntor 2008 u zhvillua konferenca për Kongresin e Manastirit, më 4 dhjetor 2009 u organizua një konferencë për profesor Selman Rizën, pa përmendur veprimtaritë nga fusha të tjera që kemi organizuar dhe mendojmë të organizojmë gjatë këtij viti.

Në vazhden e veprimtarive të mëparshme, kjo konferencë shkencore synon të trajtojë gjerësisht kontributet e akademikut Jani Thomai veçanërisht në fushë të gjuhësisë. Këtu do të shtjellohen sidomos kontributet e tij edhe për studimin e marrëdhënieve gjuhësore të shqipes me rrethin e gjuhëve indoevropiane, kryesisht ballkanike, për leksikologjinë e leksikografinë

ballkanike, për semantikën teorike, për teorinë e praktikën leksikografike shqiptare, për hartimin e teksteve shkollore, për analizën e tekstit, për frazeologjinë e frazeografinë etj.

Në këtë konferencë shkencore ndërkombëtare do të kumtojnë për çështje të tilla të programit, studiues nga qendrat universitare të Korçës, të Tiranës, të Prishtinës, të Sofjes, të Velikoternovos (Bullgari), të Selanikut (Greqi), të Shkupit, të Tetovës (Maqedoni), të Gjirokastrës, të Elbasanit, të Vlorës, nga ShBA etj., shumica ish-studentë, doktorantë e bashkëpunëtorë të akademikut Jani Thomai në studime të ndryshme, për të veçuar edhe një herë problemet që ka shtjelluar akademiku Jani Thomai në fushë të gjuhës shqipe, duke u ndalur sidomos në ato probleme që nuk janë trajtuar në veprimtari të tjera të kësaj natyre dhe duke sjellë secili kumtues vështrimin e vet shkencor mbi to.

Ne shpresojmë që kjo konferencë do të afirmojë edhe më shumë mendimin shkencor ndërmjet studiuesve e pedagogëve të universiteteve të hapësirës shqiptare dhe më gjerë duke mbushur kësaj edhe atë zbrazëti që vihet re në zhvillimin veprimtarive të kësaj natyre.

Botimi i materialeve të kësaj konference, që ne do t'a bëjmë së shpejti, do të jetë një ndihmesë e vyer për studentët e filologjisë dhe për studiuesit e rinj për njohjen e një pjese të vlerave të krijimtarisë shkencore të akademikut Jani Thomai.



Të nderuar pjesëmarrës !

Duke ju falenderuar edhe një herë për mirëseardhjen në universitetin tonë, unë e çmoj lart pjesëmarrjen tuaj në këtë konferencë dhe shpreh besimin që edhe në të ardhmen ju do të jeni mes nesh. Pa dashur të hyj në detaje të punës e veprës së akademikut Jani Thomai, sepse ato do të dalin nga kumtesat që do të mbahen nga profesorët e nderuar, nuk mund të lija pa përmendur diçka nga ajo vepër e madhe, nga puna e tij që nuk e pushon asnjëherë, nga emri i tij që nderohet dhe respektohet jo vetëm në qarqet akademike, por kudo brenda e jashtë vendit, në të gjitha trevat ku jetojnë e punojnë shqiptarët.

Duke u nisur jo vetëm nga dëshira jonë e përbashkët, por edhe e mjaft profesorëve të nderuar që janë në këtë sallë nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Bullgaria, etj, mendoj se kjo konferencë do të nxisë kërkimet e përbashkëta studimore për probleme të caktuara gjuhësore në interes të ndërtimit të një pamjeje sa më të plotë të historisë së albanologjisë, mbështetur në dijen më të përparuar që shquan mendimi shkencor i akademik Jani Thomait, do të afirmojë mendimin shkencor ndërmjet mësimdhënësve të universiteteve të hapësirës shqiptare, do të përcjellë kërkimet shkencore në fushën e gjuhësisë dhe albanologjisë etj.

Kam bindjen se kumtesat që do të mbahen në kjo konferencë, do të jenë një prurje e re në vazhden e studimeve dhe veprimtarive të tjera shkencore të organizuara në Universitetin e Korçës.

Edhe një herë ju uroj punë të mbarë dhe suksese!

I uroj profesor Jani Thomait jetë të gjatë dhe të lumtur!

Faleminderit!

Në fund, në shenjë nderimi dhe mirënjohjeje për jetën dhe veprën e akademikut Jani Thomai, unë dëshiroj që në emrin tim, si dhe të stafit akademik e të studentëve, t'i jap si dhuratë një kujtim domethënës nga Universiteti dhe qyteti i Korçës



Përshëndetja e dërguar nga Kryetari i Bashkisë Fier, z. Baftijar Zeqaj.

I nderuar Z. Prefekt!

I nderuar Z. Rektor!

I nderuar akademik Jani Thomai!

Të nderuar profesor, zonja dhe zotërinj!

Ndihem i privilegjuar që ndodhem sot i ftuar në këtë konferencë shkencore, kushtuar njërës prej figurave dominuese të kulturës shqiptare, akademikut tonë të nderuar, gjuhëtarit Jani Thomai, në 75-vjetorin e lindjes. Ky privilegj lidhet me vendlindjen e profesor Janit, me Fierin, ndaj dhe unë si drejtues i Bashkisë së këtij qyteti, i shpreh Universitetit tuaj dhe qytetit të Korçës, mirënjohjen time të thellë, për vlerësimin dhe përkushtimin e lartë që i bëni personalitetit të tij shkencor.

Vëmëndja që ju po tregoni ndaj prof. Thomait është një shembull i veçantë për të gjithë ne, sepse kjo përbën një detyrë të rëndësishme për shtetin politikën dhe shoqërinë tonë, pasi figura të tilla janë pasuri kombëtare dhe vijn rrallë midis nesh.

Ato janë edhe pika lidhjeje midis brezave dhe komuniteteve të ndryshme. Një tregues i tillë është edhe kjo konferencë, e cila do të shërbejë si një eveniment i spikatur në kujtesën kulturore midis dy qyteteve tona. Korça dhe Fieri, kanë patur me njëri-tjetrin një bashkëpunim të hershëm historik dhe kanë krijuar midis tyre një simotërzim të përbashkët në kohëra të qeta dhe të vështira. Mësuesit e parë të shkollës së parë shqipe në Fier, Viskë Babatasi dhe Thanas Floqi kanë qenë korçarë. Korçarë kanë qenë edhe disa nga inxhinjerët e shquar të naftës si, i madhi Koço Plaku, mjek si Thimi Melonashi, arkitekt, ndërtues, ekonomist dhe shumë kuadro të tjerë të fushave të ndryshme. Kontributin e tyre, komuniteti fierak e ka përjetësuar me tituj nderi, emërtime rrugësh dhe institucionesh. Ndërsa sot, është Korça ajo që nderon gjithë komunitetin fierak nëpërmjet kësaj konference shkencore kushtuar njërit prej bijëve të tij më të çmuar, profesor Jani Thomait.

I uroj kësaj konference, punë të mbarë dhe suksese në zhvillimin e saj!

Ju uroj juve prof. Jani, jetë të gjatë e të lumtur dhe suksese të mëtijshme në punën tuaj shkencore!Faleminderit!



REFERAT

**Prof. dr. ALI JASHARI, Prof. as. dr. BEGZAD BALIU, Prof. as. dr. DHIMITRI BELLO
AKADEMIKU JANI THOMAI NË 75-VJETORIN E LINDJES**

Të nderuar pjesëmarrës në këtë konferencë!

Në historinë e albanologjisë leksikografia zë vendin qendror, jo vetëm për zanafillën me një *Fjalorth* dygjuhësor të Arnold von Harfit dhe për kulmimin me *Fjalorin* e Frang Bardhit, por para se gjithash për krijimin si shkencë me *Fjalorin etimologjik* të Gustav Majerit, për ndërtimin si dije nacionale me *Fjalorin* e Kostandin Kristoforidhit, për thelbin me *Fjalorin e "Bashkimit"*, të Nikollë Gazullit e atë të Stjuart Manit dhe për sintetizimin si institucion me *Fjalorët e gjuhës shqipe* (1954, 1980) dhe me *Fjalorin e gjuhës shqipe* (2004), në të cilët kontributi i profesor Jani Thomait është rrënjësishëm si në aspektin teorik ashtu dhe në atë pragmatik.

Brenda kësaj periudhe pesëshekullore dhe brenda hapësirës europiane kontributin e tyre në këtë fushë të albanologjisë e kanë dhënë leksikologë e leksikografë të shumtë, ndërsa këtu po përmend vetëm bashkëkohësit e profesor Jani Thomait, si: Eqrem Çabej, Mahir Domi, Aleksandër Xhuvani, Kostaq Cipo, Anton Krajni, Osman Myderrizi, Androkli Kostallari, Kostaq Cipo, Xhevat Lloshi, Miço Samara, Ferdinand Leka, Emil Lafe, Shefki Sejdiu, Ali Dhrimo, Murat Bejta, Sylejman Drini, Hilmi Agani, Ruzhdi Ushaku, Shefkije Islamaj, Eshref Ymeri, Zenun Gjocaj, Mikel Ndrecaj, Abdullah Zymberi, Qemal Murati, Mehmet Ahmetaj etj.

Në këtë rrjedhë, në përvjetorin e profesor Jani Thomait, do të përqendrohemi në kontributin teorik, praktik e metodologjik në fushë të leksikografisë dhe në vendin e tij në historinë e albanologjisë.

I. Jani THOMAI: NË KËRKIM TË FJALËS

Jani Thomai lindi në Seman të Fierit më 1935. Gjimnazin e kreu në Shkodër, dhe më pas ndoqi studimet e larta e u diplomua në degën e gjuhës shqipe e të letërsisë në Universitetin e Tiranës (1958). E filloi punën në Departamentin e leksikologjisë e të leksikografisë në Institutin e Gjuhësisë e të Letërsisë. Gjatë viteve 1998–2008 ishte përgjegjës i këtij departamenti. Në vitin 2003 u zgjodh anëtar i Akademisë së Shkencave e kryetar i Seksionit të shkencave shoqërore e albanologjike, ndërsa në vitin 2008 u zgjodh sekretar shkencor i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Jani Thomai ishte dhe është anëtar në shumë redaksi e forume shkencore¹, pjesëmarrës i shumë konferencave shkencore dhe drejtues profesional i tyre². Ka qenë delegat në Kongresin e

¹ Shih: (“*Studime filologjike*”, “*Gjuha jonë*”), përmbledhjet e studimeve (“*Studime mbi leksikun ...*”, “*Leksikografia shqipe ...* etj.); **anëtar në forume shkencore** – në Këshillin shkencor të Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, në Asamblenë e Akademisë së Shkencave (që nga viti 2003), në EURALEX (“*Shoqata Europiane e Leksikografëve*”, edhe si koordinator për Shqipërinë, që nga viti 1988 - shih “*International Journal of Lexicography*”, Volume 15, Number 1, March, 2002, f. 26 dhe 14), në Komitetin

Drejtshkrimi të Gjuhës Shqipe (1972). Për të gjitha këto ai është nderuar me disa çmime kombëtare të shkallës më të lartë³.



Fushat kryesore të veprimtarisë së tij shkencore janë leksikologjia, semasiologjia, frazeologjia, fjalëformimi, kultura e gjuhës, dialektologjia dhe leksikografia; është titullar i lëndëve “Leksikologjia e gjuhës shqipe” dhe “Semasiologjia” në Universitetin e Tiranës, si dhe

Kombëtar të AIESEE (“Shoqata Ndërkombëtare e Studimeve të Europës Jug-Lindore”), në Komisionin Ndërkademi për gjuhën shqipe (Shqipëri – Kosovë) etj.

² Drejtues shkencor projektsh e redaktor shkencor veprash leksikologjike e leksikografike (fjalorët shpjegues të viteve 1980, 1984, 2002, 2006; fjalorët frazeologjikë shqip e ballkanik të vitit 1999; “Për pastërtinë e gjuhës shqipe (Fjalor)” i vitit 1998; “Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe” i vitit 2004; përmbledhje studimesh “Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, I, II të vitit 1972, III i vitit 1989; Shqiptarët e Maqedonisë e vitit 1994; “Leksikografia shqipe – trashëgimi dhe perspektivë” e vitit 2005; “Fjalor me shprehje të huazuara në gjuhën shqipe” (hartuar nga A. Jashari) i vitit 2007; “Historia e popullit shqiptar” (hartuar nga Akademia e Shkencave, si redaktor gjuhësor), vëllimet I dhe II të vitit 2002 etj.

³ Ka marrë Çmimin e Republikës të shkallës së dytë (1984); “Urdhri Naim Frashëri” i klasit të parë (1985) dhe “Qytetar nderi i Myzeqesë” (2001).

autor i teksteve të këtyre lëndëve. Gjatë kësaj kohe, në Universitetin e Tiranës ishte edhe udhëheqës shkencor doktoratash e diplomash⁴.

Në një periudhë gjysmëshekullore Jani Thomai ka botuar një varg veprash, studimesh e artikujsh për gjuhën letrare shqipe, për formimin e fjalëve, për shtresa të veçanta leksikore etj., që po të sistemohen më përafër, nuk do të ishte vështirë të kuptojmë se kontributi i tij kap një numër të gjerë fushash, nënfushash e profilizimesh specializuese, që kapin jo vetëm sinteza me karakter historik, po edhe synime e ndriçime të kërkimeve më të reja.

Gjatë kësaj periudhe Jani Thomai ka drejtuar rreth njëzet ekspedita leksikologjike në Shqipëri e në Kosovë; ka bërë vjelje fjalësh, shprehjesh e kuptimesh nga rreth 100 000 faqe (letërsi artistike, publicistikë etj.), si edhe ka bërë redaktimin e materialeve leksikore të mbledhura nga bashkëpunëtorë të terrenit për t'i botuar në "Studimet filologjike"⁵.

+Më 1967 Sektori i leksikologjisë dhe i leksikografisë, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, organizon ekspeditën e parë stacionare për kërkime të thelluara leksikore dhe onomastike. Profesor Jani Thomai është njëri nga eksploruesit e grupit të parë në Memaliaj, Pishkash dhe Cërrik. E vërteta, ekspedita individuale e grupeve institucionet shkencore kishin organizuar edhe më parë, madje menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, kur ishin themeluar institucionet e para kërkimore-shkencore në Tiranë dhe në Shkodër, në të cilat Jani Thomai kishte treguar zellin e hulumtuesit të pasionuar dhe seriozitetin e kujdesshëm të përpunuesit të lëndës në skedarë, në fjalorë, në material leksikor të botuar në revistat shkencore të institucioneve shkencore dhe në studimet monografike.

Përveç në hapësirën shtetërore të Shqipërisë, kur do të krijohen kushtet e mundësitë, Jani Thomai do të angazhohet për kërkime edhe në hapësirën e Kosovës. Kështu, në vitin 1974, ai dhe kolegë të tjerë nga Tirana e Prishtina do të bëjnë kërkime të organizuara leksikore edhe në fshatrat e Kosovës, ndërsa përvojën e tij do ta paraqesë në një artikull prezantues në revistën e Institutit të Gjuhësisë "Studime filologjike" (1974). Po në këtë revistë boton materialet "Fjalë e shprehje nga Kosova", të mbledhura në terren.

Jani Thomai ka bërë kërkime bibliografike e arkivore në disa shtete të Evropës, në Francë, Austri, Angli, Itali, Rusi, Maqedoni dhe ka përfaqësuar studimet albanologjike me kumtesa shkencore⁶ me ligjërata mësimdhëniesh.

⁴ Agim Hidi, Vehbi Kadriu (Tetovë), Rusana Hristova (Bullgari), Ali Jashari, Idriz Metani, Valter Memisha, Artur Lame etj. dhe disa mikroteza (SHPU) e punime diplome (UT).

⁵ Ekspeditat leksikologjike të vitit 1963, SF, 1964, 1, f. 202-203; Ekspeditat leksikologjike të vitit 1965, SF, 1965, 4, f. 206-207; SA, 1965, 2, f. 205-206; Ekspedita stacionare të Sektorit të leksikologjisë, SF, 1967, 3, f. 233-234; Nga ekspeditat leksikologjike në Kosovë, SF, 1974, 1, f. 223-228; SA, 1974, 1, f. 228-232; Fjalë e shprehje nga Kosova, SF, 1981, 2, f. 145-152.

⁶ Pjesëmarrje me kumtesa a me referate në veprimtari shkencore ndërkombëtare: në Simpoziumin shkencor kushtuar N. Joklit (Innsbruck, Austri, 1977), në Kongresin VI Ballkanik (Sofje, 1966), në Kongresin XIV Ndërkombëtar të Linguistëve (Berlin, 1987), në Kongresin III të EURALEX-it (Budapest,

Duke bërë hulumtime shkencore në terren dhe në arkiva kombëtarë e ndërkombëtarë, duke bërë sinteza kur të vogla e kur më të vëllimshme, duke bërë diskutime rasti dhe duke ligjëruar nga njëri institucion shkencor te tjetri, sidomos duke punuar me ngulm në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë mbi projekte dekada me radhë, Jani Thomai ka arritur të botojë disa nga veprat themelore në fushë të gjuhësisë shqiptare: projekte të përbashkëta, kryesisht fjalorë⁷, monografi me karakter kryesisht teorik⁸ dhe më në fund vëllime në dorëshkrim, me karakter monografik⁹. Sigurisht është me rëndësi të thuhet se Jani Thomai, duke qenë njohës e tipologjizues i një varg projektesh shkencore, ka marrë besimin e redaksive shkencore për një varg projektesh të karakterit enciklopedik¹⁰.

1988), në “Table Ronde Balkanique” (Bansko, Bullgari, 1995), në Kongresin VI të EURALEX-it (Amsterdam, 1994), në Koferencën shkencore kushtuar A. Desnickajas (Sankt-Peterburg, 1995), në Konferencat albanologjike (Tiranë, I 1962, II 1968), në Kongresin e drejtshkrimit të gjuhës shipe (edhe si delegat, 1972), në koferencën shkencore “Gjuha letrare shqipe dhe bota shqiptare”, 1992, si dhe në shumë konferenca, simpoziume e sesione shkencore të tjera në Prishtinë, në Tiranë e në rrethe për çështje të ndryshme të gjuhës shqipe, për leksikun e frazeologjinë shqipe etj.; ligjërata shkencore në Vjenë, Sankt-Peterburg, Prishtinë, Shkup etj.

⁷ *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, 1980, 2270 faqe (bashkëhartues e bashkëredaktor); *Fjalor i shqipes së sotme*, 1984, 1700 faqe (bashkëhartues e bashkëredaktor); *Fjalor i shqipes së sotme*, 2002, 1580 faqe (bashkëripunues e redaktor i përgjithshëm); *Për pastërtinë e gjuhës shqipe (Fjalor)*, 1998, 188 faqe (bashkëhartues e bashkëredaktor); *Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe*, 1999, 1170 faqe (me një studim hyrës prej 61 faqesh); *Fjalor frazeologjik ballkanik (në pesë gjuhë: shqip-bullgarisht-greqisht-rumanisht-serbokroatisht)*, 1999, 351 faqe (drejtues shkencor i projektit, bashkëhartues dhe redaktor shkencor); *Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe*, 2004, 1084 faqe (drejtues shkencor i projektit, bashkëhartues dhe redaktor shkencor); *Fjalor i gjuhës shqipe*, 2006, 1250 faqe (drejtues shkencor i projektit, bashkëhartues dhe redaktor shkencor); *Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe*, 2010, 646 (autor) etj. Kishte filluar puna për hartimin e *Fjalorit të madh të gjuhës shqipe* në 5 vëllim (drejtues shkencor i projektit, bashkëhartues e kryeredaktor), por tash është ndërprerë.

⁸ *Leksikologjia*, 1960, 79 faqe; *Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe*, 1981, 330 faqe; *Leksikologjia e gjuhës shqipe* (1981, 1984, 1999, 2002, 2004, 2005), 2006, 364 faqe; *Leksikologjia shqipe për shkollat e larta*, 1961, 103 faqe; Prishtinë, 1971, 117 faqe; *Leksikologjia shqipe për shkollat e larta*, 1974, 249 faqe; Prishtinë, 1978, 200 faqe; *Libri i gjuhës shqipe 3 (për shkollat e mesme)*, 1983, 110 faqe; *Prejardhja semantike në gjuhën shqipe*, 1989, 340 faqe; *Teksti dhe gjuha*, 1992, 200 faqe; *Semasiologjia leksikore*, 1997, 100 faqe; *Leksiku dialektor e krahinor në gjuhën shqipe*, 2001, 323 faqe; *Veçori leksiko-semantike të ndajfoljeve me prapashtesa në gjuhën shqipe*, 2004, 243 faqe; *Prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe (Semantikë leksikore)*, 2009, 318 faqe.

⁹ *E folmja e katundit Seman (Fonetikë. Morfologji. Sintaksë. Leksik. Tekste)*, BUShT, Seria Shkencat shoqërore, 1961, 3, faqe 155-192; 4, faqe 134-159; *Çështje të identitetit të njësive frazeologjike dhe frazeografia*, 1995, 125 faqe; *Frazeologjia popullore në veprën letrare të A. Z. Çajupit*, 1962 (dorëshkrim), 170 faqe.

¹⁰ *Fjalor enciklopedik shqiptar*, 1985 (hartimi i 9 i zërave për leksikologjinë e për leksikografinë shqipe, për gjuhëtarë etj.); *Fjalor enciklopedik shqiptar*, 2008-2009 (hartimi ose rihartimi i 10 zërave).

II. LEKSIKOGRAFI E LEKSIKOLOGJI

Kontributi i Profesor Jani Thomajt në fushë të albanologjisë, identifikohet me ato arritje kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat i ka shënuar në fushë të leksikografisë, leksikologjisë¹¹ dhe frazeografisë e frazeologjisë. Një studim për jetën dhe veprën shkencore të tij prandaj do të thoshte studim mbi kontributin e tij në fushë të leksikografisë dhe frazeologjisë, si dhe tipologjisë brenda tyre. E kjo do të thotë vlerësimi i kontributeve të tij në përmasa kohore, në vlerësimin e diskutimeve të tij në shtigjet e punës individuale dhe kolektive e institucionale në kapërcyell të zhvillimeve shumë të rëndësishme gjuhësore e shkencore të shoqërisë shqiptare, sikur janë studimet e tij mbi mënyrën e pasqyrimin të sistemit të kuptimeve dhe të përdorimit të fjalëve në fjalorin shpjegues të gjuhës shqipe, në gjurmët e fjalës shqipe, mbi çështje të leksikut potencial në gjuhën shqipe, për lëvizjen në leksikun e gjuhës shqipe në kushte të reja social-politike etj¹².

Një pjesëmarrje e tij në të gjitha fushat e dijes albanologjike, që mbulonte leksiku, nënkuptonte edhe angazhimin e tij në disa nga aspektet themelore të dijes akademike shqiptare që kishin të bënin me leksikun dhe normën, në kuptimin që dija e asaj kohe kërkonte për të përmbyllur disa nga veprat normative kombëtare, sikur ishin: fjalori dhe gramatika, e përtej tyre shqipja standarde¹³, ndërsa brenda tyre edhe disa nga aspektet speciale të vlerave të tyre, sikur është terminologjia¹⁴.

Përtej kërkimeve shkencore për aspekte të caktuara të leksikografisë dhe leksikologjisë Profesor Jani Thomai, në autorësi vetjake apo bashkautorësi ka ngritur përmendoren personale dhe kombëtare të shqipes me veprat e rëndësishme shkencore, siç është Leksiku dialektor e krahinor (2001), apo vepra fundamentale të shqipes, siç janë: Fjalor i gjuhës së sotme shqipe (1980), Fjalor i shqipes së sotme (1984 e 2002) dhe Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe (2004). Nëse vepra e parë shënon një vëllim jo shumë të zakonshëm të studimeve leksikologjike dhe

¹¹ Kapitulli për kontributin e Profesor Jani Thomait në fushë të leksikografisë dhe leksikologjisë si dhe pjesërisht ai për frazeologjinë dhe frazeografinë janë vënë vetëm në funksion të bibliografisë së pasur të tij, pasi në këtë konferencë janë trajtuar gjerësisht nga studiues të tjerë.

¹² Shih: studimet në fushë të **leksikologjisë**: Mbi mënyrën e pasqyrimin të sistemit të kuptimeve dhe të përdorimit të fjalëve në fjalorin shpjegues të gjuhës shqipe, SF, 1964, 4, f. 201-214; Studime mbi leksikun..., 1972, II, f. 129-139; Në gjurmët e fjalës shqipe, GjJ, 1983, 1, f. 28-37; Çështje të leksikut potencial në gjuhën shqipe, GjJ, 1986, 2, f. 5-16; Lëvizje në leksikun e gjuhës shqipe në kushte të reja social-politike, "Shqyrtime albanologjike", Shkup, 2000, 6, f. 51-60.

¹³ Shih: studimet në fushë të **gramatikës dhe leksikut**: Mbi evolucionin tipologjik të strukturës morfologjike e të formimit të fjalëve në gjuhën shqipe, Shkup, "Jehona", 1994, 6-7, f. 3-23; Ndajfoljet me prapashtesën **-shëm** në gjuhën shqipe, SF, 1989, 4, f. 18-37; Ndajfoljet me prapashtesën **-thi** në gjuhën shqipe, SF, 2, 1990, f. 59-71; Ndajfoljet me prapashtesën **-as/-azi** në gjuhën shqipe, SF, 1991, 2, f. 79-100; Ndajfoljet me prapashtesën **-isht** në gjuhën e sotme shqipe, SF, 1992, 1, f. 71-96; GjJ, 1991, 1, f. 23-34 etj.

¹⁴ Shih: studimet në fushë të terminologjia islame dhe leksikografia shqiptare: "Islamizmi dhe bota shqiptare", 1993, 42-53; Terminologjia islame dhe leksikografia shqiptare, "Feja, kultura dhe tradita islame ndër shqiptarët", Prishtinë, 1995, f. 309-317

leksikografike, veprat e tjera, pra fjalorët shënojnë arritjet më të larta të dijes akademike shqiptare, prandaj është e kuptueshme pse pavarësisht kritikave të kohëpaskohshme, dija e sotme albanologjike në Prishtinë dhe në Tiranë ende nuk po arrin t'i tejkalojë.

Në këtë rrjedhë, ndonëse të një formati dhe të një angazhimi tjetër janë edhe artikujt e tij, që në një mënyrë apo në një tjetër e bëjnë popullarizimin e leksikografisë dhe leksikologjisë shqiptare, si dije dhe si paradigmë e shoqërisë moderne shqiptare¹⁵.

Po t'i qasemi kronologjisë hulumtuese shkencore të profesor Jani Thomait¹⁶, nuk do të ishte vështirë të shohim përmasën shkencore të paraqitjes së tij në konferencat shkencore dhe sidomos fushat e temat e trajtimit. Prej titujve të kumtesave dhe prej nivelit të trajtimit të tyre nuk është vështirë të kuptohet përgjegjësia e tij shkencore dhe obligimet e tij profesionale e institucionale. Në qoftë se në takime të niveleve edukative e arsimore ai diskutonte kryesisht aspekte të shqipes standarde, nëse në gazeta ditore e letrare shkruante kryesisht për përmasën e zbatimit të shqipes letrare, në konferenca akademike vendore, rajonale e më gjerë, Jani Thomai shkruante, diskutonte e lexonte kumtesa për të cilat konsiderohej kompetent dhe përgjegjës në

¹⁵ Shih: tekstet për popullarizimin e kërkimeve në fushë të leksikografisë e leksikologjisë: *Seminar vjetor i Sektorit të leksikologjisë e leksikografisë*, BUSHt, Seria Shkencat shoqërore, 1961, 4, f. 189-191; *Frazeologjia – pasuri e madhe leksikore e gjuhës*, “Mësuesi”, 19,04,1963; *Seminar me mbledhësit e leksikut të shqipes*, “Mësuesi”, 23.04.1963; *Për mbledhjen e fjalëve e të shprehjeve nga goja e popullit*, “Mësuesi”, 10.06.1966; *Në të gjithë vendin tonë u ngritën rrethe shkencore të arsimtarëve për kërkime historike e filologjike*, SF, 1967, 1, f. 184-185; *Udhëzues për mbledhjen e leksikut, të frazeologjisë shqipe dhe të onomastikës shqiptare* (me bashkautorë), 1967; 1974, 17 faqe; *Suksese të leksikologjisë shqiptare*, “Zëri i popullit”, 09.05.1970.

¹⁶ *Probleme të frazeologjisë së gjuhës shqipe*, SF (revista “Studime filologjike”), 1964, 2, f. 69-94; “Jehona”, Shkup, 1971, 9, f. 55-99; “Studime mbi leksikun...”, 1972, I, f. 345-382; *Probleme të strukturës formale dhe të klasifikimit të frazeologjizmave të gjuhës shqipe*, SF, 1964, 3, f. 55-72; *Mbi rendin e fjalëve në strukturën e frazeologjizmave të shqipes*, SF, 1966, 1, f. 151-161; *Studime mbi leksikun...*, 1972, I, f. 385-394; *Aspekti shoqëror-kulturor në formimin e frazeologjisë shqipe*, SF, 1975, 3, f. 111-18; SA, 1975, 2, f. 117-128; *Çështje të formës së njësive frazeologjike*, Prishtinë, revista “Studime albanologjike”, 1977, 1, f. 113-124; *Probleme të strukturës së frazeologjisë shqipe*, “Gjuha shqipe dhe letërsia në shkollë”, 1980, 6, f. 100-110; *Veçori të përdorimit të frazeologjisë së gjuhës shqipe*, GjJ (revista “Gjuha jonë”), 1981, 2, f. 51-58; *Çështje të identitetit të njësive frazeologjike*, SF, 1995, 1-4, f. 31-34; *Frazeologjia dhe frazeografia shqiptare*, “Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare”, 2001, f. 85-99; *La phraséologie et la phraséographie albanaise*, SA, 2001, 1, f. 89-103; *Leksikografia shqipe – trashëgimi dhe perspektivë*, “Leksikografia shqipe – trashëgimi dhe perspektivë”, 2005, f. 11-25; *Leksikografia shqipe drejt objektivash madhorë: Fjalori madh i gjuhës shqipe*, “Seminar ndërkombëtar i albanologjisë”, Shkup, 2008, f. 45-57; *Zhvillime të ardhme në leksikografinë shqipe*, “Kërkime universitare”, nr. 22, Gjirokastër, 2009, f. 115-120; *Leksikologjia shqipe – arritje dhe probleme*, “Studime filologjike shqiptare”, Prishtinë, 2007, f. 121-135; *Vëzhgime mbi frazeologjizmat e gjuhës shqipe*, “Konferenca I e studimeve albanologjike”, 1965, f. 168-175 etj.

shkallë kombëtare, ballkanike e më gjerë, e këto janë kumtesat që trajtonin fushën e leksikografisë, të leksikologjisë dhe të frazeologjisë¹⁷.

Në bibliografinë e tij shkencore kumtesa, e cila i prin këtij domeni, është Mbi shpërndarjen e gjymtyrëve të frazeologjizmave të shqipes në fjali¹⁸, paraqitur në Kuvendin e Parë të Studimeve Albanologjike në Tiranë. Më 2-5 nëntor 1964; në të, veç tjerash, shtronte problemin e marrëdhënieve në mes veçorisë semantike dhe asaj gramatikore të frazeologjizmave të shqipes. Në këtë kumtesë profesor Thomai arrin në konstatimin se tipari thelbësor i frazeologjizmave gjuhësorë është uniteti semantik, por jo i pakushtëzuar, përkundrazi, i kushtëzuar nga funksioni gramatikor i togfjalëshit. "Shpërndarja e gjymtyrëve të këtij brenda një fjalie, - shprehet më në fund mjeshtri ynë, - nuk sjell shpërbërjen e frazeologjizmit semantikisht, ndërsa shpërndarja e tyre në fjali të ndryshme sjell shpërbërjen e frazeologjizmit edhe semantikisht".

Edhe në kumtesën Frazeologjia shqipe dhe detyrat e mbledhësit¹⁹, lexuar në "Seminarin e tetë kombëtar me mbledhësit e leksikut, të frazeologjisë dhe të onomastikës shqiptare", trajton një sërë çështjesh teorike që kanë të bëjnë me përcaktimin e frazeologjizmave, me vendin që ata zënë midis togfjalëshave të qëndrueshëm dhe shtrirjen e tyre në gjuhën shqipe. Më hollësisht autori ynë flet për llojet e frazeologjizmave e veçoritë e tyre dalluese. Gjithashtu, ai flet edhe për pasurinë e madhe frazeologjike të gjuhës shqipe dhe jep udhëzime mbi mënyrën e mbledhjes e të regjistrimit të tyre²⁰.

Në prag të përgatitjeve që bëheshin për hartimin e një fjalori të ri të shqipes prej 55-60.000 fjalësh²¹, profesor Jani Thomai botoi një studim mbi baza krejtësisht teorike, historike, përgjithësuese e praktike, në fushë të frazeologjisë së gjuhës shqipe. Ky studim, *Probleme të frazeologjisë së gjuhës shqipe*²², sikur shprehej mjeshtri ynë, kishte për objekt "ata togfjalësha të qëndrueshëm të formuar historikisht, që nga ana kuptimore janë ekuivalentë me një fjalë të vetme dhe, sikur fjala, shprehin nocione, d.m.th. karakterizohen nga funksioni emërtonjës"²³. Në të vërtetë, përfundonte konceptin e tij rreth kësaj teme profesor Thomai, këta togfjalësha përbëjnë frazeologjinë e gjuhës.

¹⁷ Shih: Mbi mënyrën e pasqyrimin të sistemit të kuptimeve dhe të përdorimit të fjalëve në fjalorin shpjegues të gjuhës shqipe, SF, 1964, 4, f. 201-214; Studime mbi leksikun..., 1972, II, f. 129-139; Në gjurmët e fjalës shqipe, GjJ, 1983, 1, f. 28-37; Çështje të leksikut potencial në gjuhën shqipe, GjJ, 1986, 2, f. 5-16; Lëvizje në leksikun e gjuhës shqipe në kushte të reja social-politike, "Shqyrtime albanologjike", Shkup, 2000, 6, f. 51-60

¹⁸ Mbi shpërndarjen e gjymtyrëve të frazeologjizmave të shqipes në fjali, *Studime filologjike*, 4/1964: 251.

¹⁹ *Frazeologjia shqipe dhe detyrat e mbledhësit*, SF, 2, 1968, f. 196.

²⁰ *Spektori i leksikologjisë dhe leksikografisë i Institutit të Historisë dhe të Gjuhësisë në Tiranë*, më 4. 6. 1968; shih SF, 2, 1968, f. 196.

²¹ Shih: Xh. Lloshi, Diskutim i parimeve të zgjedhjes së fjalëve për "Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe", SF, 4, 1964, f. 259-260.

²² *Probleme të frazeologjisë së gjuhës shqipe*, SF, 2, 1964, f. 69-94.

²³ SF, 2, 1964, f. 69.

Në mbështetje të këtij studimi themeltar edhe për studimet përgjithësisht në këtë fushë, profesor Jani Thomai, një bazë të gjerë leksikore të vjelë nga botimet e hershme të letrave shqipe (*Meshari*), deri te botimet e kohës (libra, gazeta, revista etj.), por duke u dhënë vendin parësor botimeve në fushë të frazeologjisë në dy shekujt e fundit. Po në këtë rrjedhë ai ka identifikuar e ka komentuar edhe dijen e atëhershme në fushë të studimeve leksikore e sidomos frazeologjike, duke filluar me studimin e Aleksandër Xhuvanit, "*Mbi thjeshtësinë e gjuhës*" (1921), në të cilin për herë të parë përkufizohen teorikisht togfjalëshat frazeologjikë, për të vazhduar me artikullin e Nonda Bulkës "*Frazeologjia shqipe (lokucionet) në veprën e Naim Frashërit "Histori e Skënderbeut"*", në të cilën trajtohet funksioni letrar e artistik i disa lokucioneve. Autori ka veçuar për kërkimet e thella në fushë të frazeologjisë edhe studiuesin Mehmet Çeliku²⁴ për kontributin e tij në studimin e dalluar të togfjalëshave si njësi gramatikore e si njësi leksikore.

Një kërkim të vëmendshëm autori i ka bërë gjendjes së studimeve të deritanishme në fushë të frazeologjisë, brenda gramatikave normative a dialektore, fjalorëve dhe artikujve të tjerë përgjithësues. Në këtë aspekt ai ka pasqyruar gjendjen e studimeve të kësaj pasurie gjuhësore në tekstin "*Leksikologjia shqipe*" (1961), në të cilin "kjo dije është parë në kontekst të kërkesave universitare, e kjo do të thotë se janë sjellë për nevoja të dijes studentore ata përbërës elementarë të frazeologjisë, të cilët janë të domosdoshëm për dijen mësimore të kohës: koncepti mbi frazeologjinë, kufijtë kërkimorë të saj, struktura e togfjalëshit, aspektet semantike e formale të tyre etj.

Në studimin sintetizues të tij për frazeologjizmat profesor Jani Thomai ka sjellë përmasën e pranisë së strukturave frazeologjike në gramatikën e Ilia Dilo Sheperit (1927), të Kostaq Cipos (1949), të Justin Rrotës (1942), të Mahir Domit (1957) dhe të Stefan Priftit (1962), si edhe në fjalorët e Francesko Rosit, të Jak Junikut, të A. Dozonit, të Gustav Vaigandit, të F. Kordinjanos, të G. Hahnit, të Don Nikë Gazullit, të Angjelo Leotit, të Kostandin Kristoforidhit dhe të "*Fjalorit të gjuhës shqipe*" (1954). Në vlerësimin e tij teorik e praktik profesor Jani Thomai i ka bërë një kritikë të hollë sidomos paraqitjes së frazeologjizmave në fjalorët dygjuhësorë, por pa lënë anash edhe fjalorët njëgjuhësorë, duke përfshirë këtu edhe fjalorin e atëhershëm të shqipes (1954).

Pasi ka shfrytëzuar gjithë përvojën historiko-gjuhësore të studimeve albanologjike në fushë të frazeologjisë, mjeshtri ynë ka marrë përsipër të pasqyrojë përvojën ndërkombëtare të linguistëve në këtë fushë, e cila, sikur thuhet që në fillim, as nuk është e përmbyllur si dije, as nuk është unike. Kjo është arsyeja pse në këtë studim autori sjell njëkohësisht edhe një sintezë për konceptet teorike e praktike të frazeologjizmave që njeh shkolla e kohës, duke filluar nga nocioni themelor: "frazeologji-a", deri te nocionet, termat, parimet gramatikore e stilistike, sikur janë: "frazeologji e gjuhës" (bashkime fjalësh, togfjalësh), "frazeologjizëm" (bashkim i lirë i fjalëve), grup frazeologjik", "njësi frazeologjike", "unitet frazeologjik", "togfjalësh frazeologjik" (bashkime të qëndrueshme fjalësh), si dhe tiparet thelbësore të frazeologjizmave, si uniteti

²⁴ Shih: *Togfjalëshat e qëndrueshëm foljorë në shqipen e sotme*, BUSHT, Sshsh, II, 1962, f. 194.

semantik (Ozhegov). Brenda këtij kapitulli janë trajtuar edhe karakteri figurativ i komponentes përbërëse të frazeologjizmave, motivimi ose mungesa e motivimit, shkalla e humbjes së pavarësisë dhe e ngurosjes së elementeve përbërëse të frazeologjizmit etj.

Në fund profesor Jani Thomai i kthehet edhe një herë korpusit të frazeologjizmave të shqipes, duke e ngritur njëkohësisht edhe paradigmen teorike të studimit, tash jo strukturën gramatikore të tyre, paraqitjen leksikografike brenda dijes albanologjike, a konceptet teorike gjuhësore të dijes së lingvistëve të kohës (kryesisht brenda shkollës ruse, italiane e franceze të kohës), por ekuivalencën semantike të fjalës, një rrafsh teorik e pragmatik i kërkimit, i cili edhe sot nuk i ka përmbushur nevojat e gjurmimit dhe të studimit të lakmuar në gjuhësinë shqiptare.

Kjo është arsyeja pse, sikur e ka theksuar që në fillim autori ynë, brenda këtij studimi jo vetëm nuk mund të thuhet të gjitha, por pas më shumë se tri dekadash të botimit të tij, sot mund të themi se ky studim edhe sot përbën bazën e një monografie shteruese në këtë fushë dhe sigurisht kjo është arsyeja pse në referencën e parë të një studimi tjetër thelles dhe tëhollues për "*Probleme të strukturës formale dhe të klasifikimit të frazeologjizmave të gjuhës shqipe*", do të theksojë: "me probleme të karakterit të përgjithshëm dhe të strukturës semantike të frazeologjizmave të shqipes jemi marrë në një punim tjetër" (SF, 3, 1964, f. 55) dhe sigurisht nuk është e rastit pse në botimin e vëllimit të parë të *SLFFGJSH* këto dy studime na dalin të bashkuar, me shënimin: shih "Studime filologjike", 1964, nr. 2, 3²⁵.

Studimi "*Probleme të strukturës formale dhe të klasifikimit të frazeologjizmave të gjuhës shqipe*"²⁶ paraqet një prej kërkimeve të rëndësishme të kësaj periudhe shumë aktive të profesor Jani Thomait. Është koha kur me dijen teorike që zotëron, me materialin e terrenit e të atij libror që vjel dhe me sintezat që nis të bëjë, vë themelet e pothuajse të gjitha veprave kapitale që do të shkruajë më vonë.

Në këtë studim janë trajtuar komponentët vendimtare që luajnë rol në ndërtimin e frazeologjizmave të shqipes, e ato, sipas autorit, janë: struktura formale, kategoria leksiko-gramatikore e komponentëve, forma e tyre gramatikore, karakteri i marrëdhënieve sintaktike, elementet leksiko-gramatikore arkaike, fjalët shërbyese etj. Në këtë strukturë, sipas autorit, rendi i fjalëve përgjithësisht nuk lot rol kuptimdalles²⁷.

Mbështetur në korpusin e gjertanishëm të frazeologjizmave letrarë e popullorë, profesor Jani Thomai arrin në disa përfundime të veçuara të fjalësit të shqipes dhe në disa struktura

²⁵ Shih, Jani Thomai, *Probleme të frazeologjisë së gjuhës shqipe*, *SLFFGJSH I*, USHT-IGJL, Tiranë, 1972, f. 345-383. Nt: I. Probleme të karakterit të përgjithshëm (356-363); II. Probleme të përmbajtjes (363-367); III. Probleme të formës (367-381); IV. Përfundime (381-382). Fusnota: 43. Résumé: Questions de phraséologie albanaise (383).

²⁶ *Probleme të strukturës formale dhe të klasifikimit të frazeologjizmave të gjuhës shqipe*, SF, 3, 1964, f. 55-74.

²⁷ *Probleme të strukturës formale dhe të klasifikimit të frazeologjizmave të gjuhës shqipe*, SF, 3, 1964, f. 55.

përgjithësuese edhe të gjuhëve të tjera. Fjala është për përftimin e zakonshëm të frazeologjizmave nga krahasimi, përmes metaforës në leksikalizim etj., të cilat ndodhin përgjithësisht edhe në gjuhë të tjera, si dhe për modele të tjera gramatikore, letrare, leksikore e semantike të përftimit të frazeologjizmave në gjuhën shqipe: përmes lidhëzës krahasuese; mbi bazën e hiperbolës; nga një folje me kuptim të përgjithshëm dhe një emër foljor i dalë prej një foljeje tjetër etj.

Një shtrirje të gjerë duket të kenë edhe strukturat semantiko-formale, për të cilat është bërë një tipologji gjithëpërfshirëse, si edhe strukturat gramatikore për të cilat është bërë një tipologji mjaft shtruese, duke i dhënë ndonjëherë studimit edhe karakter referues dialektor, letrarohistorik, e kjo do të thotë edhe përmasën diakronike të kërkimit.

Mbështetur në arritjet e kohës dhe në kontributin e tij, mund të thuhet se mjeshtri ynë nga materialet që ka pasur në dorë e që janë parashtruar pjesërisht në studimet e tij, del se tipat më të pasur e më produktivë në shqipen janë frazeologjizmat e formuar nga transformimi figurativ i togfjalëshave të lirë nga pikëpamja e formës së brendshme, frazeologjizmat folje + emër nga pikëpamja e formës së jashtme dhe njësitë frazeologjike mbiemërore nga pikëpamja e klasifikimit të përgjithshëm të frazeologjizmave të gjuhës shqipe. Por të pasura janë edhe kategoritë ndajfoljore, formimet me përsëritjen e së njëjtës fjalë ose të dy fjalëve të së njëjtës kategori leksiko-gramatikore, tipi i formuar nga shkrirja semantike e një fjale në kuptim figurativ me një fjalë në kuptim të drejtpërdrejtë, d.m.th. bashkimet frazeologjike. Frazeologjizmat emërorë e mbiemërorë, formimet fjalë me kuptim figurativ + fjalë me kuptim figurativ, konstruktet me komponentë joverbalë dhe idiomat në klasifikimin e përgjithshëm nuk janë aq të pasur e karakteristike në gjuhën shqipe.²⁸

Kërkimet e tij kur të caktuara e kur të karakterit frazeologjik e frazografik²⁹ profesor Jani Thomai i ka realizuar edhe në vepra të karakterit monografik: Fjalor frazeologjik ballkanik (1999), Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe” (1999), Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe (1981) etj.

Vëllimi monografik Çështje të frazeologjisë shqipe³⁰, praqet një nga kontributet e para të këtij lloji në studimet albanologjike. Vëllimi ka një strukturë prej katër tërësish, megjithëse pjesa e parë do të mund të quhej një hyrje e zgjeruar dhe pjesa e fundit një përfundim i zgjeruar.

²⁸ Shih, "Probleme të strukturës formale dhe të klasifikimit të frazeologjizmave të gjuhës shqipe" (SF 3/1964: 71-72).

²⁹ Një klasifikim i frazeologjizmave me vlerë ndajfoljore në shqipen e sotme, SF, 1969, 1, f. 3-44; Studime mbi leksikun..., 1972, I, 397-434; Grupe fjalësh të lidhura me frazeologjizma, SF, 1975, 2, f. 37-48; SA, 1976, 1, f. 185-210; Prishtinë, "Përparimi", 1980, 4, f. 461-476; Grupe fjalësh të bashkëlidhura me frazeologjizma në gjuhën shqipe, Prishtinë, "Përparimi", 1980, 4, f. 461-476; Frazeologjizma emërorë dhe mbiemëror në gjuhën shqipe, SF, 1975, 4, f. 67-76; Frazeologjizma foljorë në gjuhën shqipe, SF, 1976, 1, f. 89-118;

³⁰ ASH e RPSSH, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 1981, f. 331.

Fillimisht në këtë vëllim trajtohen çështje të karakterit të përgjithshëm, çështje të përmbajtjes, çështje të formës dhe mbi rendin e fjalëve në strukturën e njësive frazeologjike të gjuhës shqipe.

Boshtin kryesor të këtij vëllimi ndërkaq e përbëjnë tri tërësi të klasifikimit të frazeologjisë së gjuhës shqipe. Klasifikimi sipas strukturës: njësi frazeologjike me strukturë togfjalëshi, dhe njësi frazeologjike me strukturë fjalie; klasifikimi sipas vlerës leksiko-gramatikore: njësi frazeologjike me vlerë emërore, me vlerë mbiemërore, foljore dhe ndajfoljore; si dhe klasifikimi sipas shkallës së motivit.

Kapitull më vete në këtë vepër paraqet studimi krahasues – historik i frazeologjisë së gjuhës shqipe. Janë vendosur këtu temat e mëdha kur të trajtuara më parë e kur të ngritura në shkallë monografie më vonë për grupe fjalësh të bashkëlidhura në njësi frazeologjike, për historikun e formimit të disa njësive frazeologjike të gjuhës shqipe, për disa togje të qëndrueshme të shqipes së shekullit XVI në krahasim me shqipen e sotme, si dhe për disa paralele frazeologjike të gjuhës shqipe me gjuhët e tjera të Ballkanit.

Ndonëse të karakterit gjithëpërfshirës, edhe përfundimet e gjera të sjella në këtë vëllim janë me interes. E vërteta më parë se sa me probleme të karakterit monografik, problemet ngjajnë të karakterit referencial: njësia frazeologjike dhe frazeologjia gjuhësore, rreth përdorimit të njësive frazeologjike në ligjërim, rreth “tipit” dhe “gjedhes” në frazeologji, mikrokonteksti frazeologjik, rreth trajtimit leksikografik të frazeologjisë gjuhësore, çështje të përgjithshme etj.

Duke vazhduar trajtimin e vendit të frazeologjizmave në fjalorin e shqipes dhe në fjalorë të fushave të tjera, Profesor Jani Thomai në studimet e tij e ka parë atë edhe në funksionin gramatikor të saj. Fjalën e kemi për ato studime, brenda të cilave është bërë klasifikimi i frazeologjizmave me vlerë ndajfoljore në shqipen e sotme, apo studimi për grupet e fjalëve të lidhura me frazeologjizma, frazeologjizmat emërorë dhe mbiemëror, frazeologjizmat foljorë etj., me të cilat ai ka përcaktuar disa nga përmasat e veçanta të vendit të frazeologjizmave jo vetëm si kuptime letrare por edhe si struktura gramatikore³¹.

Përtej kërkimeve, diskutimeve dhe studimeve shumëdimensionale në fushë të frazeologjisë, Profesor Jani Thomai misionin e tij në fushë të albanologjisë e ka realizuar me dy vepra të përmasave kombëtare: Fjalor frazeologjik ballkanik” (1999) dhe sidomos veprën Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe” (1999). Si në vëllimin e parë (bashkautor) ashtu edhe në vëllimin e dytë mjeshtri ynë ka realizuar parametra kombëtar dhe ndërkombëtar të shqipes si zhvillim i brendshëm dhe si komunikim ndërgjuhësor, të cilat nuk kemi arritur deri në kohën tonë.

³¹ **Frazeologjia dhe gramatika:** Një klasifikim i frazeologjizmave me vlerë ndajfoljore në shqipen e sotme, SF, 1969, 1, f. 3-44; Studime mbi leksikun..., 1972, I, 397-434; Grupe fjalësh të lidhura me frazeologjizma, SF, 1975, 2, f. 37-48; SA, 1976, 1, f. 185-210; Prishtinë, “Përparimi”, 1980, 4, f. 461-476; Grupe fjalësh të bashkëlidhura me frazeologjizma në gjuhën shqipe, Prishtinë, “Përparimi”, 1980, 4, f. 461-476; Frazeologjizma emërorë dhe mbiemëror në gjuhën shqipe, SF, 1975, 4, f. 67-76; Frazeologjizma foljorë në gjuhën shqipe, SF, 1976, 1, f. 89-118;

III. SEMANTIKË E SEMIOLOGJI

1. Prejardhja semantike në gjuhën shqipe

Në studimet albanologjike në përgjithësi dhe në studimet leksikografike në veçanti, kërkimet semantike dhe semasiologjike të Profesor Jani Thomait zënë një korpus të rëndësishëm jo vetëm të punës së tij po gjithë linguistikës shqiptare. Nëse veprat e këtij krahu të Profesor Shefki Sejdiut për probleme të caktuara të gjuhësisë shqiptare dhe ballkanike e mesdhetare hapin procese të reja në fushë të teorisë dhe metodologjisë së kërkimit, nëse veprat dhe studimet e Profesor Zenun Gjocajt përmbledhin disa nga veçorit të e caktuara të gjuhësisë shqiptare në fushë të frazeologjizmave, vepra shkencore, sintetike dhe strukturore e Profesor Jani Thomait, përmbledh pjesën më të madhe të nevojës dhe dijes albanologjike në këtë fushë, duke filluar nga njësia leksikore për të arrirë te frazeologjia³² dhe nga njësia më e vogël gramatikore për të arrirë te struktura gramatikore dhe semantike e njësisë krahasuese të shqipes me gjuhë të tjera³³.

Pas një varg studimesh të botuar vite me parë, Profesor Thomai botoi një sintezë të parë të kësaj fushe, veprën Prejardhja semantike në gjuhën shqipe³⁴, në të cilën për herë të parë në gjuhësinë shqiptare, në përmasa të një sinteze të rëndësishme, pasqyroi gjithë pasurinë kuptimore të fjalësit të shqipes. Vepra ndahet në katër pjesë, ndërsa kapitulli i V, është një sintezë e gjerë e përfundimeve të tij, mbi problemet dhe detyrat e dijes mbi semantikën leksikografike shqiptare. Duke qenë një tekst studimor që më vonë do të marrë edhe dimensionin e përdorimit universitar si lëndë e obligueshme, në shumë aspekte, kjo vepër merr edhe karakter normativ.

Vepra hapet me kapitullin mbi konceptet themelore të semantikës dhe semiologjisë, duke i parë ato në kontekst të leksikut të gjuhës shqipe dhe shkencës mbi kuptimin. Duke qenë vepra e parë e kësaj natyre, është me shumë interes që në këtë kapitull janë trajtuar me korrektësi disa nga nocionet, termat dhe domethëniet e tyre brenda dijes së leksikografisë si tërësi dhe leksikografisë shqiptare në veçanti. Fjala është për problemet që kanë të bëjnë me konceptet themelore të semantikës leksikore, metodat e analizës semiologjike, njësinë themelore të kuptimit leksikor, teorinë e fushave semantike, ngjyrimin emocional të fjalëve dhe sistemin konceptual të analizës semantike.

³² Disa tipare e mjete dalluese stilistike të gjuhës së artikuluar kryesore të “Zërit të popullit” dhe të disa shkrimeve të tjera të viteve 1942-1944, Studime filologjike, 1974, 4, f. 135-142; Tipat themelore të derivacionit semantik në gjuhën shqipe, SF, 1981, 3, f. 87-101; Rreth polisemisë e homonimisë në gjuhën shqipe, SF, 1981, 4, f. 9-43; Formimi i fjalëve dhe prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe, SF, 1983, 2, f. 53-87; ; Rreth përmbajtjes leksikore të fjalëve në gjuhën shqipe, “Lëndët shoqërore në shkollë”, 1989, 17, f. 34-45; Rreth vlerave të fjalëve në gjuhën shqipe, GjJ, 1989, 2, f. 18-31; Dukuri të leksikut në shtypin pluralist të sotëm, “Gjuha letrare shqipe dhe bota shqiptare”, 1993, f. 103-112; Sinonimet në fjalorin frazeologjik të shqipes, “Seminari XVIII ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare”, Prishtinë, 1996, f. 315-322; Identiteti i fjalës dhe variantet e saj fono-grafike në gjuhën shqipe, “Konsulta gjuhësore e Prishtinës (1968), Prishtinë, 2008, f. 87-97.

³³ Rreth metodës së analizës së tekstit, “Revista pedagogjike”, 1984, 2, f. 3-36;

³⁴ ASH e RPSSH - IGJL, Tiranë, 1989, f. 340.

Brenda kapitullit të dytë trajtohen lëvizjet kuptimore brenda fjalës, në të vërtetë, janë diskutuar tipat e prejardhjes semantike në gjuhën shqipe. Fjala është për temat e rëndësishme që kanë të bëjnë me strukturën kuptimore të fjalës në gjuhën shqipe, përbërësit e kuptimit leksikor, tipat e prejardhjes kuptimore, analizën semantike të emrave të lëndës, lëvizjet semantike të kushtëzuara stilistikisht, shkallët e shndërrimeve kuptimore dhe zgjerimin e strukturës kuptimore të fjalëve.

Një kapitull më vete paraqesin temat e kalimit nga njësia semantike në njësi leksikore, e kjo do të thotë problemet e lidhjes polisemi – homonimi. Janë trajtuar këtu me kompetencë dhe me interes disa nga çështjet e lidhjes polisemi – homonimi, tipat e homonimeve në gjuhën shqipe, dallimet ndërmjet polisemisë dhe homonimisë dhe shkallëzimi i prejardhjes semantike.

Duke u përpjekur që të përfshijë gjithë përmasën e kërkimeve semantike dhe semasiologjike të lëvizjes kuptimore brenda çerdhes së fjalës, mjeshtri ynë hap një kapitull të ri mbi formimin e fjalëve dhe prejardhjes semantike në gjuhën shqipe. Brenda tij diskutohen nga aspekti teorik dhe praktik disa nga problemet që lidhen drejtpërdrejtë me lidhjet sintagmatike dhe grupet paradigmatiche, me përputhjet e strukturave semantike të fjalëve të një çerdheje, me modelet e formimit të fjalëve në gjuhën shqipe, me llojet e ndryshimeve semantike gjatë formimit të fjalëve, me lëvizjet semantike gjatë formimit të fjalëve dhe më në fund, me specializimin kuptimor të ndajshesave në gjuhën shqipe.

Libri mbyllet me detyrat dhe problemet që i dalin semantikës dhe sidomos semasiologjisë shqiptare, e cila prej autorit tonë me të drejtë konsiderohet zemra e leksikografisë shqiptare. Kjo është arsyeja pse në fund të këtij vëllimi jepen disa “përgjithësime më të gjera, që dalin nga vështrimi njësh i lëvizjeve kuptimore në të dyja hapësirat semantike të studiuara në fushë të shqipes; do të ndërtojë një pasqyrë pak a shumë të plotë për llojet e lëvizjeve e të lidhjeve semantike në strukturën semantike të shqipes dhe do të përcaktojë vendin që zënë këtë lëvizje e lidhjet sipas prejardhjes semantike; do të theksoj disa nga vijat më kryesore që karakterizojnë gjuhën shqipe në shndërrimet kuptimore dhe në tipat e prejardhjes semantike; do të shtrojë, së fundi, disa drejtime e detyra për studimet e ardhme në semasiologjinë shqiptare”.³⁵ Në këtë mënyrë Profesor Thomai ka arritur të disa përfundime të rëndësishme, siç janë: ndikimi semantik në sistemin fjalëformues, për specializimin e ndajshesave të shqipes, për tabanin e temave semantike, për përmbajtjen kuptimore të fjalësit të shqipes dhe bartjen e saj në kontekstin historik, për të përfunduar me rëndësinë e studimit semantik të klasave leksikore e fjalëformuese të fjalëve të shqipes.

IV. TEKSTE MËSIMORE

1. Leksikologjia e gjuhës shqipe

Në bio-bibliografinë e Profesor Jani Thomait, ndoshta nuk do të ishte i rëndësishëm kapitulli i veprave të tij me karakter normativ dhe mësimdhënës, sikur mos të ishte vepra e tij Leksikologjia e gjuhës shqipe, e botuar dhe e ribotuar disa herë, duke u bërë vepra më me

³⁵ Prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe (semantikë leksikore), f. 273.

ndikim për rreth pesë dekada³⁶. Në të vërtetë ai ka shkruar edhe një vepër tjetër të rëndësishme për nevojat e studentëve Teksti dhe gjuha (analiza leksikologjike) dhe të nxënësve Libri i gjuhës shqipe, 3/1983 (drejtues e bashkautor), por ndikimi që ka ushtruar vepra e parë universitare në Tiranë dhe në Prishtinë është i veçantë.

Vepra Leksikologjia e gjuhës shqipe është botuar për herë të parë në vitin 1961 dhe për rreth pesë dekada ka pasur disa botime në Tiranë dhe në Prishtinë, prandaj është e kuptueshme pse gjatë gjithë kësaj kohe ka pasur edhe plotësime e ndryshime, të cilat në formën më të mirë dëshmojnë për arritjet e reja të dijes së albanologjisë së kohës në përgjithësi dhe arritjet e dijes së leksikografisë e leksikologjisë në veçanti.

Nëse në botimin e parë dhe në ribotimet e saj deri në mesin e viteve '70, kjo vepër ishte thjesht një përshkrim i arritjeve historike të leksikologjisë dhe leksikografisë shqiptare, pas viteve '70, po në këtë vëllim sillen edhe aspekte të tjera të dijes teorike leksikografike e leksikologjike në Europë. Në të vërtetë, nëse në botimet e ribotimet e para autori merret kryesisht me temat e mëdha të historisë së leksikografisë, të objektit të leksikologjisë si shkencë, të kronologjisë së botimit të fjalorëve të shqipes, të strukturës gjuhësore të tyre dhe shumë shumë të disa shtresave gjuhësore të shqipes, në ribotimet e mëtejme të saj leksikologjia shqiptare vlerësohet me terma bashkëkohor të leksikologjisë europiane, me koncepte teorike dhe gjuhësore të dijes së sotme moderne mbi leksikologjinë, me tema të panjohura dhe të pastudiuara në botimet e mëparshme dhe madje me kapituj të rinj, të rëndësishëm për leksikografinë, leksikologjinë dhe albanologjinë. Në botimet e mëvonshme, studimet për semantikën leksikore dhe kategoritë themelore të saj, dukuritë e semantikës leksikore dhe grupet paradigmatiche të fjalëve, si dhe temat e kapitujt të tjerë të kësaj natyre zënë vendin kryesor të hapësirës së saj.

2. Teksti dhe gjuha

Vepra **Teksti dhe gjuha** (analiza leksikologjike)³⁷, është shkruar me qëllim që studentëve t'iu jepet një bazë solide dijeje, por sigurisht më e lartë se sa e kishin brezat e studentëve të mëparshëm. Kjo ndërkaq nuk do të thotë se mjeshtri ynë veprës i ka dhënë karakter thjesht deskriptiv. Përkundrazi, brenda saj janë sjellë një varg kërkimesh të reja dhe një varg konkluzionesh të caktuara të cilat studimit mbi tekstin dhe gjuhën, përkatësisht analizës gjuhësore të tij, i ka dhënë një dimension të ri kërkimor, brenda përbërësve të domosdoshëm mësimor.

Vepra përbëhet prej pesë kapitujve I. Metoda e analizës dhe njësia gjuhësore, II. Leksiku i gjuhës shqipe dhe teksti për analizë; III. Leksiku popullor dhe vlerat e tij; IV. Frazologjia gjuhësore dhe shprehje të tjera; V. Gjuhë dhe stil.

³⁶ Leksikologjia shqipe, 1961; Leksikologjia e gjuhës shqipe” (1974/1981, i ribotuar me përpunime e plotësime); Leksikologjia e gjuhës shqipe, 1984; Leksikologjia e gjuhës shqipe, 1999/2002; Leksikologjia e gjuhës shqipe, 2005/2006.

³⁷ Teksti dhe gjuha (analiza leksikologjike), SHB e Librit shkollor, Tiranë, 1992, f. 200.

Brenda kapitullit të parë *Metoda e analizës dhe njësia gjuhësore*, apo interpretimi i tekstit a shpjegimi i tekstit, diskutohen leksiku dhe sintaksa, dy drejtimet kryesore, ku synon analiza e tekstit. Fjala është për përmbajtjen e tekstit, mendësinë, psikologjinë, kulturën dhe prirjet shpirtërore të autorit, njohjen e një numri më të madh mjetesh të shprehjeve gjuhësore, njohjen e procedurave të analizës së tekstit, shndërrimin e tekstit, bashkimin e domethënies, dallimin e kufirit të së përgjithshmes dhe të veçantës, ekonominë në gjuhë, procedurën e analizës së tekstit; korpusin e leksikut dialektor etj. Autori arrin përfundim se janë krijuar kushtet për studimin e analizës së tekstit, jo si një kërkim si rastësi, po edhe si një punë sistematike, e me një metodë origjinale për shqipen.

Po brenda këtij kapitulli diskutohet *fjala* si njësi gjuhësore dhe vlerat e saj në gjuhën shqipe, trajtimi i shenjës gjuhësore nga aspekti teorik, si një problem i padefinuar deri në fund i gjuhësisë së përgjithshme (mendimi Sosyrit), grupi tingullor dhe lidhjen e tyre me kuptimin (mendimet e Balit dhe Benvenistes), vlera semike, vlera emocionuese, vlera artistike, vlera fjalëformuese, vlera paradigmatiske, vlera zëvendësuese (substitutive) etj. Për të vazhduar me vlerësimin e përmbajtjes leksikore të fjalëve në gjuhën shqipe: rolin e fjalës si njësi më e vogël, e mëvetësishme dhe e kuptueshme në gjuhë, për semasiologjinë si degë e veçantë e gjuhës, për semantikën leksikore, dijes mbi studimin e kuptimit të fjalëve, për rezultatet e gjertashme në studimin e strukturave të veçanta, sistemeve leksikore në tekstet shkollore apo në fjalorët shpjegues dhe terminologjik, me shkallët semantike të përmbajtjes së disa njësive leksikore ndër fjalorë të ndryshëm të shqipes, zbatimi kërkesës së standardit të shqipes në njësitë leksikore të fjalësve të shqipes etj. I nxitur dhe i pasur me dijen mbi rëndësinë e leksikut të përgjithshëm të shqipes, pra edhe atij dialektor edhe atij letrar a historik, Profesor Thomai, nuk mund të kalonte pa e vënë re një prej temave të tij të preferuara: rrugët që qojnë në pasurimin e gjertanishme të fondeve leksikore, me njësi kuptimore të karakterit historik, dialektor, gramatikor, neologjizmave dhe kontributin e studiuesve të veçantë në këtë rrjedhë kërkimesh.

Kapitulli i dytë i kësaj vepre përfshinë disa shtresa leksikore të shqipes, të para dhe të ruajtura gjithnjë në rrafshin historik, dialektor, krahasues etj, me synim funksionin e tij në analizën e tekstit: prej shtresimit indoevropiane, te shtresat e letërsisë së vjetër, asaj të rilindjes kombëtare (kur themelohet sistemi i gjuhës letrare kombëtare), format e krijimit të shtresave leksikore, dhe vendi i tyre në korpusin e sistemit të përgjithshëm të gjuhës shqipe. Një vend të veçantë zë shtresimi historik i leksikut të shqipes dhe vlerësimet e albanologëve të shumtë deri te Çabej, si dhe metoda e krahasimit të gjertanishme të shqipes me gjuhë të tjera të familjes indoevropiane, ballkanike dhe rajonale. Shtresimi i leksikut të shqipes nga pikëpamja e normës letrare, kap një dimension mjaft gjithpërfshirës të leksikut, korpusit, frazeologjisë: shtresat kryesore (fjalët dhe njësitë frazeologjike të përbashkëta për të dy dialektet); shtresa leksikore e përbashkët që është bërë pronë e gjuhës shqipe; shtresa frazeologjike e përbashkët për të dy dialektet; një korpus fjalësh të dialektit të veriut apo të jugut me struktura gramatikore të përshtatshme për standardin e tashëm të shqipes etj. Në një kapitull më vete trajtohen shtresat potenciale të leksikut të gjuhës shqipe, nga formim i fjalëve dhe fraktura gramatikore e tyre për të qenë pjesë e korpusit të shqipes standarde, deri te përvoja e gjertanishme e studimit gramatikor

gjatë shekullit XIX- XX, fondi leksikor dhe semantik i leksikut të shqipes, pasuria parashtesore dhe prapashtesore e tyre, larmia dhe shkallët semantike të tyre etj. Në fund, autori sjell një përvojë historike dhe profesionale të kërkimeve të tij leksikografike e leksikologjike mbi pastërtinë e leksikut dhe pasurimin e tij me brum amtar, brenda të cilit përvijohet përvoja e rilindësve dhe sidomos e gjuhëtarëve të gjysmës së parë të shekullit XX, dhe modeli i fjalëformimit si një metodë e përshtatshme; si dhe krijimtaria gjuhësore e shkrimtarit dhe teksti, brenda të cilit sillen përvojat dhe korpuset e pasurisë leksikore e të strukturës gramatikore dhe kuptimore të fjalës, mbështetur në fundin leksikor të Kadaresë, Nolit, Xhuvanit, Frang Bardhit etj.

Në studimin e gjuhës së tekstit, rroli i shtresës së leksikut popullor, k rëndësinë e tij të veçantë. Në veprën e Profesor Thomait, ky korpus i pafundshëm i popullit tonë zë vendin e merituar. Fillimisht ai trajtohet duke e parë rrolin e tij në ruajtjen e identitetit gjuhësor e kombëtar të popullit shqiptar, në përmbushjen e fjalësit të madh të shqipes, në bazën historike e tij që te Buzuku e Bardhi, në strukturën gramatikore e tij dhe shtresat kuptimore të periudhave të ndryshme etj; për të vazhduar me leksikun popullor dhe të folmet dialektore në *Fjalorët fjalëve dhe shprehjeve popullore*, me tipat e fjalorëve krahinor, me gjurmët e sintaksës popullore, me shtresat sinonimike, antonimike dhe homonimike të tyre; me përfshirjen e fjalorëve krahinorë në fjalorët e përgjithshëm, me modelet e ndërtimit të fjalorëve krahinor, me rastet dhe shembujt më të mirë të këtyre fjalorëve dhe me rëndësinë e tyre. Meqenëse shtresa leksikore e dialektalizmave dhe krahinorizmave përbën një fushë shumë të ndërlikuar prandaj autori iu kthehet edhe njëherë për të caktuar vendin e tyre në korpusin e përbashkët të shqipes.

Mbështetur në krijimtarinë e shkrimtarëve të letërsisë artistike: Musaraj, Shuteriqi e Agolli, te Jorgazi, Drini e Çela, autori ndalet në vlerësimin e vendit të dialektizmave dhe pasurisë së tyre brenda veprës letrare, për të dhënë më tej shembuj të zgjedhur, strukturën gramatikore, fonetike, sintaksore dhe semantike të tyre, shpërndarjen brenda veprës, kufizimet e personazheve dhe pasqyrimi i krahinave të caktuara, si dhe shfrytëzimin artistik të dialektizmave. Ndonëse pa përmasën e fondit leksikor, përvijohen edhe disa aspekte të dialektizmave leksikore në letërsinë politiko-shoqërore. Duke qenë një teme tabu, sikur është edhe një arsye pse edhe shtruarja e problemit është mjaft e rrudhur.

Kapitulli i katërt i kësaj vepre merret me frazeologjinë gjuhësore dhe shprehjet e tjera. Një diskutim teorik, përgjithësues dhe vlerësues e frazeologjisë së shqipes, përdorimit të saj, shtrirjes brenda një fjalori dhe madje një faqeje e lekseme, me disa shembuj përkatës. Po këtu sillen edhe disa veçori të normës letrare në frazeologji. Shembuj të letërsisë artistike, koncepte teorike dhe praktike të shqipes standarde dhe përvoja e gjertanishme në hulumtimin, vjeljen, studimin, dhe tipologjizimin e tyre. Janë disa krijues ndërkaq tepër të veçantë që përfaqësojnë modelin e vjeljes së fondit popullor të leksikut të shqipes. Kjo është arsyeja, sigurisht jo e vetme pse Anton Zako Çajupi është sjellë si model apo tregues e karakterit popullor të frazeologjisë, apo shembulli i krijuesit që nga letërsia popullore ka marrë si ‘në kopshtin të babës’ (Qosja).

Vepra Teksti dhe gjuha (analiza leksikologjike), mbyllet me një kapitull të veçantë *gjuha dhe stil*. Brenda këtij kapitulli autori diskuton gjuhën e mjeteve të informimit në gazetari dhe gjuhën e dialogut politik të kohës. Megjithëse një temë e madhe për diskutim, raporti mes ligjëruesve politik të saj dhe opinionit me gjasë ka bërë që autori i saj të jetë jo vetëm i matur dhe i rezervuar për diskutim e komente rasti, por merret vetëm përciptazi me këtë fenomen duke i dhënë më shumë karakter teorik se sa praktik.

V. NGA DIALEKTOLOGJIA TE STANDARDIZIMI I GJUHËS SHQIPE

Diskutimi për gjuhën letrare është një prej temave më të rëndësishme në gjuhësinë shqiptare të shekullit XX. Gjuha e përbashkët letrare, sigurisht ishte një prej vlerave më të rëndësishme intelektuale edhe më parë, sidomos gjatë periudhës së Rilindjes Kombëtare, kur ajo konsiderohej një prej përbërësve themelor të formimit të identitetit kombëtar, por ajo do të bëhet objekt diskutimi brenda gjuhësor, kryesisht gjatë shekullit XX, kur diskutimet për një gjuhë të përbashkët letrare, pra përtej normave dialektore, kalon kufijtë iluminist dhe bëhet kërkim i gjedhës deri në shkallë polemizuese. Pjesëmarrës i këtij diskutimi, veçse në përmasa akademike në gjysmën e dytë të shekullit XX bëhet edhe Jani Thomaj. Në Konferenca shkencore, në revista shkencore, në të përditshmet dhe në të përkohshmet letrare e kulturore, që nga vitet '60, Profesor Jani Thomaj ka diskutuar dhe shkruar artikuj për masat e gjera të lexuesve, dhe tekstet popullarizuese e aktivitetet mësimore, kërkimore e shkencore, për vlerat stilistike të disa fjalëve, për seminarët që i kushtohen problemit të gjuhës letrare me arsimtarët të rrethëve arsimore, për seminarin mbi problemin e gjuhës letrare në Krujë, për Kongresin e drejtshkrimit të njësuar të gjuhës letrare shqipe, për njësimin e drejtshkrimit si shfaqje e qartë e njësimit të gjuhës sonë letrare, për seminarin shkencor me arsimtarët e rrethit të Lezhës, për seminarin me rrethin shkencor të gjuhës në Fier, për përdorimin e fjalës “proce”, për fjalën shqipe në shkollën tonë, për çështje të kulturës së gjuhës në shtypin tonë, për shkallët e kulturës gjuhësore, për normat letrare të kulturës së gjuhës, për çështje të standardit gjuhësor të sotëm, për gjuhën letrare shqipe s'i shije individësh etj. Në këtë mënyrë dhe në disa forma të tjera Profesor Thomaj gjuhën shqipe e ka bërë objekt kërkimi dhe subjekt diskutimi në hapësirën shqiptare dhe në nivelet akademike e popullore të përdorimit të saj³⁸.

Sikur ka ndodhur me pjesën më të madhe të gjuhëtarëve shqiptarë, pothuajse pa përjashtim veprimtarinë shkencore e kanë filluar me kërkimet dialektologjike, edhe Profesor Jani

³⁸ Mbi disa çështje të normës në fushën e leksikut e të formimit të fjalëve në gjuhën e sotme letrare shqipe, “Shkencat shoqërore në shkollë”, 1972, 8, f. 15-25; “Probleme të gjuhës letrare...”, 1972, I, f. 168-183; Mbi kufijtë e fjalës në gjuhën shqipe dhe disa çështje të drejtshkrimit, “Kongresi i drejtshkrimit të gjuhës shqipe”, 1973, II, f. 357-366; SF, 1973, 1, f. 137-154; Le congres de l’orthographe de la langue albanaise, 1974, f. 428-433; Kongresi i drejtshkrimit..., Prishtinë, 1974, f. 428-433; Mbi disa çështje të leksikut dhe të formimit të fjalëve në gjuhën e sotme letrare shqipe, Lëndët e shkencave shoqërore në shkollë, 1973, 8, f. 15-25; Norma letrare dhe kultura e gjuhës, 1973, I, f. 61-74; Togfjalëshi, frazeologjia dhe fjala, Norma letrare dhe kultura e gjuhës, 1973, I, f. 116-133.

Thomai, e ka filluar punën e tij prej dialektologu, prandaj edhe studimin e parë të tij me karakter monografik ta ketë botuar pikërisht në këtë fushë: E folmja e katundit Seman, 1961. Dhe nuk është e rastit që një varg tekstesh të para të tij me karakter shkencor, publicistik dhe edukativ, të kenë temë pikërisht nga fusha e kulturës së gjuhës edhe atëherë kur ato shoqërohen me probleme të leksikut dhe leksikografisë dhe frazes apo frazeologjisë³⁹. I nxitur madje prej pasurisë së trashëguar dhe sidomos prej kërkimeve në teren, nga këndi i dialektologut⁴⁰, kërkimet e tij Profesor Thomai do t'i përmbledh në një vëllim më vete: Për pastërtinë e gjuhës shqipe. Fjalor”(1998).

Studimet e tij të kësaj fushe Jani Thomaj i ka hapur me kumtesën "Mbi disa togje të qëndrueshme në Mesharin e Gjon Buzukut në krahasim me shqipen e sotme"⁴¹. Me ndihmën e analizës së disa togfjalëshave të qëndrueshëm Jani Thomaj ndriçoi shkallën e karakterit popullor të gjuhës së Buzukut. Në përfundim të kësaj analize ai tha se frazeologjia e përdorur nga Buzuku nuk është krejt e veçantë as për kohën, as për të folmen e tij. Frazeologjia së bashku me aspekte të tjera të gjuhës së Mesharit tregojnë se Buzuku e ka njohur mirë shqipen e folur dhe e ka zotëruar si për të përdoruar drejt elementet ekzistuese ashtu edhe për të krijuar elemente të reja gjuhësore sipas natyrës së gjuhës popullore. Duke e krahasuar frazeologjinë e Buzukut me të shqipes së sotme, Jani Thomaj vuri në dukje se me gjithë ndryshimet që ka pësuar shqipja në zhvillimin e saj historik gjatë këtyre katër shekujve, në fushën e frazeologjisë zhvillimi ka qenë më i ngadaltë për shkak të vetë natyrës së saj. Shqipja e sotme ka mjaft elemente frazeologjike që dalin që te Buzuku, gjë që në fund të fundit tregon se gjuha jonë e sotme është zhvilluar mbi një bazë të shëndoshë popullore dhe pa u shkëputur prej kësaj".

³⁹ Fjala shqipe në vend të fjalës së huaj, GjJ, 1981, 2, f. 66-72; 1982, 1, f. 79-87 dhe 2, f. 82-89; 1987, 4, f. 81-94; Përdorimi i disa lokucioneve librore, GjJ, 1982, 1, f. 13-21; Norma e gjuhës letrare dhe kultura e gjuhës, "Probleme aktuale të kulturës së gjuhës shqipe", Prishtinë, 1983, f. 155-161; Tipare të gjuhës së shtypit në kohën tonë, SF, 1984, 4, f. 103-116; "Nëntori", 10, f. 22-35; Marrëdhënie të standardit me substandardin në shqipen e sotme, "Jehona", Shkup, 1996, 8, f. 21-33; Për pastërtinë e fjalorit në ligjërimin publicistik, GjJ, 2000, 3-4; Për pastërtinë e fjalorit të gjuhës sonë letrare, "25-vjetori i Kongresit të Drejtshkrimit", 2000, f. 85-90; Zhvillime tipologjike të shqipes drejt standardizimit, "Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare", Prishtinë, 2001, f. 253-261; Rreth pastërtisë së fjalorit në ligjërimin publicistik, GjJ, 2000, 1-2, f. 27-38; Dukuri leksikore në shtypin e sotëm, Konferenca shkencore "Gjuha letrare kombëtare dhe bota shqiptare", 2002, f. 320-327; Shqipja standarde dhe leksikografia shqiptare, Konferenca shkencore "Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare", 2003, f. 261-270; Probleme të leksikut të shqipes standarde, "Gjuha shqipe", Prishtinë, 2006.

⁴⁰ Rreth leksikut popullor në të folmet veri-lindore të shqipes, SF, 1987, 2, f. 55-74; Rreth përdorimit të fjalëve dialektore, SF, 1988, 4, f. 31-37; Rreth leksikut dialektor e krahinor të shqipes, SF, 1989, 1, f. 19-32; GjJ, 4, f. 21-29.

⁴¹ Kumtesë në Konferencën e II të Studimeve albanologjike (12-18 janar 1968), me rastin e 500-vjetorit të vdekjes së Skënderbeut, Universiteti Shtetëror i Tiranës, shih, SF, nr. 1/1968, f. 50, botuar me titullin "Mbi disa togje të qëndrueshme të shqipes së shek.XVI në krahasim me shqipen e sotme", SLFFGJSH II, USHT-IGJL, Tiranë, 1972, f. 289-297. Fusnota : 8. Tabela : 1 (295). Résumé : Groupes de mots figes de l'albanais du XVI siècle compares a l'albanais d'aujourd'hui (297).

Në studimin *Rreth Rregullave të drejtshkrimit të shqipes*⁴², Profesor Thomai konstatoi se "vënia e parimit fonetik si parim kryesor i drejtshkrimit të shqipes është e drejtë, sepse përputhet me realitetin gjuhësor, me veçoritë e shqipes së sotme letrare". (...) porse ky parim ndonjëherë nuk zbatohet me konsekuencë...". Më tej, mjeshtri ynë sjell një varg shembujsh, fenomenesh e dukurish mbi të cilat janë ndërtuar strukturat drejtshkimore dhe modelet e tjera, të cilat i tejkalojnë kufijtë e parimit të ngushtë fonetik, të cilat Profesor Thomai mendonte se duhet "shpjeguar me kushtet fonetike të tingullit"⁴³. Vështirësitë, sipas Thomait: grupimi dhe ndeshja e kriterit fonetik me atë gramatikor e historiko-etimologjik, të gjendjes së fenomenit me perspektivën e zhvillimit të tij, të fenomenit si njësi me sistemin e njësive ku bën pjesë ai"⁴⁴. Jani Thomaj propozonte që në vend të motivimit të përbashkët të kishte edhe "motivime të brendshme, i detajuar", dhe sipas grupeve të fenomeneve, të cilat mundësonin "edhe zgjidhjet e kundërta, zgjidhjet që nuk përputhen me sistemin, me të përgjithshmen etj".

Ideja e thjeshtësimit, të zgjidhjeve të dyfishta, dyhershme apo kontradiktore, duke dhënë edhe shembujt e rastit, paraqet një angazhim të rëndësishëm të Profesor Thomajit, si një kontribut i tij për mënjanimin e trajtave të dyfishta dialektore dhe nëndialektore, e cila e mundësoi edhe krijimin e një gramatike, sikur thoshte Çabej jo arkaike.

Në këtë studim Profesor Thomai, analizë të veçantë ju bënë kapitujve që trajtojnë shkrimin e fjalëve bashkë ose ndaras dhe me vizë lidhëse, të cilat ai i trajton gjerësisht veç e veç, te rregullat e shkrimit të kompozitave, fjalët e përbëra e të përngjitura, brenda strukturave gramatikore e sintaksore etj.

I kësaj natyre është edhe studimi "Mbi mënyrën e pasqyrimin të sistemit të kuptimeve dhe përdorimeve të fjalëve në fjalorin shpjegues të gjuhës shqipe"⁴⁵, i cili do të mund të quhej një nga përpjekjet e veçanta të profesor Thomait, jo vetëm për diskutimin shumëdimensional të çështjeve që shtrihen dhe përfundimeve që arrin, po edhe për vetë bibliografinë shkencore të tij. Me këtë studim, autori kalon nga qasja thjesht deskriptive dhe kur e kur gramatikore e paraqitjes së fjalëve, një dukuri kjo e pranishme përgjithësisht në studimet albanologjike të kohës, në një përmasë më të lartë të shpërndarjes së tyre në fjalor mbështetur në esencat dhe në shkallët semantike që përfaqësojnë. Duke marrë për shkak diskutimet e shumë studiuesve më në zë të kohës rreth "Fjalorit të gjuhës shqipe" (1954), autori mbështet iniciativën për përgatitjen e një fjalori të ri të shqipes, mbështetur në kritere të rrepta shkencore dhe natyrisht mbështetur në arritjet më të reja shkencore të dijes shqiptare në fushë të leksikologjisë e leksikografisë. Në këtë rrjedhë ai diskuton disa problemet të cilat sipas mjeshtrit tonë janë: "struktura kuptimore e fjalëve, dmth. vargu i kuptimeve leksikore të formuara nga pikëpamja linguistike, çështja e

⁴² *Rreth Rregullave të drejtshkrimit të shqipes*, Studime filologjike, 4/1968, f. 179-185.

⁴³ Po aty, f. 179.

⁴⁴ Po aty, f. 180.

⁴⁵ Mbi mënyrën e pasqyrimin të sistemit të kuptimeve dhe përdorimeve të fjalëve në fjalorin shpjegues të gjuhës shqipe, *Studime filologjike*, Tiranë, 4/1964: 203-214.

kuptimeve jo të lira, frazeologjikisht të lidhura të fjalëve, çështja e përdorimeve të figurshme të fjalëve, kalimi i këtyre në elemente gjuhësore, si dhe çështja e pasqyrimin në fjalor të kuptimeve leksikore, frazeologjike dhe të përdorimeve të fjalëve"⁴⁶.

Diskutimin e tij për Fjalorin (1954) Profesor Thomaj e zgjeron me shpjegimin teknik të shprehjes frazeologjike, dhe pozitës së saj pranë termave të tjerë lingvistik, kuptimor dhe përshkallëzues, për të vazhduar me vlerësimin e shpjegimin teorik të këtij termi pranë elementeve përbërës të termave të tjerë dhe dijes lingvistike që kishte për të në gjuhësinë e përgjithshme dhe në shkollën shqiptare (shpjegimeve kryesisht gramatikore dhe sintaksore) të kohës. Në këtë studim mjaft të thelluar të problemeve leksikore dhe frazeologjike, autori sjell dhe përmon një varg shembujsh të natyrës thjesht gramatikore, për t'i zgjeruar problemet në shkallë të frazeologjisë dhe kuptimeve të tyre brenda një zëri të fjalësit të shqipes. Mbështetur në shembujt e shumtë që sjell dhe në konceptet teorike për kuptimet e fjalëve dhe përdorimit të tyre, kryesisht të lingvistikës të njohur të kohës Vinogradov, autori arrin në dy përfundime themelore: a) për kuptimin e ri të fjalës, si fakt gjuhësor i formuar, i përgjithshëm dhe i detyrueshëm që duhet pasqyruar në fjalor brenda strukturës kuptimore të fjalës dhe për b) për përdorimin e ri të fjalës, si bazë për lindjen e një kuptimi të ri.

VI.PËRFUNDIME

Në historinë e albanologjisë, leksikografia zë vendin qendror, jo vetëm për faktin se ajo nisë me një fjalorth dygjuhësor të Arnold von Harfin, por sepse kulmon me Fjalorin e Frang Bardhit, krijohet si shkencë me Fjalorin etimologjik të Gustav Majerit, ndërtohet si dije nacionale me Fjalorin e Konstantin Kristoforidhit dhe sintetizohet si Institucion me Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe (1980), dhe sidomos me "Fjalorin sinonimik të shqipes"(200?) në të cilin kontributi i Profesor Jani Thomajt është i aspektit teorik, semantik dhe pragmatik.

Në studimet albanologjike të gjysmës së dytë të shekullit XX, tipologjia e studiuesve shqiptarë do të mund të bëhej duke u nisur së paku në tri aspekte:

- a) Grupin e parë e përbëjnë studiuesit të cilët më parë se me studime në jetën shkencore të kombit me tekstet e tyre kanë sjellë kryesisht përvojën e tyre të mësimdhënies dhe rezultatet e dijes shkencore të fushës që e mbulon, pa pretenduar që të sjell rezultate të reja. Qëllimi i tyre ishte dhe mbeti që lexuesit si masë e dijes të informohen me gjendjen e studimeve albanologjike në rrethana të kohës kur i shkruanin ato tekste.
- b) Grupin e dytë e përbëjnë studiuesit, të cilët më parë se dijen shkencore për albanologjinë, e kishin dashurinë për të dhe trashëgiminë e saj, prandaj në kërkimet e tyre albanologjike, sillnin kryesisht materiale të mbledhura në terren apo dokumente të zgjedhura nga arkivat kombëtare dhe ndërkombëtare, pa pretenduar që ato t'i shpjegojnë dhe vlerësojnë me komente e në mënyrë kritike; dhe

⁴⁶ Po aty, *Studime filologjike*, 4/1964: f. 203.

- c) Grupin e tretë e përbëjnë studiuesit që zotëronin dijen e fundit jo vetëm për albanologjinë si shkencë po edhe për linguistikën e përgjithshme, letërsinë dhe filozofinë e metodologjinë e shkencave humanitare, prandaj më parë se të bëhen bartës të traditës së mësimdhënies si dije masive në fushë të albanologjisë, apo bartës të traditës së krijimit të korpusit të albanologjisë si arkiv i institucionalizuar, u bënë bartës politik të institucioneve shkencore e arsimore dhe bënë përpjekje për pozicionimin e tyre në pozitë të reflektimit të teorive shkencore dhe politike njëkohësisht.

Profesor Jani Thomai është nga ata studiues të përkushtuar që me jetën e tij arriti t'i bashkohet fillimit të ndërtimit të albanologjisë si dije nacionale në fillim të gjysmës së dytë të shekullit XX; që me përkushtimin e tij t'iu bashkohet bashkëkohësve në institucionet arsimore të kohës për përgatitjen e brezit të ri të albanologëve; që me angazhimin e tij t'iu bashkohet studiuesve të vullnetit të ri për qëmtimin e materialit në teren e në tekstet e shkruara dhe të ndihmoj në krijimin e korpusit leksikor, dialektor e onomastik, të institucionit të albanologjisë; që me pasion dhe seriozitet t'i zotërojë përvojat teorike ndërkombëtare të kohës në fushë të teorisë së linguistikës së përgjithshme dhe të zbatuar dhe këtë dije ta zbatoj e ta thelloj me përkushtim në fushë të shkencës së albanologjisë. Kështu, me punën e tij prej mësimdhënësi, teoricieni e aplikuesi të saj, ai me sukses bashkoi leksikologjinë si shkencë dhe leksikografinë si kërkesë pragmatike a të zbatuar në fjalorët e shqipes dhe atyre krahasues.

Ai i ka qëmtuar dhe bashkuar kërkimet teorike dhe praktike, duke i plotësuar sa njërën po aq edhe tjetrën dhe në këtë mënyrë ai ka përditësuar njëherë studimet e tij e herën tjetër veprat monografike të tij. Në këtë mënyrë ai i ka dëshmuar prirjet e tij shkencore aspak dogmatike, një prirje mjaft e theksuar në kërkimet shkencore të kohës. Ai me jetën dhe veprën e tij ka dëshmuar përkufizimin e Profesor Rexhep Qosjes për modernitetin "pakënaqësia me veten sot për hir të vetes nesër"(1979). I tillë ai paraqitet edhe në faqet e historisë së albanologjisë: mes dogmatizmit gjuhësor të Androkli Kostallarit dhe refuzimit linguistik të Selman Rizës; mes ligjërimit akademik të Eqrem Çabejt dhe gjuhës pozitiviste të Jup Kastratit, mes etikës së fjalës së Idriz Ajetit dhe etikës së mendimit të Mahir Domit; Profesor Jani Thomaj, në studimet gjuhësore të tij sillte e diskutonte mendimet e tij me kujdes dhe me akribi shkencore terma e nocione gjuhësore nga gjuhësia e përgjithshme, pa ju dhënë atyre domosdo edhe karakterin absolut të referencës gjuhësore e aq më pak politike.

Duke plotësuar dekada me radhë librin themelor të *Leksikografisë së gjuhës shqipe* me arritje historike, teorike dhe praktike ai ka dhënë shembullin e pedagogut që ndërton breza të ri me dije të re, që historinë ia lë kohës; duke zgjeruar mendimet e tij nga studimet me karakter monografik, në vepra me karakter përgjithësuese ai ka dëshmuar se sa të rëndësishme kanë qenë konceptet teorike dhe pikëpamjet orientuese të periudhës së parë shkencore; duke aplikuar konceptet e tij teorike, historike dhe të terrenit në projekte veprash të zbatuara ai ka dëshmuar se sa e rëndësishme është qasja multidisiplinare e studimit të gjuhësisë shqiptare dhe sa e komplementare është albanologjia brenda strukturës gramatikore dhe të aplikuar.

Në këtë mënyrë kërkimet dhe sintezat e tij arrijnë disa kulme të brendshme dhe të jashtme të shqipes: nga leksikologjia shqipe te leksikografia shqipe (teori e hartim fjalorësh); nga frazeologjia gjuhësore shqipe te semasiologjia (semantikë leksikore); nga dialektologjia e fjalëformimi te kultura e gjuhës dhe synimet largvajtëse të tij e të brezit të tij: standardizimi i gjuhës shqipe.

Kështu ai ka ndërtuar veprën e tij shkencore në dy rrafshë: studim, përkatësisht studime orientuese - monografi:

a) nga studimi *Probleme të frazeologjisë së gjuhës shqipe* (1964) te vepra *Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe* (1981) dhe më tej te fjalori *Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe* (1999); nga studimi *Një klasifikim i frazeologjizmave me vlerë ndajfoljore në shqipen e sotme* (1969), te monografia *Veçori leksiko-semantike të ndajfoljeve me prapashtesa në gjuhën shqipe* (2004); nga studimi *Mbi disa çështje të normës në fushën e leksikut e të formimit të fjalëve në gjuhën e sotme letrare shqipe* (1972), te vepra me karakter shkencor dhe mësimor *Teksti dhe gjuha* (1992); nga studimi *Rreth leksikut dialektor e krahinor të shqipes* (1989), te fjalori *Për pastërtinë e gjuhës shqipe* (Fjalor, 1998) dhe më tej te monografia *Leksiku dialektor e krahinor në gjuhën shqipe* (2001); nga studimi *Mbi mënyrën e pasqyrit të sistemit të kuptimeve dhe të përdorimit të fjalëve në fjalorin shpjegues të gjuhës shqipe* (1964), te monografia *Prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe* (Semantikë leksikore, 2009) e kështu me radhë.

b) dhe modeli tjetër studim, monografi, fjalor shpjegues: na studimet problematizuese dhe historike, teorike e sintetike *Mbi mënyrën e pasqyrit të sistemit të kuptimeve dhe të përdorimit të fjalëve në fjalorin shpjegues të gjuhës shqipe* (1964) dhe *Zhvillimi i teorisë dhe i praktikës leksikografike shqiptare pas Çlirimit* (1969), te fjalorët e shqipes së sotme *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe* (1980), *Fjalor i shqipes së sotme* (1984), *Fjalor i shqipes së sotme* (2002), *Fjalor i gjuhës shqipe* (2006); dhe nga studimi *Paralele frazeologjike të shqipes me gjuhë të tjera të Ballkanit* (1966), te fjalori *Fjalor frazeologjik ballkanik* (1999) e të tjera e të tjera.

Vjeljet e fjalëve e të frazeologjisë nga të gjitha gjinitë e botimeve dhe mbledhja e tyre nga të gjitha të folmet e shqipes me ekspedita leksikologjike në terren, kanë shërbyer për njohjen e lëndës leksikore, frazeologjike e semantike të shqipes, për pasurimin e Kartotekës së leksikut të shqipes (sot me mbi katër milionë skeda) dhe për hartimin e studimeve e të fjalorëve me lëndën e saj.

Nga vetë objekti i studimit dhe nga synimet e hulumtimit vinte në radhë të parë përshkrimi e interpretimi i veçantive të gjuhës shqipe, shpesh në ballafaqim edhe me gjuhë të tjera, veçanti në formë e në përmbajtje. Është e kuptueshme kështu që studimet me objekt lëndën e shqipes kanë një shkallë më të lartë origjinaliteti, krahasuar me fusha të tjera, pikërisht për shkak të natyrës së vetë objektit të studimit, pa shpërfillur arritjet e gjuhësisë botërore dhe të trashëgimisë sonë.

Studimet teorike i kanë shërbyer pasurimit të dijeve shkencore për leksikun, frazeologjinë e semantikën leksikore të shqipes dhe kanë qenë burim kryesor për tekstet e shkollës së lartë për

këto fusha, për hartimin e temava të diplomave të studentëve dhe të mikrotezave e të tezave të kualifikimit pasuniversitar.

Fjalorët edhe më gjerë u kanë shërbyer përdoruesve të tyre, hartuesve të fjalorëve dygjuhësh me shqipen, studimeve për kategori leksikore e semantike etj., përveç që në çdo fjalor, siç dihet, përpunohet një sistem teorik shkencor, pa të cilin nuk mund të mendohet hartimi i glosarëve, zbërthimi kuptimor e ndërtimi i strukturave kuptimore të fjalëve, tipologjia e shpjegimeve, shtresimi i leksikut, elementet e mbishtresuara në semantikë etj. Duke realizuar mirë këtë sistem të brendshëm, çdo fjalor zbulon edhe pasuritë leksiko-semantike e veçantitë e shqipes në këto nënsisteme dhe krijon një shkallë ngjitjeje për një vepër tjetër leksikografike.

Kjo është arsyeja pse sot mund të thuhet që brezi i leksikologëve dhe i leksikografëve të gjysmës së dytë të shekullit XX dhe fillimit të shekullit XXI, në krye të të cilëve zë vend Profesor Jani Thomaj, në një mënyrë apo një tjetër ka përsëritur disa nga periudhat më të rëndësishme të zhvillimit të albanologjisë pesëqindvjeçare; me *Fjalorin* e Frang Bardhit dhe *Fjalorët shumëgjuhësh* të Akademisë së Voskopojës (XV-XVIII), me *Fjalorin* e Konstantin Kristoforidhit (XIX-XX), me *Fjalorin e Bashkimit* (gjysma e parë e shek. XX), me *Fjalorët e gjuhës shqipe* (1954, 1980), si dhe një varg fjalorësh dygjuhësorë (anglisht-shqipe, gjermanisht-shqipe, frëngjisht -shqip, italisht-shqip etj. dhe anasjelltas), duke përfshirë këtu edhe fjalorët shpjegues, sikur është vepra madhore *Fjalor sinonimik i shqipes* (2004), në krye të të cilit është Profesor Jani Thomai.

Dhe kjo është arsyeja pse emrit të përveçëm të tij prej Profesori të shumë brezave dhe emrit të përveçëm të tij prej leksikologu e leksikografi, mund t'i bashkohet edhe një cilësor tjetër përbashkues: Profesor Jani Thomai institucioni kombëtar i albanologjisë.

VEPRA E AKADEMIKUT JANI THOMAI NË HAPËSIRËN SOCIOLINGUISTIKE

I. Hyrje

Po ta vështrojmë veprën e akademikut Jani Thomai në këndvështrimin sociolinguistik lehtë mund konstatojmë se vepra e tij lidhet me dy nga fushat themelore të studimit në sociolinguistikë, që janë: **variantet gjuhësore dhe ndryshimi gjuhësor**.

“Leksiku dialektor dhe krahinor në shqipen e sotme” dhe “Fjalori frazeologjik i gjuhës shqipe”, janë dy vepra përmes të cilave mund të vërtetojmë se variantet gjeografike shfaqen si variante të të njëjtit sistem, që karakterizohen nga : 1) **kuptueshmëria**, gegë dhe toskë, kuptojnë më së miri pjesën dërrmuese të fondit të fjalëve e të frazeologjizmave; 2) **homologësia e strukturave**: gegërishtja dhe toskërishtja shfaqen me inventarë strukturash që shkojnë krahas ose që përputhen në mënyrë harmonike, si në fonetikë, në morfosintaksë dhe në leksik e frazeologji; 3) **përdoren nga e njëjta bashkësi shoqërore**, bashkësia iliro- arbërore-shqiptare.

Akademiku J. Thomai në vepërën “Leksiku dialektor dhe krahinor në shqipen e sotme” thekson “*Studimi i tipave të dialektizmave e të krahinorizmave dhe i ndërthurjes së faktorëve gjuhësorë e jashtëgjuhësorë, karakterizimi i historisë së fjalëve dhe i gjendjes së sotme, përcaktimi i marrëdhënieve me shtresat e tjera leksikore, sidomos me leksikun e gjuhës letrare, zbulimi i vlerave dhe i fushave të përdorimit, dallimi i elementeve vetjake nga huazimet, shtresimet nga pika të ndryshme vështrimi e çështje të tjera që janë objekt i këtij punimi, nuk marrin fund këtu, ato presin të çohen më tej me punime të tjera*”⁴⁷ duke pasur parasysh punën në lëmin e leksikologjisë, por do të vërenim se ky objekt studimi nuk mund të përjashtojë edhe disiplinën e re gjuhësore, atë të sociolinguistikës.

Gjuha e folur popullore si mjet i komunikimit me gojë, kudo e në çdo gjuhë nuk mund të ekzistojë pa frazeologjinë.

Ndryshimin gjuhësor në gjuhën shqipe mund të themi se e rrokim edhe përmes **varietetit të të folurit popullor ose gjuhës së folur popullore** që si një tipar të qenësishëm ka frazeologjinë, që është një tipar universal. Pikërisht, “Fjalori frazeologjik i gjuhës shqipe”, është një dëshmi e gjallë e këtij tipari.

Është fakt që në materialin leksikor e frazeologjik të këtyre dy veprave të konstatojmë konservacionet, por edhe prirjet e zhvillimeve të reja gjuhësore. Gjithashtu është e mundur që studimi sociolinguistik i mbështetur në veprën e akademikut Jani Thomai t’ë realizohet përgjatë dy boshteve: atij sinkronik dhe atij diakronik. Me sa lejon hapësira e një kumtese do të desha të sillja një shembull të shfrytëzimit të fjalorit frazeologjik në *etnografinë e të folurit*.

⁴⁷ Jani Thomai, *Leksiku dialektor dhe krahinor në shqipen e sotme*, Tiranë, 2001, f. 33.

II. Nga “etnopsikologjia” tek “etnografia e të folurit”

Gjithnjë e më shumë, krahas studimit abstrakt të gjuhës ngulmohet edhe mbi domosdoshmërinë e të shpjeguarit të dukurive gjuhësore, pa përjashtuar e faktorët “sociologjikë” të jashtëm. Por edhe kur tentativat për të vendosur lidhje të drejtpërdrejta midis rregullave gramatikore dhe strukturave shoqërore e kulturore përgjithësisht kanë dështuar si në rastin e Uorfit, në sociolinguistikën bashkëkohore është vërtetuar se variacionet e sjelljes gjuhësore pasqyrojnë një sistem lidhjesh shoqërore. “Ky realizim i strukturës shoqërore në aktin e ligjërit bëhet në nivele të ndryshme: fonologjik, sintaksor dhe semantik.”⁴⁸

Antropologët, duke e studiuar gjuhën si një shfaqje të sjelljes shoqërore kanë studiuar fakte të tilla, si: si lidhja midis vizionit të botës, kategorive gramatikore dhe fushave semantike; ndikimi i përdorimit gjuhësor mbi shoqërizimin dhe lidhjet ndërpersonale; ndërveprimi midis bashkësisë gjuhësore dhe bashkësisë shoqërore.

Kështu, studimi antropologjik duke e vënë theksin mbi aspektet psikologjike, kulturore e shoqërore të të folurit ka bërë të mundur theksimin e dy dukurive shumë të rëndësishme: 1) ekzistencën e roleve funksionale të të folurit në bashkësi të ndryshme dhe 2) përdorimin e kodeve gjuhësore brenda së njëjtës bashkësi shoqërore.

Hajmzi konstaton se “roli komunikativ i vlerave sociale të të folurit nuk është kudo i barazvlershëm e identik; të folurit mund të ketë peshë funksionale të dallueshme në ekonominë komunikative të shoqërive të ndryshme’ dhe “asnjë person apo bashkësi normale nuk ka repertor të kufizuar në një varietet të vetëm të kodit, në një monotoni të pandryshueshme që do të përjashtonte mundësinë e shprehjes së respektit, sharjes ironisë, distancës, rolit e pozitës shoqërore etj.”⁴⁹

Për pasojë, lidhja midis gjuhës dhe grupeve shoqërore nuk duhet konsideruar e shkëputur, por si një problem për t’u studiuar nga ana etnografike.

Në antropologjinë gjuhësore, nën emrin e etnoseantikës dhe të antropologjisë konjitive një rëndësi të vecantë kanë marrë përshkrimet etnografike të drejtuara në ngjarje konkrete shoqërore a kulturore. Kjo metodologji, e zbatuar edhe në aspektin e të folurit, bëri të mundur lindjen e “etnografisë së të folurit”. Kjo fushë kërkimi është sot një nga sektorët themelorë të sociolinguistikës.

Në traditën tonë gjuhësore kemi mjaft studime për të argumentuar lidhjen mes kulturës dhe gjuhës. Nga këto mund të përmendim shpjegimet etimologjike dhe studimet për historinë e gjuhës shqipe të profesor Eqrem Çabejt; studimet dialektologjike dhe etimologjike të profesor Idriz Ajetit, si dhe studimet bashkëkohore në lëmin e sociolinguistikës të profesor Gjovalin Shkurtajt, të cilat fakti gjuhësor shpjegohet nën dritën e faktit historik, etnografik apo nën dritën e kulturës popullore në përgjithësi. Por ç’është kultura popullore?

Studiuesi A.Uçi e përcakton si “ një sistem të ndërlikuar e kompleks vlerash, veprimtarish e marrëdhëniesh shoqërore, të formuar e të zhvilluar historikisht në lidhje të ngushtë me jetën e

⁴⁸ Shkurtajt, Gj., Sociolinguistika, f. 41, Tiranë, 2005.

⁴⁹ Po aty.

bashkësisë tonë etnike e kombëtare. Ajo ka qenë prodhim i zhvillimit të kësaj bashkësie, por edhe një mjet i formimit, i konsolidimit dhe i zhvillimit të saj.”⁵⁰

Gjithmonë duke u nisur nga këndvështrimi ynë sociolinguistik

etnokultura që studiohet nga disa disiplina shkencore, si etnologjia, folklori (në kuptimin artistik të traditave popullore), antropologjia kulturore a sociale, sociologjia, etnopsikologjia a psikologjia sociale. Natyrisht etnokultura të çon edhe etnopsikologjia që lidhet me veçoritë mendore e shpirtërore të një populli të veçantë, por edhe të një grupi popujsh. Në qoftë se do të flisnim për veti etnopsikologjike të popullit tonë, do të thoshim

se ato janë kushtëzuar nga rrethanat historike e shoqërore të veçanta. “Për të njohur karakterin e një populli, natyrën e tij të vërtetë, duhen të njihen fare mirë gjuha e tij, doket, zakonet.” (Nopça)⁵¹

Historia e iliro- arbëror- shqiptarëve gjatë mijëvjeçarëve e shekujve dëshmon luftrat për mbijetesë kundër pushtuesve që vinin nga veriu, jugu, lindja dhe perëndimi.

Pikërisht, këto kushte sollën zhvillimin e një sërë normash me vlerë morale, të cilat u zbatuan në marrëdhëniet shoqërore të traditës.

Shqiptarët duke vlerësuar të mirën, të keqen, detyrën, nderin, turpin, lumturinë formuan virtyteve të tilla, si: besa, burrëria, krenaria, mikpritja, trimëria, toleranca fetare, të cilat u kthyen në një **kod moral**. Ky kod moral shfaqet përmes gjuhës, por do të thoshim se ky kod moral “gdhendet” në njësitë frazeologjike të shqipes.

II. a. Veçori të psikës shqiptare përmes njësive frazeologjike

Duke shfrytëzuar “Fjalorin fjalorin frazeologjik të gjuhës shqipe të akademikut Jani Thomai gjen një material të pasur frazeologjik në lidhje me veçoritë e psikës shqiptare, që lidhen me **besën, kodin e nderit**, si dhe me kultet: **kulti i qëndresës, kulti i luftës dhe i trimërisë kulti i të panënshtuarit, kulti i trashëgimisë**.

Instituti i besës- si institut dokesor

Besa është një dukuri universale me natyrë etnomorale dhe etnojuridike në jetën e popujve të lashtësisë dhe të bashkësive fashatare të mesjetës. Besa në traditën e popullit shqiptar konsiderohet jo vetëm si një virtyt, por edhe si një institut dokesor. Në kushtet tona historike **instituti i besës** ka luajtur rol pozitiv të veçantë, si mjet për të vënë rregull në marrëdhëniet familjare, krahinore e ndërkrasinore.

I ra në besë (dikuajt) 1. etnogr. *I kërkoi ta mbronte nga gjakësi.. 2. Iu dorëzua në mirëbesim.*

I jap besën (dikuajt) *zotohem para dikuajt, e siguroj për diçka me fjalën e nderit.*

Ajo mbështetëj në **kultin e fjalës së thënë**, e cila, sipas mendësisë së besimeve të lashta, ishte akt hyjnor i pathyeshëm.

I jap fjalën (dikuajt) *I premtoj, e siguroj dikë për diçka.*

Lidhën fjalën *u morën vesh përfundimisht për të bërë diçka së bashku.*

⁵⁰ Uçi, A., Cështje të estetikës e të kulturës, Tiranë, 2002.

⁵¹ Tirta, M. Etnologjia e shqiptarëve, Tiranë, 2003.

E mban fjalën (dikush) *e plotëson premtimin. është i besës kund. e ha fjalën; del nga fjala; luan nga fjala.*

Në lidhje me fjalën e dhënë shohim dashurinë e shqiptarit për të vërtetën.

Shqiptarët kanë një koncept krejt të veçantë për nderin. Ky fakt ka çuar në krijimn **e kodit të nderit**. Koncepti i ndershmërisë dhe pandershmërisë del në njësitë frazeologjike, të cilat janë të shumta në numër. Duke parë përbërjen e tyre leksematike, do të dallonim:

Së pari, njësi frazeologjike që kanë në përbërjen e tyre fjalën “nder”.

Doli me nder (dikush) *gjeti zgjidhje të mirë për të dalë nga një gjendje e vështirë; përfundoi me sukses një punë të vështirë; doli faqebardhë.*

I mori nderin (dikujt) *1. E fyeu rëndë dikë para të tjerëve; e turpëroi. 2. E cnderoi një femër.*

I bëj nder dikujt *E nderoj.*

Urimet si një pjesë e kodit etik, pra si simbole të mirësjelljes janë ndërtime gjuhësore, që gjithashtu kanë në përbërjen e tyre këtë fjalë.

T’u rritë nderi! Ur. faleminderit! Qofsh i nderuar! Me nder qofsh!

Së dyti, ky koncept del edhe në njësi të tjera frazeologjike, vatrat kuptimore të cilave janë pikërisht fjalët që përfaqësojnë fjalën “nder”. Këto fjalë janë:

1. cipë p.sh:

Ka cipë (dikush) *është njeri i ndershëm, preket e turpërohet për gabimet e veta; është njeri me sedër; Natyrisht këtu përfshihen edhe ndërtimet me ngjyrim keqësues.*

I ka plasur cipa (e ballit) (dikujt) *keq. është bërë i pacipë; s’ka turp fare.*

2. fytyrë, p.sh.:

Ka një fytyrë (dikush) *është njeri i ndershëm e i ciltër;*

Ka dy fytyra (dikush) *nuk është i ndershëm dhe i ciltër, është i paqëndrueshëm e hipokrit, flet e vepron sipas interesit të vet. Është mësallë me dy faqe; (është njeri) me dy faqe; (është njeri) me dy fytyra; të lan e të lyen.*

3. ballë, p.sh.:

Me ballë të larë (ballëlarë).

Me ballë lart (ballëlart), *krenar; me kokën lart; me shpatullat drejt; me faqe të bardhë.*

Nuk e fsheh ballin (dikush) *është i ciltër e i sinqertë, nuk ka përse të turpërohet.*

4. gjak p.sh.:

Ka gjak në fytyrë (në faqe) (dikush) *është i ndershëm, është njeri me cipë.*

5. faqe p.sh.:

doli faqebardhë.

Faqja e bardhë, ai që të nderon, njeriu që të zbardh faqen; kund. faqja e zezë.

Në traditën shqiptare gabimi do çonte dikë në humbjen e nderit e madje do të njolloste “fisin”, të gjithë personat me lidhje gjaku me këtë person që etiketohet “pa nder”.

E ka për fis (dikush) *e ka zakon të trashëguar; ajo sjellje i shkon; i shkon për farë; i shkon për gjak; ia heq oxhaku.*

Vajti në fis (dikush) keq e tregoi veten se kush është e sa vlen; sillet a vepron sipas edukatës që ka marrë.

Hahni ka thënë se shqiptarët në çdo rast i është dashur të jetë gati të kapë armët, pasi ka rrojtur vazhdimisht në rrezik. Një fakt i tillë bëri që **lufta dhe trimëria** për të kthehen në kult. P.sh. fjala “pushkë” është vatra kuptimore e njësive frazeologjike me të cilat jepet pjekuria e një mashkulli: **Është bërë për pushkë** (dikush) është rritur dhe është pjekur, është bërë për të luftuar me pushkë. por, edhe emocionet a tipare fiziologjike, si: **M’u bë qejfi pushkë u gëzova shumë se plotësova cdo dëshirë; u kënaqa pa masë; mu bë zemra mal.**

E ka syrin pushkë (dikush) sheh shumë mirë larg.

E ka zërin pushkë (dikush) e ka zërin të fortë e kumbues, gjë që tregon vlerësimin për këtë armë.

Fjala “burrëri” për shqiptarët do të thotë “fisnikëri”. Jo çdo mashkull vlerësohej si burrë, por ata që kishin vetitë morale që kishte vendosur bashkësia shoqërore. Burrat që dalloheshin, sepse përfaqësonin me dinjitet bashkësinë quheshin “burra të dheut”.

Pikërisht edhe njësiti frazeologjike pjekurinë moshore dhe guximin i identifikojnë me burrërinë.

U bë burrë (dikush) 1. U rrit, u trimërua. 2. Mori guxim dhe trimërohet, nuk trembet më; mori zemër.

Burri i dheut njeri i fortë, me karakter të fortë.

(Është) një burrë e gjysmë (dikush) është trim i madh, trim e shkuar trimave.

Natyrisht kulti i luftës dhe trimërisë është i lidhur me: **“Kultin e qëndresës, kultin e të panënshtuarit”**

Njësi frazeologjike të tilla si:

E drejtoi shpinën (dikush) u bë krenar, nuk është më i përlulur e i nënshtuar; **drejtoi kurrizin.**

S’ia kanë parë shpinën (dikujt) është trim, i qëndron përballë cdo rreziku.

Nuk e fsheh ballin (dikush) 1. është trim i madh s’i trmbet (fiket) syri

Nuk i mbahet gjaku (dikujt) nuk përmbahet, mezi duron, hidhet me guxim në rreziqe.

dëshmojnë për një vlerësim të lartë për dinjitetin. Fjalët “shpinë”, “kurriz”, “ballë”, “gjak” do të thoshim se bëhen simbol i këtij dinjiteti.

Një kult tjetër, tepër i rëndësishëm është edhe “Kulti i trashëgimisë”

Kulti i trashëgimisë lidhet me ripërtëritjen e jetës. Në familjet patriarkale dëshirohej që gratë të lindnin sa më shumë fëmijë, sidomos djem, sepse pasardhësi mashkull do të sillte mbarësi, pasi ai do të trashëgonte emrin e familjes dhe pasurinë.

Në traditën e vjetër popullore bashkësia familjare është identifikuar me shtëpinë. Kjo vërtetohet në njësiti frazeologjike ku fjalët: **“shtëpi”, “derë”, “vatër”** përdoren me kuptimin familje. Natyrisht, kemi në këtë rast përdorimin e një metonimie. Në kushtet e veçanta të jetës shqiptare ripërtëritja e jetës është një domosdoshmëri për mbijetesë, prandaj edhe njësi frazeologjike bart ka një peshë të madhe emocionale p.sh.:

Iu mbyll shtëpia (dikujt) mbeti pa fëmijë, nuk la pasardhës; **mbeti pa njeri, mbeti shkretë; iu mbyll dera; iu shua pragu; i ka dalë rrënja, iu shkulën caranjtë e vatrës.**

Iu hap dera (dikujt) *siguroi vijimësinë e familjes me lindjen e një fëmje; zakonisht të një djali (sipas mendësisë poulllore).*

E mbylli derën (dikush) *vdiq pa lënë njeri pas nga gjaku dhe familja e tij, s'la pasardhës a trashëgimtarë; e mbylli shtëpinë; i hodhi rezen shtëpisë (derës); ia thau vatrën (dikujt).*

Iu shua vatra (dikujt) *mbeti pa fëmijë, nuk la pasardhës.*

Ia thau vatrën (dikujt) *nuk i bëri fëmijë.*

II.b. Gjuha është produkt i zhvillimit kulturor-historik, një ndër format dhe faktet e këtij zhvillimi

Së pari, në qoftë se do t'i drejtoheshim formës do të vërenim se me disa përjashtime të vogla të gjitha njësitë e tjera frazeologjike janë të **tipit foljore**. Gjenetikisht, trajta gramatikore pasqyron një zberthim gradual të përmbajtjes së botëkuptimeve të shprehura në gjuhë.

Kategoritë gramatikore të foljes, veta, koha, mënyra shprehin raportet me objektin dhe subjektin. Me bindje do të thoshim se mbizotërimi i njësisë frazeologjike foljore flet për dendurinë e konsiderueshme të përdorimit të këtyre njësive.

Së dyti, struktura e këtyre njësive paraqitet:

a) kryesisht dygjymtyrëshe, folje – emër. Shpesh si gjymtyrë e parë është një folje kalimtare, p. sh. **e drejtoi shpinën; drejtoi kurrizin; ka sedër, ka cipë.**

Në këtë rast kalimtarësia lidhet me gjymtyrën emërore të njësisë frazeologjike dhe shpreh raport të brendshëm, por mund të ketë edhe lidhje të dyfishtë të brendshme e të jashtme në këtë rast paraprihet nga një trajtë e shkurtër përemërore. Gjithashtu në këto njësi frazeologjike që morëm në shqyrtim do të dallonim ato të cilat nisin detyrimisht me një trajtë të shkurtër përemërore në rasën dhanore p.sh.: **i jap besën; i është ndryshkur pushka.**

Siç del edhe nga dy shembujt e mësipërm, kur kjo trajtë përemërore ka një referent të jashtëm, njësia del në tri veta, ndërsa kur ka një referent të brendshëm, del vetë në vetën e tretë.

c) Njësi frazeologjike me strukturë fjalie (a të një fragmenti të saj), i ka plasur damari i ballit; i ka plasur perdja; i është bërë faqja rrogoz; i doli boja.

Ashtu siç thuhet edhe në fjalorin frazeologjik, këto ato struktura kanë dalë nga ngrirja e një trajte fjalie dhe nuk mund të shndërrohen në struktura togfjalëshash sintaksorisht të modelueshme.

Së treti, sintagmatika e këtyre njësisë frazeologjike ose frazematika, si konteksti i realizimeve shërben jo vetëm për të nxjerrë kuptimet e njësisë, por zbulon edhe mundësitë e lidhjeve të saj sintaksore të ndryshme, tipin e leksemave që formojnë sintagma me të, tek e fundit, veçoritë e përdorimit të saj në ligjërimin e gjallë. Pikërisht këtu s'jemi kund tjetër, veçse në hapësirën sociolinguistike.

Së katërti, sinonimia është në një shkallë të konsiderueshme.

Ajo që duhet të theksojmë është se sinonimet paraqiten si të mirëfillta, pra kanë të njëjtin kuptim, por nuk kanë në strukturën e tyre asnjë gjymtyrë të njëjtë. P. sh.: **i është bërë faqja rrogoz; i doli boja; (është) cardak pa parmak; e ka ngrënë turpin me bukë; nuk e ka për gjë.** Por hasim edhe njësi sinonimike me me gjymtyrë të ndryshme, që formohen si të tilla nga kuptimet e prejardhura sinonimike. P.sh.: **i ka plasur peta e ballit; i ka plasur damari i ballit;**

i ka plasur perdja; S'i nxihet balli; s'i nxihet faqja. Pikërisht me këtë tipar dëshmohet jo vetëm pasuria frazeologjike për këto koncepte por edhe uniteti i bashkësisë shoqërore dhe bashkësisë gjuhësore shqiptare.

Në këtë kumtesë përzgjedhëm dhe trajtuam një pjesë shumë të vogël të materialit frazeologjik, por mundësitë për studime etnolingistike janë të panumërta.

Në këtë fjalor, materiali frazeologjik nuk përbën vetëm dukurinë gjuhësore, në këto njësi frazeologjike kemi historinë, etnografinë, shpirtin e një populli. Kemi etnokulturën e shqiptarit të Tiranës, Kosovës, Maqedonisë, a Malit të Zi.

Ky fjalor përfaqëson mbarë bashkësisë gjuhësore shqiptare. Frazeologjia si pjesë gjuhës sonë, shfaqet si produkt i zhvillimit kulturor-historik. Ajo është formë dhe fakt i këtij zhvillimi.

Fjalori frazeologjik i akademikut Jani Thomai është një dëshmi e **identitetit tonë kombëtar.**

AKADEMIK JANI THOMAI DHE LEKSIKOGRAFIA SHQIPE E SHEK. XXI

Profesor J. Thomai, në të 75 vitet e jetës së tij, identifikohet me prurje që e pohojnë si personalitet të spikatur shkencor dhe si një nga figurat me kontribut shumë të rëndësishëm në fushën e albanologjisë. Vepra e tij, megjithëse shpërfaqet në disa fusha, është e lidhur kryesisht dhe pazgjidhshmërisht me leksikografinë shqipe e me fjalën shqipe dhe me vepra që janë në themel të kulturës sonë kombëtare. Shekulli XX është shekulli i leksikografisë njëgjuhëshe shqipe. Ndiheja e J. Thomait në gjysmën e dytë të këtij shekulli duket, ndër të tjera, në punën si bashkëredaktor e si bashkëhartues për dy fjalorët shpjegues kombëtarë të shqipes standarde, të *Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe* (1980) dhe të *Fjalorit të shqipes së sotme* (1984) dhe për fjalorin *Për pastërtinë e gjuhës shqipe* (1998), si bashkëhartues dhe si redaktor përgjegjës për *Fjalorin frazeologjik ballkanik* (1999) dhe si hartues i të parit fjalor frazeologjik të gjuhës shqipe (1999).

Kurse shekulli XXI e gjen J. Thomain, jo vetëm drejtues të Departamentit të leksikologjisë dhe të terminologjisë, në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë, anëtar të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, anëtar të Shoqatës së Leksikografëve Evropianë, por në krye e në pozicione përcaktuese të të gjitha punëve që lidhen me leksikologjinë e leksikografinë shqipe, me semantikën leksikore, me frazeologjinë e frazeografinë në rrafsh kombëtar. Vepra e tij është shumëpërmasore, është vazhdim, rritje, ripohim i pjekurisë dhe i kompetencës së tij shkencore, si dhe i vetë shkencës leksikografike.

Vëmendja e profesorit, gjatë viteve të punës, por edhe tani, nuk është shkëputur asnjëherë nga detyra të tilla, si: *plotësimi i spektrit tipologjik leksikografik të shqipes, rritja e cilësisë shkencore, nxitja e kritikës shkencore e të studimeve teorike në këtë fushë, shfrytëzimi i përvojave botërore e bashkëkohore, botimi e përhapja e fjalorëve, përdorimi i mjeteve dhe i metodave kompjuterike në leksikografi, forcimi i bashkëpunimit dhe i shkëmbimit të përvojave, përgatitja e leksikografëve* etj. Edhe në këto çaste, kur vitet e kanë pensionuar, ai vazhdon të jetë në krye të këtyre punëve, me veprimtarinë e pandërprerë dhe me dinjitetin e shkencëtarit skrupuloz.

Ai inicioi e drejtoi përgatitjen dhe zhvillimin me sukses të dy konferencave ndërkombëtare, të parat në llojin e vetë në Shqipëri: *Leksikografia shqiptare - trashëgimi dhe perspektivë* (2005), si dhe *Gjendja dhe zhvillimi i terminologjisë shqipe* (2009).

Megjithatë, nga shumësia e vlerave të veprës së J. Thomait, po veçojmë:

Së pari, ai ka qenë dhe është **drejtues i projekteve** madhore kombëtare që realizohen në grup, të ndërmarra në kuadrin e PPKZH, si ai për hartimin e *Fjalorit sinonimik të gjuhës shqipe* (botuar më 2004), ai për hartimin e *Fjalorit të gjuhës shqipe* (botuar më 2006), ai për hartimin e *Fjalorit të madh të shqipes* (në fazë projekti dhe në dy mundësi, si fjalor pesëvëllimësh ose si fjalor njëvëllimësh, me rreth 100.000 njësi leksikore), por edhe në projekte të tjera kombëtare, si ai për ripunimin dhe për përmirësimin e *Fjalorit të shqipes së sotme* dhe ai për hartimin e një fjalori të vogël shpjegues (me rreth 30.000-35.000 fjalë), që është në fund të procesit të

realizimit. *Parashtrësit* e këtyre veprave, që nënkuptojnë *hartimin e parimeve* mbi të cilat do të realizoheshin vepra, janë produkt shkencor i akademikut J. Thomai. Platformat e përgatitura prej profesor J. Thomai për këta fjalorë kanë qenë shkencërisht të një niveli shumë të lartë. Ato mishërojnë vazhdimësinë dhe konsolidimin e punës e të përvojës së krijuar në shekullin e mëparshëm, si dhe një shkallë të re sasimore e cilësore në hartimin e fjalorëve.

Së dyti, këtë fillimshkull ai ka qenë **redaktor shkencor** i të gjitha veprave leksikografike të botuara dhe të atyre në proces, duke pasur peshën përcaktuese në zbatimin e unifikuar të parimeve për hartimin e çdo veprë. Bashkëpunimi i tij si redaktor shkencor me hartuesit dhe ndërmjet vetë hartuesve nën drejtimin e tij ka qenë jo vetëm një nga mundësitë për ngritjen cilësore të fjalorëve, por dhe një kahe e punës shkencore, korrekte dhe të pakompromistë të profesorit. Profesionalizmi ka çuar jo vetëm në verifikimin e dallimeve, që janë të natyrshme në vepra të hartuara me bashkautorë, por edhe në sheshimin, në ndreqjen e tyre, duke çuar në njësimin e sipas parimeve e kritereve të pranuar dhe duke sjellë në simetri gjithë përbërësit e fjalorëve etj.

Së treti, J. Thomai është në të gjitha këto vepra edhe **bashkautor** dhe hartimi i shkronjave prej tij kanë shërbyer si modele pune për hartuesit e tjerë. Përmendim këtu ripunimin dhe përditësimin e zërave leksikografikë që për shkronjat: A, B dhe pasqyrat gramatikore të *Fjalori i shqipes së sotme* (2002), hartues i zërave leksikografikë të shkronjave A, B, C, Ç, O, Q, U, Z, ZH të *Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe* (2004), hartues i zërave leksikografikë të shkronjave A, B të *Fjalori i gjuhës shqipe*, hartues i zërave leksikografikë të shkronjave A, B, C, Ç, U të *Fjalori i vogël i gjuhës shqipe* (2010).

Tri komponentet e punës së tij leksikografike: si drejtues, si redaktor shkencor dhe si bashkëhartues, e bëjnë atë figurën leksikografike më të plotë dhe më modelore në ditët e sotme apo në këtë fillim shekulli. Jeta e J. Thomait, si dhe e shumë gjuhëtarëve të tjerë është e lidhur pazgjidhshmërisht me fjalën shqipe, me jetën e saj. Cilat janë prurjet te veprat që i kemi përmendur deri tani?

1. Në kapërcyell të shekullit të kaluar, nën drejtimin tij u ripunua dhe u përditësua *Fjalori i shqipes së sotme*, botuar më 1984. J. Thomai pohon se “Është në natyrën e fjalorëve që të përtërihen vazhdimisht, të përsosen nga ana tipologjike, të pasurohen e të përditësohen nga përmbajtja leksikore e semantike dhe të përshtaten nga ana funksionale sipas nevojave të përdoruesve të tyre. Madje njihet prej kohësh në leksikografinë botërore që një fjalor i mirë bëhet në tipin e vet “fjalor serie” nëpërmjet ripunimeve e ribotimeve periodike.”⁵²

Duke u mbështetur në këto parime shkencore, gjatë një procesi disavjeçar, *Fjalori* u pasurua me fjalë dhe kuptime të reja, të cilat në vitet '90 të shekullit të kaluar kishin përdorim të përgjithshëm dhe mungonin në botimin e vitit 1984; u përmirësuan shpjegime dhe përkufizimesh fjalësh dhe termash, duke i shkarkuar nga ngarkesat e panevojshme ose me karakter politizues dhe ideologjizuese; u rivlerësua dhe gjeti vend më të plotë leksiku fetar, u harrën një pjesë e

⁵² J. Thomai, *Leksikografia shqipe - trashëgimi dhe perspektivë*, në “Leksikografia shqipe - trashëgimi dhe perspektivë”, f. 11

njësive frazeologjike, duke shtuar njësi të reja, por edhe thënie që pasqyrojnë përdorimin e fjalëve dhe të kuptimeve në ligjërimin e sotëm.⁵³

2. Gjithashtu, pas një pune të jashtëzakonshme, të mbështetur në përvojën e pasur të grupit hartues, si dhe nga drejtimi me aftësi e nga redaktimi me profesionalizëm shkencor prej prof. Jani Thomai, në vitin 2004 del në qarkullim ***“Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe”***. Hartuesit u gjendën para shumë vështirësive, që lidheshin, qoftë me aspektin teorik për sinoniminë leksikore, qoftë me aspektin leksikografik për fjalorin. Ndaj J. Thomai, që në krye të fillimit të punës, përgatiti një parashtrësë që mori në vepër formën e *Hyrjes*, ku jepen parimet e kriteret e ndërtimit të këtij fjalori, por edhe ku shpjegohet gjerësisht dhe në një nivel të lartë shkencor koncepti për sinoniminë leksikore (duke e parë si nga aspekti teorik, ashtu dhe nga aspekti i përdorimit në ligjërim (letërsi, publicistikë, përkthime etj.). Kjo reflektua në fjalor në të cilin sistemi teorik për sinoniminë përshkon gjithë lëndën, makrostrukturën e mikrostrukturën e tij, përzgjedhjen e fjalëve, raportet leksiko-semantike ndërmjet tyre, bashkësinë e diferencat, veçoritë e përdorimit etj. Fjalori mëton të jetë jo thjesht një vepër gjuhësore praktike, por edhe një “traktat” teorik në mungesë të studimeve të plota për sinoniminë leksikore në gjuhën shqipe.⁵⁴

Hartuesit dhe redaktori shkencor u gjendën përballë vështirësive jo të vogla, si përcaktimi shkencërisht i kufijve të sinonimisë, dallimi i dy serive të sinonimisë leksikore: *fjalë me kuptim të njëjtë* dhe *fjalë me kuptim të afërt*, përcaktimi i koncepti të vargut sinonimik dhe të grupit sinonimik, që lidhej drejtpërdrejt me njësitë që do të përfshiheshin në fjalor dhe me strukturimin e tyre në një kuptim a në të gjithë strukturën semantike të fjalës dominonte; vlerësimi i raporteve ndërmjet një fjale me vëllim semantik të gjerë (me kuptim gjenerik) dhe fjalëve që barazohen me të në fusha leksikore të ndryshme etj.

Këto vështirësi u zgjidhën në *Parashtrësën* e hartuar nga akademiku J. Thomai, por edhe hap pas hapi gjatë punës hartuese e redaktuese. Fjalori e ka kapërcyer çastin e përballjes me përdoruesin dhe me gjykimin e vlerësimin e tij. Në të gjen rreth 29.000 fjalë sinonimike, që janë të organizuara në vargje sinonimike, që janë dhënë me ndarje kuptimore, me shpjegime të ngjeshura e me shembuj nga letërsia artistike, nga publicistika, nga folklori, nga ligjërimet e folura popullore etj., me shtresime sipas përdorimit, sipas fushave e sipas vlerave të mbishtresuara, me shpjegime e shënime plotësuese që dallojnë njësitë normë nga fjalët krahinore të ngushta a të vjetruara etj.

3. Akademik Jani Thomai është drejtues i projektit, redaktor shkencor dhe bashkëhartues dhe te *Fjalori i gjuhës shqipe*, 2006. Kjo vepër kombëtare ka një numër më të madh fjalësh se fjalorët e mëparshëm, por vëllimi i tij fizik është zvogluar nëpërmjet trajtimit leksikografik të një fjalori të vogël: sinteza më të mëdha kuptimore që ngjeshin strukturat kuptimore të fjalëve, gërshetimi i tipit leksemor me atë çerdhor në fjalë me prejardhje të drejtpërdrejtë fjalëformuese. Fjalori është vepër e re leksikografike, që ruan në shkallën më të lartë vlerat kryesore të fjalorëve të mëparshëm shpjegues të shqipes dhe synon t’i rritë dukshëm këto vlera, si me fjalë e kuptime

⁵³ Shih më gjerë *Parathënie e botimit të dytë*, në “Fjalor i shqipes së sotme”, Tiranë, 2002

⁵⁴ J. THOMAI ..., *Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2004, f.

(në makrostrukturë), ashtu edhe me ndërtimin e çdo zëri leksikografik (në mikrostrukturë). Tipar themelor i këtij fjalori dhe kërkesë për hartimin tij ka qenë, ndërkaq, prirja për t'i dhënë më shumë hapësirë korpusit leksikor, d.m.th. numrit të fjalëve, veçanërisht fjalëve që sot kanë një përdorim të gjerë në fusha të ndryshme të veprimtarisë gjuhësore (kryesisht të shkruar), pra për të cilat ka më shumë nevojë përdoruesi i këtij fjalori. Fjalori është kështu një kod leksikor i përgjithshëm i ditëve tona. Ai është hartuar duke u mbështetur kryesisht në një lëndë që gjendet në KLSH (Kartoteka e Leksikut të Shqipes) ose që ka dalë nga vjeljet më të fundit të fjalëve e të frazeologjisë nga letërsia artistike, nga shtypi i kohës, nga fjalorët shpjegues kombëtarë dhe nga fjalorët e tjerë të shqipes (dygjuhësh, krahinorë, terminologjikë, frazeologjikë, sinonimikë, antonimikë etj.). Fjalori i ri, si pasqyrë e realitetit gjuhësor të shqipes standarde sot ose të vështruar nga kërkesat e këtij standardi, u ruhet elementeve të rastit, të përkohshme (kalimtare), të pangulitura ose që nuk kanë të ardhme, si edhe elementeve enciklopedike, etno-folklorike ose historike të ngushta, që në fjalorë të tjerë jepen në emër të pasurimit kulturor. Në fjalor janë përfshirë shumë fjalë, shprehje e kuptime që përdoren sot në shqipe dhe që nuk gjenden në fjalorët e mëparshëm shpjegues të shqipes. Kjo lëndë e re pasuruese, që është nxjerrë nga vjelja leksikore e veprave të letërsisë artistike a shkencore, nga shtypi i përditshëm e periodik, nga fjalorë dygjuhësh, sinonimikë, krahinorë etj., e ka përditësuar kënaqshëm fjalorin. Ai përfshin shtresën kryesore, më aktive, të leksikut të gjuhës së sotme shqipe (kryesisht nga leksiku i shqipes standarde) dhe një pjesë të kufizuar, krejt të domosdoshme, të shtresës pasive. Ky parim vlen edhe për sistemin e kuptimeve, për frazeologjinë dhe për vlerat mbishtresore të fjalëve. Në fjalor është ruajtur simetria ndërmjet strukturës leksikore dhe strukturës semantike; është ruajtur karakterit normativ etj.

Fjalori mëton të jetë një mjet pune për një rreth shumë të gjerë përdoruesish. Me këtë përmbajtje ai u drejtohet kryesisht shtresave shoqërore të nivelit të mesëm arsimor e kulturor (dhe më pak specialistëve), pra ka më shumë synime praktike sesa fjalorët e mëparshëm shpjegues të shqipes.

4. Por ky fillim shekulli, për ne bashkëpunëtorët J. Thomait dhe për mjedisin shkencor gjuhësor së shumti lidhet me përpjekjet e pareshtura të tij për realizimin e **veprës kurorëzuese të leksikografisë shqipe**, hartimin e një fjalori të madh të gjuhës shqipe, të ideuar me 5 vëllime, një kërkesë e kahershme dhe një detyrë e një rëndësie të veçantë. Puna e nisur në vitet '70 të shekullit të kaluar, përveç bazës materiale e teknike, kërkon, në nivelin e sotëm të leksikografisë, edhe sigurimin e një ekipi leksikografësh të formuar e me përvojë dhe një parapërgatitje në kohë të mjaftueshme për përmasat e vështirësitë e një veprë të tillë. Jani Thomai si shkencëtar vizionar ka këmbëngulur e këmbëngul në mënyrë të vazhdueshme për hartimin e *Fjalori të madh të shqipes* vëllimi i të cilit do të ishte me mbi 100.000 njësi leksikore e mbi 12.000 njësi frazeologjike. Profesori i mëshon faktit se shqipja është nga gjuhët e pakta që nuk ka një fjalor të tillë, për të cilin, kur shprehesh se është i domosdoshëm dhe i nevojshëm, thua më të paktën e asaj që duhet thënë. Sipas *Parashtresës*, tipi i fjalorit do të ndryshojë raportin ndërmjet funksionit informues dhe *funksionit normativ*: funksioni informues në fjalor do të rritet shumë, krahasuar me fjalorët e mesëm dhe të vegjël, si në fjalës edhe në përbërësit e tjerë të

makrostrukturës dhe të mikrostrukturës. Norma gjuhësore e standardit në fjalor do të përcaktohet jo përmes përjashtimit, por shpesh nëpërmjet kufizimeve me shënimet e nevojshme të elementeve jonormë. Fjalëve krahinore shqipe dhe krijimeve të reja me mjetet dhe sipas modeleve të shqipes do t'u hapet rruga për përgjithësim drejt standardit. Mjet dhe mënyrë dallimi ndërmjet normës dhe jonormës do të jetë edhe tipi i shpjegimit (do të ketë më shumë shpjegime me sinonimi për njësitë e kufizuara). Fjalori, nuk do të synojë t'u mbyllë dyert fjalëve, shprehjeve e kuptimeve, por do t'i hedhë ato të konkurrojnë lirisht dhe të provohen realisht në truallin e përdorimit të gjallë ligjërimit, pavarësisht nga burimi krahinor, nga krijuesi, nga mosha.⁵⁵

Nën udhëheqjen e profesorit u përgatit projekti që u dërgua për miratim. Ndërkohë që pritej të zyrtarizohej puna, grupi i hartuesve filloi punën me fjalësin e vëllimit të parë. Kurse vetë J. Thomai përfundoi së hartuari edhe një shkronjë si gjedhe të punës për hartuesit e tjerë. Krijimi i QSA dhe riorganizimi i punës shkencore në Institut, shtroi si përparësi hartimin e një fjalori të madh njëvëllimësh, për të cilin i ndoq e njëjta ecuri. Me dhimbje po rithem se, ashtu si projekti i parë, edhe ky ka hyrë në kalendrat greke, grupit të leksikografëve profesionistë po u shtohen vite mbi supe dhe zbrazëti është trembëse, për të mos thënë vrastare. Kush do ta hartojë një vepër të tillë kur praktika botërore pohon se duhen dhjetëra e qindra forca të specializuara për realizimin e saj? Ky është dhe pengu kryesor i profesorit.

5. Në punën për plotësimin e spektrit tipologjik leksikografik, përsëri nën udhëheqjen e J. Thomait, filloi para një viti puna për hartimin e *Fjalorit të vogël të gjuhës shqipe*, i cili synon të jetë mjet pune, kryesisht për shkollarët, fjalor që është në proceset përmbyllëse. **Makrostruktura** e tij përfshin, së pari, fondin themelor të shqipes bashkëkohore, fjalët me peshë emërtuese të rëndësishme, me dënduri të madhe përdorimi dhe me shtrirje gjeografike sa më gjithëpërfshirëse. Fjalësi është me rreth 30.000 fjalë dhe 2.000 njësi frazeologjike, duke lënë mënjane fjalë krahinore skajore, fjalë të vjetruara, huazime të tejkaluara, variante fonetike e fjalëformuese të panevojshme për përdoruesin shkollor, terma tepër specialë, njësi frazeologjike të rralla etj. Fjalori ruan maksimalisht pasurinë sinonimike të shqipes, duke synuar që të jetë fjalor i tipit të përgjithshëm për shkollarët, por jo fjalor shkollor. Fjalori ka realizuar **një simetri** të arsyeshme dhe të domosdoshme për fushat leksikore, që lidhen me fushat kryesore konceptore të botës materiale e shpirtërore të folësve të shqipes sot dhe është pasuruar me fjalë që përdoren dëndur në veprimtarinë mësimore, me huazime sidomos nga anglishtja, të cilat tashmë kanë zënë vend në leksikun e shqipes. Vepra karakterizohet nga një *thukësi e sintezë* semantike në **mikrostrukturën** e çdo zëri leksikografik, çka shpërfaqet në ndërtimin e strukturave të ngjeshura semantike, duke mënjeluar kuptimet dialektore shumë të rralla, kuptimet e vjetruara, kuptimet terminologjike shumë speciale, njëkohësisht, duke shtuar edhe kuptime të reja që qarkullojnë në ligjërimit shkollor sot.

⁵⁵ J. Thomai, *Fjalor i gjuhës shqipe me rreth 85.000 fjalë dhe 10.000 njësi frazeologjike*, Parashtrësë e përgjithshme, depozituar pranë Departamentit të leksikologjisë dhe të terminologjisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2008

Thukësia është arritur dhe me *shkrirjen në një të kuptimeve të afërta*, me shtrirjen e gjerë të shpjegimit me sinonimi, me përdorimin e formulave tipike shpjeguese për klasa a grupe të caktuara leksikore, me përzgjedhjen e thënieve tejet të domosdoshme etj.

d. Profesor J. Thomai në këtë fillimshkull ka ripunuar dhe ka plotësuar me lëndë të re *Fjalorin frazeologjik të gjuhës shqipe* (1999), i cili po pret ditën e botimit. Duke qenë themelues edhe i frazeografisë kombëtare, nuk e vëmë në dyshim se nga duart e tij do të dalë përsëri një vepër me prurje sasiore dhe cilësore dhe e vlerësuar në të gjithë parametrat e treguesit shkencorë e teknikë.

1. Te J. Thomai janë ndërthur pandashëm **puna hartuese** me **atë studimore** dhe kjo është një tjetër vlerë e spikatur e personalitetit të tij shkencor. Ai mbetet, tani për tani, leksikografi me punime monografike më të shumta e cilësore. Po përmend këtu *Çështje të frazeologjisë në gjuhën shqipe*, *Prejardhja semantike në gjuhën shqipe*, *Leksiku dialektor e krahinor në gjuhën shqipe*, *Veçori leksiko-semantike të ndajfoljeve me prapashtesa në gjuhën shqipe*, krahas hartimit të tekstit universitar *Leksikologjia e gjuhës shqipe* dhe përmbledhjes *Teksti dhe gjuha*. Këto punime jo vetëm tregojnë punën e autorit dhe nivelin në të cilën kanë arritur studimet tona leksiko-semantike, jo vetëm janë sinteza e përgjithësime të punës me fjalën shqipe, por edhe udhëheqin gjithë punën hartuese leksikografike, sidomos për përzgjedhjen e fjalës në një fjalor, për ndërtimin e strukturave kuptimore të fjalëve, për konceptimin simetrisë ndërmjet klasave, shtresave a grupeve leksikore, etj. Mjafton të themi që *Prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe* ka peshën e vetë të mirëfilltë në futjen të elemente çerdhore te *Fjalori i gjuhës shqipe*, 2006, për herë të parë në leksikografinë shqipe⁵⁶.

f. J. Thomai mbetet **asnjanës** në vlerësimin e punës leksikografike. Në shumë punime a veprimtari shkencor ai jo vetëm ka pohuar arritjet në fushën e leksikografisë së gjuhës shqipe, por edhe mangësitë. Ai pranon si arritje pasurimin hap pas hapi “të spektrit tipologjik leksikografik”, nëpërmjet hartimit të fjalorëve të tipave të ndryshëm: filologjikë e enciklopedikë, shpjegues (të përgjithshëm kombëtarë e krahinorë), dygjuhësh e shumëgjuhësh, terminologjikë, frazeologjikë, sinonimikë, antonimikë, historikë e etimologjikë, drejtshkrimorë e onomastikë, fjalorë autorësh, fjalorë elektronikë, të vegjël e të mesëm etj. Ky spektër tipologjik është kushtëzuar si nga kërkesat, ashtu edhe nga mundësitë e kohës, por ajo nuk është ende i plotë. Mungojnë deri më sot disa tipa fjalorësh, si një fjalor i madh e një fjalor “thesaurus”, që do të pasqyronin sa më gjerë pasurinë leksikore, frazeologjike e semantike të gjuhës shqipe dhe do të ishin burime kryesore të lëndës për shumë fjalorë të tjerë; nuk kemi ende fjalorë shkollorë dhe fjalorë “moshorë”, d.m.th. për fëmijët, për të rinjtë etj.; po ashtu nuk kemi një fjalor të fjalëve të huaja që kanë hyrë me shumicë në gjuhën shqipe që nga vitet '90 të shekullit XX e këtej (përfshirë edhe mundësinë e zëvendësimit të tyre me fjalë shqipe). Mungojnë edhe tipa të tjerë fjalorësh, shkencërisht e praktikisht të dobishëm, si fjalorë të dëndurisë (të frekuencës), fjalorë

⁵⁶ Fjalor i gjuhës shqipe, Tiranë, 2006

çerdhorë, fjalorë shpjegues profesionalë, fjalorë të anasjellë (inversë), fjalorë ideografikë, fjalorë paradigmaticë, etj.⁵⁷

Nëse para leksikografisë shqipe qëndrojnë disa detyra parësore, është meritë e akademik J. Thomai për parashtrimin e tyre më se njëherë, ndër të cilat po veçojmë: rritjen e cilësisë shkencore të fjalorëve, shfrytëzimin e mundësive e të formave të bashkëpunimit dhe shkëmbimi i përvojave leksikografike (ngritja e një shoqate kombëtare të leksikografëve; regjistrimin elektronik të fondeve leksikore, në radhë të parë të kartotekës së leksikut të shqipes me mbi 5 milionë skeda, që dëshmon rreth 180 000 fjalë, ndërmarrjen e studimeve në fushë të teorisë së leksikografisë dhe nxitjen e kritikës shkencore mbi vepra të kësaj gjinie; hartimin e historisë së leksikografisë shqipe, që të përshkruajë e të vlerësojë trashëgiminë dhe të përgjithësojë përvojën në këtë fushë.

Si përfundim, themi me bindje se nga vepra e akademik J. Thomai ka se ç'mëson dhe ç'përfiton gjuhëtari e mësuesi, studenti e dijetari i ardhshëm, ka seç fiton qytetari që synon Evropën dhe shqiptari atdhetar, sepse vepra e tij shpërfaq para të gjithëve dijen shkencore dhe metodën e studimit, produktin shumëvalencësh dhe rrugët e realizimit, ashtu si shpërfaq identifikimin kombëtar përmes gjuhës shqipe e fjalës së saj, që te ky personalitet ka gjetur përmasën më të synueshme.

⁵⁷ J. Thomai, *Leksikografia shqipe - trashëgimi dhe perspective*, në "Leksikografia shqipe - trashëgimi dhe perspective", fq. 12-13

Prof. dr. SHEFKIJE ISLAMAJ

Instituti Albanologjik i Prishtinës

PREJ FJALËS TE FJALORI

Është nder për mua të marr pjesë në një konferencë kushtuar njërit prej studiuesve të mëdhenj të gjuhës shqipe, i cili me punën e vet shkencore në një fushë shumë të rëndësishme të gjuhësisë shqiptare jo vetëm i ka vënë asaj shtyllë të qëndrueshme, por ka hapur edhe rrugë të sigurt nëpër të cilën duhet të ecë tutje gjuhësia shqiptare, teorike dhe ajo e zbatuar.

Kumtesën time e kam titulluar “Prej fjalës te fjalori”, sepse konsideroj se me këtë titull e paraqes thelbin e punës shkencore të prof. Jani Thomait.

Prof. Jani Thomai ka një trashëgimi të pasur e të shumanshme shkencore. Vepra e tij shkencore është sintezë e dijeve të tij të thella e të gjera dhe e përvojës së gjatë në studimin e çështjeve themelore që lidhen me fjalën shqipe. Si e tillë ajo jo vetëm pasuroi albanologjinë, po i çoi më tej arritjet e kohës në këtë fushë duke i siguruar asaj vend të merituar edhe në përmasën ndërkombëtare. Puna e tij shkencore në fushën e gjuhësisë shqiptare, me theks të veçantë në leksikologjinë e semasiologjinë, ka meritën jo vetëm të sistemimit të dijeve të këtyre dy fushave, po edhe të qenët mbështetëse a pikë referimi shumë të rëndësishme për studiuesit e gjuhës shqipe dhe për procesin e mësimdhënies në arsimin shqip.

Të flasësh për veprën e profesor Jani Thomait do të thotë të prekësh një numër të madh temash gjuhësore dhe të kesh aftësinë t’i riaktualizosh ato. E kjo në një shkrim sado të gjatë nuk mund të bëhet, aq më pak në një kumtesë përvjetori. Megjithatë, po bëj një përpjekje të them diçka me shpresën se ajo që do të them do të paraqesë sado pak punën e madhe të profesor Janit në studimin e fjalës shqipe e të jetës së saj në fjalorin e shqipes.

Që në studimet e tij të para të botuara në periodikun e pakët shkencor të kohës, në kohën e konsolidimit të shkencës shqiptare, ai do të nisë e nuk do të shmangë asnjëherë rrugën pas gjurmëve të fjalës shqipe, pas kuptimit të saj, në të vërtetë pas jetës së saj të përbërë. Ai do t’i hyjë me përkushtim studimit të fjalës shqipe, do të hulumtojë të gjitha gurrat e rrjedhat e saj, do të informohet për gjithçka që lidhet me të kaluarën e të sotmen e saj dhe do të ndërtojë, gjithmonë duke u nisur nga faktet, dijen në sistem mbi krijimin e burimin e saj, mbi jetën e gjallësinë e saj, mbi lidhjet e ndarjet brenda e jashtë saj, në të vërtetë do të ndërtojë dijen mbi fjalën që mban gjallë gjuhën shqipe. Mund të thuhet se profesor Jani Thomait në këtë punë, sikur edhe në veprat e në veprimtarinë e tij shkencore tregon, do të tregojë vetëdije të lartë prej studiuesi, mendimet e të cilin ndërtohen vetëm mbi argumentin shkencor. Prandaj studimet e tij janë të reja, nuk vjetrohen edhe kur vjetrohen çështjet që trajton, edhe kur koha nxjerr probleme të reja e kur kërkohen ndjeshmëri e përkushtime të tjera.

Mund të jetë që pikërisht studimi mbi të folmen e Semanit, këtu e 50 vjet më parë, falë përgatitjes që i dha puna hulumtuese në terren, dhe, pa dyshim, përgatitja teorike e metodologjike në bankat e universitetit të profesorët tanë të pakalueshëm, të jetë shtysa kryesore që do ta drejtojë e do ta përqendrojë vëmendjen e profesorit tonë kah fjala shqipe. Me studimet për fjalën shqipe, ai u bë personaliteti më i shquar e më serioz për shqyrtimin kritik të trashëgimisë leksikore të shqipes nga aspekti i saj i shtrirjes dhe nga aspekti i formimit të saj diakronik e sinkronik. Mbi bazën e këtyre interesimeve dhe të studimeve të gjuhës së gjallë e të shkruar, gjithmonë me fjalën në qendër, ai do të botojë një varg studimesh shumë të rëndësishme, përgjatë afro 50 vjetëve, të cilat do ta afirmojnë atë si figurë qendrore të gjuhësisë shqiptare dhe si njërin nga njohësit më të shquar të historisë së brendshme të gjuhës shqipe. Mendje e gjerë, me fuqi intelektuale të rrallë, studiues serioz me përkushtim e akribi të pashoqe, profesor Jani Thomai, me veprën e tij shkencore do të arrijë të lëvizë mendimin shqiptar të kohës për problemet çelës të leksikologjisë e të semantikës shqipe.

Ndihmesa që i bëri prof. Jani Thomai leksikologjisë e semasiologjisë shqipe me studimet e tij është e shumanshme dhe jashtëzakonisht e rëndësishme. Në këto dy fusha ai shtroi një varg problemesh qenësore duke i vështruar e rivështruar, pos të tjerash edhe shumë nga rezultatet e deriatëhershme, në të vërtetë brenda këtyre studimeve ai hodhi sa teori e hipoteza të reja, që ngjallën jo vetëm interesimin e studiuesve shqiptarë të kohës, po sidomos edhe të atyre që po përgatiteshin të hynin në këto fusha, duke ndërtuar shkollë të re të studimit të leksikut të shqipes dhe të semantikës së saj. Në këtë kontekst shquajnë studimet për semantikën leksikore, për strukturën kuptimore të fjalës, për lëvizjet semantike të kushtëzuara stilistikisht, për shndërrimet kuptimore, modelet e formimit të fjalëve në gjuhën shqipe e të tjera, pra përgjithësisht për llojet e lëvizjeve e të lidhjeve kuptimore në strukturën semantike të shqipes, si dhe veçoritë e shqipes në rrafshin e shndërrimeve kuptimore dhe në tipat e prejardhjes semantike - probleme këto të shtruara jo vetëm në monografinë e njohur dhe të vetmen për këto probleme në gjuhësinë shqiptare *Prejardhja semantike në gjuhën shqipe* (1989), po edhe në një numër studimesh të botuara në periodikun shkencor shqiptar e të huaj po për këto probleme.

Në *Leksikologjinë* e prof. Janit, me moshë dyzetvjeçare, e vetmja në gjuhësinë shqiptare, e vetmja, po jo e njëjta, sepse ajo u ripunua e u pasurua nëpër vite dhe sot është tekst sa shkencor e profesional, po aq bashkëkohor e i ri, gjejmë përpjekjen e parë që del si provokim për autorin që leksikologjia të vështrohet në kuptim më të gjerë e kjo do të thotë që brenda saj të përfshihen edhe disiplina a nëndisiplina që sot mëtojnë të trajtohen të pavarura në gjuhësinë në përgjithësi. Edhe pse teksti *Leksikologjia* është konceptuar si tekst universitar i mësimdhënies, ai kalon kufijtë e një teksti të tillë dhe jep shumë përgjigje edhe për shtresa lexuesish të tjerë, në rend të parë për studiuesit e dijes mbi fjalën në përgjithësi e mbi fjalën shqipe në veçanti. Aty gjejmë, jo vetëm termat, nocionet e kategoritë bazë të leksikologjisë, siç janë fjala e kuptimi leksikor, homonimet e fjalët polisemike, sinonimet e antonimet, raportet leksikore paradigmatiche e sintagmatike, semantika leksikore e frazeologjitë, shtresimet e leksikut të shqipes, po edhe çështje më pak të studiuar brenda leksikologjisë tradicionale – problemet e semasiologjisë në

kuptim të gjerë e të ngushtë. Teksti nuk i përmbahet vetëm një shkolle gjuhësore, po del si përpjekje për të paraqitur një trajtim sa më bashkëkohor në raport me zhvillimet në gjuhësinë moderne, duke i përballur gjithmonë këto dije me qëndrimet vetjake.

Në veprën *Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe* autori me kompetencë do të trajtojë çështjet themelore të frazeologjisë shqipe, ndër të tjera: koncepti mbi frazeologjinë, përshkrimi ideografik i frazeologjisë, i njësive të veçanta frazeologjike, çështje të tipologjisë së frazeologjizmave, frazemat krahasuese, strukturën e semantikën e njësive frazeologjike, çështje të ndërtimit të frazeologjizmave, shndërrimet e metaforizimi dhe aspekti njohës i frazeologjizmave, pastaj aspekti komunikues i frazeologjizmave, motivimi, ekuivalenca dhe simbolika e përbërësve frazeologjikë, frazeologjizmat, proverbat dhe shprehjet e ngurosurat. E të tjera.

Studimet që rrokin leksikun dialektor e krahinor të shqipes të profesor Janit provojnë se fjala shqipe, njësia leksikore, në përqindje tepër të lartë ka atdhe gjithë trojet shqiptare, prej pikës më të lartë në veri e deri në pikën më skajore në jug. Ndërkaq ndryshimet midis dialekteve sa i përket leksikut janë tepër të vogla, dhe dukshëm më të papërfillshme sesa ndryshimet që i shohim te gjuhët e tjera. Nga pikëpamja praktike ndryshimi midis dialekteve të gjuhës shqipe nuk ka asnjë rëndësi dhe nuk nevojitet asnjë mundim i madh që të kuptojmë dialektin tjetër. Pengesat që mund të dalin i detyrohen më shumë mungesës së kontakteve për arsyet e ditura politike e shoqërore në jetën kombëtare të shqiptarëve.

Me njohjen e thellë të gjuhës shqipe, të përmbajtjes e të strukturës së saj, të të folmeve dhe të dialekteve të saj, me forcën e analizës e të sintezës shkencore, me objektivitetin dhe logjikën e rreptë që përshkon veprën e tij, dhe me mprehtësinë e vëzhgimit e të arsytimit që e karakterizon, ai argumentoi një varg tezash themelore për veçantinë e gjuhës shqipe, për njësinë e gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare, për karakterin homogjen të saj, për pasurinë e fjalorit të shqipes dhe për mundësitë e pakufishme zhvilluese të tij. Në të gjitha këto fusha ai solli kontribute vetjake me rëndësi të madhe shkencore, po edhe kombëtare.

Duke lexuar veprën shkencore të prof. Jani Thomait do të mund t'i kuptojmë fare qartë të gjitha dukuritë që lidhen me fjalën shqipe e me semantikën e saj. Do të mësojmë si t'i kuptojmë raportet leksikore, përkatësisht marrëdhëniet e përbëra midis fjalëve. Do të gjejmë përgjigjet si t'i dallojmë nocionet bazë të leksikologjisë e të semantikës. Do të kuptojmë fare mire prirjet e zhvillimit të leksikut të shqipes. Do të mësojmë se metoda e analizës së përbërësve kuptimorë është më e vlefshme e më e realizueshme në raport me metodat e tjera: semike, distribucionale a komponenciale. Në një numër studimesh na jepën përgjigjen si të analizojmë shenjuesit leksikorë e gramatikorë të fjalës në mbështetje të nxitjeve që vijnë nga fjalorët. Në fushën e leksikografisë profesor Jani, ndër shumë të tjera, na jep edhe përgjigjen për kriteret dhe qëndrueshmërinë e tyre në hartimin e fjalorëve njëgjuhësh, kritere që duhet të rrokim sistemin dhe përshkrimin e hollësishëm leksikografik të korpusit gjuhësor, në të vërtetë rëndësinë e përpunimit të konceptit të fjalorit dhe përcaktimin e udhëzimeve konkrete, të cilat përcaktime jo rrallë i gjejmë të munguara në fjalorët e botuar së fundi në Shqipëri e në Kosovë. E kështu me radhë, e kështu, me radhë.

Përgjigjet që do të marrim për një numër të madh problemesh që shtrohen në veprën shkencore të Jani Thomait janë jo vetëm fletëhyrje në dijen mbi fjalën shqipe, strukturën dhe përmbajtjen e saj, po janë historia e saj e përvijuar në përdorimin e saj të gjallë e të shkruar. Të gjitha studimet e profesor Janit, qoftë brenda monografive, qoftë të shtrira në studimet e botuara në revistat shkencore e në përmbledhjet e ndryshme studimore, të shkruara përgjatë një qarku jo të vogël kohor, i bashkon tema e njëjtë: fjala e fjalori, të cilave u afrohet nga aspekti leksikologjik, gramatikor e metaleksikografik. Në shumicën e tyre janë hapur për herë të parë disa tema të patrajuara në shkencën gjuhësore shqiptare, duke sjellë kështu rezultate të reja, në të vërtetë pasurim tematik e pasurim përmbajtjesor.

Por, vepra e gjerë kërkimore shkencore e profesor Jani Thomai nuk është vetëm studim, teori, diskutim për çështjet leksiko-gramatikore, për çështjet leksiko-semantike, për çështje dialektore e të gjuhës letrare, po edhe për të gjitha këto bashkë në kontekstin leksikografik. Leksikografia shqipe falë fjalorëve ku autor është Jani Thomai ose të fjalorëve ku mendja e dora e tij nëse jo kryesoret, ndihen shumë, u bë më sistemore, më e zhvilluar e më bashkëkohore.

Përmes studimeve të tij me tema të ndryshme leksikologjike e semantike, më shumë se prej të gjitha studimeve të bashkëkohësve të tij nga kjo fushë, bëhemi të vetëdijshëm për mungesat që kemi në studimet teorike e në teorinë leksikografike, bëhemi të vetëdijshëm për çështjet ende të hapura e të pazgjidhura në punën kërkuese të hartimit të fjalorëve. Prandaj, studimet e tij nga kjo fushë konsiderohen më shumë se kontribut i rëndësishëm për teorinë leksikologjike e leksikografike shqipe, me theks të veçantë për leksikografinë njëgjuhëshe shqipe.

Së këndejmi e them me siguri të plotë se të rrallë janë ata studiues me përgatitjen e profesionalizmin e profesor Thomait, dhe mbi të gjitha të rrallë janë që me kaq sistems dijesh trajtojnë fjalën shqipe e hartojnë fjalor të shqipes, siç bën profesor Jani Thomai.

Profesor Jani Thomai ka prirjen e aftësinë e rrallë për të hetuar problemet çelës edhe atje ku studiues të tjerë nuk i vërejnë. Në këtë rrafsh studimet e tij janë edhe paraqitje problemore për leksikologjinë e leksikografinë shqipe dhe për gjuhësinë shqiptare në përgjithësi.

Në literaturën britanike shpesh trajtohet puna e leksikografit, e atij që ka zgjedhur fatin e të qenit i vetëmunduar, i vetësakrifikuarit. Puna në hartimin e fjalorëve, në këtë literaturë, madje, quhet edhe mallkim. Një sakrifice të tillë, një “mallkimi” të tillë, nuk i është frikësuar profesori ynë i nderuar Jani Thomai. Dhe nuk ka pasur mundësi të ndodhë ndryshe. Pas gjithë asaj pune e atij zelli të treguar në studimet për fjalën shqipe, hartimi i fjalorëve, në të vërtetë verifikimi i dijeve teorike në praktikën leksikografike, vjen si diçka e vetëkuptueshme dhe e pritshme, sepse aty, në fjalorët, profesorin e çonte rruga e filluar herët në studimin e fjalës shqipe, në të vërtetë kërkimi a gjurmimi pas fjalës shqipe, pas frazeologjisë shqipe, pas gjetjes së sinonimeve të shqipes, të filluar që në fund vitet 50 e përgjatë viteve 60 e 70, për t’u materializuar në vitet 80, 90 e në dhjetëvjetëshin e parë të shekullit të ri. Me studimet për frazeologjinë e sinoniminë ai ka përgatitur e rrahur teorikisht punën që do të pasojë në hartimin e fjalorëve për to. Në këtë rrugë shndërrimi të teorisë në praktikë, leksikografia shqipe fitoi si asnjëherë tjetër në historinë e saj

standardet më të larta shkencore e profesionale leksikografike, të tilla që e bëjnë të konkurrueshme përtej kufijve kombëtarë.

Krahas zhvillimit të leksikografisë shqipe, ku dorë të madhe ka profesor Jani Thomait, është zhvilluar edhe metaleksikografia. Profesori e di mirë se pa përvojën e leksikologut nuk mund të hartohet fjalori me kritere të vlefshme shkencore. Dhe këtu profesori ynë ka dhënë shembullin më të mirë se si duhet të pajtohet puna e leksikologut me atë të leksikografit.

Në shkrimet e tij mbi leksikografinë shqipe dhe mbi përvijimet e sotme në këtë fushë do të gjejmë edhe parashikime që ecin nëpër hapësirat ende të papushtuara të përvojës leksikografike shqiptare dhe ato hapësira nuk janë pak, me gjithë mundësitë e krijuara nga teknologjitë informative sot. Sigurisht se pajtoheni me faktin se mungon një strategji institucionale në shkallë kombëtare për të përmbushur zbrazëtitë për të cilat tërheq vërejtjen me të drejtë profesor Jani Thomai. Po shtojmë se mbështetja në literaturën e pasur leksikologjike-leksikografike, ku vendi i prof. Thomait është i veçantë, mund t'i sigurojë zhvillim të mbarë leksikografisë shqipe. Leksikografia shqipe i ka të gjitha mundësitë të bëhet pjesë e kontekstit evropian, në sajë edhe të punës së madhe në këtë fushë të profesor Jani Thomait, po gjeti mbështetjen e domosdoshme institucionale. Vlen ta rithemi se leksikografia më shumë se çka do tjetër është mjet për ruajtjen e qenësisë gjuhësore.

E quaj të rëndësishme ta them se profesor Jani Thomai shkruan qartë, thjeshtë e bukur për çështjet që nuk janë as të qarta e as të thjeshta, ndërsa të bukura mund të bëhen vetëm kur i duam a u përkushtohemi atyre, ashtu siç i ka ngjarë profesor Jani Thomait.

E ndiej të nevojshme me këtë rast të them se çdo njëri nga ne që përpiket të paraqesë përmbledhtas punën e profesor Jani Thomait pashmangshëm se do t'i hyjë në hak atij, punës së tij, sepse pashmangshëm do të reduktojë përmasën që ua jep atyre gjerësia njohëse, thellësia e hollësia e analizave linguistike dhe ndjeshmëria leksikografike, me të cilën ai i afrohet çdo fjale a çdo zëri të veçantë leksikografik.

Me kumtesën time shpresoj së paku t'ia kem arritur të arsyetoj titullin e saj *Prej fjale te fjalori*, të paraqes rrugën e profesor Thomait prej gjurmëve të fjalës shqipe e deri te kështjella e saj – fjalori.

Në këtë përvjetor, në 75 vjetorin e lindjes, me kënaqësi të veçante e uroj profesorin tonë të nderuar për jetën e tij kuptimplote, duke i shprehur dëshirën që të ketë edhe më tej shumë vite të shëndetshme e të pasura pune.

Prof. as. dr. HASAN MUJAJ
Universiteti i Prishtinës

ARRITJET E AKAD. JANI THOMAI NË GJUHËSINË KONTRASTIVE E PRAGMATIKE

Themi me shumë arsye se studiuesi i mirënjohur i gjuhësisë shqiptare Jani Thomai, me veprimtarinë kërkimore-shkencore mjaft sasiore dhe cilësore, i ka siguruar vetes një vend nderi dhe përherë të respektuar në elitën e dijeve albanologjike. Veprimtaria e përkushtuar dhe e gjatë rreth gjysmëshekullore nga këto dije e prof. Jani Thomait është kurorëzuar me arritje të reja shkencore në veçanti në fushën e leksikologjisë.

Studiuesi ynë, që në fille të kërkimeve gjuhësore, pa me të drejtë një nga detyrat parësore që i viheshin përpara dhe i vihen edhe sot e gjithë ditën gjuhës shqipe: pasurimi i fjalorit të saj me fjalë dhe shprehje të reja në mënyrë që gjuha të jetë në gjendje të ndjekë zhvillimin e shoqërisë. Ai, në këtë pikëpamje, e shpuri përpara veprimtarinë pararendëse dhe hapi hulli të reja kundrimesh në shtresimet dhe gjurmimet e pasurisë leksikore të gjuhës shqipe, të qëmtimit dhe të studimit të saj.

Në veprimtarinë e hulumtimeve shkencore-gjuhësore të prof. Jani Thomait do hetuar një veçori, që nuk mund të vihet re te secili studiues: pasuria fjalësore dhe shprehjet frazeologjike venerohen në dritën e dijeve të integruara gjuhësore dhe jogjuhësore. Në këtë integrim disiplinash shkencore thesari leksikor është kapur dhe është trajtuar në subsisteme sistemi me kompetencë prej studiuesi të formimit të gjerë mikro- dhe makrolinguistik.

Jani Thomai vuri re me të drejtë se pasuria leksikore e gjuhës shqipe shtrihet në krahina të ndryshme të ligjëritimit shqip dhe se ajo, me gjithë punën e bërë dhe me rezultatet e arritura, ende nuk është mbledhur sa duhet. Ai, në këtë pasuri, ngre lart rëndësinë e madhe të sinonimisë leksikore- një gurrë kjo e pashtershme dhe përherë freskuese për të ndërtuar tekst të shprehësisë së lartë nga ana stilistike dhe të përmbajtjes së thellë nga ana semantike; ai spikat faktin se kjo dukuri gjuhësore nuk shfrytëzohet në rastet mbizotëruese të praktikës gjuhësore dhe konstaton me të drejtë se “publicistika vijon të rendë, pa kriter e pa nevojë pas fjalës së huaj.” 1)

Leksikologjia e zbatuar në gjuhën shqipe, sidomos me punën e vazhdueshme dhe efikase të prof. Thomait, por edhe me kërkimet e studiuesve të tjerë, që nga vitet e 70-ta e këndeje në vijimësi, u zhvillua dhe u pasurua me lëndë të re leksikore e frazeologjike. Ajo, në krye me akademikun Thomai, u zgjerua, u rrit e u hulumtua me kompetencë shkencore nga këndvështrime dijesh të ndryshme dhe të gërshetuara duke u vënë kështu në një themel të fortë e të sigurt mbi të cilin po ngrihet leksikologjia e zbatuar sot.

Kontributi i J. Thomait është me interes edhe për linguistikën kontrastive, e cila, nga disa studiues të huaj, është quajtur edhe linguistikë konfrontative 2), por edhe linguistikë kontakti- një drejtim në shkencën e gjuhësisë krahasimtare, i cili nuk ndjek krahasimin e gjuhëve mbi bazën gjenetike, porse synon t’i hetojë përputhjet dhe divergjencat midis dy a më shumë gjuhëve. Objekt hulumtimi i gjuhësisë kontrastive janë interferencat gjuhësore të gjuhëve në kontakt, rrethanat shoqërore dhe statusi social i gjuhëve të tilla. 3) Nga kjo fushë studimi do parë edhe

pragmatika kontrastive si pjesë e gjuhësisë pragmatike, objekt studimi i së cilës është akti i komunikimit në të cilin marrin pjesë persona kulturash dhe shresash të ndryshme. Nga pragmatika kontrastive janë parë dhe janë trajtuar edhe keqkuptimet e ndryshme që mund të ndodhin nga partnerët e bisedës, nga pikëpamja sociokulturore e komunikimit, nga përdorimi dhe strukturimi i gabueshëm i njësive leksikore etj.

Me gjithë studimet e bëra, veprimtaria shkencore-gjuhësore e prof. Thomait ende nuk është studiuar në dritën e zbërthimeve të dijeve të reja, të cilat janë ngërthyer në kërkimet gjuhësore të dijetarit tonë. Po të ndiqet parimi i Shkollës Pragmatike të Çikagos sipas së cilës do bërë “hulumtimi i hulumtimit” (gjermanisht “Untersuchung von Untersuchung”) 4), do të dalë e kuptueshme se hulumtimi i punës hulumtuese të prof. J. Thomait do të dëshmojë se ai dha kontribut të çmueshëm në zhvillimin e disa disiplinave të reja gjuhësore, të cilat në gjuhësinë tonë po i bënin hapat e parë të konstituimit si p.sh. sociolinguistika, pragmatika gjuhësore, linguistika kontrastive ose konfrontative, etnolinguistika etj., të cilat po hetonin e po hapnin shtigje vrojtimesh të reja të ndërlidhjeve dhe të interferencave të fenomeneve të ndryshme gjuhësore. I parë nga ky këndvështrim, hulumtimi gjuhësor i J. Thomait është i gjerë, i pasur dhe paraprihet nga argumentet historike, sociologjike, kulturore, sociale etj. dhe kështu vihet e ngrihet mbi një themel shkencor dijesh të integruara, andaj mund të flitet për trajtime disiplinash të ndryshme të gërshtuara dhe të bazuara si p.sh. pragmalinguistika, sociolinguistika, linguistika kontrastive, etnolinguistika, gjuhësia e aplikuar etj.

Në këtë vazhdë, në fushën e linguistikës kontrastive, autori ndjek çështjen e depërtimeve leksikore të gjuhëve në kontakt duke i vështuar rrethanat historike, sociolinguistike, politike etj., të cilat kanë ndikuar në interferencat gjuhësore sidomos në nivel leksiku. Ai, pasi analizon një varg fenomenesh jogjuhësore e gjuhësore të leksikologjisë dhe të leksikografisë, vë re shtresëzimet e fjalorit të shqipes duke i veçuar depërtimet e ndryshme leksikore në gjuhën shqipe si p.sh. greke, latine, turke sllave etj., por, ndonjëherë, edhe depërtimin e fjalëve të shqipes në gjuhët e tjera me popujt e të cilave gjuhë shqiptarët kanë pasur kontakte të ndryshme, ku fqinjësore e ku të imponuara e diskriminuese gjatë historisë.

Ndërndikimet e gjuhëve në kontakt janë shtrirë edhe shkencën e onomastikës sidomos në fushën e toponimisë në të cilën janë futur emërtime të burimit sllav, por edhe prejardhesh të tjera. Po kështu prof. Thomai, nga gjuhësia kontrastive, pa edhe disa ndajshitesa fjalëformuese që kanë hyrë nga pikëpjekjet midis gjuhësh.

Nga pikëpamja e gjuhësisë së aplikuar akademik Thomai është shumë i merituar nga fakti se ka ndjekur me interesim dhe ka shpënë përpara teorinë pragmatike të gjuhës në veçanti në fushën e leksikologjisë. Ai ndoqi semantikën e fjalës dhe rrethanat e ndryshme të përdorimit të kuptimit të saj; ai ndoqi filozofinë e leksemës që nga përbërësit morfemorë të saj dhe deri në nivelin e strukturës tekstore, indeksikalitetin e njësive leksikore duke i hetuar treguesit e mirëfilltë semantikë e metaforikë të sistemit fjalësor të gjuhës shqipe në rrymën e moteve. Në këtë kontekst autori preku semiotikën e fjalës, logjikën, sociolinguistikën, pragmalinguistikën, teorinë e njohjes, varietetet diatopike (rajonale) dhe diastratike (shtresore) të njësive leksikore, psikolinguistikën, aksiologjinë e njësive gjuhësore sipas kontekstit dhe kontekstit etj.

Njohës i thellë dijesh heterogjene

Puna hulumtuese e studiuesit tonë është një veprimtari bashkërenduese dijesh të ndryshme, që të ndërplotësuar, nga kënde të specializuara, i referohen një çështjeje ose një fenomeni leksikologjik ose më të gjerë gjuhësor- një përparësi kjo e madhe, e cila solli kthesa të reja në ecurinë dhe në cilësinë e kërkimeve leksikologjike dhe frazeologjike. Në këtë dritë, që në fille të hulumtimeve leksikologjike, këtu e një gjysmë shekulli më parë, prof. Thomai, pasi kishte vënë re punën pararendëse, e cila kishte mbëhi për orientime e ndriçime të reja, shtroi detyrat kryesore metodologjike dhe shkencore që do të viheshin përpara gjuhësisë dhe në veçanti para leksikologjisë. Një nga synimet parësore u shtrua me të drejtë qëmtimi i visarit leksikor nga variantet e të folmeve krahinore, i cili mund të bëhej pronë e gjuhës standarde. Edhe ndërtimi i njësisë të reja leksikore me mjetet fjalëformuese të shqipes u prashtrua si punë me përparësi. Lënda e vjelë, para se të bëhej pjesë e leksikut standard, kërkonte studimin e vlerësimit e dijetarëve në shumë aspekte të subsistemit gjuhësor: domethënia dhe mundësia e lidhjeve kuptimore të njësisë gjuhësore dhe të shprehjeve frazeologjike; kuptimi i drejtpërdrejtë dhe metaforik i fjalëve dhe i shprehjeve; ndryshimi i kuptimit të fjalëve; shtresat leksikore nga anët rajonale, sociale, terminologjike, profesionale etj.; mjetet gjuhësore të ngjyritimit emocional e stilistik të fjalëve; leksiku pasiv; kuptimi leksikor i fjalëve dhe nocioni; përmbajtja dhe forma e fjalës; rëndësia e frazeologjizmave dhe klasifikimi i tyre; zhvillimi historik i leksikut të shqipes; stili, llojet dhe leksiku i tij; komunikimi dhe vlera e leksikut etj. përbëjnë disa nga interesimet kryesore shkencore të prof. Thomait. Pra, një spektër i gjerë, vërtet i gjerë.

Sikundër shihet ai u mor me çështjen themeltare të gjuhësisë aplikative: me materien nga e cila ndërtohet komunikimi gjuhësor, domethënë me funksionin e gjuhës. me pasurinë e saj, me mundësitë e shprehësisë së gjuhës, me përshtatjen e saj sipas situatës së komunikimit, sipas temës së komunikimit; me anën impulsive dhe ekspersive të të shprehjes; me zgjedhjen e njësisë leksikore sipas shtysës së veprimit; me afërinë dhe me kundërvëniet semantike të fjalëve etj. do të thotë me anën pragmatike të gjuhës.

Formimi i gjerë lingistik dhe kognitiv i dha mundësi studiuesit Thomai që të merrej, veç leksikologjisë, edhe me disa disiplina të tjera shkencore-gjuhësore, të cilat ndërlidhen me leksikologjinë dhe e plotësojnë atë për t'i kapur e për t'i trajtuar problemet në dritën e dijeve të integruara. Madje kjo është një ecuri hulumtimi që po e ndjek gjuhësia moderne sot. Nga ky aspekt prof. Thomai del shumë i avancuar. Sepse, nuk do të mund të merrej me kompetencë me depërtimet e fjalëve nga një gjuhë në tjetrën dhe me ndërndikimet e tjera të gjuhëve në kontakt po të mos kishte kulturë të gjerë nga gjuhësia kontrastive; hulumtimi i leksikut të shqipes nga aspekti i prejardhjes së leksemave dëshmon se ai trajtoi edhe çështje të historiologjistikës. Nga ky pikëvështrim do shtuar se linguisti ynë nuk do të mund të merrej me sukses me gjurmimet e leksikut të shtresave të ndryshme sociale, me përdorimin e tij sipas rrethanave të komunikimit dhe faktorëve gjuhësorë e sociokulturorë dhe treguesve të tjerë jashtëgjuhësorë po të mos kishte

dituri të thella nga sociolinguistika, etnolinguistika, linguistika e aplikuar etj.; prof. Thomai nuk do të mund të merrej me gjuhën si veprim funksional e praktik sidomos kur shkruan për stilet sikur u mor po të mos kishte formim të gjerë edhe nga pragmalinguistika; ai nuk do të mund të merrej me denotacionin dhe konotacionin e shenjave gjuhësore sikur u mor po të mos kishte dituri edhe nga semiotika- nga ky fundament i të gjitha shkencave siç e quan Persi 5) këtë dije; ai bashkërendoi kompetencën e performancën dhe hetoi me të drejtë se pasuria leksikore e frazeologjike e varieteteve të të folmeve krahinore është me interes të veçantë për t'i shtuar mundësitë e funksionit komunikativ të gjuhës, andaj ky thesar i çmueshëm, që shtrihet në fusha të ndryshme të veprimtarive shoqërore, meritonte të vlej e të studiohej për ta pasuruar gjuhën standarde.

Këtë themel të pragmalinguistikës e ndoqi nga këndi filozofik i teorisë së veprimit dhe pragmatikën gjuhësore e pa si disiplinë empirike. Vështruar nga pikëpamja e teorisë së Sharl Morrisit dhe e interpretimit të tij për shenjën gjuhësore, studiuesi ynë del të jetë marrë edhe me aksiologjinë e shenjave gjuhësore, do të thotë me ndërtim in dhe funksionin e vlerave semantike, stilistike, etike dhe estetike të njësive leksikore; gjithënjë nga ky standard kundrimi vuri re edhe aspektin epistemologjik të raportit të shenjave dhe të ndërtimit të tekstit.

Gjuhësorja do parë si mjet i kognicionit dhe i njoftimit përmes njësive leksikore në varësi nga situata e të shprehurit, tema, motivi etj. nga diktohet edhe stili dhe seleksionimi i ndërtimit të tij kishte parë dijetari Rudolf Karnapi 6). Në këtë kontekst edhe studiuesi Thomai thekson rëndësinë e kuptimit leksikor dhe të nocionit të njësive leksikore, të mundësisë emërtuese të leksemave në kuptimin e mirëfilltë dhe metaforik.

Pasi sipas mendimit të Hegelit njerëzit janë “shtëpi e gjuhës” dhe gjuha është “...strehim i mendimit njerëzor” (die Behausung des menschlichen Denkens) 7), atëherë konstatimi i akademikut Thomai për të mbledhur thesarin leksikor e frazeologjik nga terreni i etnisë gjuhësore, nga shtresat e ndryshme sociale dhe fushat e ndryshme të veprimtarive shoqërore, del të jetë shumë i bazuar dhe parim që do ndjekur në kërkimet e gjuhës shqipe.

Janë me shumë interes pragmatik parashikimet e prof. Thomait për sendërtimin e projektit të madh nga fusha e leksikografisë sonë, për hartimin e një fjalori të madh në disa vëllime të shqipes standarde. Për t'u arritur ky synim i rëndësishëm shkencor, vë në dukje autori ynë, kërkohet një punë me përkushtim e leksikografëve më të njohur dhe e specialistëve të fushave të ndryshme të truallit të shqipes në mënyrë që në këtë vepër të përmbledhet pasuria leksikore e frazeologjike e gjuhës shqipe.

NURI PLAKU
Specialist në Muzeun Historik, Fier

E FOLMJA MYZEQARE MIDIS GJUHETARIT JANI THOMAI DHE SHKRIMTARIT JAKOV XOXA

Çdo e folme krahinore ka një relacion intimiteti të veçantë me përfaqësuesit më të denjë të kulturës që i përkasin origjinës së saj. Shpesh ky relacion kthehet edhe në privilegj për këtë të folme, në vartësi të nivelit shkencor dhe shkallës së përfaqësimit të tyre. E folmja e Myzeqesë gëzon pikërisht këtë status dhe pikërisht në vartësi të trajtimit nga dy kolosët e kulturës shqiptare që janë bijtë e saj më të spikatur; gjuhëtari Jani Thomai dhe shkrimtari Jakov Xoxa. Është pikërisht ky intimitet që e bëri prof. Jani Thomain ta fillonte karrierën e tij shkencore me punimin e diplomës **“E folmja e katundit Seman”** kushtuar gjuhës së vendlindjes së tij në vitin 1958, botuar 3 vjet më vonë në Buletinin e Shkencave Shoqërore në Universitetin e Tiranës.

Ndërsa Jakov Xoxa iu zvordh metropolit dhe punoi për vite të tëra në manastirin e Shën Mërisë në Apoloni, motivuar pikërisht nga ky intimitet. Kjo e folme u vu kështu në penën e dy burrave më të mëdhenj që ka nxjerrë deri më sot krahina e Myzeqesë. **“Gjuha është qela e qenies”** thotë filozofi **Martin Heidegger**. Pikërisht në këtë “qelë” të qenies ata u rikthyen me punën e tyre dhe krijuan kultin e kësaj të folmeje nëpërmjet përjetësimit të saj shkencor dhe artistik.

Për prof. Jani Thomain e folmja e Semanit dhe e Myzeqesë është konsideruar si një **“ujë pagëzimi”** nëpërmjet së cilës ai veshi së pari pelerinën e shkencëtarit të ardhshëm. Atëhere ishte një djalosh i ri, kurse e folmja e kësaj krahine ishte në periudhën e “plakjes” si të gjithë dialektet e tjer që po shkonin drejt konvergimit në gjuhën standarte.

Në këtë punim prof. Thomai grumbulloi material të bollshëm në kontakt të drejtpërdrejt me popullin dhe bëri interpretime të detajuara, duke rrokur të gjitha veçoritë dhe ngjyrimet gjuhësore të kësaj të folmeje. Vetë karakteri statistikor i këtij punimi tregon për një angazhim serioz dhe mjaft të preokupuar. Ai sjell në **65 faqe, 2426** shembuj të ndryshëm. Nga këto në kapitullin e fonetikës janë **1043** shembuj, në **morfologji 919** dhe në **sintaksë e leksik 464**. Midis tyre gjallojnë pjesëza dhe forma konkrete strukturore, të specifikuara në bazë të kësaj gjeografie, evidentohet prejardhja e **216** fjalëve dhe është mbledhur një fjalorth me **440** fjalë, ndërkohë kur nga e gjithë krahina e Myzeqesë, në vitin 1958 Jorgji Gjinari, një tjetër studjues, ka mbledhur **412** fjalë. Kjo është një prurje e konsiderueshme për kohën, e cila ka ndikuar në hartimin e fjalorëve dhe ruajtjen e këtij fondi në memorjen historike gjuhësore.

Çdo gjuhëtar i interesuar, do të gjejë te ky material një bazë studimore të pasur për kryerjen e interpretimeve të ndryshme nga këndvështrime të reja sociale dhe shkencore. Një nga studiuesit kryesor që i është referuar këtij materiali është edhe Çabej, në veprën e tij të rëndësishme, **“Studime etimologjike”**.

Nga ky realitet, fosilizuar në memorjen tonë kulturore, nëpërmjet studimit të prof. Thomait, ne jemi në gjendje të zhbirojmë gjithashtu edhe karakteristikat kryesore të këtij mikrosistemi në

kuadër të makrosistemit të përgjithshëm, për të pasqyruar evoluimin e kulturës gjuhësore ndër vite, duke e konsideruar atë një oaz të kësaj kulture.

Kështu, nga fusha **leksikore** e këtij studimi na vjen një numër fjalësh të cilat nuk janë më frekvente, por janë futur në fjalor si rezultat i këtij kontributi.

1 – Fjalë nga fondi leksikor i materialeve të kulturës popullore me përdorim të përditshëm, si; karroqe, brokë, mokërr, mlacë, kotruve, voce, djepe, krehër leshi, çikrikë, emra **kafshësh shtëpiake** si; buall, buallicë, mushkore, kotorr, emra kafshësh dhe **shpendësh të egra** si dosëbalë (baldosë), lejlek, borroviq etj. Funkcioni i këtyre emërtimeve është i lidhur me nivelet e jetës së atëherëshme pastorale, trashëguar nga thellësia e shekujve në kushtet e një ekonomie të mbyllur dhe të një ekosistemi të virgjër e të pacenueshëm. Në realitetet e mëvonshme të ndryshimeve social-ekonomike të kësaj treve, emërtime të tilla u bënë pjesë e së shkuarës historike dhe kontaktet krahasuese me të, kryhen vetëm nëpërmjet studimeve të tilla si monografia e prof. Thomait.

2 - Dihet se në këtë zonë veshjet popullore filluan të mënjanoreshin në vitet 1930 dhe u zhdukën plotësisht nga përdorimi në vitet '60. Prodhimi i tyre realizohej në mënyrë artizanale dhe banorët përdornin një numër të pasur emërtime të kësaj fushe, si; tezgjahu, shtupi, maji, liri, indi, melica, dërrili, brezi, takija e shumë emra elementësh të tjerë etnografikë. Mbas zëvendësimit të tyre me veshje të prodhimit industrial, një pjesë e objekteve të këtij përdorimi u shndërruan në relike muzeore dhe emërtimet e tyre tashmë bëjnë jetë të plotë arkivore. Baza e këtij arkivi që gjendet së pari në punimin e prof. Thomait, është pikërisht një nga vlerat më të rëndësishme të këtij kontributi.

3 - Në një fokus të tillë, punimi i prof. Thomait krijon gjithashtu edhe një korrelacion të dukshëm midis dy realiteteve gjuhësore të kësaj treve; të atëherëshme e të tanishme, duke shërbyer kështu efektivisht si një gradacion i evoluimit të kësaj të folmeje deri në nivelet e sotme, në përputhje me kushtet normative të gjuhës. Në fushën e fonetikës dhe morfologjisë të kjo e folme, sot vihen re bjerrja e shumë dukurive për evidentimin dhe argumentimin e të cilave qëndron si referencë shkencore pikërisht ky punim.

“Në të folmen e katundit *Seman* përdoret shumë e ashtuquajtura rasa “vendore” me parafjalët e kallxores *në, për, nëpër...* kjo rasë përdoret shumë në këtë të folme dhe, së dyti, ajo përdoret shumë veçanërisht me parafjalët *në* dhe *me...* Kur emri mbaron me dy bashkëtingëllore, midis emrit dhe *t* – së së “vendores” del një zanore anaptiktike, e ngjashme me nyjen shquese të emrit: *ujku/* me shkurtabiqin *n-barkut/* shkoj *n-vadhin* e *dhënet; ngjaco* viçin *n-hasllit*, etj.”⁵⁸ Edhe mbas 50 vjetësh kjo dukuri bën jetë aktive në këtë të folme, megjithëse shumë rrallë, por gjithësesi, duhet theksuar se është një realitet gjuhësor i prekshëm. “*U mbështet n-mezhdën e kanalit*” apo “*lopa u fut n-kanal*”. Ky element shfaqet si një “nën normë” e kësaj të folmeje.

⁵⁸ Jani Thomai, *E folmja e katundit Seman*, Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiranës, nr.3, Tiranë 1961, fq.178.

Po kështu evidentohen raste të përdorimit të **mbiemrit të shquar në funksion të emrave, si; “i mallkuari”, “i paudhi.”** Edhe sot ky variant është mjaft i përdorshëm tek të gjitha moshat dhe kategoritë e tyre kulturore.

4 - “Përemri ajo, zakonisht kur ndodhet në fund të fjalive pyetëse, ndihet në formë të apokopuar, flitet vetëm elementi deiktik a-: *ça bën a? ça isht a?*”⁵⁹ Edhe ky variant nuk është zhdukur plotësisht nga përdorimi, por duhet theksuar se aty ku shfaqet, ka ndryshuar fushën semantike fillestare dhe ka marrë funksione të reja plotësuese, veshur me ngjyime afektive të kategorisë së humorit, duke shprehur kështu pasurimin e shprehjeve të ngritura gjuhësore në nivelet e përdorimit të përditshëm popullor.

5 - Edhe në aspektin e foljeve shfaqen ndryshime të dukshme. **“Me foljet e zgjedhimit të tretë përdoret nganjëherë veta e tretë shumës për vetën e parë njëjës: nuk punojn un qi t’han tjetër.”**⁶⁰ Tashmë kjo dukuri thuajse nuk ekziston.

6 - Një element i rëndësishëm ndryshimi është edhe mospërdorimi i ndajfoljes së kohës *njimëndi*. Nëpërmjet këtij studimi, jepet evoluimi i saj nga *gjimëni*, në *nashi* dhe tashmë në *tashi* dhe *tani*.

Po kështu, ndajfolja **anës** bëhet **ane** dhe përgjithësisht ndihet si përdorim i pandryshuar.

Ky korrelacion i së folmes së Semanit me realitetin e tanishëm gjuhësor është mjaft i larmishëm dhe punimi i prof. Thomait do të jetë një vlerë e ricikluar në funksion të përhershëm të kohës.

Ai ka gjithashtu edhe vlera manuale dhe udhërrëfyese për mësuesit e gjuhës e të letërsisë shqipe, për të evidentuar përdorimin e dialektalizmave të përdorura nga shkrimtarë të ndryshëm në veprat e tyre letrare. Mësuesit e gjuhës veçanërisht ata të brezave të rinj, ju shërben si një pikë referimi për të konstatuar të folmen dialektore të nxënësve dhe për të shmangur përdorime të tilla.

Një kontribut të rëndësishëm ka dhënë prof. Thomai edhe në evidentimin e njesive frazeologjike të kësaj të folmeje. Në **“Fjalorin Frazeologjik të Gjuhës Shqipe”**, nga **11 000** njësi të tilla disa qindra prej tyre i përkasin pikërisht të folmes myzeqare.

Një kult letrar së folmes së Myzeqesë ia ka ngritur edhe prozatori i shquar, i letërsisë shqipe, Jakov Xoxa me veprën e tij të plotë, veçanërisht me romanin **“Lumi i vdekur”**. Studiuesja e mirënjohur **Shefkie Islamaj** e trajton atë gjerësisht në monografinë **“Gjuha e Jakov Xoxës”**, aq sa një paralel i tillë mund të hiqet vetëm me trajtesën që i ka bërë akademiku Rexhep Qosja krijimtarisë së poetit tonë kombëtar, Naim Frashërit.

E folmja myzeqare te Xoxa përbën tharmin strukturor dhe kodin e sistemit të tij krijues. Nëpërmjet veprës së tij letrare, ai ka mundur t’i japë asaj një status të veçantë duke ia rritur vëllimin e përdorimit dhe hapësirat e gjera semantike përtej kufijve të zakonshëm gjeografikë. Veçanërisht tek **“Lumi i vdekur”**, gjuha që përdor ai **“...është në të njëjtën kohë gjuhë lokale e**

⁵⁹ Po aty, fq.179.

⁶⁰ Po aty, fq.183.

gjuhë kombëtare. Myzeqeja dhe bregdeti shqiptar do t'i dhurojnë Xoxës lëndë të bollshme gjuhësore..."⁶¹

Mjaft nga njësitë leksikore emërtesat e elementeve të larmishme të fushës etnografike dhe etnokulturore, të faunës dhe rrafshit floreal të kësaj treve, janë bërë prezentë në këtë prozë me të gjitha ngjyrimet e tyre karakteristike, duke u bërë pasuri e vyer e makrosistemit tonë gjuhësor.

Nëpërmjet fondit të saj të hershëm, ai ka aktivizuar shumë fjalë të panjohura më parë, njësi leksikore, emërtime të ndryshme nga hapësirat e aktivitetit njerëzor, duke ekspozuar kështu tiparet më të dallueshme të këtij areali. Nga "Lumi i vdekur" kjo e folme është kthyer tashmë, në një "lumë të gjallë" që ka vërshuar në pasurimin e gjuhës sonë kombëtare dhe veçanërisht në fondin e saj leksikor. Me këtë të folme Xoxa krijoi një raport komunikimi të thellë midis saj dhe artit të fjalës së shkruar, një raport të ndërruar organikisht nga njëri-tjetri dhe në shërbim të njëri-tjetrit.

Në fushën e **sinonimeve**, ai ka krijuar vargje me brumë dialektor të marrë nga realitetet e jetës së përditshme të kësaj treve dhe ju ka dhënë atyre nuanca semantike të ridimensionuara, të tilla si; **akullimë, bimërritës, birbo, veshak, bishtëroj**, etj. Mjaft nga këto fjalë shënojnë nocione specifike vendore që mund të shërbejnë si njesi emërtuese të përdorimit të gjerë.

Në fushë të **leksikut** ai ka krijuar një fond të pasur fjalësh, të cilave ua ka zgjeruar funksionin fillestar, duke i veshur me funksione të reja konotative dhe poetike. Të tilla prurje mund t'i evidentojmë nga leksiku pastoral si; **djathë i parratur, lahurë, misërnike, kalca** (fragment kostumi popullor) **mëgojëz**, (frer kali) **dorak** (shkop dhe doreza e parmendës), **majoke**, etj.

Nga bota bimore e shtazore, veçanërisht nga bimët e egra në rritje të lirë si; **jambruku, zhuka, kulmaku**, nga shpezët e egra; **qyrylyk, guekër, gjel çamalldar**, nga bota shtazore; **buacë, kotorr, mëzat**, etj.

Mjaft fjalë të tjera të rralla dialektore si; **i sertë, biçak, truaj, munxë**, janë bërë tashmë pjesë e fjalorit të gjuhës letrare.

Gjithë sistemi i njësive frazeologjike, i cili te Xoxa shprehet me një efektivitet të lartë të vlerave shenjuese dhe vlerësuese, është thujse i tëri i ngjyrosur me elementë psikologjikë dhe filozofikë të kësaj treve. Edhe vetë e folura e përditshme e saj, dallohet për nivel të lartë abstragimi. Mprehtësia, humori dhe ironia, matura dhe urtësia, të cilat janë pjesë dominante e veprës së tij letrare, simetria estetike dhe rrezatimi semantik, janë pikërisht elementë esencialë të së folmes myzeqare.

Kjo frazeologji është bërë pjesë e kulturës sonë gjuhësore dhe përbën padyshim një kontribut të vlefshëm të prozës jakoviane.

Onomastika dhe **toponimia** tek Xoxa përbëjnë një fushë me frymëmarrje të gjerë semantike dhe simbolike. Shumicën e këtyre emrave, mbiemrave dhe toponimeve, Xoxa i merr të gatshëm nga areali bregdetar i kësaj të folmeje, ku njihet gjithashtu edhe përkatësia fetare e popullsisë së saj të besimit ortodoks. Të tillë janë emrat **hipokoristikë**, që përfundojnë në emërore me zanoren

⁶¹ Shefkie Islamaj: *Gjuha e Jakov Xoxës* (më tej; "Gjuha e ...", vep. e cit.), Prishtinë, 2000, fq.104.

“I”, të cilët nuk janë përfutur nga procesi i zvogëlimit të emrave të tipit Aleksandër – Leksi, Llazari – Llazi. Përkundrazi shkurtimi i tyre është i gatshëm në këtë të folme, duke iu nënshtruar brenda saj një transformimi historik për të ardhur deri në ditët tona si emra të plotë.

Në fushën e **mbiemrave**, Xoxa jep gjithashtu përftesa semantike me ngarkesë të lartë konotative. Por, edhe në këtë aspekt, ai gjen të gatshëm mbiemra kuptimorë, të cilët janë formuar mbi shprehjet profesionale apo tipare të veçanta karakteristike të njerëzve të veçantë si; Qafoku, Kulari, Longari, Kedhi, Gremi, Vidhi, Peshku. Edhe sot këta mbiemra, gjallojnë në këtë trevë si mbiemra fisesh.

Toponimia e kësaj zone bëhet gjithashtu pjesë e kontekstit dhe makrokontekstit në prozën e Xoxës. Kisha e Shën Gjergjit, Këneta e Sheqishtës, Mulliri i Kryegjatës, Gjoli i Povelçës, Hauzi i Buacave, Pylli Mbret, veçanërisht ato të “Lumit të vdekur” janë pasuri e kësaj zone. Madje vetë titulli i këtij romani i shkaktoi Jakovit fillimisht një konflikt të heshtur me banorët të cilët e “anatemuan” atë, sepse cënoi universin e tyre shpirtëror të shprehur përmes gjuhës dhe toponimisë së kësaj treve. Realisht, “Lumi i vdekur” ishte i njohur ndër ta si “Lumi i vjetër”. Jakovi ndërtoi me të stilet e bukura, Lumi i vdekur. Banorët ju meritën pse ai e transformoi toponimin e tyre arkaik. Por, pak më vonë, ata u familjarizuan me emërtimin e ri dhe e bënë të përdorshëm në komunikimin e tyre të përditshëm. Pikërisht kjo bukuri përshkon si fill demarkacioni gjithë pasurinë gjuhësore të kësaj krahine, duke i ngritur asaj një monument letrar të përveçëm e të paarrtshëm deri më sot në letërsinë shqipe.

Mjaft nga kjo pasuri që sjell Xoxa nga e folmja e Myzeqesë kanë marrë edhe aftësi **apelative**. Shprehje të tilla si Koz Dynjaja, Hani i Bishtanakës, Pylli Mbret, Lumi vdekur, janë bërë cilësorë të një gjinie të caktuar.

Kjo fushë pret studime dhe sigurisht që do të dalë më në pah pasuria e kësaj të folmeje, veçanërisht karakteri historik i saj. Sepse Xoxa, si njeri me kulturë të gjerë që ishte, e njihte toponiminë e trashëguar nga historia e Apolonisë, nga religjoni ortodoks që dihet se ka një pasuri të madhe në lashtësinë e kësaj treve. Nga historia e Apolonisë ne njohim toponimin e bukur “*Shëtitorja e zonjave*”, me të cilën Xoxa operon në “*Bulevardi i Ujit të Dashurisë*”, nga Manastiri i Ardenicës operon me “*Ishulli i manastirit*”.

“**Polivalencat kuptimore të fjalëve dashuri, zemërim, vuajtje ose mall në romanin Lumi i vdekur kapërcejnë kufijtë semantikë të tyre të përshkruar në FGJSSH.**”⁶²

Por, krahas funksioneve të tilla artistike, strukturës dhe prejardhjes gjeografike, ngarkesave psikologjike dhe filozofike, tek Xoxa mbetet ende një virgjëri studimore ngarkesa emotive që mbart proza e tij në përputhje me identitetin e kësaj të folmeje.

Sepse gjithë potenciali i saj folklorik, reflekton ngjyrimet e theksuara emotive, ç’ka shpreh karakteristikat më të qenësishme të këtyre banorëve. Kulti i dashurisë dhe i gruas, është mbizotërues tek këta “...**njerëz të së ardhmes**” siç i quan Kadareja.⁶³ Nga folklori i zonës ka qindra këngë me timbër të theksuar lirik dhe Xoxa e njihte mirë gjithë këtë pasuri të

⁶²Po aty, fq.149.

⁶³ Ismil Kadare, *Qyteti i jugut*, Tiranë: “Naim Frashëri” 1967, fq. 217.

pashtershme.”**Miltoja e dinte: nafariotët nuk e kanë zakon të trembin dashurinë**”,⁶⁴ thotë ai. Kjo do të thotë se edhe poezia e prozës së Xoxës është pjesë esenciale e së folmes myzeqare.

Është interesante, por vihet re se kjo psikologji shfaqet edhe në mjetet stilformuese të këtij autori. Tipik është rasti i përshkrimeve me përsëritje.”**Hane-hane**”, “**dora-dorës**”, “**ik e ik**”, apo **pleonazmi** i cili gjendet thuajse i gatshëm në të folmen myzeqare: **Vath në veshë, dëborë e bardhë, errësira pus e zezë, akull e ftohtë**, etj.

Dihet se Jakov Xoxa i dha bukurinë e përveçme kësaj të folmeje, duke e gjallëruar atë edhe nëpërmjet figuracionit artistik. Dhe një nga perlat e këtij sistemi është padyshim edhe metafora në të cilën Jakovi e quan Myzeqenë “**Magje e perëndisë**”.

Pikërisht në këtë “magje perëndie” u gatua edhe akademiku ynë i nderuar Jani Thomai. Por me prof. Janin dhe Myzeqenë nuk ka ndodhur si me sentencën e njohur të mospranimit të profetit nga vendlindja. Përkundrazi, ai përbën një nga emblemat e rralla të kësaj treve, i vlerësuar dhe i fokusuar në vëmendjen e përhershme të komunitetit të saj. Së pari, Jani Thomai është i vetmi akademik që ka dalë nga kjo krahinë dhe, si i tillë, ai ka tërhequr përherë vëmendjen e komunitetit të vendlindjes së tij. Në vitin 2001 shoqata kulturore – atdhetare “Myzeqeja” e vlerësoi atë me titullin “Nderi i Myzeqesë” me motivacionin, “**Për veprimtari të shquar shkencore në fushën e gjuhës shqipe.**”

Në vitin 2008 ai ka qenë pjesë e një takimi entuziast në komunën e Semanit, fshat i lindjes së tij ku u nderua me titullin “**Qytetar nderi**” i kësaj komune. Po këtë vit, me rastin e 100 vjetorit të hapjes së shkollës së parë shqipe në Myzeqe, prof. Jani Thomai u nderua me titullin e lartë “**Qytetar nderi**” i Qarkut të Fierit, me motivacionin “**Për kontribute të shquara në fushën e gjuhësisë**”.

Populli i kësaj krahine, është krenar që ka nxjer nga gjiri i vet, prof. Jani Thomain, këtë burrë të shquar i cili së bashku me Jakov Xoxën, i ngritën kultin e nderit të vërtetë emrit të kësaj krahine dhe të folmes së saj.

⁶⁴ Jakov Xoxa: *Lulja e kripës*, Tiranë: “Naim Frashëri” 1980, fq.84.

**Prof. as. dr. ALEKSANDRA PILURI, Universiteti i Korçës,
NIKO DAKO, SHBA**

PERSONALITETI I AKAD. JANI THOMAI NË FUSHËN E ARSIMIT

Personaliteti i prof. Janit është i gjithanshëm. Ai nuk është vetëm studiues. Profili i tij është shumë më i gjerë se kaq. Ai është edhe mësimdhënës, pedagog, hartues tekstesh mësimore për nxënës e studentë etj. Ai është edhe mik, këshillues i urtë në punë për më të rinjtë, model korrektesie dhe sjelljeje qytetare.

Me veprimtarinë e tij pedagogjike dhe shkencore ai u bë bashkëthemelues i Universitetit të Tiranës dhe bashkudhëtar i të gjitha ndryshimeve që ka pësuar arsimit i lartë në vendin tonë. Që në fillimet e punës së tij si pedagog në fushën e gjuhësisë ai u rendit me dinjitet krahas figurave të shquara të gjuhësisë shqiptare, si Eqerem Çabej, Selman Riza, Mahir Domi e Shaban Demiraj dhe krijoi gjeneratën e re të gjuhëtarëve shqiptarë.

Kontributi i tij më i rëndësishëm në fushën e arsimit është pasuria e madhe që ai ka krijuar si hartues programesh, tekstesh e fjalorësh që përbëjnë një bazë të fuqishme metodike dhe shkencore për zhvillimin e arsimit mbarëkombëtar e ve[anërisht të arsimit të lartë dhe atij pasuniversitar. Ai ka botuar një varg veprash dhe tekste gjuhësore si: “Leksikologjia e gjuhës shqipe”, “Teksti dhe gjuha”, “Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe”, “Fjalor gjuhësor ballkanik”, “Fjalor i gjuhës shqipe” etj.

Si pedagog ai gjatë jetës së tij krijoi modelin e një mësimdhënësi që mëshironte në mënyrën më të shkëlqyer vullnetin e madh, pasionin shembullor, përkushtimin dhe këmbënguljen për të zbuluar të vërtetën shkencore. Mendimi i tij i pavarur krijues, vlerësimi dhe bashkëpunimi me kolegë dëshmon për cilësitë e një shkencëtari bashkëkohor që ka lënë gjurmë të pashlyeshme në fushën e shkencës dhe të edukimit.

Më lejoni t’iu përcjell juve disa impresione të njërit prej ish-studentëve të prof. Janit dhe ish-pedagogut të fakultetit tonë, z. Niko Dako, që aktualisht punon në Amerikë dhe posaçërisht i ka dërguar për këtë Konferencë.

Lënda e leksikologjisë kishte vërtet diçka të veçantë: jo vetëm qëndrimin dinjitoz e korrekt të pedagogut para studentëve, seriozitetin që ua impononte edhe atyre, mënjanimin në maksimum të fjalëve të tepërta a të kota, saktësinë e jashtëzakonshme në interpretimin e njohurive, por edhe gjithë atmosferën që mbizotëronte në auditor. Për të qenë i sinqertë, duhet të them se unë, që kisha qenë mësues dhe e pëlqeja atë profesion, e studioja për një kohë të gjatë profesor Janin në orën e leksionit: studioja gjestet, mimikën, komunikimin me auditorin, buzëqeshjet, ndonëse të rralla, mënjanimin e ndonjë fjale sado pak fyese për studentët, e studioja dhe ndieja një lloj admirimi për këtë pedagog të ri në moshë, që ishte edhe autor i tekstit-dispensë për studentët, çka donte të thoshte se ishte një autoritet në fushën e studimeve leksikologjike. Këto ishin jo vetëm përshtypjet e mia. Gjithë kursi ynë kishte të njëjtin vlerësim. Profesor Jani na kishte bërë për vete dhe ne e respektonim pa asnjë rezervë.

Ajo që spikat në punën e profesor Janit si pedagog ka të bëjë, besoj, me brendinë e lëndës që ai shtjellon. Në ato qindra e qindra fjalë, që në pamje duken të zakonshme e që përdoren

mijëra herë gjatë jetës, profesor Jani zbulon labirintet e tyre të pafund, zbulon ligjësitë e ndërtimit e të lidhjeve të tyre, numrin e madh të kuptimeve që mund të fitojnë, vlerat e tyre shprehëse, dhe të habit në analizën e frazeologjisë së gjuhës sonë, strukturat, dinamizmin dhe shprehësinë e atyre konstrukteve popullore, që shpesh duken si diçka e ngurtë.

Dhe Niko Dako vazhdon: Duke dëgjuar profesor Janin kuptuam më mirë se të studiosh gjuhën, qenka një punë shumë e thellë dhe e vështirë, gjë për të cilën u bëmë edhe më të vetëdijshëm në vitet në vazhdim, kuptuam se gjuha nuk janë vetëm emrat e foljet, kryefjala e kallëzuesi. Profesor Jani ishte nga të parët pedagogë që na zbuloi pasurinë e admirueshme të leksikut të gjuhës sonë amtare dhe vlerat e tij shprehëse që s'kanë kufi.

Leksionet e profesor Janit nuk shquhen vetëm për nivelin e tyre shkencor, për pasurinë e tyre leksikologjike, për forcën e argumentimit, por edhe për mënyrën e mesimdhënies së tyre. Leksioni shkollor, paraqitja logjike e tij, kombinohet me diskutimin, punën hulumtuese të studentëve, duke nxitur mendimin e pavarur krijues e kritik të tyre. Ai promovoi në auditor një të mësuar aktiv jashtë kornizave të pedagogjisë tradicionale, konformizmit duke stimuluar të mesuarit problemor dhe të vetëdijshëm të studentëve.

Studentët e tij në vite kujtojnë me dashuri dhe respekt profesorin e papërtuar, korrekt, human, motivues të studentëve që i këshilloi në punët e tyre krijuese duke ndihmuar në krijimin e brezave të shkencëtarëve të rinj. Në qëndrimin ndaj tyre spikat rigoroziteti shkencor, udhëheqja metodike, kritika konstruktive, por edhe miqësore, mbështetja e pakursyer dhe besimi në aftësitë dhe përpjekjet e tyre në fusha të ndryshme të shkencës. Kjo është arsyeja që profesori ynë i nderuar ka miq dhe kolegë të vjetër dhe të rinj në gjithë Shqipërinë dhe jashtë saj, që vazhdojnë të shohin tek ai burimin e informacionit shkencor, modelin e një shkencëtari që nuk rresht se krijuari, por dhe njeriun me të cilin mund të konsultohen, të shkëmbejnë mendime dhe të bashkëpunojnë.

Një pjesë e rëndësishme e veprimtarisë së tij pedagogjike është edhe drejtimi i kualifikimit shkencor dhe metodik i mësuesve të gjuhës shqipe në të gjitha shkollat e vendit. Edhe këtu ai u dallua për kërkesa tepër të larta, qëndrim serioz dhe trajtime cilësore. Kjo ka ndikuar në rritjen e profesionalizmit dhe mesimdhënies shkencore të gjuhës shqipe në të gjitha nivelet e shkollës.

Profesor Jani ndjehet i nderuar nga kjo veprimtari e organizuar nga universiteti ynë, duke kontribuar së bashku me ne për formimin e brezave të rinj, por une dua të theksoj që Universiteti F.S.Noli, ne të gjithë ndjehemi shumë më të nderuar që profesor Jani prej vitesh është pedagog i këtij universiteti.

Me këtë mendim bashkohet edhe Z. Niko Dako i cili shprehet: “Ndiej një ngazëllim të thellë që qyteti im dhe universiteti ku kam dhënë mesim, po i kremton me dinjitet 75-vjetorin akademikut Jani Thomaj, një nga emrat më të spikatur të gjuhësisë sonë”.

TRAJTESA BASHKËKOHORE TË AKADEMIKUT JANI THOMAI PËR SEMANTIKËN LEKSIKORE

Në faqen 16 të botimit të dytë veprës së tij akademiku J.Thomaj, duke u bazuar në një përcaktim të gjuhëtarit francez Greimas se semasiologjia ka qenë “një bijë e varfër e semantikës”, të krijon idenë se ndoshta një shkencë të tillë, e cila e lindur dhe e studiuar pas atyre që dhe sot në shumë njerëz nënkuptojnë shkencën e gjuhës (gramatika dhe fonetika), nuk do të kishte shumë për të thënë. Fakti që kjo shkencë huazoi dhe një korpus termash, konceptesh dhe metodash të përpunuara prej atyre që përmendëm, do t’i dukej si një “kostum i përdorur” këtij drejtimi. Për më tepër që kjo degë dhe sot e ka të vështirë të përcaktojë me lehtësi objektin e saj të studimit dhe metodat e veta brenda kuadrit të shkencës së gjuhësisë. Përfundimi i akad. J.Thomait se: “*Studimi i semantikës gjuhësore e sidomos i semantikës leksikore nuk ka më frenim, pavarësisht nga zbrazëtitë ende të pambushura ose mendimet herë-herë shumë të ndryshme në këtë fushë.*”⁶⁵ sjell në konceptin e studimit shkencor të kësaj fushe mundësi të larmishme dhe të parrahura deri më sot.

Kështu, botimi i ripunuar i akademikut sjell tashmë jo një vepër që i duhet fshirë pluhuri, por që me gjerësinë dhe thellësinë e trajtimeve të koncepteve të semantikës, me zbatimin e tyre për gjuhën shqipe të sjella përmes një ripërmasimi të ri shkencor, mbetet një vepër ende e vetme në llojin e saj.

Në të paraqiten në mënyrë të plotë të gjitha dukuritë që lidhen me semantikën. Në një vepër të tillë kanë zënë vend të hollësishëm analiza e shkollave gjuhësore në lidhje me semantikën duke vlerësuar faktin që këto shkolla, pavarësisht trajtimeve të skajshme, sollën specifikimin e semasiologjisë si shkencë. Duke i parë nocionet themelore të semantikës të lidhura jo thjesht me zbatimin e tyre në tërësinë e gjuhëve, por në veçanti, në gjuhën shqipe, akademiku J.Thomai vë në themel të analizës semantike analizën në përbërës kuptimorë, duke theksuar se njësia themelore minimale është përbërësi i kuptimit leksikor.

Gjerësia e trajtimeve për kuptimin leksikor, përbërësit e kuptimit, leksikalizimin, thekson faktin që kuptimi leksikor përbën njësinë themelore të semantikës, e cila mund të zbatohet lehtësisht në zbërthimin e strukturës semantike të shqipes. Njësitë minimale të kuptimit, përbërësit kuptimorë merren në tërësinë e tyre si njësi të cilat zbërthehen nëpërmjet teorisë së fushave. Në vështrimin e prof. Jani Thomajt prejardhja kuptimore ec sipas vijës së kalimit nga njësitë minimale (përbërësit e kuptimit leksikor) në njësitë maksimale të strukturës kuptimore. Janë pikërisht lëvizjet kuptimore që ndodhin mbi bazën e kalimeve semantike gjatë prejardhjes kuptimorë ato që krijojnë mundësitë e zbërthimit të polisemisë në homonimi. Ndëthurja e analizës semantike me atë distribucionale dhe komponencionale ka çuar në lindjen e koceptit të fushave linguistike. Në një trajtim të gjerë teorik, akademiku J.Thomaj sjell në vëmendjen e

⁶⁵ J.Thomai, *Prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe*, EDFA, Tiranë, 2009.

specialistëve vështirësitë e trajtimit të semantikës leksikore në bazë të fushave leksikore, po aq sa e bën dhe lehtësisht të mundur nëpërmjet trajtimit të këtij koncepti nga gjuhëtarë si Ipseni, Trieri, Porcigu, Lajonsi etj. *Përkufizimi i fushës si një tërësi lidhesh e njësive gjuhësore*(*semantike, leksikore, leksiko-sintaksore që mbulohet nga një fjalë ose një grup fjalësh ka bërë të mundur që të përshkruhet fusha semantike e çdo fjale duke u nisur nga pika të ndyshme vështrimi* (nga ideja e polisemisë fusha semantike-gjithë kuptimet e fjalës në një etapë të caktuar të gjuhës; nga ideja e homonimisë- fusha semantike e kuptimit të parë të fjalës e dallueshme nga ajo e kuptimit të dytë sipas elementëve semantikë pertinentë; nga ideja e lidhjes kuptimore të fjalëve-grupime sipas elementëve semantikë të përbashkët të sinonimeve apo sipas elementëve semantike të kundërta të antonimeve; sipas prejardhjes e lëvizjeve kuptimore të klasave leksiko-semantike e semantiko-fjalëformuesetë fjalëve etj). Përshkrimi i fushave, qoftë sipas tiparit semantik, qoftë sipas lidhjeve sintagmatike, qoftë si tërësi kundërvëniesh gjuhësore (në bazë të dimensionit semantik), qoftë si tërësi distribucionesh ka bërë të mundur një strukturim më të plotë semantik të fjalëve, zberthim më të hollësishëm të kuptimit leksikor drejt zbulimi të njësive minimale semantike apo dhe të tipareve semantike⁶⁶.

Studimi i këtyre dukurive është vështruar në lidhje të ngushtë me njëra-tjetrën brenda konteksteve dhe mikrokonteksteve ku fjalët sendërtojnë kuptimet e tyre, zbulojnë mekanizmin e përdorimeve, shfaqin veçoritë paradigmatiche duke e ndërthurur me analiza semasiologjike duke e çuar drejt zgjidhjeve objektive larg formalizmit ekstrem gjuhësor.

Po ashtu në shpjegimin e lidhjeve kuptimore përcakton katër përbërës bosht që mbështeten në përbërës të njëjtë, të ngjashëm, të ndryshëm dhe të kundërt. Këta përbërës bëhen burim i lindjes së nuancave kuptimore dhe kuptimeve të veçanta të cilat pasurojnë leksikun e shqipes me kuptime të gjalla.

Katër elementët bazë semantikë si brenda strukturës kuptimore të një fjale, ashtu dhe brenda çerdhes fjalëformuese (elementë që mund të jenë të ruajtur, të ndryshuara, të zhdukura apo të shtuara) ai i klasifikon në përbërës semantikë njëjtësues dhe diferencues. Është kundërvënia e tyre që përshkon rrugën e prejardhjes kuptimore, ndarjen e nuancave kuptimore të kuptimit leksikor, duke ndjekur rrjedhën që nga polisemia në homonimi. Njësitë specifike të semantikës (tiparet e realies-elementët e koncepteve-përbërësit e kuptimit leksikor nuk vështrohen shkëputur nga njëra-tjetra, si element i gjuhës për gjuhën⁶⁷, por në lidhje të ngushtë me kategoritë e të tri rrafshëve: realitetit, mendimit dhe gjuhës duke i përcaktuar kështu gjuhës bazën sendore-nocionore.

Nga ana tjetër, po aq e rëndësishme shihet ndjekja e zhvillimit historik të gjuhës e vështruar nëpërmjet studimeve etimologjike që ndihmon në mënyrë të drejtpërdrejtë për motivimin semasiologjikë etapave të prejardhjes kuptimore. Kjo, sipas prof. Jani Thamit tregon një dinamikë të kuptimit leksikor në gjuhën shqipe pothuaj të barabartë me njësitë që rrjedhin fjalëformimi duke sjellë një pasurim të jashtëzakonshëm të leksikut të shqipes. Kështu,

⁶⁶ J.Thoma, *Prejardhja semantike në gjuhën shqipe*, EDFA, Tiranë, 2009, f. 65

⁶⁷ Sipas konceptit të Sosyrit të shprehur në “Kursi i gjuhëssë së përrgjithshme”, Prishtinë, 2002.

akademiku J.Thomaj e sheh prejardhjen semantike si një analizë që nuk vjen e rastësishme në një vështrim thjesht sinkronik, duke vërtetuar thënien e Çabejt se “Nga pikëpamja e historisë së tyre, fjalët që përbëjnë leksikonin e gjuhës janë të krahasueshme me degëzat a gemat e një druri, të cilat me trugun e tij nuk janë ngjitur pandërmjetësisht, po në degë të mëdha që që ndahen prej këtij e nga të cilat ato janë degëzuar”⁶⁸.



Specializimi i lartë i ndajshesave në gjuhën shqipe krijon mundësi dhe për krijimin klasave të specializuara leksikore, modifikimi i këtyre ndajshesave sjellin lëvizje kuptimore dhe shpesh dhe kategoriale. Nëse vështrojmë në një kalim të shpejtë modelet semantike të fjalëformimit, mbi bazën e katër temave bazë që shërbejnë si burim i fjalëformimit akademik, J.Thomai nuk bën thjesht një përshkrim të rrugëve të fjalëformimit, por arrin në përfundime të rëndësishme për strukturat fjalëformuese të temave përkatëse. Është nga të parët gjuhëtarë shqiptarë që ka arritur të ndërthurë studimin krahasues të njësive gjuhësore me analizën statistikore të të dhënave, sipas numrit të modeleve dhe shpërndarjes së tyre. Kjo analizë statistikore krijon një pasqyrë të qartë të aftësisë fjalëformuese të temave si brenda së njëjtës kategori leksiko-gramatikore ashtu dhe midis kategorive të ndryshme. Kështu ai arrin në përfundime të rëndësishme që truktura fjalëformuese me bazë tematike emërore është e më e larmishmja, më e pasura në modele, por as në formimet kategoriale as në modelet fjalëformuese nuk ka të njëjtën shkallë prodhimtarie.

I gjithë ky punim nuk mbetet thjesht në kuadrin e një studimi të ngushtë brenda semantikës leksikore. Duke u nisur nga ideja që fjalorët shpjegues kanë për detyrë të kodifikojnë sistemin leksikor dhe semantik të gjuhës amtare, në këtë studim akademik J.Thomai jep një pasqyrë

⁶⁸ E. Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes I*, Tiranë, 1982, f. 73

krahasuese të semantikës të disa fjalëve në dy fjalorë shpjegues të shqipes (të 1954 dhe të 1980). Analizat e strukturave kuptimore të fjalëve në perspektivën e zhvillimeve të nuancave dhe kuptimeve të reja kuptimore në varësi të rrethanave historiko-shoqërore, kërkon pasqyrimin në fjalorë të strukturave sa më përfshirëse kuptimore, gjë që është mjaft e vështirë. Dhënia e strukturës kuptimore sipas disa kriterëve, si: ndarja e kuptimeve leksikore nga njëri- tjetri, dallimi i nuancave kuptimor edhe blloqeve kuptimore si dhe përcaktimi i lidhjeve të prejardhjes semantike, rendi i kuptimeve, vëllimi i tyre dhe shkalla e përkufizimeve sipas tipit të fjalorit janë të domosdoshme për ndërtimin e një fjalori shpjegues sa më përfshirës dhe të strukturuar. Pikërisht duke u mbështetur në këto procedura, “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” i vitit 2002 dhe ai i vitit 2006 janë fjalorë të cilët në vetvete kanë zbatuar me rigorozitet kriteret e mësipërme, duke u bërë mjaft të përdorshëm si dhe prurja bazë në fushën e leksikografisë shqipe.

Duke i uruar jetë të gjatë profesorit tonë të nderuar, i urojmë gjithashtu vazhdimësi në punën e tij në dobi të shkencës së gjuhësisë.

Prof. as. dr. Thoma DHIMA
Universiteti “E. Çabej”, Gjirokastrë

PROBLEME TË GJUHËSISË SË PËRGJITHSHME NË VEPRËN E AKADEMIK JANI THOMAIT

Rreth njëzet vjet përpara, kur nga katedra e sapoformuar e gjuhës dhe të letërsisë shqipe në Universitetin e Gjirokastrës, m'u caktua të jepja lëndën e *Gjuhësisë së përgjithme*, u ndodha përpara një sërë vështirësish. Jo vetëm se isha pedagog i ri e pa përvojë, si shumica e pedagogëve të porsaemëruar në atë katedër, jo vetëm se dega jonë e gjuhë-letërsisë ishte e sapoformuar, por kryesorja ishte se për këtë lëndë ishte e vështirë të gjeje e literaturë në ato vite. Kishte, pra, një mungesë totale të informacionit e të materialeve në këtë fushë. Si çdo lëndë tjetër në atë kohë, edhe gjuhësia e përgjithshme, i nënshtrohej një radiografie ideologjike, madje kjo për natyrën e vet, më tepër se të tjerat, se trajtonte probleme të filozofisë së gjuhës dhe probleme që kishin të bënin me rrymat dhe drejtimet e ndryshme gjuhësore. Por çështja më e vështirë ishte konceptimi i kësaj lënde, se çfarë duhej të përmbante ajo. Të gjitha këto vështirësi me kohë erdhën e u kapërcyen. Nuk ka, besoj, manual të gjuhësisë së përgjithshme sot në botë që të mos përmbajë elemente e njohuri nga gjuhësia strukturore ose strukturalizmi, që pushtoi çerekun e dytë të shekullit XX, e që i dha gjuhësisë një orientim e perspektivë të re, duke çelur shtigjet e një shkence moderne gjuhësore. Në kushtet e pengesave e barrierave ideologjike, merret me mend se sa mund të depërtonte strukturalizmi në Shqipëri dhe sa e vështirë ishte gjetja e literaturës për të dhe për zhvillimet e reja në gjuhësi. Sot, pas kaq vjetësh pune e përvoje në këtë fushë, mendova të përmbledh leksionet e mia të gjuhësisë së përgjithshme, enkas për studentët, sipas programit mësimor të shkollave tona të larta. Duke shfletuar skedat dhe shënimet e mia të shumta për probleme të ndryshme të gjuhësisë, gjeta edhe mjaft skeda të nxjerra nga libri i J. Thomait *Prejardhja semantike në gjuhën shqipe*, botuar më 1989, pikërisht kur unë merrasha me punën kërkimore në këtë fushë. E them sot me bindje të plotë se ky libër, në kohën kur u botua për herë të parë, ishte një ndihmë e madhe për ne pedagogët që jepnim gjuhësi të përgjithshme për disa çështje të kësaj fushe. Mendimi për të shkruar diçka për kontributin e këtij gjuhëtari në fushën e gjuhësisë së përgjithshme, më ka ngacmuar prej kohësh dhe ftesa për këtë konferencë më shtyu ta realizoj atë.

Literatura që kishte shfrytëzuar autori ishte e re në Shqipëri dhe e panjohur deri atëherë, megjithëse disa vepra të shfrytëzuara ishin botuar vite më përpara e madje ishin përkthyer në vende të ndryshme të Europës. Ai u është referuar jo vetëm korifejve të njohur, të themi klasikë, të gjuhësisë si Humboldti, Sosyri, Potje, Paul, Trier, Ullman, Delbryk, Vund, Sperber, Kasirer, Urban, Lanzher etj., por edhe autorëve më të rinj që u bënë të famshëm në gjuhësi me kontributin e tyre të shquar si Xhon Llajëns, Leon Blumfeld, Prieto, Klod Zhermen, Harris, Kac, Fodor, Naïda, Apresian, Lamb e deri te Çomski e shumë të tjerë.

Në *Prejardhjen kuptimore* shprehen qartë, ndër të tjera, dy çështje ndër më themeloret të gjuhësisë së përgjithshme. E para, problemi i semantikës ose semasiologjisë si shkencë, problem që edhe sot diskutohet në gjuhësinë e përgjithshme dhe e dyta, analiza e drejtimeve të ndryshme në gjuhësi për probleme të koncepteve themelore të semantikës leksikore, siç është kuptimi i fjalës dhe përbërja e kuptimit leksikor, ku janë marrë në analizë të gjitha rrymat e strukturalizmit, si dhe ato para e pas tij dhe qëndrimi i tyre në lidhje me kuptimin në gjuhë. Për çështjen e parë, duke iu referuar Grimasit, *Semantique structurale*, 1972, i cili thotë se semantika si shkencë ka

qenë bijë e varfër e lingistikës që ka lindur e fundit, pas fonetikës dhe gramatikës, nga mbarimi i shekullit XIX, autori vë në dukje se kështu ka ndodhur edhe me gjuhësinë strukturaliste, ku pas shkollës fonologjike të Pragës e gramatikës gjenerative mori vrull semantika, po me dyshimin në se kemi këtu një shkencë homogjene e për më tepër lingvistike. Përpunimi i metodave të veta, edhe përcaktimi i objektit të vet për semasiologjinë, edhe sot e kësaj dite përbëjnë vështirësi. Sematika, thotë autori, nuk ka përparësinë e fonetikës që inventari i numurueshëm konkret i fonemave lehtëson punën në fonetikë e në fonologji dhe i bën të përpikta studimet në këto fusha. Në semantikë ka ende koncepte të pangulitura e të paqëndrueshme për njësitë e saj si: *sema*, *semema*, *semiema*, *noema*, *semantema*, *tipari semantik*, *përbërësi i kuptimit*. Prandaj shumë gjuhëtarë vazhdojnë ta quajnë semasiologjinë shkencë në kërkim⁶⁹. Autori arrin në një konkluzion të qartë e të argumentuar shkencërisht në lidhje me qëndrimin ndaj semantikës si shkencë, se semasiologjia i ka përvijuar tashmë tiparet e veta si shkencë dhe nuk është në atë gjendje konfuzioni të dikurshëm, pavarësisht nga qëndrimet e ndryshme. Mendimet skeptike dhe faza e dyshimeve për shkencën e semasiologjisë mund të konsiderohen tashmë të kapërcyera dhe studimi i semantikës gjuhësore, e sidomos i semantikës leksikore, nuk ka më frenim. Kështu studimet semasiologjike janë në vijë të parë e janë zgjeruar aq shumë sa zënë vend të parë në gjuhësi⁷⁰.

Sa i përket problemit të dytë që shtruar më lart, në kapitullin *Konceptet themelore të semantikës* autori prek dhe shtjellon vertikalisht koncepte që i përkasin gjuhësisë së përgjithshme, sidomos për kuptimin dhe shenjën gjuhësore, duke u nisur që nga teoritë *nomo* e *fise* të antikitetit, duke vazhduar me nomonalistët e realistët në Mesjenë e nga maksima skollastike e cila thotë se *fjala shënon sendin me ndërmjetësinë e konceptit* e deri te konceptet e gjuhësisë gjenerative sot. Lidhja zinxhir *send – koncept – kuptim – fjalë*, lidhje e cila shkaktoi kaq shumë debate në gjuhësi, duke bërë që shkolla e drejtime të ndryshme gjuhësore të diferencohen nga njëra-tjetra, nga qëndrimi që mbajten ndaj kësaj lidhjeje, analizohet thellë e në gjerësi nga autori, sepse ajo është baza për të vendosur lidhjen e drejtë e të natyrshme ndërmjet realitetit, mendimit e gjuhës. Çështja se çfarë përmban shenja gjuhësore, çfarë lidhjeje vendoset midis dy anëve të saj, të shenjuarit dhe shenjuesit, çfarë natyre kanë këta dy përbërës të saj, edhe sot e kësaj dite gjen interpretime të ndryshme, sipas qëndrimeve që kanë mbajtur e mbajnë gjuhëtarët. Ullmeni e Sosyri i quajnë shenjën e konceptin njëlloj entitete mendore duke shkuar drejt idesë se referenti (i shënuari) nuk i intereson semasiologut. Lidhur me problemin e lëvizjes kuptimore, përfaqësuesit e drejtimit logjicist dhe shkolla psikologjiste e Vundit, të gjitha shndërrimet e kuptimeve përpiqen t'i vërtetojnë me arsye psikologjike, përmes sistemesh të ndërlikuara asociative. Përfaqësuesit e këtyre drejtimeve dhe teoria gjenetiko-empirike e H. Shperberit dhe E. Velanderit kuptimin leksikor ose e barazojnë me konceptin, ose gjithë proceset semasiologjike i shpjegojnë sipas teorisë asociative, teori që merr për bazë ndryshimet në konceptet fillestare, sipas një asociacioni organik ndërmjet fjalës dhe sendit, ose ndërmjet kuptimit dhe konceptit. Marri dhe gjuhëtarë të tjerë si A. Martia, A. Noreini, S. Ullmeni etj. duke shkëputur formën nga përmbajtja, duke ia nënshtruar çdo gjë në gjuhë kuptimit, ku gjithçka rregullohet sipas ligjeve të kuptimit, e kthyen semasiologjinë në një bazë universale të të gjitha dukurive gjuhësore, duke hedhur bazat e një drejtimi që u quajt *universalizmi semantik* i cili u shfaq në rryma të ndryshme strukturaliste. Kjo u duk, p.sh., në gjuhësinë franceze që me Sosyrin, për të cilin kuptimi i një shenje gjuhësore është ajo që shpreh kjo shenjë kur shqiptohet, pra kuptimi është një dukuri asociative, jashtëgjuhësore. Po kështu, Prietoja e quan kuptimin një

⁶⁹ J. Thomai, *Prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe (Semantikë leksikore)*, EDFA, Tiranë 2009, fq. 16

⁷⁰ *Po aty*.

entitet jolinguistik. Po nga ana tjetër, ky autor dhe të tjerë e pranojnë kuptimin si element të aktit semik. Në këto qëndrime autori nxjerr prirjen për të lënë mënjane identitetin jolinguistik të mendimit dhe të njihet vetëm identiteti linguistik i tij⁷¹.

Biheiviorizmi amerikan me Blumfildin e përjashtoi kuptimin nga gjuhësia, sepse për Blumfildin kuptimi i një njësie është shuma e situatave ku ajo shfaqet si stimulus. Kuptimi është objekt i psikologjisë së sjelljes. Kuptimi i fjalës *mollë* është punë e botanistit dhe jo e gjuhëtarit. Gjuhësia funksionale me Martinenë e të tjerë e shohin kuptimin si element të nyjëtimit të parë, që lidh konceptin me njësinë gjuhësore duke vënë në themel konceptin asociativ. Funksionalizmi e pa drejt konceptin e klasës së njësive gjuhësore: fjalën, leksemën, monemën, duke vënë në bazë të klasifikimit konceptin e “ndjenjës gjuhësore” të folësit. Raportet midis njësive gjuhësore dhe fakteve konkrete gjuhësia funksionale i konceptoi sipas raporteve tingull-fonemë nga edhe u huazua, pra, sipas një koncepti asociativ që e kishte formuluar Sosyri që më 1916: *Entiteti linguistik nuk ekziston veçse nëpërmjet asociacionesh të shënuesit e të shënuarit*⁷².

Gramatika gjenerative e ndau qartë aspektin sintaksor të studimit të fjalisë nga aspekti semantik duke dalluar anomali të tipit sintaksor: *mua duamë hamë bukës* dhe *animali të tipit semantik* si shembulli i njohur i Çomskit *Idetë e gjelbra pa ngjyrë flenë me furi*, për të treguar se ajo që quajmë ndërtim i drejtë (në kuptimin sintaksor) nuk ka të bëjë fare me aspektin semantik, me kuptimin, po është organizuar sipas ligjeve të veta⁷³. Në qoftë se do t’u referohemi botimeve më të fundit për fazat e zhvillimit të gramatikës gjenerative, mund të shtojmë këtu se qëndrimi i Çomskit ndaj përbërësit semantik në gramatikën gjenerative ka ndryshuar sipas këtyre fazave. Ndryshe nga modeli i *Strukturave sintaksore në Teorinë standarde*, gramatikës i shtohet modeli semantik që mungonte më parë. Më pas, te *Teoria standarde e zgjeruar* pranon që përbërësi semantik vepron jo vetëm mbi strukturën e thellë si në *Teorinë standarde*, por edhe mbi strukturën sipërfaqësore. Në këtë konceptim të ri të Çomskit ndikuan sidomos kritikën nga ana e semantikës gjenerative. Në modelin *Parime dhe parametra* Çomski përbërësin semantik e quan formë logjike (FL), me të cilën duhet kuptuar interpretimi semantik i strukturës sipërfaqësore. Roli i semantikës tani rritet së tepërti, se i kalohen funksionet që në modelet e mëparshme i takonin të dyja strukturave⁷⁴.

Të gjitha trajtimet që pamë këtu për kuptimin në gjuhë, për natyrën e tij dhe për marrëdhëniet që ai vendos me entitete të tjera, janë trajtuar nga autori duke u mbështetur në mënyrë rigorozë në kriterin e lidhjes së pandashme midis formës dhe përmbajtjes në gjuhë dhe në tezën se gjuha është realiteti i drejtpërdrejtë i mendimit. Autori nuk përshkruan vetëm shkollat dhe qëndrimet e ndryshme në lidhje me kuptimin, por mban dhe qëndrim kritik ndaj tyre, duke iu përmbajtur në mënyrë rigorozë tezës që përmendëm më lart.

Një çështje që ka interes për gjuhësinë e përgjithshme është analiza që prof. J. Thomai i bën përbërjes së kuptimit leksikor, duke marrë në konsideratë qëndrimet e gjuhësisë tradicionale dhe qëndrimet e gjuhësisë strukturaliste. Kjo analizë fillon me përcaktimin e njësive themelore të gjuhës a ligjërit, *fjalës*, me të cilën lidhet kuptimi. Gjuhësia strukturaliste, që me Sosyrin, duke parë dobësinë e gjuhësisë tradicionale për pasigurinë në përcaktimin e kufijve të fjalës, e vendosi atë në kryqëzimin e dy boshteve, të boshtit sintagmatik dhe të boshtit paradigmatic. Gjuhësia funksionale përcaktoi si njësi themelore *monemën*, kurse gjuhësia gjenerative u mor me *frazën* (në kuptimin e sintagmës). Nga gjuhësia amerikane lindi më tej kategoria e *morfës* dhe e

⁷¹ Po aty, fq. 22-23

⁷² Po aty, fq. 25

⁷³ Shih Th. Dhima, *Gjuha shqipe, Sintaksa*, shblu, Tiranë 2008, fq. 8

⁷⁴ Shih më gjerë R. Memushaj, *Gjuhësia gjenerative*, fq. 133

alomorfeve. Autori mban një qëndrim të vetin pamëdyshje në lidhje me njësinë themelore të gjuhës. Për të *fjala është njësi qëndrore jo vetëm e leksikologjisë dhe e gjuhës në përgjithësi, por edhe e semasiologjisë në veçanti që do të thotë se nuk mund të ketë një prerje rrënjësore ndërmjet studimit formal të gjuhës dhe studimit të kuptimeve*⁷⁵.

Në analizën e përbërjes së kuptimit leksikor, duke iu referuar shkollave të ndryshme të strukturalizmit, autori ka shpjeguar, së pari, konceptin e termit strukturalizëm si dhe përmbajtjen dhe kuptimin që mori ai në Europë dhe në Amerikë. Këto shpjegime janë me shumë interes për gjuhësinë e përgjithshme. Sipas tij, termi strukturalizëm në Amerikë pati një kuptim disi të ndryshëm e më të ngushtë se në Europë. U quajt kështu shkolla pasblumfildiane që sundoi në Amerikë pas Luftës I Botërore. Disa parime të kësaj shkolle nuk përputhen me parimet e strukturalizmit sosyrian e passosyrian, madje ndonjëherë edhe kundërvihen me to. Nuk duhet menduar se qe Sosyri ai që dha të gjitha parimet e strukturalizmit. Me mprehtësi ai vëren se idetë e stukturalizmit gjenden që te Herderi, Laibnici, Humboldti, madje edhe më parë në filozofinë gjermane paskantiane. Kjo rrymë e përfaqësuar nga Kasireri, Urbani, Lanzheri etj. u zhvillua pavarësisht nga strukturalizmi sosyrian. Teza themelore e strukturalizmit formulohet kështu: *Çdo gjuhë përbën një strukturë raportesh ose një sistem, njësitë linguistike nuk janë veçse nyja në një sistem ose në një rrjetë relacionesh. Ato janë rezultante të këtyre relacioneve dhe nuk ekzistojnë jashtë tyre*. Në këtë tezë autori kritikon faktin që strukturalistët njohin si parësore raportet dhe mohojnë mëvetësinë objektive të njësive gjuhësore. Një konceptim i tillë u shtri edhe në semantikë ku njësitë vihen në varësi të plotë të raporteve semantike, çka duket qartë në teorinë e fushave (leksikore, semantike etj.). Kuptimet e fjalëve të të gjitha gjuhëve mund të analizohen, sikurse fonemat, në përbërës më të vegjël (ose në tipare dalluese) që janë të pavarur nga gjuhët konkrete, duke e konsideruar përcaktimin e tipareve dalluese semantike thjesht arbitrar. Funksionalistët e Pragës mendonin se struktura e çdo gjuhe është e përcaktuar nga funksionet që kjo duhet të plotësojë. Këto funksione janë universale, me që edhe nevojat njerëzore e shoqërore janë universale. Edhe në semantikë nisën të veçohen njësitë universale. Le të kemi parasysh sot universalet gjuhësore që është një nga pikat më të forta të teorisë së Çomskit⁷⁶.

Një ndër shkollat e strukturalizmit europian që e çoi në ekstrem analizën formale të kuptimit të fjalës në përbërës ose në tipare dalluese (e ka ose nuk e ka tiparin e përcaktuar), është *glosemantika* e Hjelsmslevit. Konceptet e saj të formës dhe substancës së përmbajtjes dhe të formës dhe substancës së shprehjes kanë mbetur sot në gjuhësi. Analiza dhe shembujt përkatës nga *Prolegomanat* e Hjelsmslevi, një libër i vështirë për t'u gjetur dhe kuptuar sot, mund të gjenden në *Prejardhjen kuptimore* të J. Thomait, ku forma e përmbajtjes analizohet në figurën e përmbajtjes. Njësia më e vogël e kuptimit e Hjelsmslevit është *plerema*, një koncept i afërt me tiparin semantik, me semën, që ngrihet në nivelin e kategorive universale, e vlefshme për çdo gjuhë.

Analiza distribucionale, ashtu sikurse glosemantika, vlerësoi më shumë raportet. J. Apresiani duke u nisur nga teza e Z. Harrisit, sipas së cilës dy morfema që kanë kuptime të ndryshme dallohen gjithashtu në një pjesë edhe nga distribucioni i tyre, del në një postulat të kundërt me të Harrisit, sipas të cilit një dallim semantik mund të mos shfaqet në një dallim sintaksor, por çdo dallim sintaksor është patjetër pasqyrim i një dallimi semantik. Thelbi i analizës distribucionale është karakterizimi i njësive leksikore sipas distribucionit (pranëvënies) me njësi të tjera. Në themel të kësaj metode është vënë edhe mendimi i Harrisit. Kjo vlen si për kuptimet e një fjale (polisemantike) edhe për fjalët me kuptime të njëjta (sinonimike). Për çdo

⁷⁵ Po aty, fq. 30

⁷⁶ Po aty, fq. 32

njësi semantike (kuptim) ose leksikore (fjalë) jepet korpusi i plotë në të cilat shfaqet njësia e studiuar. Kjo ishte një arritje e gjuhësisë amerikane.

Në gjuhësinë amerikane lindi një metodë e analizës së kuptimeve leksikore që u quajt *komponenciale* e cila synon të ndërtojë fizionominë e njësive themelore semantike nëpërmjet njësive minimale, të cilat morën emërtime të ndryshme sipas autorëve e rrymave të ndryshme, si *përbërës semantik, tipare semantike, sema, plerema, noema etj.* Kjo analizë nisët nga teza se mund të analizosh kuptimin e çdo lekseme duke u nisur nga tërësia e përbërësve të kuptimit ose të tipareve semantike. Mbrojtësit më me peshë të strukturalizmit passosyrian të kësaj teorie ishin L. Hjelmslevi e R. Jakobsoni. Parimet që ata zbatuan në gramatikë e në semantikë ishin parime që Trubeckoi më parë i kishte zbatuar në fonolgji. Përfaqësues të kësaj shkolle janë A. Greimasi, B. Potjeja, L. Prietoja, E. Koseriu etj. Disa vjet më vonë kjo metodë u zbatua nga strukturalistë të tjerë të njohur si M. Lambi, E. Naida, Uriel Vanraihu, J. Katzi e J. Fodori. Metoda komponenciale duke u bazuar në opozicionet dhe në konceptin e binarizmit ka ndihmuar në zbulimin e fushave leksikore e semantike. Kjo metodë u zhvillua në drejtime të ndryshme, sipas gjuhëtarëve dhe shkollave strukturaliste, por më shumë se dallime në këto drejtime ka ngjashmëri. Kjo duket nga fakti që të gjithë janë përpjekur të ndërtojnë një inventar të plotë të përbërësve universalë të kuptimit. Nga përbërësit universalë dalin edhe kuptimet universale. Metoda komponenciale është kritikuar për karakterin psikologjist dhe subjektiv, për skematizmin duke mënjanuar specifikën e gjuhëve të ndryshme dhe për moszbatimin e saj në të gjitha leksemat, në fjalët abstrakte dhe në fjalët shërbyese.

Gjuhësia funksionale analizën komponenciale e modifikoi në një masë të vogël dhe e zbatoi duke e quajtur *analizë semike*. Kjo metodë ka epërsi ndaj metodës distribucionale, sepse nuk sheh vetëm afërsinë e jashtme të leksemave, por merret drejtpërdrejt me studimin e kuptimit të një grupi leksemash të së njëjtës fushë semantike. Fjalori i njohur i strukturalizmit në semantikë me termat *semë, sememë, arkisememë, semantemë* është kontribut i kësaj metode. Pavarësisht nga pikat e kritikueshme të saj, për karakterin e theksuar subjektiv e për mungesë objektiviteti, ajo pati si anë pozitive se depërtoi në njësi më të imëta semantike, përqasi njësi semantike e leksikore të njëjta, depërtoi në zbulimin sa më të plotë të kuptimit të fjalëve etj.

Në përshkrimin e shkollave të strukturalizmit, autorë të ndryshëm, analistë e historianë të gjuhësisë, në mënyrë të njëanshme i kanë mëshuar më shumë kontributit të strukturalistëve në rrafshin fonetik e fonologjik, si dhe në rrafshin gramatikor dhe më pak anës semantike dhe përpunimit që strukturalizmi i bëri këtij rrafshi të gjuhës. Në *Përbërja kuptimore* të J. Thomait gjen në mënyrë të plotë, do të thoshim, tablonë e punës që bënë shkollat e ndryshme të strukturalizmit europian dhe amerikan në rrafshin semasiologjik të gjuhës. Ky është padyshim një kontribut i padiskutueshëm dhe me shumë vlerë në gjuhësinë e përgjithshme dhe në teorinë e semasiologjisë.

MARRËDHËNIET FJALË/KUPTIM DHE TERM/KONCEPT NË KËNDVËSHTRIMIN E AKADEMIKUT JANI THOMAI

Ideja e këndvështrimit gjuhësor si kriter parësor për studimin e problemeve të semantikës së gjuhës ka rreze të gjerë zbatimi në tërë veprën e akademikut Jani Thomai dhe shtrihet në mënyrë integruese në semantikën leksikore, e konkretizuar në mënyrë të veçantë në marrëdhëniet fjalë/kuptim, të pasqyruara në strukturën semantike të fjalës shqipe. Përqendrimi i problemeve të semantikës te fjala kushtëzohet nga vlera strukturore e përmbajtësore e fjalës si njësi bazë e gjuhës; në rrafshin e formës ajo përfshin në vetvete njësitë më të vogla (morfemat, fonemat), por përfshihet në njësitë më të larta (në togfjalëshat dhe fjalitë), kurse në rrafshin e përmbajtjes përbëhet nga njësi të strukturuar minimale e maksimale, që lidhen në sistem me njëra-tjetrën dhe kështu, si forma ashtu edhe përmbajtja shpjegohen me njësitë e njëra-tjetrës⁷⁷.

Koncepti semantik i akademikut Jani Thomai, i mbështetur në kriterin e mirëfilltë gjuhësor, përshkon si fill i kuq të gjitha studimet e tij e në mënyrë të veçantë, veprën “Prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe”⁷⁸. Këtu qëndron edhe thelbi i qëndrimeve të tij kritike ndaj ideve të bazavënësve të semantikës, duke përfshirë më të mëdhenjtë, secili nga të cilët ka vënë nga një gur në themelet e saj, si figurat e përmbajtjes (Hjelmslev), sema e semema (Grimas), noema (Prieto), fushat semantike (Trir, Porcig). Mund të pohohet se nxjerrja në pah nga ana e tij e kufizimeve të secilit bazavënës të semantikës, në mënyrë të veçantë qëndrimet mbivlerësuese të tyre ndaj faktorëve jashtëgjuhësorë (logjikë, psikologjikë etj.), ndriçojnë me dritë të re idetë e mëdha që ata kanë futur në semantikë, të cilat kanë çuar përpara semantikën leksikore, si, analiza komponenciale, analiza distribucionale, teoria e fushave. Të gjitha këto kontribute kanë vendin e tyre në analizat e veçanta të semantikës leksikore.

Diapazoni i gjerë që përfshin koncepti semantik i akademikut Jani Thomai, i shtjelluar në mënyrë të thellë e të gjithanshme në kryeveprën e tij “Prejardhja kuptimore ...”, jep mundësi të hidhet dritë jo vetëm në anët dhe shfaqjet e fjalës dhe të kuptimit, duke përfshirë këtu tipat e fjalëve dhe të kuptimeve (konkrete, abstrakte, të figurshme), por edhe në areale përtej fjalës dhe kuptimit, të cilat, të vështuara gjuhësisht, lidhen drejtpërdrejt a tërthorazi me to. Një vend më vete zënë këtu termi dhe koncepti i shënuar prej tij. Këto dy madhësi, termi dhe koncepti, sigurisht përbëjnë njësitë themelore të terminologjisë, e cila, sipas këndvështrimit të sotëm, është një fushë më vete studimi, si shkencë me bazat e saj teorike, parimet, sistemin konceptor dhe metodat e analizës. Po të vështrohen të dyja këto njësi, njëra e formës (termi), tjetra e përmbajtjes (koncepti) nga pikëpamja thjesht terminologjike, ato do të dilnin pjesërisht jashtë kriterit të vështrimit gjuhësor të tyre dhe nga kjo pikëpamje, termi dhe koncepti, të krahasuar me fjalën dhe kuptimin, do të shiheshin si madhësi të kundërvënja të dy rrafsheve të ndryshme: të rrafshit të fjalës dhe të termit, të kuptimit dhe të konceptit.

⁷⁷ L. Hjelmslev, *La linguistique structurale*, Editorial d’A.L.VI. pp. v-XI, 1944.

⁷⁸ J. Thomai, *Prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2009.

Krahas këndvështrimit të mësipërm në rrafshin terminologjik-konceptor termi dhe koncepti mund të trajtohen edhe me kritere thjesht gjuhësore, të cilat dalin si të nevojshme dhe më qenësore për të zbuluar lidhjet e termit me njësinë bazë të gjuhës me fjalën si edhe të konceptit me kuptimin. Brenda këtyre marrëdhënieve fjalë/kuptim dhe term/koncept⁷⁹ krahas zbulimit të mekanizmit të formimit të kuptimit, të zbërthyer në strukturën semantike të fjalës, zbulohet dhe mekanizmi i formimit të konceptit të termit po brenda strukturës semantike të fjalës si strukturë sistemore-konceptore.

Për sa i përket termit si njësi emërtuese e konceptit, në historinë e zhvillimit të leksikut të shqipes, qysh nga rilindësit, ai është identifikuar e veçuar në kuadrin e fjalës në veprat shkollore të tyre, si njësi speciale, e përdorur në fusha të ndryshme të dijes, por pa u diferencuar thellësisht nga fjala, si termat *emër*, *mbiemër* (gjuh.), *mbledhje*, *zbritje* (mat.), *ishull*, *gadishull* (gjeogr.). Në fillim për konceptin “term” është përdorur *skaj* (Xhuvani), më vonë *termín* (Riza), që si i tillë sot takohet edhe në Kosovë, kurse qysh prej disa dhjetëvjeçarësh shënohet me *term*. Për njësinë e përmbajtjes është përdorur *kuptim*, më vonë *nocion* (përdorur edhe nga J. Thomai), kurse kohët e fundit, nën ndikimin edhe të anglishtes, si edhe për shkak të aftësisë fjalëformuese, është konsoliduar *koncept* (J. Thomai).

Lidhur me studimin e marrëdhënieve term/fjalë, një nga studiuesit e parë në fushë të shqipes që e ka përfshirë termin si tip fjale (= lloj fjale, d.m.th. njësi emërtuese speciale) në fokusin e teorisë së fjalës, si në rrafshin e formës, ashtu edhe në atë të përmbajtjes, si edhe në kuadrin e trekëndëshit të Ogdenit objekt-koncept-fjalë⁸⁰, është akademiku Jani Thomai qysh në tekstin mësimor për shkollën e lartë “Leksikologjia shqipe” në disa botime të përpunuara nga viti 1974⁸¹. Studimin e thelluar të marrëdhënieve fjalë/term në rrafshin e përmbajtjes, mbi bazën e analizës së strukturës semantike të fjalës shqipe, ai e ka bërë në veprën “Prejardhja ...” (2009).

Duke e paraqitur fjalën dhe termin si dy njësi të diferencuara njëra nga tjetra, ku fjala shpreh kuptim, kurse termi shpreh koncept, autori i “Prejardhjes...” nënvizon se “si fjala, ashtu edhe termi lidhen mbi një bazë të përbashkët që është koncepti, i cili mbetet kurdoherë themeli i kuptimit”⁸². Me këtë “koncept të përbashkët” ai ka parasysh atë që ai e quan *baza sendore-konceptore* e kuptimit. Duke qenë si bërthamë e kuptimit koncepti i fjalës bëhet bazë edhe për konceptin e termit, çka do të thotë se koncepti i termit ose del nga koncepti i fjalës ose ngrihet mbi bazën e këtij koncepti. Megjithatë në të dyja rastet, si kur del nga koncepti i fjalës, ashtu edhe kur ngrihet mbi bazën e tij, koncepti i termit përbën një madhësi të një niveli më të lartë. Pra, kemi koncept të nivelit të fjalës (= baza sendore-konceptore) dhe koncept të nivelit të termit të ngritur mbi nivelin e fjalës. Kështu mund të bëjmë skematikisht paraqitjen e mëposhtme:

⁷⁹ A. Duro, *Termi dhe fjala në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2009.

⁸⁰ C. Ogden, I. Richards, *The meaning of meaning*, 4^e edition, London, 1936.

⁸¹ J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1974.

⁸² J. Thomai, *Prejardhja..., vep. e cit.*

Në vështrimin e mekanizmit të zbulimit të konceptit e kuptimit për fjalën dhe konceptin e specializuar për termin mund të bëjmë dy paraqitje skematike, nga ku mund të përftohen dy struktura përmbajtëse: struktura semantike e fjalës me përfshirje brenda edhe strukturën konceptore të termit dhe veças struktura konceptore e termit. Në të dyja rastet elementet e përmbajtjes përfaqësohen nga e njëjta shenjë (i njëjti shënjes), e cila shfaqet si polisemë për çdo kuptim e koncept.

Fjala + termi

1. <i>rrënjë</i> sendore-konceptore)	(si shprehës i kuptimit bazë = bërthama	↓
	(“ <i>rrënjë</i> ” e pemës, si koncept i zakonshëm i pasqyruar nga fjala <i>rrënjë</i>).	
2. <i>rrënjë</i>	(si shprehës i konceptit të specializuar në	↓
fushën e botanikës, i cili ka dalë prej	konceptit të	
zakonshëm <i>rrënjë</i> . Me që	konceptet kanë dalë nga	
njeri-tjetri,	atëherë diferencimi i tyre ka të bëjë	
më	tepër me shkallë niveli: koncepti i fjalës – i	
ulët, kurse koncepti i termit – i lartë. Ky i	fundit	
del si interpretim i të parit. Kjo mund të	vërehet edhe tek <i>mal</i> (me	
kuptim = koncept të	zakonshëm dhe <i>mal</i> me koncept shkencor në	
	gjeografi).	

Diferenca ndërmjet koncepteve të shprehura
nga të njëjtat shenja mund të zbulohen në
përkufizimet e tyre me dallime ndonëse të
vogla, në dy fjalorë të ndryshëm: në një fjalor
shpjegues dhe në një fjalor terminologjik, siç
mund të duket tek *rrënjë*:


	<i>rrënjë</i> në Fj. 1980: “Pjesa kryesore kryesisht nën	
↓	dhé e një bime ..., që e mban të ngulur dhe që	shërben për të
	thithur ujin e ushqimin”	
	<i>rrënjë</i> në Fjalor Teknik (McGRAË-HILL) ⁸⁴ : “Organ	
↓	i një bime enëzore, zakonisht e	nëndheshme,
	pa gjethe e lule...”	

⁸⁴ McGRAË-HILL, *Dictionary of scientific terms*, 1978.

3. *rrënjë* si shprehës i një koncepti në fushën e
↓ matematikës

4. *rrënjë* si shprehës i një ngjyrese emocionuese-
shprehëse (“*rrënja* e këtij fisi është e thellë”).

Struktura konceptore e termit mund të ndërtohet pjesërisht si e veçuar mbi bazën e strukturës semantike të fjalës, ku çdo term si shënues i një koncepti mëvetësohet sipas fushës së dijes, por ajo mund të plotësohet më tej me zbërthime të mëtejshme, ku konceptet dalin si “zhvillime” të njëri-tjetrit. Struktura konceptore del kështu me shkallë largësie të ndryshme ndërmjet koncepteve, të cilat (shkallët) mund të indeksohen numerikisht. Po sjellim një shembull me *kokë* si term përfaqësues për fusha të ndryshme, por edhe për koncepte të identifikuara në lidhjet sintagmatike të termit, që shërbejnë si kontekste të tij.



Mund të vërehet se termi *kokë*, i veçuar si i tillë sipas fushës së dijes ku takohet koncepti përkatës që ai shënon, mund të përfaqësojë edhe koncepte të tjera që lidhen me të dhe në këtë mënyrë struktura konceptore e tij zgjerohet më tej, si *kokë* (korrëse) (= “aparati prerës i makinës korrëse”), *kokë* (rrahëse) (= “pjesa goditëse e çekiçit së bashku me pjesën ballore”), *kokë* (e frazës) (gjuh.) (= “pjesa kryesore e një strukture gjuhësore ...”) etj. Ndonëse si njësi e veçuar, e shkëputur nga fusha ku përdoret, *kokë* si term s’mund të kuptohet pa elementin përcaktues, si, p.sh., *kokë* pa *rrahëse* në *kokë rrahëse*, *kokë* pa *frazë* në *kokë e frazës*, në ligjërim ajo mund të funksionojë dhe e veçuar si: “Fraza përbëhet prej *kokës* dhe pjesës tjetër që e plotëson”, “Aparati i korrjes përbëhet prej *kokës* dhe pjesës tjetër mbështetëse...”. Kjo tregon se në këtë rast ne e trajtojmë termin në nivelin e termit fjalë dhe të palidhur me

sistemin terminologjik. Këtu mund të thuhet se kemi një vështrim gjuhësor të termit dhe e gjithë struktura konceptore e tij përbëhet nga një varg konceptesh të lidhura njëra me tjetrën në kuadrin e një shenje. Prej këtej, e vështruar në këndvështrimin e semantikës gjuhësore, gjithë struktura konceptore përbën një strukturë polisemantike. Megjithatë vështruar nga pikëpamja terminologjike, d.m.th., nëse të tëra këto lidhje do t'i shihnim si shenja termformuese në kuadrin e tërë sistemit terminologjik, atëherë secila shenjë do të ishte bazë e ndërtimit të termave togfjalësh dhe gjithë struktura mund të shihej si strukturë homonimike⁸⁵. Kjo mund të dilte e qartë nëse do t'i shihnim këto lidhje shkurt edhe në kuadrin e 2-3 fushave të dijes. Si shembull këtu mund të sillnim termin *pikë*, të përdorur në disa fusha dije si term më vete dhe në përbërje të termave togfjalësh si elemente përcaktuese:

Pikë (gjeom.) → *pikë prerjeje* – *pikë ndërprerjeje* – *pikë rakordimi*;

↓

pikë (usht.) → *pikë zjarri* – *pikë vrojtimi* – *pikë kontrolli*;

↓

pikë (fiz.) → *pikë ngrirjeje* – *pikë shkrirjeje* – *pikë vlimi*;
etj.

Nga sa parashtruam më sipër del se këndvështrimi gjuhësor është i vlefshëm për çdo njësi të rrafshit të përmbajtjes, qoftë ajo edhe jo plotësisht e lidhur me semantikën gjuhësore (leksikore) siç është koncepti i termit, mjafton që kjo njësi abstrakte të lidhet me fjalën sikur edhe me një pjesë ose me disa elemente të saj.

Vështruar nga kjo anë termi, i trajtuar në nivelin e termit fjalë, shërben si shembull i lidhjes së përmbajtjes së tij, të konceptit si njësi e rrafshit jashtëgjuhësor, me kuptimin si njësi e rrafshit gjuhësor, përmes një elementi të ndërmjetëm që qëndron midis tyre, siç është baza sendore-konceptore e kuptimit. Në këtë rast termi lidhet me bazën me të cilën ai krijohet në gjenezën e tij, me fjalën (siç sollëm si shembull *mal* (fjalë) – *mal* (term) (gjeogr.), por edhe me zhvillimin në vetvete siç sollëm si shembull *kokë* (njeriu) – *kokë* (organi) e më tej *kokë* (shpuese) deri *kokë* (e frazës) (në gjuhësinë gjenerative). Vështrimi i termit mbi bazën e kriterëve të semantikës gjuhësore është shumë dobiprurës dhe shërben për të studiuar në thelb mekanizmin e krijimit të konceptit (si akt krijimi) dhe për të zbuluar mekanizmin e funksionimit të tij si produkt i krijuar.

⁸⁵ Xh. Lloshi, *Rreth disa shfaqjeve të homonimisë në gjuhën shqipe*, në: “Studime për leksikon...”, I, Tiranë, 1972.

Prof. as. dr. ABDULLA BALLHYSA
Universiteti “A. Xhuvani”, Elbasan

AKAD. JANI THOMAI PËR ANALIZËN LEKSIKOLOGJIKE TË TEKSTIT

“ Kushdo që përpiqet të kuptojë një tekst a një thënie [...] doemos duhet të hyjë në analizën e atyre mjeteve të shprehjes që e ndërtojnë këtë tekst, d.m.th. të kuptojë fjalët, lidhjet e tyre vlerat e mjeteve në rrjetin e tërë tekstit etj.” – shprehet profesor Jani Thomai kur flet për metodën e analizës së tekstit. (1992)⁸⁶

Vinte ky pohim në një kohë kur në shkollat tona parauniversitare, veçanërisht në gjimnaze, por pse jo, edhe në Fakultetet e Letrave, zhvillohej një lëndë a orë e veçantë mësimi, e emërtuar “ Koment letrar”.

Kjo disiplinë e interpretimit dhe e shpjegimit të tekstit, duke u konsideruar si pjesë e Stilistikës Letrare, i linte “dorë të lirë” dhe i jepte krahë imagjinatës së mësuesit të letërsisë, qoftë edhe duke mos u mbështetur edhe aq, në materialin leksikor , në “brumin” e vërtetë me të cilin ishte ndërtuar ajo poezi apo ai paragraf, d.m.th. ai tekst.

Si *shembull* mund të sjell këtu 4 vargje të interpretuara nga një mësues gjimnazi në fund të viteve ’80-të:

*Nga lufta kthehen
shkëmbinjsh debojë.
Me gaz në buzë,
Me këngë në gojë.*

Komenti i mësuesit.

Këtu dalin – shprehet ai, tri ide të mëdha dhe me vlera të përhershme për popullin tonë:

- 1. Shkëmbinjsh debojë= malet tona kanë qenë përherë depo armësh e strehë për luftëtarët e të gjitha kohërave, për lirinë dhe pavarësinë e këtij vendi. Ata janë dhe do të jenë aleatët tanë në luftën e drejtë që bën populli shqiptar kundër pushtuesve të të gjitha kohërave dhe ngjyrave.*
- 2. Me gaz në buzë= ky ishte gëzimi i fitores në këtë luftë të drejtë, por të pabarabartë. Ky popull luftarak ka të drejtë të gëzojë se kështu sakrificat e bëra nuk shkuan kot dhe u shpërblyen me liri, aq shumë të dëshiruara. Autori shpreh kështu edhe gëzimin që ndien vetë.*
- 3. Me këngë në gojë = Kënga i ka shoqëruar përherë festat dhe gëzimet tona. Kënga e pushkës për liri dhe kënga e festës së fitores nuk janë ndarë asnjëherë nga njëra-tjetra. Populli ynë, me këngë i përcillte trimat në beteja dhe, po me këngë, i priste ata ballëhapur e çlirimtarë.⁸⁷*

E nga ky lloj “ fluturimi letrar ” shkollaresk, që na vjen nga shkolla e vjetër aristoteliane, e cila vazhdon ndikimin e saj tek ne edhe sot e kësaj dite, synon të na “shpëtojë” vepra, aq e nevojshme dhe e domosdoshme për kohën “ Teksti dhe Gjuha” (analiza leksikologjike), e botuar

⁸⁶ Jani Thomai, “ Teksti dhe Gjuha”, SHBLU, Tiranë 1992, f. 6.

⁸⁷ Këtë lloj komentit e kam dëgjuar në një orë mësimi “ Koment nga Epopeja e Ballit...” në vitin 86 në një gjimnaz të Elbasanit, zhvilluar nga njëri prej mësuesve i cili mbahej si ndër më të mirët në atë kohë.

prej prof. Jani Thomait për t'u ardhur në ndihme të gjithëve: mësuesve dhe studentëve, pasuniversitarëve dhe studiuesve të gjuhës dhe të letërsisë.



Është ky një tjetër gur i madh e i rëndë që mësuesi ynë, prof. Jani, vendos në themelet e një disipline të re, që sapo kishte nisur të kristalizohej si fushë më vete studimi, me teorinë dhe e praktikën përkatëse.

Ai është ndër të parët në gjuhësinë tonë që sjell *tendencën për një shkollë të re të interpretimit të tekstit*, të folur dhe të shkruar, duke iu përmbajtur idesë bazë se veçoritë e fjalëve të leksikut, përdorimi i njësive leksikore, “*përbëjnë “qelizat” e ndërtimit të tekstit dhe mbartin veçanësitë themelore që karakterizojnë tekstin në përgjithësi*”⁸⁸

Nga kundrimi i hollësishëm i veprës, për këdo që synon ta kuptojë mirë një tekst, del mësimi se pa analizën e mjeteve të shprehjes të cilat janë pjesë ndërtuese të atij teksti, pa i kuptuar mirë fjalët, lidhjet midis tyre, pa i analizuar mirë kuptimisht dhe përdorimisht fjalitë dhe shprehjet e tij, nuk mund të arrihet një analizë të mirëfilltë.

⁸⁸ Po aty, vep.cit, f. 4.

Duke iu përmbajtur këtij parimi të fortë të shkollës Sosyriane, që, për hir të së vërtetës, duhet thënë se pak ishte e dëgjuar e aq më pak njihej në ato vite në Shqipëri, autori dallon shkencërisht përdorimin e kësaj metode edhe në fusha të tjera si: stilistika letrare dhe psikanaliza.

Duke qenë përherë i përkorë e duke synuar që shkenca gjuhësore Shqiptare, e veçanërisht, kujdesi për të shmangur keqinterpretimet e diletantizmat e mundshme në përdorimin e metodës së analizës së tekstit në gjuhësi, autori, me “hallin” e prindit për mirërritjen e krijesës së re porositi: “*Boshti që përshkon zbatimet e drejta të kësaj metode, është ballafaqimi i gjuhës me mendimin, i mjeteve dhe i mënyrave të shprehjes me përmbajtjen e tekstit dhe me synimet e krijesit (folës e shkruar).*”

Nga na tjetër, jo vetëm komenti për koment, i pambështetur në materialin konkret (fjalën dhe lidhjet përdoruese të saj), por edhe mbitheksimi i analizës gramatikore, edhe kjo një sëmundje e vjetër e shkollës sonë, shihet si një proces që nuk mund të jetë mbizotërues gjatë analizës tekstore.

Analiza gramatikore si analiza morfematike e fjalëve, karakterizimi i pjesëve të ligjëratës, përcaktimi i gjymtyrëve të fjalisë etj., të zbatuara me korrektesë, sipas rasteve të paraqitura dhe në masën e duhur, nuk mund të lihen edhe jashtë analizës së përgjithshme të tekstit. Kryerja e edhe e këtij procesi do çonte analizuesin në një shikim e trajtim aq më pranë tërësorës për një njësi tekstore të dhënë.

Pra, edhe pse si disiplina më vete, metoda e analizës së tekstit (analiza leksikologjike) shihet e trajtohet si një mundësi lidhjeje edhe me disiplinat e përmendura më sipër.

Një qëndrim i tillë (jometafizik) është karakteristik e i shprehur edhe këtu, në këtë hulli të re studimore, si në të gjitha studimet dhe fushat kërkimore ku ka dhënë e vazhdon të japë kontributin e tij të vyer prof. J. Thomai.

Një tjetër karakteristikë e mënyrës se si shkruan e i parashtron edhe çështjet më të koklavitura prof. Jani Thomai është *thjeshtësia dhe konkretësia*, që ndeshet edhe në veprën për të cilën po flasim. Kjo besoj se vjen nga *qartësia e pikëpamjeve dhe siguria në shtrimin e tyre*. Prej këtej ne arrijmë të kuptojmë qartë dhe pa as më të voglin dyshim se metoda e analizës së tekstit, kuptimi dhe zbatimi i saj në gjerësi dhe në fusha të ndryshme ka sjellë si rrjedhim edhe larminë edhe kundërshtinë kuptimore e zbatuese gjëra që janë të zakonshme dhe të nevojshme në hulumtimet shkencore. Ajo që duhet theksuar këtu është fakti se zbatimi i kësaj metode në gjuhësi ka shfaqur *dy mangësi themelore*:

1. përdorimin kryesisht në tekstet letrare, duke lënë jashtë këtij zbatimi edhe lloje të tjera tekstesh dhe duke u mbuluar së shumti nga stilistika letrare dhe
2. analiza ka mbetur vetëm si e tillë, analizë, pa shkuar në përfundime dhe sinteza e përgjithësime.

Duke tërhequr vëmendjen për kujdes në përdorimin e formalizuar, “të standardizuar” të kësaj metode në gjuhësi (në analizën leksikologjike të teksteve), autori sqaron domosdoshmërinë e shmangies së skemës tradicionale e cila përmbledhet në:

1. inkudrimin e tekstit; 2. zbulimin e rendit të ideve; 3. shpjegimin linear të tekstit; 4. cilësimin e mjeteve me vlerë artistike.

Një përdorim i tillë i skematizuar deri në ekstrem çon pikërisht në ndrydhjen e mundësive të pafundme që jep kjo metodë dhe në shkollarizimin e saj.

Në ditët e sotme tingëllon si diçka fare banale (si e paranjohur), por në fund të viteve '80-të, koncepti për tekstin e llojet e tij ishin pothuaj të turbullta e gati-gati të panjohura prej masës së atyre personave që e kishin zgjedhur për profesion gjuhën dhe letërsinë duke përfshirë edhe mësimin e saj në shkollë e në universitet. Mund të numëroheshim me gishtat e dorës vetat që kishin pasur rastin të njiheshin me vepra të tilla të botuara jashtë qoftë në shqip si p.sh. “ Shumësia e tekstit (1980) e Rexhep Ismajlit, apo në gjuhë të huaj si vepra e Sosyrit e Hjelslevit etj. Edhe vepra e prof. Xhevat Lloshit “ Stilistika” botuar në mesin e viteve '80-të, pak njihesh nga masa e atyre që kishin nevojë të përditshme analizën stilistike e letrare të veprave letrare që përfshiheshin në programet mësimore të asaj periudhe.

Së këtijmi del edhe më mirë në pah kontributi i Shkencëtarit Jani Thomai i cili *diti të sjellë thjeshtë, qartësisht dhe thuktazi, të dhënat kryesore për këtë lloj metode e shkolle në gjuhësi.*

Duke u ndalur në Parametrat e analizës të bie në sy edhe një tjetër risi, që pasqyron ndryshimin e mendimit të specializuar mbi gjuhën dhe rëndësinë e njohjes së saj. Tanimë theksi vendoset tek përdorimi dhe funksioni i gjuhës dhe jo aq tek forma e saj. “ *Analiza është metodë dhe si objekt ka tekstin që përbëhet nga fjalë e fjali. Pra, leksiku (fjalët e kuptimet) dhe sintaksa (togfjalëshat, sintagmat dhe fjalitë) janë dy drejtimet kryesore ku synon analiza e tekstit. Rrjedhimisht, mund të bëhet një analizë e mirë e tekstit nëse analizuesi ka njohuri sa më të plota për leksikun dhe sintaksën e gjuhës shqipe, të gjuhës letrare shqipe, të gjuhës dialektore, të ligjëtimeve dhe të stileve funksionale. Vetëm kështu mund të shkohet më tej [...] për të zbuluar strukturimin e tij të brendshëm, si lidhet forma e shprehjes me përmbajtjen e caktuar, si lidhet teksti bazë me makrotekstin, me autorin, me kohën etj.*”⁸⁹

E, siç theksova, këto e të tjera koncepte si këto, ishin pothuaj të reja për shumicën e studentëve, mësuesve dhe pasuniversitarëve, të cilët ishin disa orë në javë përpara provës së analizës (komentit) të teksteve të ndryshme.

Kur e analizon se ç'ka ndodhur në atë kohë (kur po shkruhej e përgatitej botimi i këtij materiali) del në përfundimin se kjo ishte *një frymë e re* që kishte filluar të ndihej fort në zbatimet gjuhësore të asaj periudhe. Kam parasysh këto faktin e hartimit të programeve, planeve dhe të teksteve të reja për mësimin e lëndës së gjuhës shqipe në shkollën 8-vjeçare. Autorët e këtij dokumentacioni e vinin theksin se gjuha që u mësojmë fëmijëve nuk duhet atyre për stoli akademike, ajo është mjet e vegël në zotërim të atij që do ta përdorë dhe frytshmëria e komunikimit varet pikërisht nga ky posedim praktik përdorues. Gjuha, përpara se të jetë formë, është funksion. Këtë mesazh, që thyente konceptin tradicional se “*kush njih gramatikën – zotëron gjuhën*” u munduam t'u përcjellim në atë kohë arsimtarëve dhe kujtdo që merrej me

⁸⁹ po aty , vep. cit., f. 9.

gjuhën në shkollë dhe, në këtë hulli, padyshim, një ndihmesë mjaft e madhe ishte dhe botimi i veprës “ Teksti dhe gjuha”.⁹⁰

Nga ana tjetër analiza e tekstit, as mund të njëjtësohet dhe, as mund të shmanget nga analiza stilistike. Analiza leksikologjike e tekstit merr nga analiza stilistike, por dhe e përfshin atë. Synimet e analizës së stilistike janë pjesë përbërëse e analizës së tekstit.

Prof. Jani e njeh mirë gjendjen e studimeve shqiptare në këtë lëmë dhe për këtë arsye, duke synuar që të jetë sa më i saktë shprehet se “ Ato synime (të analizës stilistike, shënimi im A.B.) janë formuluar në mënyrë të përgjithësuar nga Xh.Lloshi : “ *Analiza stilistike nuk kërkon përftesat dhe figurat e veçanta, por parimin drejtues të organizimit..., duke vënë në dukje jo vetëm vlerat stilistike, por funksionin e domethënien e tyre.*”⁹¹

“Analiza e tekstit është shumë më e gjerë, prandaj ka synime shumë më të gjera. Veç synimeve të analizës stilistike, ajo kërkon edhe zbulimin e vlerave të mjeteve të shprehjes gjuhësore, të përftesave stilistike dhe të përftesave të veçanta, të figurave gjuhësore dhe të figurave letrare, zbulimin e mundësive të tjera të shprehjes të së njëjtës përmbajtje mendimore ose emocionuese, motivimin e njërës ose të tjetrës zgjedhje gjuhësore të shprehjes së një përmbajtjeje të caktuar etj.”⁹²

Të gjitha këto, të shprehura si qëndrim teorik mbi çështjen që po rrahim, nuk do t’i kishin vlerat e tyre të plota pa shembujt dhe kontributet e zgjidhjeve praktike të shkruara nga vetë autori. Pikërisht bollëku i shembujve me praktika analize për vepra të llojeve e të madhësive të ndryshme ia shtojnë vlerat veprës, ia rrisin frytshmërinë e përdorimit nga cilido që kërkon t’i hyjë punës jo dhe aq të lehtë të analizës së tekstit.

Në përfundim, pa pasur drojë se zgjatëm, por duke u tutur se nuk po arrij të zbuloj ndonjë të re a krejt të panjohur, pasi vepra e prof. Jani Thomait është zëmadhe në gjithë lëmin e studimeve e të veprave gjuhësore shqiptare dhe ballkanike, më lejoni ta mbyll këtë kumtesë me urimin: - E paçim përherë kështu Profesorin tonë, të ri dhe shëndetplotë në fizik dhe në krijimtari !

Në fund të viteve – 70-të, kur dëgjonim në universitet fjalën *leksikologji*, na vinte ndërmend edhe prof. Jani Thomai, por tani, kur dëgjojmë të njëjtin term, na shfaqet përpara “princi i studimeve shqiptare” në këtë fushë e cila pret edhe punëtorë lëvrues të tjerë që duhet ta ndjekin këtë shembull frymëzues.

Faleminderit!

⁹⁰ Në ato vite (1990-91) u krijuan të ashtuquajturat “Bërthama të modernizimit të Gjuhës Shqipe”, të cilat ishin ngritur dhe funksiononin pranë Kabineteve Metodike (në vartësi të ISP-së) në rrethe të ndryshme të vendit. Këto bërthama kishin si detyrë kryesore përcjelljen e së resë që sillte dokumentacioni i ri për lëndën e gjuhës shqipe në shkollën 8-vjeçare. Bashkë me trajtimin teorik kryheshin edhe praktikat përkatëse të cilat ishin në mbështetje të nocioneve të reja që zinin vend e organizonin këto programe, tekste e literaturë ndihmëse. Libri “ Teksti dhe Gjuha “ishte një material mjaft i dobishëm dhe frytdhënës për këtë synim.

⁹¹ Xh. Lloshi, Vlerat stilistike në një tregim të Migjenit, “ Nëntori”, 1983.

⁹² Vep.cit. f. 11.

Prof. as. dr. ARTUR LAMAJ
Universiteti “E. Çabej”, Gjirokastrë

DISA VËSHTRIME TË PROF. JANI JHOMAIT MBI MOTIVIMIN E NJËSIVE LEKSIKORE NË GJUHËN SHQIPE

Duke ndjekur evolucionin e dijes gjuhësore shqiptare, nuk mund të harrosh arkivin jetësor e shkencor të akademikut Jani Thomai, leksikologut të autoritëshëm që në hulumtimet dhe studimet e veta, ka qenë i gatshëm të paraqes pasionin, punën e kujdeshme, intuitën, shpjegimet, zgjidhjet e mundshme për kategori, dukuri, procese, klasa e derivate leksiko-semantike, për kodifikimin e njësive leksiko-gramatikore në fjalorët shpjegues, dy gjuhësh, krahinorë e ballkanikë etj.⁹³

Dijet, ligjërimet, artikujt dhe monografitë e prof. Jani Thomait që prej disa dekadash janë mjete pune e studimi në auditoret universitare. Ato sjellin dritë për makro dhe mikrostrukturën semantike. Është e rëndësishme të thuhet se sa më shumë futesh në gjiththëniet e prurjet e krijimtarisë së tij, aq më pranë ndjen thellësinë e plotësinë e analizave, të përfundimeve, maturinë shkencore; zbulimin e mesazheve udhëhapëse për dijen semantike, stilistikore, dialektore, psikolinguistike etj.

Në hapësirat e tyre merr udhë edhe parashtesa jonë, duke iu afruar ndihmesës e shpjegimeve, perceptimit gjuhësor e social të motivimit. Motivimi është një faktor i rëndësishëm në organizimin e leksikut. Studiuesit evropianë e kanë perceptuar atë si “një lidhje të nevojshme që vendos folësi midis fjalës dhe kuptimit të saj, ose si një lidhje midis fjalës dhe një shenje tjetër”⁹⁴.

Sipas trajtimeve në rrjedhë kronologjike, mësojmë se motivimi merr udhë në filozofinë platoniane, ku mbartet me emërtimet kratilizmë e mimologjizmë. Ai popullarizohet në vitet '70 të shekullit XX nga Gerard Genette dhe ka në themel shpjegimet për lidhjen mes fjalës e realitetit të treguar. Krahas këtij qëndrimi, dija enciklopedike na mundëson njohjen e vlerësimeve të partizanëve të arbitraritetit të shenjës se “fjalët janë pikturë e gjërave”, apo tezën e Frojdit se “fjalët janë gjurmë të një trashëgimi filogjenetik”.

Në këtë udhëhapje, studiuesit e gjuhëtarët shqiptarë i kanë orientuar analizat e tyre në struktura që përcjellin vështrime, krahasime e klasifikime, me një parashtesë që fillon me shpjegimin e origjinës, të lidhjeve morfologjike e paradigmatiche të fjalëve, të marrëdhënieve të fomës me përmbajtjen e njësive terminologjike⁹⁵, dmth kanë bërë objekt studimi lidhjet midis pjesëve të shenjës gjuhësore: signifiant e signifié (shënuesi dhe i shënuari), shpjegimet e lindjes së fjalës e të kuptimeve të saj, solidarizimin a bashkëshoqërimin e fjalëve në sintagma e togfjalështa⁹⁶.

⁹³ Lamaj, A. Disa vështrime mbi leksikun poetik, *Kërkime universitare*, Gjirokastrë, 22, f. 33.

⁹⁴ Holeš, J. Est-ce que le signe linguistique est motivé, *Phonologica* 76, ph. 133.

⁹⁵ Proko, V. - Duro, A. Motivimi në terminologjinë e agronomisë në rrafshin e temëformimit, *SF*, 1-2, 2006, fq. 75-94.

⁹⁶ Gjocaj, Z. *Struktura leksiko-semantike e stilistike e frazeologjisë shqipe*, Prishtinë, 2001.



Duke dashur të këndvështrojmë fillin e aureolës së parashtrimeve të studiuesit Jani Thomai, që ne mendojmë se i përket semantikës, nuk mund të lëmë pa përmendur se gjuhëtari largpamës iu afrohet perceptimeve sosyriane për arbitraritetin e shenjës⁹⁷ e motivimin relativ të disa njesive leksikore komplekse⁹⁸, vështrimeve të Andrea Martinesë⁹⁹ për motivimin sekondar, “si një rast i veçantë i strukturës së leksikut, por edhe si mjet i ekonomisë në gjuhë”, përcaktimeve të S. Ullmanit¹⁰⁰ për motivimin e konvencionalitetin si “tipare sinkronike që lidhen me tejdukshmërinë a padukshmërinë për një bashkësi gjuhësore të dhënë”, klasifikimeve e tezave të shkollës çeke për motivimin e fjalëve sipas tipareve e cilësive të qenieve e sendeve¹⁰¹, mesazheve të Eqrem Çabejt për kërkimin e kuptimit të parë e të vërtetë të fjalëve.

Leximi dhe hulumtimi i vëmendshëm i ligjërimit shqip, mbledhja e lëndës drejtpërdrejt në terren i kanë dhënë mundësinë të gjejë e veçojë, formëfjalë që bëjnë përjashtim nga parimi sosyrian i arbitraritetit të shenjës, kuptime të motivueshme e të pamotivueshme, morfema e tema fjalëformuese, struktura paralele semantikoformuese mes sintagmave e njesive frazeologjike etj.

⁹⁷ Thomai, J. *Prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2009, 78.

⁹⁸ Vincent, N. *La sémantique*, Berlin, 1998, f. 25.

⁹⁹ Holeš, J. Est-ce que le signe linguistique est motivé, *Phonologica* 76, ph. 134.

¹⁰⁰ Holeš, J. Est-ce que le signe linguistique est motivé, *Phonologica* 76, ph. 135.

¹⁰¹ Duchaček, O. *Précis de sémantique française*, Paris, 1967.

Është plotthënës fakti se prof. Jani Thomai di të mbart e përshtas për gjuhën shqipe teza e perceptime që kanë të bëjnë me komunikimin semiotik e gojor mes folësve. Kur mëton për të shpjeguar karakterin dhe tiparet e onomatopeve sipas kriterit kuptimor,¹⁰² autori merr parasysh analogjitë mes formës dhe kuptimit, ngjashmërinë mes formave gjuhësore dhe realiteteve që ato tregojnë, por gjithsesi faktet e përmendura tregojnë se kjo mundësi është relative dhe e kufizuar. Në udhën e përqsasjeve që i bëhen kësaj kategorie me fjalën, gjuhëtari ndalet në karakterin e ngjashmërisë relative, sepse çdo gjuhë mundëson një stilizim të veçantë të materialit sonor që ofron realiteti.¹⁰³ Kështu, tingujt e nyjëtuar *bum, ciu, fësht, gau, gërr, ham, tring, uuu* etj. që imitojnë në mënyrë të përafërt zhurmat e zërat e qenieve e sendeve në natyrë, perceptohen si sinjale të drejtpëdrejta, në ndryshim nga fjalët që janë quajtur “sinjal i sinjaleve”.¹⁰⁴

Në hullinë e studimeve në këtë lëmë vihet re një kombinim i arsyeshëm i tezave të tij me ato të shkollës gjuhësore perëndimore, kur bëhet fjalë për trajtimin e disa njësive leksikore që mund të analizohen, interpretohen e motivohen falë deduksionit “pëmë me ... kokrra ...”, si: *dardhë, ftua, kumbull, mollë, qershi, limon, mandarinë* etj. Në këto raste lidhja e formës tingullore me kuptimin qartësohet nga njohja e njësive tjera terminologjike.

Shkrimtaria e tij profesionale ngjan me një mozaik me larmi trajtimesh. Në udhën e studimeve që i përkasin fushës së etimologjisë, ai është vazhdues dhe bashkudhëtar me gjuhëtarët shqiptarë që vunë nga një gur në ndërtesën e burimit të shqipes apo që “mungesën e krahasimit të jashtëm e kompesuan me një njohje të plotë të gjuhës amëtare”.¹⁰⁵ Kështu, si vëzhgues i hollë, por edhe si njohës me detaje i strukturave leksikore e semantike të shqipes, ai bashkohet me mendimet e gjuhëtarëve se “motivimi është themelor për të kuptuar se si një gjuhë zhvillohet përmes historisë”.¹⁰⁶ apo me vështrimin se “në historinë e fjalëve gjendet motivimi diakronik i njësive dhe ndryshimeve”.¹⁰⁷ Sipas këtij vështrimi, sqarohet ç’ka është e përbashkët dhe ç’ka është e veçantë në dikotominë: lëvizje kuptimore e prejardhje kuptimore.

Laboratori krijues i prof. Jani Thomait bëhet më interesant e nxitës, sidomos kur merren në shqyrtim: prejardhja semantike e fjalëformuese e fjalës. Në këtë drejtim ai dallohet për cilësinë dhe vëllimin e trajtimeve. Në dhjetëra artikuj e disa studime ndeshim teza e pohime që vënë në plan të parë dinamikën e njësisë semantike, e njësisë leksikore, fshehjen e mundësisë së brendshme për zhvillim të mëtejshëm, në një marrëdhënie të drejtpëdrejtë të formës me përmbajtjen¹⁰⁸. Kështu, përgjigjen e pyetjes se ç’duhet të ketë një njësi semantike që të shërbejë si temë prodhuese, studiuesi J. Thomai e sendërton me zhvillimin e përbërësve kuptimorë “*formë e pozicion i përparmë*” të fjalës hundë në nuanca e kuptime leksikore të veçanta, si: *hunda e njeriut, hunda e anijes, hunda e çekiçit, hundë deti*.

Leksikologu Jani Thomai ka ditur të kodojë e përcjellë, si rrallë kush, mesazhe e argumente për prejardhjen semantike të një fjale. Me dorën e një mjeshtri e mendjen e freskët janë

¹⁰² Thomai, J. *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 50.51.

¹⁰³ Vincent, N. *La sémantique*, Berlin, 1998, f. 22.

¹⁰⁴ Thomai, J. *vep.cit.* Tiranë, 2009, 79.

¹⁰⁵ Çabej, E. *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, Tiranë, 1982, f.32.

¹⁰⁶ Vincent, N. *vep.cit.* Berlin, 1998, f. 35.

¹⁰⁷ Martinet, A. Homonymes et polysèmes, *La linguistique*, 1972, 2, f. 39.

¹⁰⁸ Thomai, J. *vep.cit.* Tiranë, 2009, 91.

projektuar e strukturuar shkrime që mundësojnë depertimin në rrjedhën e kësaj kategorie shumëpërmasore. Kështu, zbulimi e labirinteve e motivimi i një fjale kërkohet në “zbërthimin e lidhjeve midis kuptimeve të saj dhe kuptimit fillestar, të marrëdhënieve që vendosen brenda vetë kuptimeve të prejardhura, si edhe të raporteve që motivojnë formimin e një fjale me anën e ndajshesave”.¹⁰⁹

Në shumëthëniet e një analize të hollësishme për figuracionin gjuhësor në gjuhën shqipe, ai arrin në përfundimin se mbartja metaforike, metonimike, këputja, shtimi apo zëvendësimi i boshtit semantik, janë procese që shërbejnë për të motivuar shndërrimet kuptimore të fjalës e sintagmës, të frazës e njësive frazeologjike.

Në sytë e monografive të botuara ndeshim jo vetëm një analizë të përpiktë, por edhe përshkrimin e klasifikimin e grupit paradigmatic të çerdhes së një fjale në: **derivate leksikore**, ku mbetet pa ndryshuar kategoria leksiko - gramatikore (*punë – punëtor - punëtori*) apo në **derivate leksiko - gramatikore** (*punoj, punim, i punuar*) me ndryshimin e kësaj kategorie. Falë analizës së fakteve gjuhësore dhe deduksioneve shkencore, marrin udhë shpjegimet për trashëguesit e njërit kuptim a përbërës të njësive derivuese të grupit të parë¹¹⁰ dhe për trashëgimtarët e shumë kuptimeve të njësive derivuese në grupin e dytë.¹¹¹ Për prof. Jani Thomain “*qartësia e kuptimit leksikor të morfemës rrënjore është mundësi për motivimin e lehtë të kuptimit leksikor të fjalës së re.*”¹¹²

Në studimet e këtij lloji nuk mund të lihen në harresë gërshetimi midis ligjit të ekonomisë dhe ligjit të diferencimit në gjuhë. Me të drejtë pohohet se raporti midis shenjave dhe kuptimeve është i pabarabartë, diferencimet në gjuhë varen nga tipi i shenjës dhe karakteri i strukturës semantike të saj.¹¹³

Në studimet e tij janë trajtuar e klasifikuar kuptime, fjalë e grupe fjalësh që bëjnë pjesë në leksikun dialektor, në ligjërimin poetik popullor, duke sjellë shpjegime të reja për tipologjinë fjalëve, simbolikën e sintagmave poetike, për lidhjet kuptimore që sendërtohen në ligjërimin e Naim Frashërit e ligjërimin lasgushian.¹¹⁴

Një komponente e rëndësishme e formimit të personalitetit të tij shkencor është njohja e gjerë e kodimi i frazeologjisë popullore. Për të “*njësia frazeologjike nuk lind si shënues e drejtpërdrejtë e sendit, e tiparit, e veprimit, por si shënues e ndërmjetuar*”¹¹⁵; gjithashtu tipari i pikënisjes së njësive frazeologjike “*përfaqësohet nga kuptimi i figurshëm i komponentit të përcaktuar ose përcaktues.*”¹¹⁶ Në punimin “Çështje të frazeologjisë shqipe”, duke u ndalur gjerësisht në krahasimin e strukturave formale e semantike mes togfjalëshave frazeologjike me togfjalëshat e lirë gjenetike, autori arrin në përfundimin se “për të zbuluar sa më qartë e sa më

¹⁰⁹ Dervishi, V. Termat e mekanikës në gjuhë shqipe dhe burimi i tyre konceptor, në *Studime filologjike*, 1991, 1, f.71.

¹¹⁰ Thomai, J. *vep.cit.* Tiranë, 2009, 219.

¹¹¹ Thomai, J. *vep.cit.* Tiranë, 2009, 223.

¹¹² Thomai, J. *vep.cit.* Tiranë, 2009, 253.

¹¹³ Duro, A. Fjala term dhe struktura semantike e fjalës shqipe, në *Studime filologjike*, 3-4, 1999, f. 53.

¹¹⁴ Lamaj, A. Disa vështrime mbi leksikun poetik, *Kërkime universitare*, Gjirokastrë, 22, f.35.

¹¹⁵ Thomai, J. *Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe*, Tiranë, 199, f.7.

¹¹⁶ Ejntrej, G. Rreth kritereve të hartimit të « Fjalorit frazeologjik të gjuhës shqipe, në *Studime filologjike*, 1-2, 2005, f. 96.

saktë kuptimin leksikor”¹¹⁷ duhen parë temat semantike të prejardhjes së kuptimeve frazeologjike.

Dijet dhe interesat e prof. Jani Thomait në fushën e frazeologjisë janë disa drejtimshme. Ato i kanë dhënë mundësinë jo vetëm të kodifikojë mirë e bukur lëndën e vjelë, por edhe të parqes e shtjellojë teza që joshën gjuhëtarët e rinj për t’iu afruar arealit semantik. Krahas shpjegimeve të përgjithshme, gjuhëtari ndalet veçanërisht në rëndësinë që ka motivimi për zbulimin e kuptimit, gjetjen e burimit, shpjegimin e lëvizjeve kuptimore, njohjen e truallit gjuhësor të formimit.¹¹⁸ Në vijim të këtij vështrimi merren në analizë njësi frazeologjike, në të cilat motivimi sinkornik është i mundshëm ose i pamundur, duke shtënë në punë argumentet se strukturat paralele për njësitë * i *mati puls*, *i *mbylli derën* e sendërtojnë motivimin, ndërsa mungesa e strukturave homofone të gjalla në *i *jap dum*, *i *ra bretku* e bëjnë motivimin sinkronik të pamundur. Në këtë hulli, vijnë edhe përcaktimet gjuhëtarëve të rinj dhe pasuesve tij për motivimin si proces gjuhësor e psikik, si burim i kuptimit të fjalës, sintagmës, të vetë gjuhës,¹¹⁹ si edhe për motivimin konceptor – strukturor e strukturat temëformuese¹²⁰.

Nga sa parashtruam, mund të përfundojmë se akademiku Jani Thomai është studiuesi vëzhgueshollë i strukturave leksikore e semantike të shqipes. Me dorë mjeshtri, maturi e argumente shkencore, ai iu është afruar njësive semantike e leksikore, mundësisë së tyre për zhvillim të mëtejshëm, zbulimit të kuptimit, gjetjes së burimit, shpjegimit të lëvizjeve kuptimore, njohjes së truallit gjuhësor të fjalës, sintagmës, njësisë frazeologjike. Gjithë jeta e tij ka qenë një sfidë që ka mëtuar risitë. Në këtë udhëkalim ai u ka kushtuar vëmendje të veçantë elementeve burimore të kuptimit të gjuhës e njësive të saj.

¹¹⁷ Thomai, J. *vep. cit.*, Tiranë, 199, f. 9.

¹¹⁸ Thomai, J. Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe, Tiranë, f.181.

¹¹⁹ Gjocaj, Z. Struktura leksiko-semantike e stilistike e frazeologjisë shqipe, Prishtinë, 2001, f. 209.

¹²⁰ Proko, V. – Duro, V. Motivimi në terminologjinë e agronomisë në rrafshin e tëmformimit, në *Studime filologjike*, 2006, 3, f. 76.

Prof. dr. QEMAL MURATI
Instituti Albanologjik i Prishtinës

PRIRJE E TIPARE TË LEKSIKUT TË SHQIPES GJATË ZHVILLIMIT TË TIJ HISTORIK

Fjalën në gjuhën shqipe, më mirë se kushdo tjetër, e ka studiuar në një plan shumëdimensional Prof. Jani Thomai, gjuhëtar me erudicion të rrallë e me kontribute të veçanta në albanologji, leksikolog dhe leksikograf i rangut të parë, të cilit dhe i kushtohet ky punim në Jubilarin e nderuar të 75-vjetorit të lindjes së tij, për meritën e veçantë që e ka formuar leksikologjinë shqiptare si shkencë dhe ka formuar breza të tërë leksikologësh e leksikografësh. Me peshën e mendimit të tij, pa dyshim ai është bërë referencë në albanologji dhe në ballkanistikë.

Çdo fjalë ka historinë e vet

Fjala, si njësi themelore me kuptim më vete e gjuhës, ka jetë. Edhe ajo lind, zhvillohet – e ndryshon kuptimin dhe formën e saj – dhe vdes (zhduket). Nëse dikush sot i thotë dy fjalë në gjuhën shqipe të para njëmijë vjetve, kur t'i dëgjojmë ato do të kujtojmë se janë kinezisht. Po t'i lexohet një greku vetëm një gjysmëvarg i Homerit, që është shkruar para tetë shekujsh, ai ose do të mohojë se Homeri ka qenë grek, ose do të refuzojë se vetë është grek (S. Frashëri, Gjuha, Logos-A, Shkup, 2002).

Gjatë historisë së formimit të gjuhës, sikundër e thoshte Horaci 2000 vjet më parë, *ringjallen shumë fjalë që dikur ishin zhdukur, ndërsa humbasin shumë të tjera që sot zënë një vend nderi, po ta kërkojë përdorimi...që është ligj dhe normë e të folurit* (Leka 2007, 265). Kështu ka ndodhur dhe në zhvillimin historik të leksikut të gjuhës shqipe, ku shumë terma e leksema të huazuara ose prej brumit të vendit, nuk i kanë format dhe kuptimet e tyre që i kanë pasur dikur.

Kësisoj, fjala tjetër kuptim ka pasur në përdorimet e saj të kryehershme, tjetër kuptim ka sot, e tjetër kuptim mund të ketë në zhvillimet e saj të mëvonshme. Fjalët në përdorimin e tyre shpeshherë e zgjerojnë ose e ngushtojnë kuptimin e tyre nga ai fillestar ose primitiv, jo rrallë dhe e ndryshojnë fare, pra marrim një kuptim të ri, krejt të ndryshëm nga i pari. Kjo ndodh si me fjalët brenda një gjuhe, dialektizmat leksikore, ashtu dhe me fjalë të huazuara nga gjuhë të ndryshme. Kështu p.sh. fjala “*Botues*” në një shtet komunist nuk është e njëjtë me atë që përdoret sot.

Diçka për kureshtje mbi historinë e disa fjalëve, si e ndryshojnë kuptimin ose si errësohet kuptimi fillestar, do të sjellim disa shembuj më poshtë.

Fjalë me zgjerim dhe me ndryshim kuptimi

Albanizëm – 1. të qenët kundër dogmave të fesë sunduese: Shqiptarët, që u kthyen në të krishterë qysh në shekullin e parë, formuna në shekullin e tetë një herezi të njohur me emrin *albanizëm* (Konica 2001, 79). 2. fjalë a shprehje idiomatike e shqipes, që e ka vetëm shqipja, e që si e tillë mund të ketë shkuar edhe në gjuhë tjera. Khs. *albanizmat ballkanike: besa, katund, karpë, etj.*

Arbanas – epitete (atribute) me të cilin në krye të herës (në mesjetë) administrata sllave shënonte një kategori sociale të barinjve, blegtorin, jo një kategori etnike, që si të tillë ua jepte personave në funksion të nofkës: *Petre, Arbanas, Nikolla Arbanash, Gon Arbanas*. Atributin *arbanas* në kuptimin e “bariut” nuk ia vunë vetes vetë shqiptarët, por ardhësit, përkatësisht pushtuesit sllavë. Emri *Arbën* u mor nga serbët në fillim si emër etnik, e më pas mori dhe funksionin e sinonimit për “bariun” (Gashi 2007, 324).

Barbar - Qytetet greke e gjetën identitetin e tyre duke shpikur një armik për ta përshkruar gjithmonë si të keq e të shëmtuar, përtej realitetit të fakteve: “*barbarët*” (fjala onomatopeike e krijuar pikërisht nga grekët) apo më mirë “njerëzit që flisnin një gjuhë të pakuptueshme”. Dhe më barbarët mes barbarëve ishin persët. “Barbari përshkruhej si i ndryshëm në gjithçka: jo vetëm që nuk fliste si grekët, por as nuk hante si grekët, të cilët përcaktoheshin si “bukëngrënës”.

Më vonë kjo fjalë mori kuptime të ndryshme. Në FGJSH (2006) *barbar* shenjohej me këto kuptime: 1. hist. emër me të cilin grekët e romakët e vjetër quanin me përbuzje të huajt, që nuk flisnin gjuhën e tyre. 2. përb. Shumë i prapambetur, i pagdhendur e primitiv; i egër e shkatërrimtar: *sjellje barbare*.

Bibliotekë e Bibël - lidhen me emrin e vjetër fenikas *Biblos*, qendër e prodhimit dhe e eksportit të papirusit (letrës), kështu që *bibla* etimologjikisht në thelb do të thotë “papyrus, libër prej papirusi”. Më vonë, *Bibël* mori kuptimin e një libri të shenjtë për “*Dhiata e vjetër*” (për fenë e hebrenjve e për fenë e krishterë) dhe “*Dhiata e re*” (vetëm për fenë e krishterë).

Nëdrkaq, fjala *pergamen* analogjikisht vjen nga emri i qytetit *Pergamon* në Azinë e Vogël (R. Bugarski, *Pismo*, Skopje, 2001, 147).

Bojkot - pakkush e di që fjala angleze *bojkot* (*bojkotim, bojkotoj*) lidhet me emrin personal të britanikut Çarls Bojkot (1832-1897). Në anglisht *to bojkot* në fillim kishte kuptimin “dëboj një tregtar të pandershëm” (Çarls Bojkotin nga punëtorët e tij, që i shfrytëzonte pa mëshirë), ndërsa më vonë fitoi atë kuptimin që e ka sot: “pengoj një veprimtari politike, ekonomike, kulturore etj., duke mos marrë pjesë në të” (K. Jorgaqi, *Leksikone xhepi për gjuhën, Tiranë, 2000*).

Bumerangu - është një vegël e epokës së gurit në trajtë shkopi të përkulur, e përdorur nga banorët aborigjenë të Australisë për të goditur viktimën (shpend) në fluturim e sipër. Hedhja e tij synon të godasë viktimën, por në rast se nuk ia arrin qëllimit, atëherë shkopi pasi përshkon një trajektore gjysmërrethore i kthehet me forcë atij që e lëshoi. 2. fig. veprim që kthehet e bie te vepruesi.

Dobi – Te Bardhi dhe Bogdani sllavizmi *dobī*, që sot shënjon përparësinë ekonomike, fitim tregtar, ka dhe kuptimin e fitores ushtarake (Riza 1996, 244).

Gjellë – ushqim. Dikur fjo fjalë kishte kuptimin “jetë”, që del të ruhet te ruhet te titulli i veprës së autorit arbëresh Jul Variboba “*Gjella e Shën Mërisë Virgjër*” (= *Jeta e Shën Mërisë Virgjër*). Edhe te Buzuku *gjellë: gjell* “rroj” (nga *gjallë*). Khs dhe sllav. *život* “jetë” (= žito “drithë, si ushqim themelor për jetë”, sh. Živko Bojadžiev, *Uvod v ezikoznaniето*, Plovdiv, 1997).

Kafshë – qenie e gjallë, shtazë. 2. Njeri i trashë dhe i pasjellshëm. Kjo fjalë e rrjedhur nga lat. *causa*, dikur kishte kuptimin fillestar “gjë, send”, që del të ruhet në trajtën e saj të ngurosur te geg. *kashelashë* – *ka(fsh)ë e lash(t)ë* = tosk. *gjëegjëzë*, e *gjëkafshë* “send”. Autori i gramatikës së

parë shqipe, Francesco Maria da Leçe, shkruante: ”*Këtë Diccionar, oh Shqipëtar i dashun, e shkrova jo për zotni tande, qi di ma fort se unaj, veç për vetëhe, qi jam për së largu, e gjuhën e shqiptarëve e kam posi kafshë të huoqjë*”.

Kallnor – vjet. janar (FGJSH). Kjo fjalë në origjinën e saj shënonte festivalin i Vitit të Ri latin “*kalendar*”, që si e tillë u ruajt më pas në variantin e vjetër gegë “*kallnor*”.

Kastë – fjalë me origjinë iberike (la casta), që është e pranishme edhe në spanjisht dhe në portugalisht. Që andej ajo u përhap edhe në të tjera gjuhë. Koncepti i saj i parmë ishte “racë, klan, sistem rigjid racor me bazë lidhjet e gjakut”. Me kalimin e kohës, koncepti i kastës, me zhvillimet politike, krijoi një pezhorizim të ri semantik. Nga koncepti lidhjet e gjakut, u kalua në një koncept më të gjerë, ku kastë mund të krijohet edhe përmes lidhjeve të interesit, lidhjeve krahinore, politike, etj.

Katun – Kjo leksemë ballkanike e proveniencës së barinjve shqiptarë dhe arumunë, në fillim shenjonte kuptimin ‘bashkësi e njerëzve shqiptarë dhe vllëh, që merreshin kryesisht me blegtori e bënë një jetë shtegtare; vendbanim i përkohshëm i këtyre njerëzve’. Më vonë në gjuhën shqipe kjo fjalë e ndryshoi formën fonetike dhe kuptimin *katund* ‘*fshat*’, kurse me kuptimin e parë te FGJSH regjistrohesh vetëm si historicizëm.

Letrar – te Bogdani *letërar* kishte dy kuptime: “lexues” e “shkrimtar”. Pastaj mori kuptimin që ka sot, të atij që shkruan vetë, “shkrimtar”.

Maqedon, me të cilin sot emërtohet popullsia sllave e Maqedonisë, që veten e quan paraardhëse të maqedonasve të lashtë antikë – e që historikisht nuk ka kurrfarë lidhjeje. Kuptimi i këtij emri etnik është i paditur, ashtu siç nuk dihen dhe kuptimet e emrave të tjerë etnikë: *ilir, trak, dak, grek, latin, bullgar*, etj. Por në përdorimin e termit *maqedon* gjatë shekujve e mijëvjeçarëve, studiuesit që janë marrë me çështje të gjuhës e të historisë, të shekullit 18 dhe të fillimit të shekullit 19 (si p.sh. Nikollë Keta, Gjergj Guxeta, Engjëll Mashi etj.) kanë vënë re se termi *maqedon* është përdorur në kuptimin “shqiptar i hershëm”, domethënë për të treguar popullsitë vendëse jo greke të Gadishullit Ballkanik. Më vonë termi *maqedon* e ndërroi kombësinë, dhe sot me këtë term emërtohet popullsia sllave e Maqedonisë.

Nga emri i sotëm *maqedon*, në kuptimin e asaj se ky term bart “përzierje të ndryshme etnike” në Maqedoni (sllave, shqiptarë, turq, vllëhë, romë, hebrenj etj.), francezët kanë krijuar termin *macedoine* (maqedone) për “një lloj sallate e përzier”, me kuptim të figurshëm “gjë e përzier” (siç është një përzierje dhe vetë Maqedonia me grupe të ndryshme etnike).

Mik - në kërkimin gjenealogjik të fjalës *mik* (nga lat. *amicus*) shohim që kjo fjalë në zanafillë kishte një kuptim tjetër nga ç’ka sot. Thelbi i fjalës *mik* (fr. *hôte*), sikundër e ka vënë re F. Konica, ishte dikur “ai që ju e ftoni në sofrën tuaj, ose ai që ju fton në sofrën e vet”. Këto kuptime në kohën e sotme janë bjerrë, janë zvetënuar, sepse miku sot rrallëherë ftohet në sofër, rrallëherë i shtrohet sofra. Në traditën vuthjane të Malit të Zi (Ahmeti 1996, 211), ka ekzistuar një kategorizim i mikut, i njohur dhe i pranuar nga të gjithë: *Mik kryesor; mik i parë; mik shpije; mik i largët; mik i babës (mik i vjetër); mik pa dhanë e marrë; mik i mikut* etj. Prandaj duhet bërë dallimi midis *mikut* dhe *mysafirit* që e qet rruga ose halli. Dallimi midis tyre ka konsistuar në faktin se i pari ka qenë në lidhje miqësore (dhënie ose marrje), është i njohur dhe vjen me qëllim.

Ndërsa mysafiri mund të jetë ose jo i njohur, por vetë përkufizimi tregon se ai është i rastësishëm, e ka qitur rruga për hallet e veta, që e ka zënë nata në rrugë dhe duhet ta kalojë diku brenda.

2. fig. keq. që është i padëshirueshëm. Në lojën e letrave: *kush e ka mikun* ? (letrën 14-të).

Mysafir bised. Miku që vjen në shtëpi për vizitë ose për të bujtur (FGJSSH). Rrjedhur nga turq. *musafir*, arb. *musāfir* “udhëtar, mik i rastit, mysafir i papritur (që vjen rastësisht, papritur).

Seminar – nga latinishtja *seminarium* – *vend i mbjellë me farë*. Sot përdoret për të shënuar: 1. mësimin që zhvillohet në grupe të ndryshme të shkollës së lartë, 2. punim që hartohen nga studentët në një fushë të caktuar, 3. aktivitet shkencor, 4. fet. Shkollë që përgatit priftërinj.

Sorbona - Universiteti më i vjetër në Francë, themeluar që në vitin 1257 nga Robert dë Sorbon. Pakkush e di që emri i këtij universiteti të famshëm lidhet me emrin vetjak *Robert dë Sorbon*.

Sharlatan – Kjo fjalë tashmë ka marrë një kuptim më të gjerë se ai që kishte shekuj më parë, kur tregonte mjekët mashtrues, dhe tregon njerëz të cilët pretendojnë se kanë njohuri të posaçme në një fushë të shkencës, kur në fakt atje janë thjesht amatorë.

Tlina-t – brekët e gjata që i veshin në dimër (Kosovë). Kanë marrë emrin kështu sepse dikur bëheshin prej liri. Sot ato fabrikohen prej materialeve të ndryshme industriale, porse emrin ende e ruajnë të pandryshuar *tlina-t*.

Universitet – termi *universitas* emëronte në mesjetën e vonë një “shoqëri mbrojtëse korporative”. Më vonë mori kuptime të tjera si “bashkësi” dhe “shoqëri”. Sot ka kuptimin e një institucioni të lartë shkollor.

Terminologjia politike

Ballkan - Edhe Ballkani, ai gadishull i njohur historikisht për primitivizëm e grindje ndërmjet popujve përkatës, në epokën e re po ndryshon fytyrë politikisht dhe po integrohet në Evropë jo vetëm me koncepte të reja, por dhe me një emërtim të ri – *Evropa Juglindore*.

Evropë - Në fjalorin e sotëm modern të gjuhëve, kuptimin e tyre të parë e kanë ndryshuar edhe shumë fjalë dhe nocione të reja gjeografike e politike dhe janë veshur me semantikë të re. Kësisoj, *Evropa* – nuk e ka më atë kuptimin që e ka pasur dikur, por shënjon një “bashkësi moderne të shteteve liberale dhe demokratike”.

Politikë – të parët që e përdorën konceptin “*politikë*” ishin grekët, para afro 2500 vjetësh. Ata banonin në qytete-shtete, ose polise. Fjala “*politikë*” vjen nga “*polis*” (qytet) dhe u përdor për të treguar drejtimin e qytetit-shtet dhe të shoqërisë.

Koncepti “*politikë*” sot përdoret me kuptimin “mënyra se si i marrin vendimet organet shtetërore dhe si vihen në jetë ato; veprimtaria e pushtetit shtetëror të një vendi, që lidhet me qeverisjen e drejtimin e shtetit; tërësia e çështjeve dhe e ngjarjeve shoqërore e shtetërore, të brendshme e ndërkombëtare”.

Në shqip ne e përdorim këtë fjalë si në rastin kur flasim për “veprimtarinë që ka në bazë të saj konkurrencën e partive apo individëve për pushtet” (në anglisht: *politics*), ashtu edhe kur flasim për një “kurs të caktuar veprimi që qeveri, parti, apo organizata të ndryshme përzgjedhin mes disa alternativave të mundshme” (në anglisht: *policy*).

Këto nuancime të këtij termi në anglisht dhe në shqip i dallon publicisti Eduard Zalosnjaja: “Në disa raste, ai madje ka vazhduar *ta ndjekë atë politikë* (policy) edhe kur i është bërë e qartë se do ta dëmtonte në *lojën politike* (politics)... Dhe *kjo politikë* (policy), do t'i kishte shërbyer bajagi mirë qeverisë Berisha edhe në *lojën politike* (politics). Sepse paratë nga shitja në verë e energjisë së akumuluar në kaskadën e tejngopur të Drinit do të ndihmonin në mbushjen e arkës së boshatisur të shtetit. (Shekulli, 18. 1. 2010).

Fjalë me kuptime të veçanta që nuk gjenden në gjuhë të tjera

Në fjalësin e saj, gjuha shqipe ka krijuar disa leksema për nocione të posaçme etnokulturore, që nuk kanë shoqe (gjegjëse) në gjuhët e tjera të familjes indoevropiane, si këto që do t'i sjellim më poshtë.

Besë f. Albanizëm që ka hyrë në shumë gjuhë ballkanike, e cila brenda shqipes shkon me *bind* e me *bé* (Çabej 1976, 62).

Det-i m. Shqiptarët i thonë detit *det*: kjo fjalë, me sa duket, nuk ekziston në asnjë gjuhë tjetër dhe ata janë të vetmit në Mesdhe që e quajnë me këtë emër (Matvejeviç 2003, 123). Pas Joklit, etimologjikisht *det* rrjedh nga ievr. **deub-eto* “i thellë”, që dha **deët*, në arbërishten e Italisë *dejt*, e me kontraktion *dēt* me vokal të gjatë (Çabej 1976 118). Për faktin që është një fjalë e vjetër e gjuhës shqipe, kjo leksemë ka krijuar një varg rrjedhojash e përdorimesh. Kështu, krahas kuptimit të përmendur: Deti Adriatik, Deti Jon, janë krijuar dhe një varg përdorimesh të figurshme, si:

Det njerëzish “shumë njerëz”;

Kur të bëhet deti kos iron. “kurrë, asnjëherë”;

As në det, as në breg “në asnjë vend, asgjëkund; as në qiell, as në tokë”;

I futet detit me këmbë “”nis një punë që nuk mund të bëhet ose që është jashtëzakonisht e vështirë”;

E mori deti (lumi) “e pësoi keq, e gjeti e keqja, u shkatërrua” (në shqipen e Kërçovës *e mori luma*, që dëshmon se emri *lumë-i* dikur mund të ketë qenë i gjinisë femërore *lumë-a*);

Ka marrë detin në sy “i duket çdo gjë shesh me lule, ka dëshira e shpresa të tepruara, kujton se do të bëjë gjëra të mëdha”;

E mat detin me filxhan “ka shumë durim për të bërë një punë që kërkon kohë e durim të madh” (FGJSH).

Fjalë ose kuptime fjalësh që nuk pasqyrohen në FGJSSH

Burrneshë – a f. virgjëreshë e përjetuar, e cila merr rolin e burrit në Shqipërinë e Veriut. Kur i vdiste burri në luftë, ose për shkaqe të tjera familjare, kur merrte rolin e të parit për të mbajtur familjen, ajo vishej me tesha të burrave si shenjë se nuk do të martohej. Në Rugovë të Kosovës kanë qenë të njohura *burrneshat* e tilla. Ky *zakon i përбетimit* të vajzave (në familjet ku nuk ka pasur fëmijë meshkuj), që edhe për një gjeneratë me tesha të burrave simbolikisht të vazhdojë kultin e shtëpisë dhe familjes, me gjasë i përket trashëgimisë ilire (Vlahović 1984, 152).

Te Fjalori i gjuhës shqipe fjala *burrëreshë* (*burrneshë*) shënohet me kuptimin “vajzë a grua trime dhe e zonja” (FGJSH, 2006) (sipas analogjisë me *trimëreshë/ trimneshë*).

Dylber mb. homoseksual. Mashkulli që me bukurinë e tij josh meshkujt e tjerë, në kuptimin e sotëm modern *gay*. Në Kosovë përdoret kryesisht si sinonim për *gjakovar-in* (Kosovë).

Gjamatore etnogr. vajtores (FGJSH). 2. Në Malësinë e Veriut gratë nuk bëjnë gjëmë, ato e kryejnë vajtimin, prandaj quhen *vajtore*, por jo *gjamatore*. Gjëma bëhet vetëm për burrat dhe vetëm nga burrat, pas ceremonisë së vajtimit nga gratë.

Gjëmëtar-i m. etnogr. ai që qan me gjëmë të vdekurin (FGJSH). 2. Në Malësinë e Veriut i vdekuri nuk qahet me gjëmë, atij vetëm i bëhet gjëmë pa lot, sepse qarja konsiderohet zhburrim.

Kushtrim – thirrje për t'u ngritur në luftë ose në gjendje gatishmërie: *lëshoi (dha) kushtrimin* (Fjalor i gjuhës shqipe 2006, 515).

Në fakt, kushtrimi ka qenë një institucion i Shqipërisë Veriore dhe i shqiptarëve të Malit të Zi, që është manifestuar në këtë mënyrë: Kushtrimi ka qenë thirrje mobilizuese e karakterit ushtarak popullor për t'u shkuar në ndihmë krahinave të rrezikuara nga sulmi i armiqve. Zanafilla e kushtrimit kanë qenë zonat kufitare, si p.sh. Krahina e Gucisë dhe e Plavës, duke qenë në kufirin verior të trojeve etnike, sa herë që janë rrezikuar nga të huajt, osmanët, serbët apo malaziasit, ka “*qit kushtrimin*”. Kushtrimin shkonin “me qitë” dy djem të rinj, pasi në raste të tilla kërkoheshin veprime të shkathhta, të shpejta dhe të përpikta. Vendet prej nga “qitej kushtrimi” për krahinat e tjera kanë qenë të njohura. “Me lajmue Shalën, kushtrimi qitej në Qafë të Pejës, ndërsa me lajmue Malësinë e Gjakovës, Kushtrimi qitej në Qafë të Borit, në Qafë të Vranicës; me lajmue Rugovën e Pejën me nahije kushtrimi qitej në Rugovë”. Kushtrimi qitej duke thirrur: “Oooo, *hiq djallë se ka ra shkau, more!*” Thirrja gjithmonë shoqërohej me nga pesë të shtëna me pushkë. Kur situata vlerësohej se është tepër serioze, kushtrimi qitej duke thirrur: “Ooo, *hiqni burra, prej në shtatë e në shtatëdhjetë, more, se na ka ra shkja!*” Ose “Ooo, *mos leni burra, bre se na ka ra shkja!*”. Burrat e krahinave që u drejtohej kushtrimi, me të shpejtë tuboheshin dhe “math e zdath si kanë qëllue, me pushkë në dorë”, niseshin në drejtim të Mymleqetit të mirë (Plavës dhe Gucisë). Në raste të tilla, në këto krahina hynte në fuqi besa e vatanit, prandaj vullnetarët që niseshin atje ku ai rrezikohej, bashkoheshin vëllazërisht. Të moshuarit tregonin se gjithmonë më të shpejtë kanë qenë dukagjinast (shaljanët), “çi asni herë s'vinin ma pak se 400 burra”, zbraznin një batore pushke “me lajmue se mrrini Shala në nimë” (Ahmeti 1996 215).

Çdo fjalë ka historinë e vet, prandaj mund të thuhet: *historia e fjalëve, e me këtë dhe historia e huazimeve, është historia e kulturës materiale dhe shpirtërore të një populli* (të cilit i përket) (Saržoska 2000, 7). Arkeologu i madh anglez Artur Evans (1895), i pajisur me njohuri të mirë të gjuhëve sllave dhe të asaj shqipe, gjen mjaft *elemente linguistike të trashëgimisë latine të mbartur në gjuhën shqipe*, si: origjinën e fjalës *tërmet* – lat. *terrae motus*, apo festivali i Vitit të Ri latin “*kalendar*”, i ruajtur në variantin e vjetër gegë “*kallnor*”.

Prof. as. dr. XHELADIN ZYMBERAJ
Fakulteti i Edukimit - Prizren

ÇËSHTJE TË HOMONIMISË DHE TË POLISEMISË NË VEPRËN E AKADEMIK JANI THOMAIT

Akademik Jani Thomai, formimi i tij filologjik shumë i thellë klasik dhe modern, i ka mundësuar atij të depërtojë në çështjet thelbësore të dijes së Leksikologjisë.

Akademik Jani Thomai, më duket, e kishte kuptuar që moti se një fushë virgjër e gjuhësisë shqiptare është leksiku bashkë me tërësinë e fjalëve vështruar nga ndërtimi, nga kuptimi dhe nga përvijimësia e shtresimit të tyre. Siç dihet, çështja e shtresimit kronologjik të leksikut përgjithësisht dhe e shqipes veçanërisht është e një rëndësie të veçantë. Dëshira e madhe dhe vullneti i pashoq i një gjuhëtari, kërkimtari, e ka motivuar atë për t'u marrë cilësisht dhe natyrshëm me dijen e Leksikologjisë dhe me selektimet e saj, pra me Leksikun e gjuhës shqipe dhe zhvillimin e tij; me fjalën si njësi leksikore; me semantikën leksikore; me semasiologjinë; me lëvizjet kuptimore; me shumëkuptimësinë (poliseminë); me grupet paradigmatiche të fjalëve; me frazeologjinë e gjuhës shqipe; me leksikun e shqipes standarde; me veçoritë leksikostilistike të shqipes dhe periudhat e zhvillimit të saj.

Veprimtaria e gjatë dhe rruga jetësore e rrahur nga ana shkencore e Akademik Jani Thomait, ia kanë mundësuar që të selitë idetë, të cilat qëndrojnë në themel të Leksikologjisë së gjuhës shqipe si shkencë dhe të përcaktojë zhvillimin e saj të mëtejme. Sipas tij, leksiku dhe frazeologjia shqipe vlerësohen si pasuri kulturore e përbashkët kombëtare. Kjo pasuri, natyrisht, duhet të shërbejë për kultivimin dhe zhvillimin e gjuhës standarde. Shtresimi i kësaj pasurie sipas vlerave reale është në funksion të shtresimit shkencor të leksikut të shqipes.

Më vonë, e gjithë kjo krijimtari dhe punë cilësore e pandërprerë, dhe ky mund frytdhënës dijetari u kurorëzua me 21 veprat e botuara dhe me rreth 80 studime, artikuj shkencorë, kumtesa të botuara në revista shkencore destinuar për këtë fushë.

Po të lexosh me kujdes veprimtarinë shkencore gjuhësore të Akademik Jani Thomait, ajo të lëvizë shpirtin dhe të vë në përballje me thellësinë e analizës shkencore, me saktësinë e të dhënave, me synimet e qarta të studimit dhe me forcën e sintetizimit.

Ai synonte që pasuria e krijuar nga goja e popullit të përbëjë tërësinë e mjeteve leksikore e frazeologjike. Në këtë pikë piquen edhe idetë e studiuesve e gjuhëtarëve të mëhershëm si: A. Xhuvani, E. Çabej etj.

Profesor A. Xhuvani vazhdimisht i jepte rëndësi gjuhës së gjallë të popullit: “Nuk mund të krijojmë fjalë të reja mbas qejfit t'onë ose ashtu si na e pret mendja neve, pa u pështetë në shembëlla të gjalla të popullit”¹²¹.

Edhe profesor Çabej, një njohës i thellë i visarit leksikor të gjuhës sonë edhe gjuhëve të huaja, ka dhënë një pasqyrë të gjerë jetës së fjalëve të gjuhës sonë. Mahir Domi, në një studim të tijin, Mbi veprimtarinë shkencore të Prof. Eqrem Çabejt thekson: “Në sajë të studimeve

¹²¹ A. Xhuvani, Thërrmije gjuhe, “Nëndori”, 1960, nr.3, f.163-164.

etimologjike të Prof. Eqrem Çabejt si dhe të studimeve të tjera është shtuar mjaft fondi i njohur si vendës i leksikut të shqipes, ka dalë më në pah pasuria, vitaliteti dhe origjinaliteti i saj”¹²².

Pra, falë këtij vështrimi të ri, i janë kthyer fondit autokton, të trashëguar një numër fjalësh që trajtoheshin si huazime latine, sllave, greke, italiane etj. Akademik Jani Thomai, në vijimësi, leksikun e gjuhës sonë e vështron si një sistem të plotë e të organizuar njësish gjuhësore. Më tej, duke u nisur nga parimi i universit se çdo gjë është në lëvizje, Thomai, mendoj, fjalën, frazeologjinë, kuptimet, leksikun dhe shtresat të tij i sheh si njësi të gjuhës që zhvillohen e ndryshojnë paprerë, që përsosen e funksionalizohen në dobi të gjuhës standarde.

Akademik Jani Thomai pohon se në vazhdimësi janë kryer një varg studimesh për antonimet, për homonimet, për poliseminë, për frazeologjinë, për leksikografinë. U hartuan disa fjalorë etimologjik shumëgjuhësh. Studimet shqiptare ecën përpara edhe në fushën e formimit të fjalëve; në fushën e leksikografisë; për herë të parë u ndërmorën studime edhe në fushën e Stilitikës gjuhësore dhe vlerësimi, shtresimi stilitik i leksikut të shqipes u bë në mënyrë sistimore¹²³.

Në shtegun e gjatë shkrimor të Akademik Thomait vijimësohen konceptet e drejta e të qarta për fjalën si njësi, për kufirin midis fjalës e trajtave të saj, midis fjalës e togfjalëshit, midis fjalës e morfemës; për lëvizjet kuptimore të fjalëve dhe figurat gjuhësore, për kuptimet e fjalëve, për shumëkuptimësinë (poliseminë); për homoniminë; për grupet e fjalëve: homonimet, sinonimet, antonimet, grupet paradigmatiche të fjalëve etj.

Kuptimi leksikor tërësor dhe i mëvetësishëm përbëjnë tiparin themelor të asaj njësie që quhet fjalë. Fjalët gjatë përdorimit në gjuhën shqipe fitojnë aftësinë për të marrë më shumë se një kuptim. Prandaj, si të tilla quhen fjalë shumëkuptimshme (polisemantike), ndërsa kjo dukuri gjuhësore quhet shumëkuptimësi (polisemi). Gjuha vetë ka krijuar disa modalitete për aktualizimin e fjalës në ndërtimet në të cilat ajo merr kuptimin. Akademik Thomai shkencërisht ka sqaruar se të gjitha kuptimet leksikore të një fjale përbëjnë strukturën kuptimore. Në atë strukturë përfshihen kuptimi fillestar, kuptimi kryesor dhe kuptimet e prejardhura (konkrete, abstrakte dhe të figurshme). Për shembull mbiemri **i lartë** mund të ketë togzueshmëri me fjalët: **shkollë e lartë, studimet e larta, zë i lartë, tension i lartë** etj. Në vargun e kuptimeve fjala ka kuptimin kryesor themelor si më të rëndësishmin. Sa i përket lindjes së kuptimit historikisht fillestar të fjalët e parme këtë çështje Jani Thomai ia lë Filozofisë dhe Historisë së gjuhës. Polisemia në kontekste të caktuara fiton edhe forcë shprehëse p.sh. Plaku më pritë me **bujari**. Rrëza e kanë traditë **bujarinë**. Nënata e dëshmorëve i pritën me tufa **lulesh**. Ata ranë në **lule** të rinisë. Kuptimet leksikore lindin nga kuptimet figurshme të fjalëve. Dhe , rruga, sipas Thomait është nga krahasimi në metaforë, nga metafora në leksikalizim. Te fjalët me kuptime të shumta ka një tërësore që i bashkon këto kuptime p.sh.: **shesh pazari, shesh qyteti, shesh kuvendi, log burrash, log kuvendi** etj.

Përbërësi që i bashkon kuptimet kryesore të fjalës është boshti kuptimor i fjalës polisemantike. Ai jo vetëm që është i qëndrueshëm, por edhe i lidh të gjitha kuptimet në një varg

¹²² Mahir Domi, Mbi veprimtarin; shkencore të prof. Eqrem Çabejt, Studime Filologjike 1, Tiranë, 1979, f. 9.

¹²³ Jani Thomai, Leksikologjia e gjuhës shqipe, Tiranë, 2006, f.16.

të vetëm. Nga kuptimi kryesor i fjalës, më vonë lindin kuptimet e prejardhura të saj. Thelborja qëndron në atë se sa më shumë shtrihet vargu i kuptimeve të reja, aq më shumë ato largohen nga kuptimi fillestar. P.sh.: mbiemri **i regjur** mund të togëzohet me fjalët: **trup i regjur, lëkurë e regjur, postaqi e regjur, plak i regjur, i regjur në punë**, etj. Krejt natyrshëm, Thomai ka saktësuar se kuptimi a përbërësi kuptimor që shërben si burim për lindjen e kuptimeve të reja, përbën temën semantike dhe prej saj nis rrugën formimi i një kuptim të ri¹²⁴.

Ai më tej ka vënuar një krahasim të përputhshëm midis zbulimit të temës semantike për kuptimet e prejardhura dhe atij të temës prodhuese për fjalët e prejardhura. në këtë pikë vënerimi, Prof.dr. Hasan Mujaj, një studiues i mprehtë i gjuhësisë moderne ndër të tjera thekson: “Transpozicioni semantik mundëson shtrirjen e figuracionit shprehës të njësive gjuhësore, por edhe të formave të ndryshme gramatikore të sajara me anë ndajshesash”¹²⁵.

Pra, vetë zgjerimi i strukturës kuptimore të fjalëve është një pasurim për leksikun. Përballë këtyre zhvillimeve të hovshme në fushën e teknologjisë moderne, edhe emërtimi e struktura kuptimore e fjalëve paraqet një botë të pasur dinamike. Për pasojë edhe vëllimi i kuptimeve të fjalëve ndryshon, mund të zgjerohet edhe të ngushtohet. Duke trajtuar më tej shumëkuptimësinë, Jani Thomai thekson se lindja e kuptimeve të reja leksikore është shpjeguar tashmë si një pikëpajme e përgjithshme e lëvizjes kuptimore.

Për një saktësim më të mirë në këtë drejtim, ai shtie në përdorim metodat e analizës semasiologjike nëpërmjet opozicionit të njësive semantike për zbulimin e përbërësve të tyre.

Në vijën e zhvillimeve kuptimore, Thomai ka sqaruar cilësisht edhe lidhjen e polisemisë me homoniminë d.m.th. lindjen e kuptimeve nëpërmjet prejardhjes kuptimore. Siç dihet, homonimia ka të bëjë me praninë e fjalëve të njëjta si tingëllim, të cilat nuk kanë lidhje kuptimesh.

Akademik Thomai edhe poliseminë, edhe homoniminë i sheh si dy dukuri të ndryshme, por që në rrafshin kuptimor edhe në disa struktura të prejardhjes mund të kenë pika takimi. Me prejardhjen kuptimore lidhen homonimet që kanë dalë nga shpërbërja e polisemisë të cilat quhen homonime leksiko-semantike¹²⁶.

Vetë lindja e homonimeve nga shpërbërja e polisemisë na shtyen të mendojmë për ndryshim të zhvillimit të polisemantizmit. Kur lind një kuptim i ri do pranuar se ka lindur një fjalë e re. P.sh. në Australi ekziston një fis që për **ngjyrën e kuqe** ka 15 fjalë, pra fjala **e kuqe**, atje përceptohet në 15 mënyra. Mendoj se duhet shikuar krejt natyrshëm kalimin nga polisemia në homonimi. Kalimet e tilla vërehen edhe te mënyrat e fjalëformimit sidomos, te konversioni, p.sh. emrat: **buzë, anës, rreth (buzë lumit, anës gardhit, rreth burimit)** kalojnë në parafjalë në pozicion para emrave të tjerë të rasës rrjedhore. Po kështu ndodh edhe me disa ndajfolje, të cilat kalojnë në parafjalë, disa folje kalojnë në pjesëza formante. Ky kalim bëhet, sipas Thomait, kur një kuptim i fjalës polisemantike largohet shumë duke i shkëputur të gjitha lidhjet me kuptimet të tjera. Si e tillë, fjala nis të bëjë një jetë më vete si një njësi gjuhësore. Pastaj ajo mund të ketë

¹²⁴ Jani Thomai, Leksikologjia e gjuhës shqipe, Tiranë, 2006, f.127.

¹²⁵ Dr. Hasan Mujaj, Stilistika gjuhësore në epikën kreshnike, Prishtinë, 2003, f.93.

¹²⁶ Jani Thomai, vepra e cituar, f. 130.

aftësinë për t'u futur në lidhje e kontekste të reja. Polisemantizmi na çon edhe te krijimet e reja leksikore. Kështu janë formuar homonimet p.sh. fjala **gremç-i** “degë e një lisi të rrëzuar, degë e kthyer, e thyer” dhe **gremç-i** “cfurk metali me katër fije (rrema) të kthyer” si mjet për të gërmuar plehun e bagëtisë në stallë. Pra në të mirë të strukturës semantike të shqipes është zbulimi i prejardhjes kuptimore me lidhje të tjera homonimike. Së fundi, mund të themi se polisemantizmi si një dukuri zhvilluese e pasuruese në gjuhë është në funksion të zgjerimit të kuptimeve të reja të fjalëve.

Përfundim

Shkrimet dhe veprat e Akademik Jani Thomait janë model i punës shkencore në fushën e Leksikologjisë.

Ai ka dhënë një kontribut të çmueshëm në zhvillimin e kësaj shkence. Përgjithësimet, shqyrtimi i thellë i fakteve gjuhësore, vërtetimet konkrete të tyre përvijohen nga vështirësitë e analiza të mprehta të realitetit gjuhësor jo vetëm në fushën e Leksikologjisë, të Leksikografisë, por edhe të shkencave të tjera gjuhësore.

Shpresojmë që edhe në vitet e ardhshme Akademik Jani Thomai ta ketë fuqinë të vijoje me përkushtim veprimtarinë e tij të frytshme shkencore në të mirë të Gjuhësisë shqiptare.

Dr. RAQI BELLO

Universiteti „Sv.Kiril i Metodij” Veliko Tërnovo, Bullgari

NDIHMESA TË AKAD. JANI THOMAI NË FUSHËN E FJALËFORMIMIT

Të marrësh guximin të shkruash për veprën e akad. Jani Thomait është sa e lehtë po kaq edhe e vështirë. Është e lehtë, sepse mundësia për të zgjedhur një temë në larminë e problematikës gjuhësore që ka trajtuar ky gjuhëtar, që është si një det i madh në fushën e linguistikës, është shumë e madhe dhe të lehtëson jashtëzakonisht punën, sepse atje mund të gjejë veten çdo gjuhëtar dhe çdo “kapriço” gjuhësore e tij. Vështirësia vjen për faktin, se duhet të kesh kujdes në trajtesën që do të bësh që t’i afroresh sadopak të vërtetës së thënë nga një linguist i kapaciteteve me emër tashmë, jo vetëm në trojet shqiptare, por edhe në rrethet gjuhësore ndërkombëtare.

Akad. Jani Thomai është një nga specialistët shqiptarë më të njohur në fushën e semantikës leksikore, leksikologjisë dhe leksikografisë, frazeologjisë (shqiptare dhe ballkanike) si dhe në atë të fjalëformimit. Në këtë artikull do të ndalemi dhe do t’i kushtojmë një vëmendje të posaçme ndihmesës që ka dhënë ai në fushën e fjalëformimit, fushë në të cilën mban emrin e një autoriteti të padiskutueshëm.

Fjalëformimi ose sistemi i formimit të fjalëve në gjuhësinë shqiptare në punimet e gjuhëtarëve tanë zë një vend me rëndësi dhe nuk ka ngelur më mbrapa se problemet e tjera linguistike. Në përgjithësi çështja e fjalëformimit në linguistikën shqiptare ka ndjekur tendencat e gjuhësisë evropiane duke ia përshtatur ato gjuhës shqipe. Atij (fjalëformimit), në gjuhësinë evropiane e sidomos asaj perëndimore (këtu mund të futet edhe ajo shqiptare), nuk i është përcaktuar ende një status përfundimtar. Linguistët nuk kanë arritur t’i japin zgjidhjen teorike e praktike se ku duhet të jetë vendi i tij në gjuhësi – si pjesë e morfologjisë, si pjesë e leksikologjisë apo si pjesë e morfologjisë dhe e leksikologjisë njëkohësisht. Kohët e fundit, nën ndikimin e strukturalizmit dhe gramatikës transformacionale, në shkollat gjuhësore të shumë vendeve evropiane, sidomos atyre qendrore, është përqaftuar ideja se fjalëformimi duhet trajtuar si disiplinë e veçantë e pavarur gjuhësore. Me rëndësi në këtë drejtim është teoria e gjuhëtarit çek M. Dokulil, e parashtruar në dy vëllimet “Tvoření slov v češtině” (M. Dokulil 1962, dhe në bashkëautorësi 1967)¹, ku fjalëformimi është trajtuar si disiplinë e veçantë e gramatikës. Ai e ndan atë edhe nga morfologjia edhe nga leksikologjia, duke thënë që fjalëformimi është morfologji leksikore (M. Dokulil 1967). Rezultatet e arritura në fushën e fjalëformimit përse i përket gjuhësisë shqiptare nuk janë të pakta dhe kanë dhënë ndihmesën e tyre në zhvillimin e saj. Fjalëformimi është trajtuar deri diku në mënyrë të plotë dhe në nivel të qëndrueshëm duke u munduar të ndjekë prirjet në gjuhësinë teorike e pragmatike evropiane dhe botërore, pavarësisht se nga ana e trajtimit teorik të problemit të fjalëformimit ngelet ende shumë për t’u bërë. Mjaft gjuhëtarë shqiptarë (duke filluar nga A. Xhuvani, E. Çabej, K. Cipo, A. Kostallari dhe duke vijuar me J. Thomai (për të cilin do të flasim në veçanti), M. Samara, Sh. Demiraj, J. Kole, P. Haxhillazi, E. Hysa, A. Dhrimo, M. Çeliku, M. Totoni, B. Beci¹ etj.) në trajtesa të veçanta, në

artikuj e monografi ose në punime kolektive, në libra mësimore ose në vepra, botime të ASH-së, janë marrë me çështjen e formimit të fjalëve në gjuhën shqipe. Problemet që ngrenë dhe trajtojnë ata në veprat e tyre, përsa i përket fjalëformimit, janë të shumta. Janë bërë mjaft vërejtje për anën morfologjike dhe për atë semantike të fjalëformimit. Në ato studime hasim një përshkrim të sistemit fjalëformues të shqipes dhe vihen në pah veçoritë e formimit të fjalëve sipas tipit ose mjetit fjalëformues. Kur bëhet trajtimi i njësive të reja leksikore, si objekt kryesor në këto studime, vëmendje i është kushtuar më shumë prejardhjes fjalëformuese dhe jo kaq shumë prejardhjes semantike. Me gjithë këto trajtesa në këtë fushë, krahasime të plota strukturash kuptimore në dritën e prejardhjes semantike nuk janë bërë, nuk janë ndjekur lëvizjet kuptimore dhe llojet e modifikimeve, nuk janë treguar se çfarë trashëgohet e çfarë ndryshon gjatë këtyre shndërrimeve kuptimore, cila është forca modifikuese e ndajshesës, ndryshimi leksiko-gramatikor, kompozimi dhe trajtesa të tjera që i përkasin fjalëformimit. Të gjitha këto gjejnë hapësirë dhe trajtohen më së miri në veprat e J. Thomait. Rezultatet e arritura në fushën e fjalëformimit nga studimet e autorëve të ndryshëm janë të mëdha dhe të qëndrueshme dhe duhen vlerësuar akoma më shumë po të merret parasysh edhe historia relativisht e re e zhvillimit të gjuhësisë shqiptare në përgjithësi. Arritjet e linguistikës shqiptare përbëjnë një bazë të mirë teorike dhe praktike për të vazhduar më tej dhe për të ndjekur tendencat më të reja dhe më moderne të linguistikës përsa i përket fjalëformimit dhe për ta nxjerrë atë nga ujdhesat tradicionale. Nga ana e trajtimit teorik të fjalëformimit një ndihmesë të veçantë dhe të vyer ka dhënë akad. Thomai në veprat e tij për leksikologjinë dhe në veçanti në dy librat e tij “Prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe (semantikë leksikore)” dhe “Veçori leksiko-semantike të ndajfoljeve me prapashtesa në gjuhën shqipe”.

Me librin e tij *Prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe (semantikë leksikore)* (Thomai 2009)¹, autori na shfaqet si një specialist i semantikës leksikore, si një nga themeluesit e parë të saj. I mbështetur në përvojën e tij, në aftësinë për të përgjithësuar dhe për të nxjerrë konkluzione, si dhe në teoritë e vjetra tradicionale dhe atyre më të reja ai jep kontributin e tij në fushën e semantikës leksikore. Sistemi semantik nuk është parë jashtë lidhjeve me sistemet e tjera të gjuhës, ai është trajtuar si sistem i gërshetuar me to, në lëvizjet e në funksionim, në kategoritë, njësitë e rregullsitë. Prejardhja semantike ka një kuptim të ngjashëm me prejardhjen fjalëformuese, sepse parakupton lindjen e një njësie të re semantike nga një tjetër njësi e tillë. Sistemi i prejardhjes fjalëformuese është shprehja më e dukshme e prejardhjes semantike. Prandaj në një kapitull të veçantë, të titulluar *Lëvizje kuptimore brenda çerdhes së fjalës*, autori i kushton një rëndësi të veçantë formimit të fjalëve dhe prejardhjes semantike në gjuhën shqipe (Thomai 2009: 215-271) duke e trajtuar në disa pika, që janë bazë për fjalëformimin. Në pikën e parë *Lidhjet sintagmatike dhe grupet paradigmatiche* (Thomai, 2009: 215-224) thekson se me rëndësi në semasiologji është studimi i semantikës së fjalës në lidhjet sintagmatike dhe në grupimet paradigmatiche. Lidhjet sintagmatike të fjalëve janë pasqyrë e lidhjeve logjike dhe shprehen gjuhësisht me lidhjet ndërmjet emërtimeve përkatëse. Ato dalin dy llojesh edhe në gjuhën shqipe: -*lidhje të drejtpërdrejta e të nënshtrimit* dhe *lidhje të tërthorta e të barazisë*. Për prejardhjen semantike kanë rëndësi vetëm lidhjet hiponimike ndërmjet një fjale e fjalës së

prejardhur prej saj. Në njësitë leksikore, në aspektin emërtues, kuptimi i temës prodhuese është më thelbësor, kurse në aspektin „komunikues” është kuptimi i formantit më thelbësor. Tema prodhuese përmban thelbin semantik, kurse formanti sjell modifikime, si ato kuptimore, kategoriale e gramatikore. Grupin e madh paradigmatic të çerdhes së një fjale autori e ndan në dy nëngrupe: nëngrupi i derivateve leksikore, që përfshin formimet me ndajshesa e pa ndajshesa *pa ndryshuar kategoria leksiko-gramatikore*; nëngrupi i derivateve leksiko-gramatikore, që përfshin formimet me ndajshesa dhe pa ndajshesa dhe *me ndryshim të kategorisë leksiko-gramatikore*. Të gjitha këto janë mjaft të rëndësishme në studimet që kanë lidhje me fjalëformimin. Në pikën e dytë, të titulluar *Përputhjet e strukturave semantike të fjalëve të një çerdheje* (Thomai 2009: 224-228), autori nëpërmjet strukturës kuptimore të derivateve, të ballafaquar me strukturën kuptimore të derivuesit ndjek lëvizjet semantike, drejtimet e shkallëzimet e tyre, sidomos përparimin hap pas hapi drejt një abstraktimi sa më të madh. Në kalimet nga derivuesi tek derivati thellimi i abstraktimit shoqërohet me ngushtimin e rrethit të treguesve fillestarë, burimorë. Pika e tretë, *Modelet e formimit të fjalëve në gjuhën shqipe* (Thomai 2009: 228-248), është një nga pikat më të rëndësishme ku trajtohet fjalëformimi. Këtu autori na jep një pasqyrë të qartë të arritjeve të bëra në këtë fushë dhe ato çka nuk janë thënë, sidomos për veçoritë e prejardhjes semantike, që lidhet me prejardhjen fjalëformuese, duke u munduar të hedhë dritë në këtë drejtim. Sipas autorit për njësinë leksikore më të lartë hedh dritë njësia leksikore më e ulët dhe formanti, gjithnjë në rrafshin e kuptimit. Duke u mbështetur në sistemin e njohur të mjeteve, mënyrave e të tipave të formimit të fjalëve në gjuhën shqipe, ai ndërton një pasqyrë të prejardhjes fjalëformuese mbi bazë tematike, e cila mund të shërbejë si mbështetje për përshkrimin e shpjegimin e prejardhjes semantike lidhur me sistemin e formimit të fjalëve. Si pikënisje ai merr temën prodhuese dhe si grupe fjalësh në planin paradigmatic merr vetëm fjalët shënjuese të mirëfillta, emrat, mbiemrat, foljet e ndajfoljet. Duke u nisur nga katër tema fjalëformuese (emërore, mbiemërore, foljore e ndajfoljore) arrihet në thjeshtimin e strukturës së prejardhjes fjalëformuese dhe në të njëjtën kohë lehtësohet rrokja e prejardhjes semantike, zbulohen veçoritë e shqipes për prodhimtarinë e temave në fjalë dhe për gjatësinë e vargut të prejardhjes fjalëformuese, për natyrën e lidhjeve semantike ndërmjet hallkave të këtij vargu etj. Duke analizuar pasqyrat e ndërtuara me temat e lartpërmendura (emërore, mbiemërore, foljore, ndajfoljore) autori bën përgjithësime mjaft të vlefshme në fushën e fjalëformimit: - pasqyra me *tema emërore* tregon për një strukturë fjalëformuese mjaft të gjerë, të pasur dhe të larmishme në modele. Formimet kategoriale dhe modelet fjalëformuese nuk kanë të njëjtën shkallë prodhimtarie. Mospërputhje ka edhe në vetë modelet e grupeve fjalëformuese kategoriale me bazë tematike emërore me gjithsej 90 modele. Në grupin e emrave ka 42 modele, në grupin e mbiemrave ka 19 modele, në grupin e foljeve 19 modele dhe në grupin e ndajfoljeve ka 10 modele; - pasqyra me *tema mbiemërore* dëshmon për një strukturë fjalëformuese më të ngushtë dhe më pak të larmishme në modele, gjithsej 41, se ajo me bazë tematike emërore. Shkalla e prodhimtarisë për formimet kategoriale dhe modelet fjalëformuese nuk është e njëjtë. Modelet e grupeve fjalëformuese kategoriale gjithashtu nuk përputhen. Në grupin e emrave ka 10 modele, në grupin e mbiemrave ka 20 modele, në grupin e foljeve ka 8 modele dhe në atë të

ndajfoljeve ka 3 modele; - pasqyra me *tema foljore* dëshmon për një strukturë të gjerë fjalëformuese për formimin e emrave dhe foljeve dhe mjaft të varfër për formimet ndajfoljore. E gjithë struktura ka rreth 40 modele, nga të cilat për formimin e emrave ka 17 modele, për formimin e mbiemrave ka 6 modele, për formimin e foljeve 15 modele dhe vetëm 2 modele për formimin e ndajfoljeve; - pasqyra me *tema ndajfoljore* dëshmon për një strukturë të ngushtë dhe jo sistematike me rreth 26 modele. Për formimin e emrave ka 2 modele, për formimin e mbiemrave ka 9 modele, për formimin e foljeve ka 6 modele dhe për formimin e ndajfoljeve ka 9 modele.

Për të katër temat fjalëformuese (emërore, mbiemërore, foljore dhe ndajfoljore) del se në gjuhën shqipe formohen rreth 200 modele, kurse po të shtojmë edhe ato me tema të tjera (përemërore, onomatopeike etj.) numri i modeleve mund të rritet deri në 250. Çdo model ndryshon nga përmbajtja, duke nënkuptuar patjetër një lëvizje kuptimore.

Për sa i përket fjalëformimit për pjesë e ndryshme të ligjëratës gjendja në gjuhën shqipe paraqitet si vijon: *emrat* formohen me anë të 68 modeleve, ku shumica (42) janë me bazë tematike emërore dhe shumë pak (2) me bazë tematike ndajfoljore; *mbiemrat* formohen me anë të 55 modeleve, kryesisht me bazë tematike mbiemërore dhe emërore; *foljet* me anë të 48 modeleve, kryesisht me bazë tematike emërore e foljore dhe *ndajfoljet* me anë të 24 modeleve, më shumë me bazë tematike emërore e ndajfoljore. Sipas prodhimitarisë së temave, të cilat marrin pjesë në formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, del se vendin kryesor e zënë temat emërore të ndjekura nga ato mbiemërore e foljore. Pra fjalëformimi na del më shumë me temë emërore, e cila është e pranishme në shumicën e modeleve fjalëformuese. Në gjuhën shqipe formimet tematike më prodhimore janë brenda së njëjtës kategori leksiko-gramatikore. Modelet fjalëformuese që nuk çojnë në ndryshime leksiko-gramatikore janë të shumta. Modelet fjalëformuese dallohen nga njëri-tjetri edhe nga ndryshimet e kuptimeve midis njësisë së re leksikore të formuar dhe temës semantike prodhuese. Me rëndësi në këtë pikë janë edhe paraqitja skematike, që ka bërë autori, e këtyre modeleve fjalëformuese.

Në pikën e katërt, *Llojet e ndryshimeve semantike gjatë formimit të fjalëve* (Thomai 2009: 248-252), autori, duke analizuar pasqyrat e pikës paraardhëse, bën klasifikimin e lëvizjeve kuptimore sipas elementeve të ndryshimit në tri grupe: -*ndryshime të kuptimit kategorial*, që ndodhin në $\frac{3}{4}$ e vargjeve të modeleve fjalëformuese. Kur një fjalë ndryshon kategorinë leksiko-gramatikore ajo bëhet një njësi e re leksikore, që shoqërohet me ndryshime në kuptimin leksikor; -*ndryshime të kuptimit leksikor të fjalës* ose të klasës së fjalëve, që ndodhin në të gjitha vargjet e modeleve fjalëformuese. Ndryshimet e kuptimit leksikor mund të jenë të përgjithshme, që lidhen me tërë grupin paradigmatic, por mund të jenë edhe të veçanta, që lidhen me njësinë leksikore derivuese (temën semantike dhe kuptimin leksikor të formantit fjalëformues); -*ndryshime të përbërësve suplementarë* me vlerë të njësive semantike themelore. Këto ndryshime kanë të bëjnë me modele të veçanta dhe i dedikohen ndryshimeve që sjell në kuptimin e njësive së re leksikore formanti fjalëformues, ndryshime që kanë të bëjnë me nuancat e shkallës së intensitetit të veprimit, të kolektives, të përsëritjes, të përforcimit, të ngjyimeve emocionuese etj.

Pika e pestë *Lëvizja semantike gjatë formimit të fjalëve* (Thomai 2009: 252-266) zë një vend të konsiderueshëm në këtë kapitull. Nëpërmjet shembujsh autori na jep një tablo të qartë të larmisë së madhe të përkimeve e të lëvizjeve kuptimore, shkallën e modifikimeve, vlerat e mjeteve modifikuese, ruajtjen e thelbit semantik të derivuesit të derivati etj. Ai thekson se gjatë fjalëformimit, çdo fjalë e re e prejardhur dallohet nga përmbajtja, nga veçoritë e formimit e të zhvillimit semantik, në ruajtjen a trashëgimin e përbërësve kuptimorë të fjalës burimore, në zhvillimet e jashtme e të brendshme semantike, në tipat e prejardhjes semantike dhe në drejtimet e lëvizjeve semantike.

Me shumë rëndësi për fjalëformimin janë edhe ndajshesat. Specializimi i tyre bën të mundur krijimin e gjedheve semantike në formimin e fjalëve të prejardhura dhe për formime kategoriale. Ndajshesat e specializuara sjellin modifikime të njëjta kuptimore e emocionale edhe kur i përngjiten temave të ndryshme fjalëformuese (tema prodhuese). Prandaj autori nuk lë pa trajtuar, nëpërmjet shembujve, edhe këtë anë të formimit të fjalëve në pikën e fundit të këtij kapitulli, e titulluar *Specializimi kuptimor i ndajshesave* (Thomai 2009: 266-273).

Një studim i veçantë bashkëkohor, që ka të bëjë me fjalëformimin në gjuhën shqipe, na vjen po nga akad. Jani Thomai. I titulluar *Veçori leksiko-semantike të ndajfoljeve me prapashtesa në gjuhën shqipe* (Thomai 2004)¹, ky libër e pasuron linguistikën shqiptare dhe më konkretisht është një prurje dhe arritje në fushën e fjalëformimit., është një studim i thelluar teorik që na sjell një konceptim të ri për ndajfoljen - si kategori leksiko-gramatikore, duke e parë dhe hedhur më shumë dritë në anën leksiko-semantike të saj, gjë e cila nuk është bërë deri më tani. Autori, duke u mbështetur në analizën semasiologjike, bën ndarjen dhe përcakton raportet e elementeve gramatikore e leksikore të ndajfoljeve me prapashtesa në gjuhën shqipe. Duke zbatuar këtë metodë për klasën e ndajfoljeve autori na paraqet zhvillimet semantike që ndodhin në çerdhen e fjalës të motivuara nga ndërhyrja e formanteve fjalëformuese, siç janë prapashtesat. Libri fillon me një parathënie (Thomai 2004: 5-8), ku autori motivon nevojën e një studimi të tillë, për shkak të mungesës së kundërimit nga ana leksiko-semantike e ndajfoljeve me prapashtesa. Në kapitullin e parë (Thomai 2004: 8-33) jepet koncepti për ndajfoljen në literaturën gjuhësore shqiptare dhe atë të huaj dhe jepen përfundime për semantikën e ndajfoljeve. Pas kësaj vjen pjesa më thelbësore dhe më e rëndësishme e punimit, që ka lidhje me fjalëformimin, ku autori shqyrton ndajfoljet sipas klasave fjalëformuese (Thomai 2004: 33-166). Pas një pjese për trajtimin leksikografik të ndajfoljeve të shqipes (Thomai 2004: 166-192) jepen përfundimet e përgjithshme që dalin nga analizat e klasave të veçanta (Thomai 2004: 192-201). Treguesi i shembujve, bibliografia shkencore si dhe lista e burimeve të shembujve me shkurtime në fund të librit (Thomai 2004: 201-241) gjithashtu përbën një ndihmesë të madhe për specialistët që punojnë në fushën e fjalëformimit dhe të leksikologjisë.

Nga ky përshkrim i shkurtër i punimit, me rëndësi për ne paraqitet ajo pjesë e tij ku autori trajton çështjen e fjalëformimit tek ndajfoljet me ndajshesat sipas klasave fjalëformuese. Në fillim të çdo grupi ose tipi fjalëformues autori jep përmbledhtas të dhënat gjuhësore – historike (diakronike) që janë dhënë për çdo formant nga autorë të ndryshëm, për gjenezën (originën) e tij dhe temat fjalëformuese me të cilat lidhet. Vetëm një nga formantet (-çe) del i huaj (me origjinë

nga turqishtja), kurse të tjerat janë autoktone. Kategoria fjalëformuese e ndajfoljeve me prapashtesa në gjuhën shqipe është trajtuar nga autori si një kompleks tipash fjalëformues. Çdo tip fjalëformues është i ndërtuar jo vetëm mbi bazën e veçorisë së strukturës onomasiologjike dhe veçorisë leksiko-gramatikore të temës fjalëformuese, por edhe mbi bazën e veçorive që mbart formanti fjalëformues. Materiali (në rastin konkret ndajfoljet) që na paraqitet nga autori është dhënë në mënyrë sinkrone, d.m.th kemi ndajfolje ku tema fjalëformuese dallohet qartë dhe formanti fjalëformues mund të veçohet. Le të përqendrohemi tani konkretisht në tipat fjalëformues veç e veç: *Tipi fjalëformues me prapashtesën -as/-azi* (Thomai 2004: 33-64) ka më shumë ngjyrim popullor. Ndajfoljet e formuara me këtë formant përbëjnë një grup të pasur në krahasim me grupet e tjera dhe shtrirja e tyre është e gjerë në të gjithë territorin e vendit. Temat fjalëformuese, të cilave u përngjitet formanti fjalëformues -as/-azi, janë tema emërore, mbiemërore, foljore dhe ndajfoljore. Më i pasur del grupi i ndajfoljeve me temë emërore (nga këto tema shumica janë thjeshta dhe pak nga tema emrash të përbërë), të cilat shënojnë vend, mënyrë qëndrimi a veprimi dhe lojëra popullore, pastaj ai me temë mbiemërore, ku ndajfoljet e formuara nga këto tema kanë lidhje semantike me përmbajtjen e mbiemrave gjegjëse. Ndajfoljet e formuara me tema foljore janë më të pakta. Këto tema mund të përkojnë me temën e së tashmes, të pjesores ose mund të jenë tema foljesh të përbëra e të përngjitura. Bazë e përbërjes semantike të këtyre ndajfoljeve (me temë foljore) është „ndajfoljezimi” i elementit semantik të veprimit. Ndajfoljet me temë ndajfoljore janë të pakta. Përsa i përket temës ndajfoljore, ajo mund të jetë e thjeshtë, e prejardhur, e përbërë a e përngjitur dhe onomatopeike; *Tipi fjalëformues me prapashtesën -thi* (Thomai 2004: 66-80). Ndajfoljet e formuara me këtë prapashtesë fjalëformuese nuk janë të shumta. Ato shënojnë përgjithësisht mënyra veprimi dhe janë të mbarë gjuhës. Temat emërore, të cilave u përngjitet formanti fjalëformues, janë emërore, ndajfoljore, mbiemërore dhe onomatopeike. Në shumicën e rasteve ato janë të thjeshta, por ka edhe të përbëra.; *Tipi fjalëformues me prapashtesën -isht* (Thomai 2004: 80-124). Ky është tipi më i ri, më i pasur dhe më prodhimtar nga të gjitha tipat e tjerë fjalëformues. Kjo prapashtesë fjalëformuese është më prodhimtarja dhe më aktivja në formimin e ndajfoljeve në gjuhën e sotme shqipe. Ajo bashkohet kryesisht me tema emrash, mbiemrash dhe më pak me tema ndajfoljore. Një grup i pasur ndajfoljor në këtë tip është ai që lidhet me emërtimin e gjuhëve dhe shënojnë mënyrën se si flitet një gjuhë. Mund të thuhet se prapashtesa -isht, duke iu bashkangjitur temës emërore të vendit ku flitet gjuha, na del si një formant i specializuar në këtë drejtim. Edhe ndajfoljet e formuara me tema mbiemërore janë të shumta, në dallim nga ato të formuara me tema ndajfoljore ose me nga pjesore me vlerë ndajfoljore, që janë më të pakta në numër. Të ndërlikuara janë formimet e ndajfoljeve me përngjitje e prapashtesim njëkohësisht. Për këtë tip fjalëformues me rëndësi paraqiten edhe formimet me prapashtesa të zgjeruara (-ërisht, -ësisht, -ëllisht, -nisht etj.); Edhe *Tipi fjalëformues me prapashtesën -shëm* (Thomai 2004: 124-149) është mjaft produktiv. Ky grup ndajfoljesh mund të quhet i ri për gjuhën letrare. Temat fjalëformuese, të cilave u bashkohet formanti fjalëformues, mund të jenë emërore, foljore, mbiemërore e ndajfoljore; *Tipi fjalëformues me prapashtesën -t(ë)* (Thomai 2004: 149-153). Temat fjalëformuese për ndajfoljet e këtij tipi mund të jenë foljore, mbiemërore e më pak ndajfoljore.

Ndajfoljet e formuara me këto tema dhe sufiksin fjalëformues -t(ë) nuk janë të shumta; Temat që formojnë ndajfoljet e *Tipit fjalëformues me prapashtesën -a dhe -aj* (Thomai 2004: 153-157) janë emërore, foljore, mbiemërore, ndajfoljore dhe onomatopeike. Kjo prapashtesë fjalëformuese nuk arrin të bëhet shumë produktive në formimin e ndajfoljeve në shqip. Këto ndajfolje janë të kufizuara në përdorim; *Tipi fjalëformues me prapashtesën -sh* (Thomai 2004: 157-162). Ndajfoljet e këtij tipi formohen nëpërmjet prapashtesës -s she temave fjalëformuese emërore, ndajfoljore ose prej numërorësh. Ndajfoljet e formuara i përkasin si normës letrare edhe asaj stilistike; *Tipi fjalëformues me prapashtesën -çe* (Thomai 2004: 162-166). Ndajfoljet e këtij grupi janë formuar nga tema emërore dhe prapashtesa fjalëformuese -çe me prejardhje të huaj (turke). Këto tip ndajfoljesh janë të vjetruara për gjuhën letrare. Ato përdoren më shumë në ligjërimin e folur dhe letërsinë artistike.

Kjo ishte shkurtimisht paraqitja e grupeve ose tipave fjalëformuese të ndajfoljeve në gjuhën shqipe. Si tip më i pasur dhe më prodhimtar është ai me prapashtesën fjalëformuese -isht, kurse si më i varfër dhe joprodhues del ai me prapashtesën -çe. Nga ana tjetër formimet ndajfoljore me prapashtesat fjalëformuese -az/-azi, -thi, -çe janë kryesisht të ligjërit të folur, kurse ato me prapashtesat -isht, -shëm janë të ligjërit të shkruar. Disa nga prapashtesat, si -isht, -shëm, -çe, - të mund të jenë prapashtesa fjalëformuese edhe për emra e mbiemra, që do të thotë që në sistemin fjalëformues, përsa i përket formanteve, mund të shfrytëzohen të njëjtat mjete fjalëformuese (formantet) për pjesë të ndryshme të ligjëratës. Për formimin e ndajfoljeve na del se gjuha shqipe ka edhe formante të specializuara që janë vetëm ndajfoljore (-as/-azi, -thi), duke krijuar modele fjalëformimi të specifikuara ndajfoljore. E rëndësishme për fjalëformimin dhe për atë ndajfoljor në rastin konkret, e zbatuar nga autori në këtë punim, është tipologjia (Thomai 2004: 194) e cila na paraqitet në mënyrën fjalëformuese (d.m.th. si formime me prapashtesa), në temat fjalëformuese, në kuptimet leksiko-gramatikore, në vlerën dhe qëllimin që përmbajnë tipat fjalëformues prapashtesorë, në krijimin e grupeve paradigmatiche (kryesisht të sinonimisë).

Siç vumë re ndihmesa e akad. J. Thomai në fushën e fjalëformimit është mjaft e madhe. Metodatat e përdorura nga ai, sidomos për ndajfoljen, do të jenë modele udhërrëfyese në studimet dhe punimet e ardhshme, me temë fjalëformimin, për pjesë të tjera të ligjëratës në gjuhën shqipe ose për studime në fushën e fjalëformimit krahasues midis shqipes dhe gjuhëve të tjera indoevropiane, sidomos atyre ballkanike.

Prof. as. dr. BAHTIAR KRYEZIU
Fakulteti i Edukimit, Gjilan, Kosovë

PASTRIMI DHE PASURIMI I GJUHËS SHQIPE NË SYNORIN E AKADEMIK JANI THOMAIT

*"Me e përmbajtun gjuhën të thjeshtë e të dlirtë nuk
asht një rregull arti për njerinë e diçëm e të
qytetnuem, por asht një nevojë e një detyrë që
rrjedh nga ndjenja e naltë e fisnike e kombsis"
Prof. Aleksandër Xhuvani*

Si për koincidence, akademik Jani Thomai, duke folur për prof. Androkli Kostallarin me rastin e 75-vjetorit të lindjes së tij, këtu e 28 vjet më parë (e ne sot jemi takuar për të shënuar pikërisht 75- vjetorin e lindjes së akademik Jani Thomait), profesor Thomai pati thënë: “Një përvjetor i shënuar si ky, i 75-ti i lindjes së prof. Androkli Kostallarit, na jep rastin e pritur që të përkujtojmë këtë personalitet të gjuhësisë shqiptare për kontributin e tij të gjerë e cilësor në fushën e gjuhës shqipe, ... për ta rivendosur më mirë në vendin që i takon në ndërtesën e shkencës kombëtare shqiptare dhe për ta popullarizuar më gjerë, që prej saj të përfitojnë edhe më shumë gjithë brezat e rinj të gjuhëtarëve tanë. Këtë e ndiejmë si një detyrim, edhe sepse prof. Androkli Kostallari nuk është ndonjë studiues kalimtar ose shkencëtar koniunkturë, përkundrazi, personaliteti i tij shkencor, të cilin e ka krijuar vetë, me punë, është i plotë e i qëndrueshëm”¹²⁷. Por, një mendim i tillë, vallë, a nuk vlen edhe për prof. Jani Thomain? Autor i 12 librave, i 8 fjalorëve - si bashkëhartues, i 3 monografive, i disa veprave me bashkëpunim të pjesshëm (kryesisht fjalorë), drejtues i mbi 20 ekspeditave leksikologjike në Shqipëri e në Kosovë, kërkimtar bibliografish e arkivash në Francë, Austri, Angli, Itali, Rusi, Maqedoni, pjesëmarrës në shumë kongrese, simpoziume, konferenca e sesione shkencore të mbajtura në vend e në qendrat më të njohura ballkanike e evropiane, autor i mbi 150 studimeve të botuara në organet shkencore të vendit dhe jashtë vendi etj., në fusha të ndryshme të gjuhësisë: dialektologji, leksikologji, leksikografi, frazeologji, semasiologji, fjalëformim, në punë të njësimin të gjuhës letrare, të normimit të shqipes dhe të kulturës së gjuhës, duke nënkuptuar këtu, pa dyshim, edhe pastrimin dhe pasurimin e gjuhës sonë, apo më mirë të themi, njeri që u mor pothuaj me “gjithë etnosin dhe etosin e shqiptarëve”¹²⁸

I tërë ky opus shkencor i akademik Thomait, pra, s’ka se si të mos jetë një dëshmi e pamohueshme se në sofrën e atyre burrave të mëdhenj të albanologjisë, si: Aleksandër Xhuvani,

¹²⁷ Jani Thomai, *Personaliteti shkencor i prof. Androkli Kostallarit* (mbajtur në Sesionin shkencor përkujtimor me rastin e 75-vjetorit të lindjes së akademik Androkli Kostallari (Tiranë, 12 nëntor 1972), *Studime filologjike*, nr. 1--2, Tiranë, 1998, 27.

¹²⁸ Rexhep Ismajli, *Shenjë dhe ide*, Prishtinë, 1974, f. 84.

³ Grup aturësh, *Fjalor për pastërtinë e gjuhës shqipe*, AShSh (Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, Tiranë, 1998, f. 3.

Eqrem Çabej, Kostaq Cipoja, Selman Riza, Androkli Kostallari, Mahir Domi, Idriz Ajeti, Shaban Demiraj e të tjerë, një vend i denjë gjithsesi i takon edhe akademik Jani Thomait.

Pastrimi i gjuhës shqipe në njërën anë dhe pasurimi i saj në anën tjetër, kanë qenë dhe mbeten detyra të përhershme, si në kohë, ashtu dhe në hapësirë, si nga studiuesit e saj, ashtu dhe nga institucionet arsimore-shkencore dhe qarqet e tjera shoqërore. Kujdesi për të nis që nga shkrimtarët tanë të vjetër, për t'u rritur ai interesim edhe më nga rilindësit, “të cilët i dhanë asaj përmasat e një veprimi kombëtar të bashkërenditur”¹²⁹. Veqilharxhi, që në kohën e tij, ishte shprehur qartë se zhvillimi i gjuhës shqipe do të kalonte në udhën e pastrimit nga fjalët e huaja të panevojshme dhe të pasurimit me *fjalë e kuvise* të qëmtuara në të folurit e popullit, si dhe me fjalë të formuara rishtas¹³⁰, e të cilin program, më mirë se të tjerët e vuri në jetë, babai i gjuhës shqipe, Konstandin Kristorforidhi. Po për këtë çështje, edhe bilbili i gjuhës sonë, Naim Frashëri, bëri shumë. Ai, duke i qortuar bejtexhinjtë, shprehet “të gjithë kanë bërë faj që s’falet e të metë që s’ndjehet kurrë: kanë përzier gjuhën e bukur shqip me fjalë të huaja! Gjuha jonë duhet shkruar fjeshtë shqip, se fjalët e huaja e shëmtojnë shumë. Është e gjerë gjuha jonë dh’e e bukurë shumë, ka fjalë fort të mira për të vënë në vënt të fjalëve të huaja”¹³¹. Andaj, nuk është rastisi që në fjalorin “*Për pastërtinë e gjuhës shqipe*” të ASHSh-së, ku njëri nga tre bashkautorët është edhe akademik Jani Thomai, në faqen 3 të kësaj vepre të thuhet: “Në mendimin dhe në punën e rilindësve pastërtia e gjuhës ishte e pandarë nga detyra për pasurimin e saj. Në veprat e tyre rilindësit u përpoqën të shpalosin visarin e fjalëve të gjuhës shqipe dhe të dëshmonin aftësitë e gjera të saj për të formuar fjalë të reja”¹³².

Në këtë vazhdë edhe akademik Thomai, duke e mbajtur parasysh rëndësinë e këtij problemi dhe seriozitetin që mpleks ai më vete, ka dhënë dhe po jep ndihmesë të çmuar në këtë fushë, siç shihet edhe me paraqitjet e tij në shumë tubime shkencore, në rubrikën “*Fjala shqipe në vend të fjalës së huaj*” të botuar në revistën “*Gjuha jonë*”, ose edhe në botimet tij të paraqitura si më poshtë*. Profesor Thomai, si studiues me formim kulturor e shkencor enciklopedik që është, në një konferencë të organizuar mes Akademive të Shkencave të Shqipërisë e ASHA të Kosovës, si dhe Qendrës për Studime Albanologjike, me të drejtë pati nënvizuar se shqipja nuk duhet menduar si një gjuhë që ka qenë ose duhet të jetë e mbyllur. Ajo gjithnjë është pasuruar me fjalë, qoftë sa i përket terminologjisë apo edhe leksikut të përgjithshëm. “Në rrjedhën e saj, shqipja, lidhur ngushtë me historinë e popullit që e flet këtë gjuhë, ka marrë nga greqishtja e vjetër, e mesme dhe e re, nga sllavishtja, turqishtja dhe më vonë nga gjuhët neolatine si frëngjishtja, italishtja e në ditët tona me shumicë nga anglishtja. Ajo do të vazhdojë të marrë fjalë, por duhet të dallohen fushat e përdorimit të përgjithshëm nga fushat e përdorimit special. Në terminologji pranimi i një fjale të huaj është paksa më i lejueshëm, por kjo nuk do të thotë të pranohet çdo huazim; ndërsa në leksikun e përgjithshëm duhet të ketë një

¹³⁰ Emil Lafe, *Naim Frashëri dhe fjala shqipe*, Studime filologjike, nr. 4, Tiranë, 1990, f. 98.

¹³¹ Jani Thomai, *Vështrim mbi leksikun e ligjërit poetik të Naim Frashërit*, “Gjuha jonë”, 1-4, ASHSh (IGjL), Tiranë, 1997, f. 44.

¹³² Grup autorësh, *Vepra e cituar*, Po aty.

kërkesë shumë më të lartë për përdorimin e fjalëve shqipe”¹. Në një paralelizëm me institucionet ligjvënëse dhe ekzekutive, ku dhe më së shumti ndeshim shpërfilljen e fjalës shqipe, Thomai i quan gjuhëtarët ligjvënës, por jo ekzekutues. “Gjuhëtarët mund të bëjnë studime, të hartojnë fjalorë, ndërhyjnë në tekste mësimore, por nuk kanë fuqi që të detyrojnë ministrinë, universitetet, shkollat, mësuesit, të përdorin të gjithë këtë terminologji që i takon shqipes”¹.

Si shkaqe kryesore të një depërtimi aq të madh e aq të shpejtë të fjalëve të huaja në leksikun e shqipes dhe të gjendjes aktuale të shqipes, akademik Thomai e pranon nga fakti:

- i zhvillimeve të reja të vendit, i ndryshimeve politiko-shoqërore, lëvrimi i fushave a i drejtimeve të reja të shkencës e të ekonomisë (si informatika, biznesi, financat), hapja e Shqipërisë (dhe e pjesëve të tjera të banuara me shqiptarë) ndaj botës, marrëdhëniet më të gjera me gjuhët e kulturat e tjera, shumësia e gazetave dhe e revistave dhe hyrja në politikë, në drejtim shtetëror, në administratë, në publicistikë etj. e shumë specialistëve nga fusha të tjera (me formim jofilologjik), andaj edhe është e kuptueshme që në këto kushte kanë hyrë termat e huaj të fushave përkatëse, janë rikuptimësuar terma specialë në ligjërimin e përgjithshëm (si *kolaps* ekonomik; punë *kapilare* me njerëzit; *transparencë* e kompanive piramidale; politikë e *menaxhimit*; *pista* e ndjekjes së krimit etj.);
- i një snobizmi intelektual, duke e ndjerë frazën e mbushur me fjalë të huaja si shenjë të një kulture të lartë dhe frazën e pastër shqipe si shenjë të një gjendjeje të kapërcyer, si te shembujt: *angazhim* (zotim), *eksperiencë* (përvojë), *prezencë* (prani), *aktivitet* (veprimtari), *konkludoj* (përfundoj), *ambient* (mjedis), *tendencë* (prirje), *aprovuj* (miratoj) etj.;
- i dobësismit të ndjeshmërisë ndaj atdhetarisë dhe ndaj identitetit kombëtar, një nga tiparet themelore të të cilave e përbën pikërisht gjuha amtare;

* *Norma e gjuhës letrare dhe frazeologjia e gjuhës shqipe*, “Probleme aktuale të kulturës së gjuhës shqipe”, Prishtinë, 1983, f. 155-161; *Çështje të leksikut potencial në gjuhën shqipe*, “Gjuha jonë”, 1986, 2, f. 5-16; *Ndihmesa e revistës “Gjuha shqipe” për pastrimin e pasurimin e mëtejshëm të gjuhës letrare*, “Gjuha jonë”, 1986, 3, f. 88-95; *Rreth shtresimit historik të leksikut të shqipes sipas studimeve të prof. E. Çabejt*, SF, 1988, 3, f. 75-83; *Rreth përdorimit të fjalëve dialektore*, SF, 1988, 4, f. 31-37; *Rreth leksikut dialektor e krahinor të shqipes*, SF, 1989, 1, f. 19-32; GjJ, 4, f. 21-29; *Dukuri të leksikut në shtypin pluralist të sotëm*, “Gjuha letrare shqipe dhe bota shqiptare”, 1993, f. 103-112; *Marrëdhënie të standardit me substandardin në shqipen e sotme*, “Jehona”, Shkup, 1996, 8, f. 21-33; *Rreth një korpusi frazeologjik ballkanik*, “Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare”, 1986, f. 675-680; *Ndihmesa e akademikut Idriz Ajeti në fushën e leksikologjisë shqipe*, “Studime”, Prishtinë, 1997, f. 89-95; *Për pastërtinë e fjalorit në ligjërimin publicistik*, GjJ, 2000, 3-4; *Për pastërtinë e fjalorit të gjuhës sonë letrare*, “25-vjetori i Kongresit të Drejtshkrimit”, Tiranë, 2000, f. 85-90; *Dukuri leksikore në shtypin e sotëm*, Konferenca shkencore “Gjuha letrare kombëtare dhe bota shqiptare”, 2002, f. 320-327; *Shqipja standarde dhe leksikografia shqiptare*, Konferenca shkencore “Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare”, 2003, f. 261-270; *Për mbledhjen e fjalëve e të shprehjeve nga goja e popullit*, “Mësuesi”, 10.06.1966; *Të ruajmë e të pasurojmë fjalorin e gjuhës shqipe*, “Puna”, 31.01.1967; *Gjuha e popullit – gurrë e pashtershme*, “Ylli”, 1968, 7; *Nga ekspeditat leksikologjike në Kosovë*, SF, 1974, 1, f. 223-228; SA, 1974, 1, f. 228-232; *Fjalë e shprehje nga Kosova*, SF, 1981, 2, f. 145-152; *Dialektizma leksikore në letërsinë artistike*, “Drita”, 29.03.1987; 05.04.1987; *Çështje të kulturës së gjuhës në shtypin tonë*, “Tribuna e gazetarit”, 1988, 4, f. 24-36; *Për një kulturë gjuhësore më të lartë*, “Zëri i popullit”, 29.03.1988; *Normat letrare të kulturës së gjuhës*, “Zëri i popullit”, 22.02.1990; *Gjuha letrare shqipe s’është shije individësh*, “Bujku”, Prishtinë, 29.01.1997 etj.

- i padituri së dhe i mungesës së formimit gjuhësor e kulturor të disave, si te keqpërdorimi i fjalëve: *alibi*, *mesazh* etj., ose ngatërrimi i fjalëve krejt të ndryshme, si: *simulim* e *stimulim*, *perfekt* e *prefekt*, *aluzion* e *iluzion*, *fruta* e *fryte*, *statut* e *status*, *emetim* e *imitim*, *zgjedhje* e *zgjidhje*, *kontekst* e *kontest*, *atlas* e *atllas*, *adaptim* e *adoptim* etj., ose dhe keqpërdorimi së bashku i fjalës shqipe e të huaj me të njëjtin kuptim, si: ka një *përvojë* dhe një *eksperiencë* të madhe, e përcollën me *nderim* e *respekt*, ngritën një komision *këshillimor* e *konsultativ*, unë ju *garantoj* dhe *siguroj*, me *shqetësim* e *reokupacion* të madh, qëndrim sa *njerëzor* aq edhe *human*, dha një *ndihmesë* dhe *kontribut* të çmuar etj.
- i krijimit të një mendësie mohimi (nga disa individë a grupe njerëzish) për dukuri ose arritje të mëparshme, si p.sh., kur është fjala për standardin e shqipes ose edhe të alfabetit të gjuhës sonë; kujdesi i pamjaftueshëm për ruajtjen e pastërtisë së leksikut, dobësimi i punës me gjuhën amtare në shkollë, përgatitjen dhe kujdesin jo të duhur të vet mësuesve për të ruajtur të pastër gjuhën tonë etj.
- nga fakti i dobësimit ose i pezullimit të hallkave organizative: mosfunksionimi i Komisionit për pastrimin dhe pasurimin e gjuhës letrare shqipe dhe thuajse ndërprerja e punës së rregullt që drejtonte ai, siç ishin rubrikat në shtyp, ligjëratat në televizion, kurset e kualifikimit për arsimtarët, për redaktorët e për korrektorët; mungesa e një ligji për të përcaktuar përgjegjësinë e të gjithë atyre që cenojnë gjuhën amtare, deri edhe te tabelat e dyqaneve, të lokaleve e të kioskave etj., kur dihet se përdorimi i panevojë i fjalëve të huaja, edhe kur nuk përbën shkelje të normës (në kuptim të përgjithshëm), gjithsesi cenon kulturën e gjuhës, mëvetësinë e saj.

Cila është arsyeja e përdorimit të fjalëve e shprehjeve të huaja, si: këtë *e konsideroj* të drejtë; bëri *prezent* problemet; *promovimi* i një libri të ri etj., sikur pyet akademik Thomai, kur për to kemi shprehje shumë të mira të natyrës së shqipes: “këtë *e quaj* (e *marr*, e *vlerësoj* të drejtë); *paraqiti* problemet; *paraqitja* e një libri të ri etj.

Akademik Thomai, nga frika se syri e veshi ynë pak nga pak po na mësohen me fjalë të huaja e të panevojshme (tashti prej gjuhësh perëndimore), mundësinë e pastrimit të gjuhës nga ndikimet e gjuhëve të huaja, që “vështirësojnë marrëveshjen me shtresat e gjera sociale, “intelektualizojnë” gjuhën dhe e largojnë atë nga ligjërimi i bukur dhe i thjeshtë popullor, e sheh:

- në mënjanimin e plotë të disa fjalëve të cilat kanë përgjegjëset e tyre në gjuhën shqipe e të cilat janë të tepërta në këtë gjuhë. Të tilla akademiku ynë i nënvizon fjalët: *abonohem*, *abonim*, *abonent* – *pajtoj*, *pajtohem*, *pajtim*, *pajtimtar*; *angazhim* (zotim), *definitiv*, *definitivisht* – *përfundimtar*, *përfundimisht*; *inspiroj*, *inspirohem*, *inspirim*, *i inspiruar* – *frymëzoj*, *frymëzohem*, *frymëzim*, *i frymëzuar*; *gratis* – *falas*, *unanimisht* – *njëzëri*, *inaugurim* – *përurim*, *kontribut* – *ndihmesë*, *fenomen* - *dukuri*, *mentalitet* – *mendësi*, *presion* – *trysni*, *princip* – *parim*, *okupator* – *pushtues* etj., etj., e të cilat fjalë nuk kanë asnjë vlerë kuptimore e stilistike plotësuese në krahasim me fjalët shqipe përkatëse, prandaj ato duhen mënjeluar pa ngurrim nga përdorimi ynë i përditshëm, qoftë në ligjërimin e folur, qoftë në atë të shkruar.

- në mundësinë e zëvendësimit të pjesshëm të disa fjalëve e çerdhe fjalësh, ku një a disa prej tyre zëvendësohen plotësisht në të gjitha kuptimet, ndërsa të tjerat zëvendësohen pjesërisht ose nuk zëvendësohen fare, p.sh.: *aktivitet - veprimtari, aktivist – veprimtar*, por: *aktiv,-e, aktivizoj, aktivizohem, aktivizim* (nuk janë zëvendësuar ende ose zëvendësohen në disa përdorime); *determinoj, determinant – përcaktoj, përcaktues*, por: *determinizëm* (e pazëvendësuar); *ekstrem,-i, - skaj, ekstrem,-e – i skajshëm, e skajshme*, por: *ekstremist, ekstremizëm* (të pazëvendësuar); *univers – gjithësi*, por: *universal, universalizoj* (të pazëvendësuar) etj.
- në zëvendësimin e pjesshëm të disa fjalëve e çerdhe fjalësh, në një ose në disa kuptime (zakonisht në kuptimet kryesore), p.sh.: *agrar – bujqësor*, por: *reformë agrare, çështje agrare*; *esencë – thelb* (në thelb kuptim i figurshëm), por: *esencë lulesh; tarracë – brezare*, por: *shtëpi me tarracë* etj.¹

Akademik Thomai, duke qenë i bindur se pa forcimin e ndjenjës kombëtare dhe të dashurisë për gjuhën amtare e deri te ngritja e hallkave organizative dhe shtimi i veprimtarisë e i formave të punës që i shërbejnë këtij qëllimi, nuk kapërcehet kjo gjendje e papranueshme në leksikun e gjuhës shqipe të ditëve tona dhe të statusit të saj aspak të lakmueshëm sot, kërkon ndihmën edhe të institucioneve më të larta shkencore e shoqërore-politike, ngase “Çështja e gjuhës amtare i takon politikës mbarëkombëtare dhe përgjegjësisë mbarëkombëtare. Se, siç citon edhe vetë Artur Rambon, “një shoqëri zbulohet përmes pamjes së gjuhës së vet”¹. Formimi i Komisionit të përhershëm për organizimin e punës për pastrimin dhe pasurimin e mëtejshëm të gjuhës letrare shqipe (1979), botimi i revistës “Gjuha jonë” (1981) – Shqipëri, me rubrikën “*Fjala shqipe në vend të fjalës së huaj*”, ku akademik Thomai ishte njëri nga anëtarët; botimi i revistës “Gjuha shqipe” (1983) – nga Instituti Albanologjik, me rubrikën “*Gjuha në praktikë*” etj., ashtu si dhe botimi i disa veprave të kësaj natyre, që u dhanë një nxitje të re diskutimeve shkencore dhe punës konkrete në fushën e pastërtisë së gjuhës, janë vetëm disa nga mekanizmat që ndihmojnë në këtë rrafsh.

Në gjuhën tonë, ashtu si dhe gati në të gjitha gjuhët e botës, jo si modë, por si nevojë e kohës, kanë hyrë e po hyjnë fjalë e formime të huaja (një numër syresh pa farë nevojë - siç u shprehëm më sipër), por edhe sish të cilat vetëm sa e pasurojnë gjuhën, e bëjnë më funksionale dhe më të zhdërvjelltë në përdorimin e saj, në përmbushjen e misionit të saj për marrëveshje. Për fjalët si: *rentgen, mercedes, om, vat, amper, atom, katalizator, anodë, katodë, qelizë, embrion, hipotenuzë, tangjentë, neutron, proton...* – dikur, pa të cilat edhe tashti vështirë mund të mendohet leksiku i shkencave të fizikës, të kimisë, të biologjisë, të matematikës etj., e *internet, digjital, softver, celular, disketë; global e globalizim, digjital e digjitalizim, tender e tenderim, market e marketing, kompjuter e kompjuterizim* – sot, si dhe sa e sa fjalë të tjera, kemi bindjen se as akademik Thomai nuk është kundër. Kur ato përdoren me cum grano salis – me terezi, siç thoshte Fishta, nevoja për to është edhe më e madhe. Andaj, gjithë fjalët e huaja nuk duhet të vështrohen si “mish i huaj” në trupin e shqipes, por pjesë e saj, si gjuhë kulture, si shenjë e marrëdhënieve të ndërsjellë në kulturat e popujve të ndryshëm dhe si shprehje konkrete e përngritjes kulturore të popullit shqiptar. Popujt, sot e gjithë kohën, kanë përfituar

nga kultura e njëri-tjetrit. Në këtë kuptim, hyrja dhe përdorimi i shprehjeve të huazuara është një dukuri që haset në të gjithë kombet e zhvilluara e që, edhe në gjuhën shqipe kjo është një dukuri e vënë re prej kohësh...¹.

Është opinion i drejtë i grupit të autorëve të fjalorit “*Për pastërtinë e gjuhës shqipe*”, pra, edhe i akademik Thomait, se “krahas gjuhëtarëve, kanë dhënë e japin një ndihmesë të çmuar edhe shkrimtarët, përkthyesit, publicistët, njerëzit e kulturës, nëpunësit, ushtarakët, të cilët janë krijues, shpeshherë të panjohur, të shumë neologjizmave të qëlluar, që i shërbejnë pastërtisë së gjuhës sonë”¹, që nënkupton dhe pasurimin e saj. Akademik Thomai, pasurimin e gjuhës e mbështet edhe në hapjen e rrugës fjalëve krahinore shqipe dhe krijimeve të reja me mjete e sipas modeleve të shqipes, ashtu siç kishte porositur edhe mësuesi i tij, bard i shkencave albanologjike, prof. E. Çabej, duke mos u mbyllur dyert fjalëve, shprehjeve e kuptimeve, por duke i lënë ato “të konkurrojnë lirisht e të provohen realisht në truallin e përdorimit të gjallë ligjërimor, pavarësisht nga burimi krahinor, nga krijuesi, nga mosha”.¹ Ai, po ashtu, kërkon që në gjuhë të ketë prore vjelje të reja fjalësh, kuptimesh, njësisht frazeologjike, shembujsh, në mënyrë që gjuha jonë të përditësohet me lëndën e re. Në këtë hulli është edhe qëndrimi i akademik Rexhep Qosjes, i cili, duke paraqitur opinionet e tij për pasurimin e gjuhës letrare, shkruan se “krijimi i fjalëve të reja, ringjallja e disa fjalëve plaka, përdorimi i krahinorizmave, zgjerimi a ndryshimi a, më në fund, saktësimi i kuptimit të disa fjalëve të marrëveshjes së përditshme”¹ janë bazë e mirë për një gjuhë të pastër e të pasur shqipe.

Ndër burimet që shumë dhe shpejt ndikojnë në zhvillimin - pasurimin e leksikut të një gjuhe, profesor Thomai përmend edhe pluralizmin e mendimeve të shprehura në organet e shtypit (gazeta e revista), në mjetet e informimit e të propagandës (radioja e televizioni), si dhe në format e tjera të ngjashme (mitingjet, parlamenti, konferencat e shtypit etj), nga të cilat debate herë-herë të ashpra, sikur edhe gjuha ka një përfitim, sepse ajo vë në lëvizje të gjitha mjetet e saj, pasurohet¹, si p.sh. me fjalëkrijim: *socialistët a pësisistët* (nga (Partia) Socialiste – PS-ja), *demokratët a pëdistët* (nga (Partia) Demokratike – PD-ja), *stabilistët* (anëtarët e Qeverisë së Stabilitetit), *rendistët* (forcat e ruajtjes së rendit publik); pastaj fjalët si: *eksodistët, dyshtetësi, replikim, agjenturë*; me fjalë të burimit krahinor: *trand, mëtim, prishaqejf, mjeran...*; ndajfolje me prapashtesën –*shëm*: *guximshëm, ndjeshëm, kërcënueshëm, thekshëm* etj.; me ringjalljen e disa fjalëve të sistemeve të mëparshme të ekonomisë, të organizimit shtetëror, të administratës etj., si: *bashki, sindikatë, kolegji* etj.; me fjalë me kuptim të figurshëm, me ngjyrim negativ: *frëngjia* (e partisë), *çobanët* (e partisë), *gjuetia e shtrigave, diasporak*, (politikan) *latant*, (çmime) *tavan*, juristë *hamullorë...*; me emërtime analitike (togfjalësha e shkurtesa) për dukuri të reja të jetës pluraliste: *policia financiare, SHIK-u, asistenca sociale, ruandi i parë (i dytë) i zgjedhjeve, subjekt elektorale* etj.

Përveç një numri fjalësh të hyra në shqipen, akademik Thomai pohon se pasuri gjuhësore kanë qenë e mbeten edhe njësitë frazeologjike të mbarë gjuhës, të cilat nuk kanë asnjë tregues krahinor, si: *brez pas brezi, shkel e shko, me krah hapur, me mend në kokë, s’e prish gjakun*, etj.; njësitë frazeologjike me burim dialektor a krahinor, por që tashmë janë bërë pronë e përgjithshme e gjuhës (*kodër pas bregut, gjallë e ngushtë, çoj zemrën peshë, e vuri në bisht të*

lahutës...); njësi frazeologjike dialektore a krahinore që mëtojnë të bëhen pasuri me mundësi të mëdha përgjithësimi në gjuhë, por që ende nuk kanë fituar atë status dhe përdoren, varësisht nga vendi ku janë krijuar (*e ka ba dorën grusht* “është dorështrënguar, nuk jep asgjë”, *nuk e bajke duej* “nuk e lidh dot muhabetin, s’ia nxjerr kokën fjalës” (K); *ia bën korbit me sy* “është duke vdekur”; *hall me buaj, hall me qe* “s’di ç’të bëjë, është mëdyshas, as kështu as ashtu... (M); *dhjetë hunj e një purtekë* “shkel e shko, sa për të shkuar radhën”; *e hëngri djathin e Kolës* “vdiq”... (D)¹, etj., etj.

Për veprimtarinë dhe punën e tij shkencore kolosale që ka bërë e po bën profesor Jani Thomai në fushën e gjuhës shqipe, veç shpërblimeve të tjera, u dekorua me “Çmimi i Republikës” i shkallës II (1984), “Urdhëri Naim Frashëri” i kasit I (1985), kurse shoqata kulturore atdhetare “Myzeqeja” e nderoi atë me titullin “Nderi i Myzeqesë” (2001), komuna e Semanit, që është edhe vendlindja e tij, i jep titullin “Qytetar nderi” i kësaj komune (2008), e po këtë vit, për punën e tij të palodhshme shkencore, u nderua edhe me titullin e lartë “Qytetar nderi” i Qarkut të Fierit, me të cilin titull ai tanimë qëndron krahas shkrimtarëve të njohur Jakov Xoxe e Nasho Jorgaqi, Mësuesit të Poullit Edmond Lule, artistëve Albert Verria e Luftar Paja etj., por ne kujtojmë se edhe shënimi sot, në këtë konferencë, i 75-vjetorit të lindjes së tij, organizuar nga Universiteti “Fan S. Noli” i Korçës, fjalët e ngrohta e miradije të ish-nxënësve e të studentëve të tij, si dhe të studiuesve të tjerë, jo vetëm nga trojet mbarëshqiptare, janë shpërblimet, dekorimet, pranimet, urimet e pse jo edhe falënderimet më të mëdha dhe më të sinqerta për akademik Jani Thomait, shkencëtarin i cili nuk u bë shkencëtar, por lindi i tillë – siç do të thoshte profesor Mahir Domi.

P ë r f u n d i m

Akademik Jani Thomait, përveç studimeve në fushë të dialektologjisë, semasiologjisë, fjalëformimit, në punë të njësimi të gjuhës letrare, të normimit të shqipes dhe të kulturës së gjuhës, e sidomos në fushën e leksikologjisë, leksikografisë e frazeologjisë, ka shprehur interesimin e tij edhe për pastrimin dhe pasurimin e gjuhës sonë. I ndikuar nga rilindësit tanë e i mësuar nga mësuesi i tij, kurora e gjuhësisë shqiptare – prof. Eqrem Çabej, profesor Thomai pastrimin e gjuhës e sheh përmes mënjanimi të plotë të disa fjalëve të huaja, si: *angazhim* (*zotim*); *definitiv* (*përfundimtar*); *gratis* (*falas*) etj.; në mundësinë e zëvendësimit të pjesshëm të disa fjalëve e çerdhe fjalësh, si p.sh.: *aktivitet* - *veprimtari*, *aktivist* – *veprimtar*, por: *aktiv*,-*e*, *aktivizoj*; në zëvendësimin e pjesshëm të disa fjalëve e çerdhe fjalësh, në një ose në disa kuptime (zakonisht në kuptimet kryesore), p.sh.: *agrar* – *bujqësor*, por: *reformë agrare*, *çështje agrare* etj.

Si shkaqe kryesore të një depërtimi aq të madh e aq të shpejtë të fjalëve të huaja në leksikun e shqipes, akademik Thomai e pranon nga fakti: i zhvillimeve të reja të vendit; i marrëdhënieve më të gjera të shqipes me gjuhët e kulturat e tjera; i një snobizmi intelektual, duke e ndjerë frazën e huaja si shenjë të një kulture të lartë dhe frazën e pastër shqipe si shenjë të një gjendjeje të kapërcyer, si te shembujt: *eksperiencë* (përvojë), *prezencë* (prani), *tendencë* (prirje), *aprovj* (miratoj) etj.; i dobësimit të ndjeshmërisë ndaj atdhetarisë; i paditërisë dhe i mungesës së

formimit gjuhësor e kulturor të disave, si te keqpërdorimi i fjalëve: *alibi*, *mesazh* etj., ose ngatërrimi i fjalëve krejt të ndryshme, si: *simulim* e *stimulim*, *perfekt* e *prefekt*; i krijimit të një mendësie mohimi si për standardin e shqipes ose edhe për alfabetin e gjuhës sonë; i dobësimit ose i pezullimit të hallkave organizative etj.

Megjithëkëtë, për fjalët si: *rentgen*, *embrion*, *hipotenuzë*, *neutron*... – dikur, e *internet*, *celular*, *globalizim*, *tender* etj. – sot, si dhe sa e sa fjalë të tjera, as akademik Thomai nuk është kundër (nuk është purist), kur ato përdoren me terezi, siç thoshte Fishta dhe e pasurojnë gjuhën tonë, siç ndodh edhe me gjuhët e tjera të botës.

Akademik Thomai, pasurimin e gjuhës e sheh edhe në hapjen e rrugës fjalëve krahinore; në pluralizmin e mendimeve të shprehura në organet mediale; në debatet herë-herë të ashpra, si p.sh. me rastin e fjalëkrijimeve: *socialistët* a *pësisistët* (nga (Partia) Socialiste – PS-ja), *demokratët* a *pëdistët* (nga (Partia) Demokratike – PD-ja); pastaj fjalët si: *eksodistët*, *agjenturë* etj.; me ringjalljen e disa fjalëve të sistemeve të mëparshme të ekonomisë, të organizimit shtetëror, të administratës etj., si: *bashki*, *sindikata*, *kolegj* etj.; përmes përdorimit të njësive të ndryshme frazeologjike të mbarë gjuhës, si: *brez pas brezi*, *shkel e shko*; të njësive frazeologjike me burim dialektor a krahinor (*kodër pas bregut*, *gjallë e ngushtë*; *nuk e bajke duej* “nuk e lidh dot muhabetin, e hëngri djathin e Kolës “vdiq” etj.

Për veprimtarinë dhe punën e tij shkencore kolosale, profesor Jani Thomai është shpërblyer e nderuar disa herë nga institucionet arsimore e organet shtetërore të vendit.

Prof. as. dr. ASLLAN HAMITI
Universiteti “Shën Qirili e Metodi“, Shkup, Maqedoni

NDIHMEA TË AKAD. JANI THOMAI NË FUSHËN E LEKSIKUT DIALEKTOR

Është kënaqësi që jemi mbledhur këtu, në Korçë në një Konferencë Shkencore Ndërkombëtare në të cilën shënojmë 75-vjetorin e lindjes dhe veprimtarinë gjysmëshekullore shumë të frytshme të akademik Jani Thomai.

Akademiku i nderuar është një nga figurat më të shquara të shkencës shqiptare, sidomos në fushën e leksikologjisë, leksikografisë, të frazeografisë e të semasiologjisë.ⁱ

Nga studimi mbi leksikun dialektor dhe krahinor në shqipen e sotme të studiuesit dhe pedagogut të fjalës shqipe përvijohen dy porosi udhërrëfyese, largpamëse e dobiprurëse për gjuhën dhe kombin tonë:

Porosia e parë: Vetëdijësimi ynë për shfrytëzimin e leksikut dialektor e krahinor si burim kryesor për pasurimin e fjalësit të shqipes letrare. Thjesht, vepra del me parimin se lënda gjuhësore (fjalët dhe tipat fjalëformues) nuk duhet “importuar” pa nevojë nga gjuhët e tjera të Evropës e të botës, kur kemi “prodhimin tonë” e mund ta gjejmë gjithandej ku flitet shqipja dhe në letrat shqipe.

Porosia e dytë: Leksiku është sfera më e lëvizshme e gjuhës. Pasuria leksikore e pashtershme e shqipes dhe pak e shfrytëzuar deri më tani duhet të jetë burimi më i rëndësishëm për pastrimin nga elementi i huaj dhe për pasurimin e shqipes standarde me njësi leksikore, semantike e stilistike. Në procesin e standardizimit të mëtejshëm e të modernizimit të shqipes, për ta bërë atë të aftë që të përmbushë nevojat e shumëllojshme të një shoqërie të zhvilluar dhe për të konkurruar me sukses me gjuhët më të zhvilluara të botës, prirja kryesore duhet të jetë thjeshtimi i formave gramatikore dhe zgjerimi i fondit leksikor me burim anas (dialektor e krahinor).

Në veprën “Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme” prof. Jani Thomai,ⁱⁱ si një profesionist i rrallë, shfrytëzon të arriturat më të reja në këtë fushë dhe ato i shpie përpara. Në qëndrimin për dialektizmat e krahinorizmat, për leksikun dialektor e krahinor, për dialektet e të folmet, për gjuhën letrare e për probleme të tjera teorike kyçe jo vetëm që është mbështetur në të arriturat shkencore të kohës, që dalin nga një varg punimesh dialektologjike, leksikologjike, në punime për gjuhën letrare etj. por ato me një rreptësi shkencore i analizon dhe i saktëson, madje shfrytëzon edhe të arriturat teorike e praktike të gjuhëve të tjera, veçmas të frëngjishtes e të rusishtes. Vepra shquhet me shembuj të shumtë që ka sjellë autori. Pothuaj se gjysmën e tekstit të studimit e zënë fjalët dialektore e krahinore dhe gjegjëset e tyre në shqipen standarde.

Në këtë monografi, të ndarë në pesë kapituj, autori jep ndihmesa të çmuara: I. Rreth koncepteve e termave “dialektizëm” e “krahinorizëm”. II. Për leksikun dialektor e krahinor të shqipes dhe shtresimin e tij. III. Rreth leksikut dialektor e leksikut të gjuhës letrare. IV. Për fushën e përdorimit të dialektizmave e të krahinorizmave. V. Rreth trajtimit leksikografik të dialektizmave dhe të krahinorizmave, për ta pasuruar studimin me Treguesin e shembujve dhe me Bibliografi të pasur.

Dialektizmave e krahinorizmave leksikore në shqipen nuk i është kushtuar ndonjë studim i veçantë edhe pse deri më tani janë botuar disa fjalorë krahinorë visesh të ndryshme, monografi përshkruese për shumë të folme shqipe ku bashkë me sistemin fonetik e fonologjik bëhet fjalë edhe për leksikun e të folmes përkatëse.ⁱⁱⁱ Po kështu, nuk mungojnë edhe punimet me vlerë që shtjellojnë çështje lidhur me nevojën e vjeljes së leksikut dialektor e krahinor^{iv} si burim i pashtershëm për pasurimin e leksikut të shqipes së sotme^v dhe si lëndë për hartimin e fjalorit të madh^{vi}, për sinonimet,^{vii} antonimet^{viii} dhe homonimet^{ix} në gjuhën shqipe, elementet e huaja leksikore në shqipen dialektore e letrare etj.^x Shtrirjes territoriale me izoglosa të veçanta të leksikut dialektor e krahinor i është kushtuar edhe vëllimi i dytë i Atlasit dialektologjik të shqipes.^{xi}

Sipas njohurive tona, akademik Jani Thomai ka shkruar monografinë e parë më të plotë e me prurje të reja për leksikun dialektor e krahinor në gjuhën e përbashkët kombëtare.

Pas një trajtimi të shumanshëm të termave “dialektizëm” e “krahinorizëm”, analizës dhe sintezës së përkufizimit të deritashëm të tyre, ngjashmërisë dhe dallimit etj., akademik Thomai përfundon: “Mund të pranojmë me marrëveshje një kriter dallues të përafërt ndërmjet dialektizmave e krahinorizmave: kur fjala, që nuk e ka gjuha letrare, gjendet vetëm në një të folme ose në të folmet vetëm të një krahine, të merret si krahinorizëm; kur fjala gjendet në tërë dialektin ose në disa të folme të një dialekti (kuptohet, që mund të jenë edhe të krahinave të ndryshme), të merren si dialektizëm.”^{xii}

Prof. Thomai pranon tri kritere për të përcaktuar karakterin dialektor a krahinor të fjalëve:

a) Kriteri i grupimit paradigmatic, d.m.th. kur fjala është dysor a sinonim dialektor i qartë i një fjale tjetër që është pranuar si e normës letrare të tipit: *uzdajë* – shpresë, *pendël*, *shpendël* – pupël, *thi*, *guc* – derr; *gjã*, *hajvan* – kafshë; *kaposh/kokosh*, *knus* – këndes, gjel; *kallamboq/kollomoq* – misër; *gjiton*, *kojshi*, *komshi* – fqinj; *konop*, *tërkuzë* – litar etj.

b) Kriteri gjuhësor-fjalëformues, pasi cilësohen si dialektore a krahinore edhe variantet fjalëformuese (veç varianteve fonetike) që nuk janë normë letrare, si p.sh. në Has,^{xiii} në Shkrel^{xiv} e gjetkë për të treguar banorët e një vendi u shtojnë emrave të vendeve vetëm nyjën e përparme *i*: *i shaljan*, *i hazjan*; *i shkrel*, *i hot*, *i kastrat*. Në Gjilan të Kosovës banorët e fshatrave thonë jam (ai është) *i Godenve*, *i Shurdhanve*, *i Dunavve*, *i Biçakve*, *i Çelikve* (në kuptimin banor i fshatit Goden, Shurdhan, Dunav, Biçak, Çelik). Në të folmen e fshatit Brezë të Karadakut të Shkupit për formën standarde “çka” përdorin krahinorizmin mjaft të përhapur në shumë të folme të tjera të gegërishtes qendrore *xhit*, ndërsa për “diçka” thonë formën e përngjitur *dixhit*.^{xv}

Në Veri kemi formime fjalësh me prapashtesën –shëm, në Jug me –uar: *i punueshëm* – *i punuar*, *i dëgjueshëm* – *i dëgjuar*, *i kuptueshëm* – *i kuptuar*, *i thyeshëm* – *i thyer* ... kuptohet që të dyja format janë normative dhe se ka dallim kuptimor ndërmjet formave të fjalëve me –shëm nga ato me –uar. Fjala vjen, kur themi se materiali që gjendet brenda një pakoje është e thyeshme, d.m.th. atë duhet bartur me kujdes se mund të thyhet, ndërsa nëse themi se diçka është e thyer kuptojmë se tani më veprimi ka mbaruar. “Dialektet e të folmet kështu përbëjnë një pasuri të pamatshme jo vetëm me njësi leksikore, por edhe me tipa e mjete fjalëformuese të specializuara për kategori gramatikore, klasa leksikore ose fusha konceptore të veçanta.”^{xvi}

c) Kriteri i fushës leksikore ose i fushës tematike (emrat e bimëve, të kafshëve, të shpendëve, të orendive shtëpiake, të veshjeve, të veglave të bujqësisë e të zejtarisë etj., kur janë lokale ose kur ndryshojnë mjaft nga një krahinë në tjetrën).^{xvii}

“Dialektet e të folmet kështu përbëjnë një pasuri të pamatshme jo vetëm me njësi leksikore, por edhe me tipa e mjete fjalëformuese të specializuara për kategori gramatikore, klasa leksikore ose fusha konceptore të veçanta.”^{xviii} Gjerësia e shtresës leksikore e krahinore, që përfshihet në rrethin e gjuhës letrare, sa vjen e rritet. Në këtë brez bëhet “fermentimi” i nevojshëm, gjatë të cilit fjalët krahinore fitojnë vlera të reja në atë shkallë sa bëhen “mbidialektore”, pra, nga krahinorizma bëhen ish-krahinorizma në gji të gjuhës letrare.^{xix}

Babai i fjalës shqipe në studimin e tij vend të posaçëm i kushton edhe sinonimisë dialektore. Për këtë me të drejtë përfundon se: “Sinonimia leksikore është mundësi gjuhësore nxitëse edhe për thithjen e fjalëve nga të folmet. Shtresa më e gjerë e fjalëve dialektore e krahinore përbëhet nga ato fjalë që kanë hyrë ose mund të hyjnë në gjuhën letrare si sinonime leksikore të fjalëve më të përgjithshme a të dialektit tjetër, duke sjellë jo vetëm larmi, por edhe pasurim me nuanca kuptimore, ngjyresa emocionuese etj. (tipi *piskamë, ushtimë, jehonë, dashakeq, keqdashës, cep, kënd, rrok, i rremë, rrekem* etj.).”^{xx}

Shtresën kryesore të leksikut të shqipes së sotme standarde e përbëjnë fjalët e shprehjet ***që i takojnë gjithë truallit gjuhësor të shqipes***, të cilat nuk mund të cilësohen më si të këtij a si të atij dialekti. Kjo shtresë përfshin pjesën kryesore të fjalëve e të shprehjeve të mbarë shqipes, pa të cilën nuk mund të merret me mend jeta e gjuhës së një kombi. Ballafaqimi i leksikut të dialektit të Veriut me dialektin e Jugut brenda gjuhës kombëtare krijon një raport të veçantë leksemash, që hetohet burimi dialektor e që krijojnë çifte sinonimike, si: *fshat – katund, vajzë – çikë, qumësht – tambël; fqinj, gjiton – kojshi, komshi; nxjerr – qes, ftoj – thirr, derr – thi, kyç – çelës, litar – konop, tërkuzë; rrugë – udhë, kokë – krye, kurriz – shpinë, hap – çel, tërë – gjithë, gjalpë – tëlyen, mëmëdhe – atdhe, ngordhë – cofë, dehem – pihem, dyzet – katërdhet, tigan – fultere, fërtere; fshehurazi – tinëz, gënjeshtër – rrenë, kafshë – gjã, hajvan; mbyll – mshel, rrogoz – hasër, këpucë – kundra, shportë – kosh, kopsht – bahqe, patate – kompir, misër – kallamoq, sopatë – sakicë, kotec – koçak, këndez – knus, gjel; kërriç, pulisht – përllak, kec – edh, bushtër – kuçkë, lingua – zagar, luleshtrydhe – dredhëz, xhaxha – mixhë, fik (zjarrin) – shkym (zjarrin), çlodhem – pushoj, dem – m(ë)zat, ajër – frymë, eja – hajde, buf – hut; tregoj, rrëfej – kallëzoj, shikoj – kqyr etj.*

Në konkurrencën normative – pohon Thomai - një (ose dy) mund të mënjanohet, por më e zakonshmja është ngulitja si dysorë leksikore, që në shumë raste është arritur përfundimisht, sikurse *hap – çel, ngre – çoj, kokë – krye, kurriz – shpinë, def – dajre, rrok – kap, sjell – bie, sjell – godit, sos – mbaroj, spec – pipërkë, trangull – kastravec* etj., që mund të thuhet se janë barasvlerës si nga kuptimi, ashtu edhe nga shtrirja në përdorim.^{xxi}

Në të folmet shqipe ka edhe shumë fjalë të njëjta, por me variante fonetike të dallueshme, të tipit *borë, bor, vdorë, xborë, zborë; shtëpi, shpi, shpaj/shpoj/shpëj; lëshoj, lshoj, shloj; fëmijë, fmi, fmajë; syri, sýni, sajni; punoja, punonja, punojsha, punojshna* etj.

Përveç zhvillimit të brendshëm e të mëvetësishëm gjuhësor, në degëzimin dialektor deri diku kanë ndikuar, sidomos në leksikun dhe në sintaksën e të folmeve anësore, gjuhët e huaja në kontakt. Kështu, ndikimi i gjuhëve sllave është më i madh në të folmet shqipe të Maqedonisë, në kosovariste e shqipen e Malit të Zi; në Shqipërinë e Jugut vërehet më shumë ndikimi i greqishtes, në pjesën e bregdetit veriperëndimor është më i fuqishëm ndikimi i italishtes etj. Të tilla janë sllavizmat: *brazdë, zheg, fllad, mraz, torishtë, voz, llovaçkë, potvërd, okolla, apet (opet)* etj. orientalizmat: *aksham, asker, azgan, badihava, begenis, çarshi, çoban, dost, gajle, haber, hyzmeqar, kollaj, sabah, sebep, tuxhar, vakt* etj.

Rrugët e hyrjes dhe të përdorimit të turqizmeve akad. Jani Thomai i paraqet në një skemë me katër tipa, përkatësisht **turqizma**:

- a) të zëvendësueshëm (*javash* – ngadalë, *karshi* – kundrejt, *bile* – madje, *qoshe* – kënd, *bosh* - i zbrazët etj.);
- b) si leksik special (historizmat, etnografizmat);
- c) me ngjyresa emocionuese (negative) e stilistike:
- ç) si dialektizma e krahinorizma.

Përgjithësisht është konstatuar se shumë huazime leksikore nëpër të folme kanë mbetur si historizma a arkaizma, të gjitha këto me emëruesin e përbashkët si krahinorizma.

Ndarja fetare e shqiptarëve (në islamë, ortodoksë e katolikë) nuk ka lënë gjurmë të thella në ndryshueshmërinë gjuhësore të tyre, përveç në emrat vetjakë dhe në fondin e fjalëve që lidhen me ceremonitë, zakonet e kulturën fetare përkatëse.

Dialektet e shqipes kanë qenë dhe vijojnë të mbeten ende burim i pashtershëm për pasurimin e leksikut të gjuhës letrare me fjalë e frazeologji popullore, kuptime e ngjyime fjalësh, mjete shprehëse si dhe për zhvillimin e normës leksikore. Veprimi pasurues i të dy dialekteve mbi leksikun e gjuhës letrare është i barabartë. Pasuria leksikore e frazeologjike e shqipes, vlerësohet si pasuri e përbashkët kombëtare, pavarësisht nga burimi dialektor.

Gjuha letrare merr prej dialekteve çdo fjalë e shprehje që i duhet për të plotësuar sistemin dhe që i sjell asaj një pasurim të vërtetë. Kështu, janë bërë pronë e gjuhës standarde një varg fjalësh e shprehjesh nga dialekti i Veriut, si *arushë, argëtoj, befas, cucë, diktoj, doke, fatos, bjeshkë, kacafytem, zanë, i zyrtë, zeje, pushtoj, burrneshë, pushtoj, akullnajë, kodër pas bregut* etj. Disa fjalë madje ruajnë edhe trajtën fonetike dialektore, si: *amtare, zanore, zanë, shmang, farefisni, besëtytni, rrënojë, dashnor, shtambë, ranishte, bërthamë, krenar, synoj, barnatore, dhanore, mbeturinë* etj.

Ka edhe shumë fjalë e shprehje të tjera nga dialektet që mund të hyjnë në leksikun e gjuhës letrare, sepse e pasurojnë atë, zëvendësojnë fjalët e huaja, sjellin nuanca e ngjyime emocionale etj. Mjafton të përmendim këtu pasurimin e gjuhës standarde nga dialekti i Veriut me vargje sinonimesh të tipit: *grunishtë-grunore-grunajë* “arë e mbjellë me grurë”, *tamblak* “qengj pirës”; *tamblatore, tamblore, tamëltore* “lopë që jep shumë qumësht”; *tambloriz, tamëloriz* “oriz me qumësht”, *lule a bar tamblu; drynoj* “mbyll me dry”, *shpeshtinë* “pyll i dendur”, *shterpni* “të qenit shterp” etj.

Kolosi i fjalës shqipe sjell qindra shembuj dialektizmash ose krahinorizmash që s’e kanë ende një sinonim të mirëfilltë në gjuhën letrare (me kuptime ose nuanca kuptimore të veçanta) dhe që mund të përgjithësohen lehtë e të hyjnë në gjuhën letrare, si: *angërduf* “ai që fryhet e kapërdiset si gjel deti; ai që mbahet më të madh”; *ankojë* “njeri që qahet e ankohet vazhdimisht”, *cikon* “nxjerr lëng (pema)”, *defatore* “grua që i bie defit”, *cucërrohem* “mblidhem shuk, bëhem grusht (nga frika etj.)”, *cukëlan* “që i ka rënë leshi vende-vende (për bagëtinë)”, *cullohem* “bëhem si fëmijë”, *eracak* “që nuhat mirë, që i bie në erë gjahut shpejt (zakonisht për qenin)”, *faran* “misër i farës”, *gërdhajë* “pjesët e padobishme të një fruti (pjesa e brendshme e frutit (p.sh. mollës) që nuk hahet bashkë me farat)” e një varg fjalësh të tjera.^{xxii}

“Të tilla fjalë e kuptime fjalësh ndër të folme ka me mijëra. Kartoteka e leksikut të shqipes -thotë Thomai - (KLSH) përmban shumë prej tyre, por ende ka shumë të tjera të pambledhura, që janë pasuri e çmuar e gjuhës dhe që mund të pasurojnë më tej gjuhën letrare kombëtare. Prandaj, me gjithë ndërlikimet që ka, studimi i kësaj shtrese është me rëndësi të veçantë. Studimi i tipave të dialektizmave e të krahinorizmave dhe i ndërthurjes së faktorëve gjuhësorë e jashtëgjuhësorë, karakterizimi i historisë së fjalëve dhe i gjendjes së sotme, përcaktimi i marrëdhënieve me shtresat e tjera leksikore, sidomos me leksikun e gjuhës letrare, zbulimi i vlerave dhe i fushave të përdorimit, dallimi i elementeve vetjake nga huazimet, shtresimet nga pika të ndryshme vështrimi e çështje të tjera që janë objekt i këtij punimi, nuk marrin fund këtu, ato presin të çohen më tej me punime të tjera.”

Gjuhëtari ynë i shquar në rrafshin kombëtar e ballkanik leksikun dialektor e krahinor e vështron edhe në krijimtarinë popullore dhe në letërsinë artistike. Ja se si shprehet ai në monografinë “Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme”: “Dihet që populli është krijuesi i gjuhës në tërësi, por te leksiku dialektor e krahinor dora e tij duket më e afërt, më e drejtpërdrejtë, gjë që ka sjellë për këtë një emërtim më të përgjithshëm: *leksik popullor*.... Si një nga burimet më të mëdha e më të sigurta për pasurimin e gjuhës letrare, në mos më kryesori, ai nuk mund të cilësohet sipas vendit që ka në shtresat leksikore të gjuhës, por sipas vlerave të paçmueshme, reale e potenciale, që janë shumë herë vendimtare në drejtimin e zhvillimeve gjuhësore, pa përmendur këtu fusha të tilla të gjera, si krijimtaria gojore popullore, letërsia artistike ..., në të cilat leksiku dialektor e krahinor ka, veç vlerave, edhe mbivlera, që s’i ka leksiku i përgjithshëm ose leksiku i gjuhës letrare. Këtu duhet të kujtojmë edhe aftësinë e madhe depërtuese të leksikut dialektor e krahinor në çdo “enë gjaku” të gjuhës letrare, madje deri në terminologjinë tekniko-shkencore.

Ai identifikon dhe na sjell shumë fjalë me burim dialektor e krahinor në veprat e autorëve të vjetër, që nga Buzuku, Budi, Bardhi, Bogdani, nga vepra të letërsisë së Rilindjes shqiptare etj., duke u mbështetur edhe në studimet e gjuhëtarëve të tjerë, veçmas të prof. Eqrem Çabejt, Androkli Kostallarit, Aleksandër Xhuvanit, Xhevat Lloshit etj.

Është e njohur se para formimit të shqipes standarde (në Kongresin e Drejtshkrimit, Tiranë, 1972) pothuajse të gjitha veprat e shkrimtarëve tanë janë shkruar në gjuhën dialektore a krahinore, shpeshherë me përpjekje për një gjuhë mbidialektore a mbikrahinore. Por, edhe pas formimit të gjuhës standarde shqipe, përdorimi i fjalëve dialektore e krahinore në letërsinë

artistike është i lejueshëm: asaj i jep një ngjyrim popullor, bisedor. Fjalë të këtilla gjejmë edhe në shumë vepra të shkrimtarëve bashkëkohorë (si te veprat e Gjergj Fishtës, Lasgush Poradecit, Jakov Xoxës, Mitrush Kutelit, Dritëro Agollit e të shumë shkrimtarëve të tjerë në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi e në diasporë).

Dialektizmat e krahinorizmat në një tekst letrar përfshihen për qëllime stilistike. Ato shpesh i përdorin shkrimtarët për tipizimin e gjuhës së personazheve dhe për karakterizimin e mjedisëve përkatës në veprat letrare. Funkcionet që marrin krahinorizmat janë jo të pakta: për përshkrimin e peizazhit të fshatit ose të qyteteve të tjera, për riprodhimin e mjedisit, jetës familjare, për individualizimin ose tipizimin e personazhit (sepse shkrimtari e lidh personazhin për një të folme a krahinë, për një grup shoqëror, profesional ose kulturor) si dhe për efekte lirike a komike. Në prozën e Mitrush Kutelit, p.sh. krahinorizmat janë përdorë për të arritur efekte të dyskajshme: si shfaqje e një gjuhe pa prestigj, inferiore që pasqyron mungesën e zhvillimit, për të dhënë humor e satirë, dhe në skajin tjetër, për të shprehur dinjitetin e jetës popullore, të banorëve të lashtë, të vlerave folklorike e burimore.

Me ngulitjen e normës së gjuhës standarde, krahinorizmat bëhen identifikues të përkatësisë territoriale të folësit e personazhit, evokojnë veçantinë e kulturës materiale e shpirtërore të tyre.

Profesori ynë i nderuar analizon krahinorizmat në veprat letrare të disa shkrimtarëve që kanë krijuar në gjuhën letrare, si Mitrush Kuteli, Shefqet Musaraj, Jakov Xoxa e Dhimitër Shuteriqi si dhe të disa shkrimtarëve që kanë vepra me bazë dialektore, veçmas poezinë e Enver Gjerqekut.

Kontribut të madh mjeshtri i fjalës shqipe ka dhënë edhe në studimin e shkallës dhe të mënyrës së pasqyrimin të dialektizmave dhe të krahinorizmave në fjalorët shpjegues normativë të shqipes, në përcaktimin e parimeve të përgjithshme të përfshirjes së tyre në këta fjalorë, në vlerësimet shkencore për fjalorët e deritashëm krahinorë si dhe në përfaqësimin e dialektizmave e të krahinorizmave në fjalorët dygjuhësh shqip – gjuhë e huaj ose anasjelltas.

Si leksikolog dhe leksikograf më i njohur shqiptar, me një përgatitje të jashtëzakonshme teorike dhe me përvojën e madhe praktike, ka arritur të na japë zgjidhje konkrete leksikografike. Ndërveprimi gjuhë shqipe – dialekt – gjuhë standarde, veçmas në fushën leksikore, përbëjnë një nga problemet më kryesore e nga më të vështirat. Çdokush që do të vë detyrë vetes të hartojë ndonjë fjalor krahinor, fjalor shpjegues normativ ose fjalor dygjuhësh shqip – gjuhë e huaj apo anasjelltas vështirë se do të bëjë një punë të suksesshme pa konsultuar me vëmendje prurjet praktike e shkencore të akademik Jani Thomait.

Akademik Thomai shpreh bindshëm disa nga veçoritë themelore të normës letrare në leksik:^{xxiii}

a) Veçori e përgjithshme e normës letrare në leksik, në krahasim edhe me atë të nënsistemeve të tjera, është, siç dihet, gjerësia relative e veprimit të saj, që lejon praninë e dysorëve e madje të vargjeve normative, ku bëjnë pjesë, si gjymtyrë të barasvlershme, edhe fjalë dialektore a me burim dialektor. Dysorë e vargje të tilla, si: *fshat – katund – hap – çel, kokë – krye, udhë – rrugë, shpinë – kurriz, i shkathët – zhdërvjellët, gjel – këndes – kokosh, vajzë – çupë*

– *cucë* etj., fjalorët shpjegues të shqipes i japin si të rrafshit normativ, duke vënë, pa dyshim, në vendin e parë njërën fjalë, dominanten, që është më e përgjithshme, më asnjëse, më e zhvilluar semantikisht, më e ngulitur në përdorim.

b) Si veçori e dytë e normës leksikore mund të përcaktohet perspektiva e saj e hapur, lëvizja dhe zhvillimi dinamik i pandërprerë, ndryshe nga sistemi fonetik ose struktura morfologjike, që, pas një precipitimi normativ, stabilizohen, fiksohen, duke pakësuar vazhdimisht variantet e dysorët, ndërkohë që në sistemin leksikor variantet nuk pakësohen, madje edhe mund të shtohen, pasi gjuha letrare kërkon një leksik të pasur, të larmishëm, me shumë sinonime.

c) Veçori tjetër e normës letrare në leksik është përshtatja me kërkesat e stileve në një shkallë më të gjerë se mjetet e nënsistemeve të tjera (më afër qëndron sintaksa). Kjo lejon që edhe në fjalorin shpjegues kombëtar leksiku dialektor të zërë vend më të gjerë, shumë herë jo si normë e përgjithshme, por me vlera stilistike të veçanta dhe me prirjen drejt ngulitjes si normë stilistike. Kalimi nga norma stilistike te norma e përgjithshme letrare është njëra rrugë që i çon edhe i rrënjos shumë fjalë dialektore në fondet leksikore të gjuhës letrare.

Babai i fjalës shqipe bën edhe një analizë statistike të njësive leksiko-semantike krahinore në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” me përfundimin se “sasia e fjalëve dhe e kuptimeve të karakterizuara si krahinore në FGjSSh nuk është e madhe. Për një fjalor shpjegues kombëtar të shqipes së sotme, të tipit të mesëm, me karakter normativ, por edhe synime informuese, kjo sasi mund të ishte edhe më e madhe, gjë që do t’i shërbente edhe më mirë sistemit leksikor e stilistik të gjuhës letrare. Fjalët e kuptimet krahinore u takojnë të folmeve të ndryshme të shqipes, të Veriut e të Jugut, përfshirë edhe të folmet arbëreshe.”^{xxiv}

Shkencëtari ynë me të drejtë e konsideron si të dobishme vazhdimin dhe intensifikimin e gjurmimit, mbledhjes dhe të studimit të leksikut dialektor e krahinor të shqipes

“Fjala shqipe - thotë profesori - është një nga krijesat e pavdekshme të popullit, e cila, duke kapërcyer shekujt, ka hyrë në kohën tonë më e pastër e më e fuqishme, sepse në të krijuesi i madh popull ka vënë dorën e dashurinë e vet. Gjuhëtari e gjurmoi me ngulm dhe ia zbuloi vlerat, shkrimtari e lëmoi dhe e zbukuroi, poeti e futi në këngë dhe ia shtoi forcën. Në fjalën shqipe ka hyrë e ngjeshur tërë jeta shumëshekullore e popullit tonë të lashtë e luftarak, kultura e tij e gjerë dhe e ruajtur mirë, një histori e lavdishme plot beteja. Tek ajo janë kthyer përherë sytë e brezave e kanë gjetur armë të fuqishme për mbrojtjen e njëjtësisë së vet si popull e komb.

Shkencëtari i fjalës të shqipes edhe pse u jep përgjigje të merituar shumë çështjeve, ai përsëri lë të hapura disa probleme që duhet zgjidhur në të ardhmen. Shtresa leksikore e dialektizmave dhe e krahinorizmave, ose leksiku dialektor e krahinor, përbën një fushë të gjerë e të ndërlikuar në sistemin e gjuhës kombëtare dhe një çështje të vështirë për studimet gjuhësore.^{xxv} Megjithatë, leksikologu ynë arrin që edhe këtyre çështjeve të ndërlikuara t’u japë përgjigje shkencore. “Që tek emërtimet e përdorura deri më sot për këtë shtresë fjalësh, si “lokalizma, regjionalizma, idiomatizma” dhe “dialektizma” - fjalë dialektore e “krahinorizma” - fjalë krahinore, së bashku me konceptet që përfaqësojnë, shfaqen paqartësi ose qëndrime të

ndryshme, që është edhe shprehje e një gjendjeje të paarrirë studimi”. Leksikografi ynë i njohur me këtë studim çon përpara përkufizimet dhe saktësimet e koncepteve dhe termeve “dialektizëm” e “krahinorizëm” si dhe sjell një fond shumë të pasur fjalësh dialektore e krahinore.

“Njohja e lëndës dialektore është ende e pamjaftueshme dhe jo e thelluar, megjithë punën e madhe që është bërë për grumbullimin e mbledhjen e saj; pra punimi pasqyron shkallën e sotme të njohjes së leksikut dialektor a krahinor... Do të duhen gjurmime të veçanta për çdo fjalë, që i zbulon kufijtë e shtrirjes së saj (edhe sipas kuptimeve që ka), për të thënë pastaj një mendim më të sigurt. Kjo ndjekje deri në fund e izoglosave, që është detyrë e Atlasit dialektologjik”^{xxvi}, tani më u përmbush.

“Veç njohjes së pamjaftueshme të lëndës, vështirësi krijohen edhe për shkak të zbrazëtive të mëdha në studimin e leksikut dialektor e krahinor, qoftë të karakterit dialektologjik e historiko-gjuhësor, qoftë të karakterit leksikologjik. Pa mohuar arritjet e shënuara, që përmenden në këtë punim, - shprehet Thomai, - duhet thënë që vetë karakteri i ndërlikuar i problemeve, të cilat lidhen me leksikun dialektor e krahinor, hap shtigje për interpretime të ndryshme, për pohime a mohime të diskutueshme, në gjuhësinë tonë e në gjuhësi të tjera.”^{xxvii} Në monografitë dialektore vëmendje më e madhe i kushtohet përshkrimit të veçorive fonetike-fonologjike e morfologjike, ndërsa përciptas përshkruhet leksiku i të folmes, duke hartuar rëndom një fjalor të varfër, ndërsa fusha sintaksore pothuajse mungon fare.

Për studimet e mëtejme lë hapur shumë shtigje të reja kërkimi, duke thënë se “Dëshirojmë që këto e çështje të tjera, që lidhen me leksikun dialektor, të bëhen objekt studimesh më të hapëta e më të thelluara.”^{xxviii}

Monografia “Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme” është literaturë e patjetërsueshme për të gjithë leksikografët, leksikologët, dialektologët dhe albanologët në përgjithësi, sepse vepra ka vlerë të shumanshme dhe hap horizonte të reja për gjuhën kombëtare në përgjithësi, duke vështtruar në rrafshin leksikor marrëdhëniet dialekt – krijimtari popullorë – krijimtari letrarë – shqipe standarde - planifikim të shqipes.

“Fjalës shqipe i janë përkushtuar breza të tërë luftëtarësh e atdhetarësh, dijetarësh e dashamirësish të gjuhës amtare. Gjuha shqipe ka heronjtë e dëshmorët e vet. Nuk ka vepër shkrimtari të mirë, - thotë profesori, - që të mos ketë nxjerrë në dritë një numër fjalësh e shprehjesh të rralla e me vlerë të burimit popullor. Leksiku shqip dialektor është në bërthamën e leksikut popullor.

Gjurmimi, mbledhja e studimi i fjalës shqipe me kohë është kthyer në detyrë jo vetëm shkencore, por edhe atdhetare...”^{xxix}

Këtë veprimtari shkencore dhe atdhetare të gjurmimit, mbledhjes, regjistrimit dhe të studimit të fjalës e të frazeologjisë shqipe po e bën si rrallëkush heroi i gjuhës shqipe, akademik Jani Thomai.

Dr. NORA MALAJ, Tiranë

Prof. dr. VEHBİ BEXHTI, Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë, Maqedoni

FJALORI FRAZEOLOGJIK I AKADEMIK JANI THOMAI - PJESË E NDRYSHIMEVE SOCIOLOGJISTIKE NË PËRDITSHMËRINË E KOMUNIKIMIT

Të nderuar pjesëmarrës të këtij simpoziumi,

Më lejoni të falenderoj organizatorët e kësaj konferencë dhe nëpërmjet kësaj kumtese të shpreh mirënjohjen më të thellë për akademik, prof. Jani Thomain dhe për të gjithë kontributin e tij në fushën e frazeologjisë.

1.Frazeologjia si koncept dhe roli i saj në ligjërimin e përditshëm

Frazeologjia është njëra nga katër disiplinat e njohura të fushës së leksikologjisë. Ajo ka për bazë të studimit idiomat, njësitë dhe bashkimet frazeologjike në një gjuhët caktuar. Pra, ato mund të vështrohen në disa rrafshë: në rrafshin sinkronik dhe diakronik, në një gjuhë të vetme ose në disa gjuhë ku synohet të vihen në dukje pikëpërkimet dhe pikëdallimet në mes tyre. Gjuha shqipe është shumë e pasur me frazeologjizma, me të gjitha tipat e njohura. Ajo është mbledhur dhe shpjeguar teorikisht mjaft mirë edhe në gjuhën tonë. Për këtë disiplinë gjuhësore ne sot kemi disa dhjetëra studime, artikuj e madje edhe monografi në gjuhën shqipe.

Sipas “Fjalorit të Gjuhës së Sotme Shqipe” të vitit 1980, termin **FRAZEOLOGJI** e gjejmë të përcaktuar në këtë mënyrë: *“Tërësia e togjeve dhe e thënieve, e shprehjeve të qëndrueshme të një gjuhe, të cilat janë të pandashme nga ana leksikore, kanë kuptim tërësor, të njësishtëm, të mëvetësishëm e gjithnjë të figurshëm, riprodhohen në ligjërime si njësi të gatshme dhe kryejnë funksionin e një fjale a të një fjalie të vetme.”*

Është njësia gjuhësore me karakteristike të një gjuhe. Natyrisht kemi të drejtë ta quajmë kështu, pasi ajo që është një prej elementeve më të rëndësishëm që e karakterizon dhe e shquan një gjuhë nga të tjera, është pikërisht frazeologjia. Me të del në pah origjinaliteti dhe veçantia e saj.

Shqiptarët zakonisht thonë: *Mos i fut hundët kudo!, M’u bë zemra mal , Bëj pallë, Dikush thumbit, dikush patkoit, Dushk për gogla, As për peng e as për dorëzon, S’është as i huntit ,as i litarit, E hedh gurin e fsheh dorën, Ia ktheu shpinën (kurrrizin) diku, Ai të çon me pi e të kthen pa pi ujë, Shkoi t ‘i nxjerrë brirët e i la edhe veshët, Nuk i bihet murit me kokë, Nuk lëshon pe, E hëngri kokën e vet, Hoqi të zitë e ullirit, I hedh hi syve, , E mbajti fjalën, E hëngri fjalën, E mori më qafë, E la pa mend në kokë, Iu bë gjaku ujë, Petulla në ujë, Atij/ asaj/ nuk i zihet besë, Ia shkeli rrota bishtin etj..*

Këto njësi a shprehje frazeologjike nuk i përdorin popujt dhe gjuhët e tjera. Madje as ata rreth nesh. Këto janë karakteristike vetëm për gjuhën shqipe. Prandaj në të qëndron veçantia e saj, origjinaliteti.

2. Përkufizimi i mësipërm nxjerr në pah se frazeologjizmat kanë këto elemente:

- 1.Qëndrueshmërinë e fjalëve ose të elementeve përbërëse;
- 2.Pandarshmërinë e elementeve përbërëse;
- 3.Njësueshmërinë tërësore, kuptimore e figurative të elementeve përbërëse;
- 4.Mosndërtimin ose mosformimin e tyre në momentin e ligjërit, meqë janë të gatshme;



5.Bravshësinë e tyre me një fjalë të vetme, nga aspekti kuptimor (kjo fjalë e vetme mund të jetë sinonimike me togun frazeologjik, po jo krejtësisht identike me të), ndërsa nga aspekti gramatikor i tërë togu frazeologjik ka vlerën dhe kuptimin e fjalëve emërtuese (Fjalë emërtuese, sikundër dihet, konsiderohen: emrat, mbiemrat, foljet dhe ndajfoljet), përkatësisht si një gjymtyrë fjalie (si gjymtyrë kryesore ose e dytë e fjalisë); 6.Shumëkuptimësinë tyre, varësisht nga konteksti i përdorimit; etj..

Këto janë ndërtime kryesisht popullore, d.m.th. kanë karakter dialektor. Por një pjesë e madhe e tyre sot kanë gjetur një shtrirje pothuaj në të gjitha treva shqipfolëse.

Kjo njësi gjuhësore është vjelë mjaft mirë nga goja e popullit.

Problemi themelor që shtrihet në teori dhe në praktikën e hartimit të një fjalori frazeologjik është përcaktimi i identitetit të njësisë frazeologjike , sikundër është , në nivelin e leksikut përcaktimi i fjalës. Kjo ngërthen, së pari, veçimin e njësive fraziologjike në variantet e formave të përdorimit të saj, që e paraqesin atë në ligjërim si një njësi frazeologjike.

Në mënyrë letrare për frazeologjinë është dhënë ky përcaktim:

“Frazelogjia nis atje , ku kuptimi leksikor i fjalës mbulohet nga kuptimi i figurshëm i togfjalëshit të qendrueshëm”.

Në qasjen që mund t’i bëjmë “Fjalori Frazelogjik i gjuhës shqipe” të Jani Thomaj, ai është i pari i këtij lloji në historinë e leksikografisë shqiptare, si nga tipi, vëllimi dhe lënda që përfshin, ashtu edhe nga konceptimi, parimet dhe kriteret e zbatuara për trajtimin dhe pasqyrimin e frazeologjisë në fjalor.

3. Rëndësia e fjalorit dhe impakti i saj

Në pjesën e parë me titull “Frazeologjia e gjuhës shqipe” trajtohen disa çështje teorike dhe kanë të bëjnë me identitetin e njësive frazeologjike, me sinoniminë në frazeologji dhe me modelimin e tyre, me gjymtyrët organizuese të njësive frazeologjike, ndërsa në pjesën e dytë me titull “Trajtimi leksikografik i frazeologjisë”, jepen parimet e hartimit të fjalorit”

Rëndësia e fjalorit qëndron jo vetëm se ka vlerat teorike, por edhe ato praktike,- do të shprehen studiuesesit. U shërben studimeve të ardhshme, studiuesve të gjuhës shqipe, si dhe vlen për studime të mëtejshme. U shërben edhe mësuesve edhe gazetarëve, për t’u njohur më mirë dhe më drejtë. Sipas tij, nëpërmjet frazeologjisë informacioni është më tërheqës dhe më i saktë.

Ky fjalor shërben në mënyrë të veçantë për të zëvendësuar fjalët e huaja të panevojshme, me fjalë shqipe, të cilat kanë edhe një shprehësi më të madhe. Me hapjen e Shqipërisë, është e kuptueshme që edhe gjuha shqipe, u vu përballë gjuhëve të huaja, sidomos, italishtes (kufitare) dhe anglishtes (ndërkombëtare). Hyrja e këtyre fjalëve ishte shumë e madhe dhe kjo ndodhi në mënyrë të pakontrolluar, pikërisht atëherë, kur shqipja s’kishte nevojë për to. Por ka edhe kufizime, pasi jo të gjitha fushat e veprimtarisë gjuhësore u rrezikuan nga fjalët e huaja, përmendim këtu letërsinë artistike. Problemi shtrohet në fushën e përgjithshme, për ligjërimin politiko-shoqëror dhe publicistikën. Në mënyrë të veçantë në këto fusha ndeshemi me fjalë të huaja të panevojshme. Kjo terminologji ka hyrë për shumë arsye, ndër të tjera edhe për një përshtypje të gabuar dhe një tendencë të shfaqur nga disa politikanë, shtetarë, deputetë, publicistë, që duan të tregojnë një nivel të lartë kulture, duke përdorur fjalë në gjuhë të huaj. Njëherazi ky problem i këtyre ligjëtimeve ndodh edhe për shkak të padijes ose mosnjohjes së fjalëve shqipe. Futja e këtyre fjalëve pa kriter është një dukuri e dëmshme, pasi është një “ndotje” për gjuhën. Por kur flasim për rrezikun, nuk kemi parasysh vetëm leksikun. Publicistika dhe media duhet të jenë më të kujdesshme lidhur me fjalët e huaja të panevojshme.. Gjithashtu edhe në media, por edhe në këtë fushë, shpesh s’mund t’i vihet faj gazetarit, pasi ai e ka për detyrë të shkruajë fjalime nga më të ndryshmet. Gazetarët duhet të jenë më të përgjegjshëm, qoftë edhe kur kanë shumë punë, pasi bashkë me informacionin që ata japin, edukojnë dhe transmetojnë gjuhën. Fjalori u shërben jo vetëm studiuesve, por edhe përkthyesve dhe të gjithë shqipfolësve për të njohur më thellë e më mirë pasurinë e madhe të frazeologjisë shqipe, si dhe për ta përdorur atë, drejtë e saktë në ligjërimin e shkruar e të folur.

Ai ka vlera për publicistët, gazetarët, punonjësit e medias së shkruar e elektronike, të cilët duhet jo vetëm ta njohin këtë pasuri të madhe gjuhësore, por edhe ta përdorin atë me vend për ta bërë gjuhën e informacionit që i japin publikut, sa më shprehëse dhe emocionuese.

4. Vlerat teorike dhe praktike të fjalorit. Ky fjalor ka vlera teorike dhe praktike. U shërben studimeve të ardhshme, studiuesve të gjuhës shqipe, si dhe vlen për studime të mëtejshme. U shërben edhe mësuesve edhe gazetarëve, për t’u njohur më mirë dhe më drejtë, thotë Samara. Sipas tij, nëpërmjet frazeologjisë informacioni është më tërheqës dhe më i saktë. Publicistika dhe media luajnë një rol të rëndësishëm në përcjelljen e gjuhës, prandaj lidhur me fjalët e huaja të panevojshme, publicistika dhe media duhet të vënë më shumë dorë mbi këto gjëra, duke treguar një kujdes të madh edhe në rastet kur u mungon koha dhe kur kanë më shumë punë, pasi bashkë me informacionin që ata japin, edukojnë dhe transmetojnë gjuhën. Shqipja flitet sot nga më se gjashtë milionë vetë në Republikën e Shqipërisë, në Kosovë, në viset shqiptare të Maqedonisë, të Malit të Zi, të Serbisë jugore, si dhe në viset e Çamerisë në Greqi. Shqipja flitet gjithashtu, në ngulimet shqiptare në Itali, në Greqi, në Bullgari, në Ukrainë, si dhe

ndër shqiptarë të mërguar në viset e ndryshme të botës para Luftës së Dytë Botërore dhe në këtë dhjetëvjeçar in e fundit. Gjuha shqipe mësohet dhe studiohet në disa universitete dhe qendra albanologjike në bote, si në Paris, Romë, Napoli, Kozencë, Palermo, Shën Pjetërburg (Leningrad), Pekin, München, Bukuresht, Selanik, Sofie, etj.

5. Fjalori dhe takimet me gjuhët e tjera

Edhe pse shqipja ka pranuar huazime nga fqinjët, po ashtu tregon jashtëzakonisht disa dëshmi të kontaktit me greqishten e lashtë; Si e tillë është gegërisht mokën (toskërisht mokër), nga greqishtja mekhane'. Kontaktet e afërta me romakët japin shumë huazime latine - mik nga latinishtja amicus, këndoj nga cantare. Përveç kësaj, huazimet e tilla të fjalëve në shqip vërtetohen nga ngjashmëritë në zhvillimin e latinishtes së folur në Ballkan dhe Rumani, një gjuhë e romantizmit ballkanik. Për shembull, latinisht paludem u kthye në padulem dhe pastaj padure në Rumani dhe pastaj pyll në shqip, të dyja me kuptim të modifikuar. Anasjelltas, rumanishtja po ashtu i ndan disa terma vendorë jo-latinishte me shqipen—p.sh. rumanisht brad, shqip bredh. Andaj këto dy gjuhë reflektojnë kontakte të veçanta historike të kohëve të hershme. Komunikimet e hershme me barbarët me sa duket kontribuan për fjalën "tirq" (nga bashkimi i vjetër "thigh-breech), përderisa huazimet me kontaktet e hershme sllave mund të atribuojnë në kontaktet kulturore gjatë 500 viteve të kaluara me venedikasit, osmanët, grekët (deri në jug), dhe sllavët (deri në lindje). Shqipja apo forma e saj e hershme, shumë lehtë mund të jetë burimi për të zberthyer mënyrën e ndërtimit të gjuhës së pare universale para çarjeve të medha dialektore dhe me vone shndërrimit të tyre në gjuhë të veçanta. Studimi i tipareve të tilla regjionale në Ballkan është bërë një rast klasik për hulumtimin mbi fenomenin e përhapjes së gjuhës. Ajo ka rrjedhur qysh nga arbërit, është zhvilluar dhe pasuruar ndër shekuj, duke u mburrur me fjalët dhe shprehjet më të bukura të popullit dhe njerëzve më të shquar të penës së kombit tonë. E, në këtë rrjedhë të furishme, nuk ka mënuar "të huazojë" edhe gjëra të spikatura nga simotrat e saj, fjalë e shprehje të bukura që, me kalimin e kohës, nuk e ndiejnë veten keq në "shtratin" e lumit të shqipes, shprehet prof. dr. Ali Jashari, autor i fjalorit të parë të shprehjeve të huazuara në gjuhën shqipe "Ndër ato që kanë gjetur vend fort bukur në mjedisin tonë gjuhësor dhe kulturor janë edhe kalket, huazimet frazeologjike, fjalët e urta dhe proverbat, si dhe thënie të njerëzve të shquar (që do t'i përmbledhim nën termin "shprehje të huazuara"), të cilat, shpesh, duke kaluar nga një gjuhë në tjetrën, kanë mbetur anonime. Duke studiuar këtë realitet gjuhësor, shprehjet e huazuara nuk duhet të vështrohen si "mish i huaj" në trupin e shqipes, por pjesë e saj si gjuhë kulture", - shprehet autori Jashari. Për të realizuar fjalorin janë shfrytëzuar arritjet e leksikografisë shqiptare, studimet në fushën e frazeologjisë shqipe, si dhe traditën e gjuhësisë së huaj në hartimin e fjalorëve me kalke dhe huazime frazeologjike.

6. Këndvështrimi socio-linguistik dhe risitë e komunikimit

Në jetën e përditshme, Fjalori Frazeologjik është një botim shumë i rëndësishëm, që në rrafshin socio-linguistik e shtrinë raportin e kohës me gjuhën dhe shoqërinë. Kjo të krijon mundësinë e parjes së raporteve gjuhë-shoqëri, sipas kategorive gjuhësore globale, si p.sh. "gjuha x apo dialekti y", ose antare e veçante e "bashkësisë Z".

Nuk ekzistojnë kufijtë në mënyrat me të cilat njerëzit lidhen me njëri-tjetrin për motive vetidentifikimi, sigurimi, fitimi, argëtimi, besimi fetar apo çdo lloj qëllimi tjetër të përbashkët. Si

rrjedhojë, nuk ekzistojnë kufij në sasinë dhe në varietetin e bashkësive gjuhësore ,që mund të individualizohen në shoqëri.

Ky fjalor vjen si një risi gjuhësore, për të parë sesi kanë lulëzuar shprehjet fraziologjike, si janë konservuar dhe kanë ardhur në kohët e sotme. Nëpërmjet këtij fjalori, të hartuar sipas kriterëve dhe standarteve që përdoren për hartimin e këtij fjalori, janë gërshetimet teorike me kërkesat për zgjidhjet praktike. Ky fjalor përveçse rëndësisë së vlerave gjuhësore, më shumë se fjalët, mbart treguesit e psikologjisë së mendësisë së popullit, të historisë dhe të kulturës. Duke e parë këtë fjalor në optikë sociale, del në radhë të parë , problemi i lëvizshmërisë (zhvendosjes) gjeografike: njërëzit zhvendosen nga një vend në tjetrin, duke sjëll me vete dialektet e tyre, ndonëse me kalimin e kohës , i modifikojnë ato për t'ia përshatur mjedisit të ri. Vendosija e thjeshtë e folësit në një hartë gjeografike mund të krijojë një model pak a shumë të çrregullt, sipas lëvizshmërisë së popullsisë.

Së dytit, gjeografia është vetëm një nga faktorët që ka lidhje me çështjen në fjalë. Faktor të tjerë janë klasa shoqërore, gjinia, mosha.

Së treti, nëpërmjet këtij fjalori , shfaqen rrafshet e kulturës së gjuhës shqipe. Nëpërmet këtyre shprehjeve frazeologjike, të lejon të vëzhgosh sjellen natyrale të njerëzve, së fundi, nëpërmjet antropoligjisë së gjuhës, ajo të lejon që të krijosh dhe të vlerësosh ADN e gjuhës shqipe.

Gjuha e një shoqërie është një aspekt i kulturës së saj, raporti i gjuhës me kulturën, është ai i pjesës me të tërën.

Këtë kontribut jep edhe ky fjalor në ligjërimin e së përditshmes.

Prof. as. dr. VEHBI KADRIU
Universiteti i Shkupit

RRETH PIKËPAMJEVE DHE QËNDRIMEVE TË AKADEMIK JANI THOMAIT PËR FRAZELOGJINË E GJUHËS SHQIPE

Ka qenë pikërisht fusha e interesimeve të mia për frazeologjinë që më ka takuar së pari dhe për së afërmi me prof. Janin, ose më mirë të them ka qenë shtegu për të hyrë në botën e studimeve gjuhësore të tij dhe për të mos dalë kurrë prej saj. Ndonëse veprimtaria studimore e akademik Jani Thomait shtrihet edhe në lëmenj të tjerë të kërkimeve e interesimeve gjuhësore, mendoj se ajo ka zënë fill e është ngjizur në radhë të parë në gurrën e leksikut e të frazeologjisë shqipe.

Në qoftë se ndiqet tipologjia e pikëpamjeve dhe qëndrimeve të tij në fushën e studimeve gjuhësore, po sidomos të shkrimeve e botimeve leksikore e frazeologjike, do të vërejmë se ato i shquan në radhë të parë mbështetja e gjerë lëndore, koherenca e mendimit dhe e shprehjes gjuhësore, përvijimi metodologjik e shkencor, zgjerimi dhe thellimi i natyrshëm dhe logjik, shfrytëzimi i përvojave bashkëkohore të mendimit shkencor të përbotshëm, vazhdimësia e zhvillimit të traditës së trashëguar të arritjeve në gjuhësinë tonë etj. Të gjitha këto që përmendëm në funksion prijatar kanë pikërisht njohjen e thellë e të gjerë të pasurisë së pashtershme të gjuhës shqipe, jo vetëm të bazës letrare e standarde, por edhe mbarëpopullore. Këtu mbase duhet kërkuar edhe qëndrueshmëria dhe vlera emblematike e mendimit të tij shkencor, sidomos në fushë të leksikologjisë e të frazeologjisë shqipe.

Fushëveprimi i gjerë i fjalëve dhe i frazeologjizmave, vlerat kuptimore dhe përdorimore, funksionet shprehëse dhe stilistike të tyre, si duket kanë qenë shqetësimi i tij i përhershëm si gjuhëtar e veprimtar i palodhur. Mbi këtë bazë, ne mund të themi me plot gojën se këto fusha përbëjnë veprën e tij jetësore, ndihmesën kapitale pa të cilën nuk mund të mendohen këto dy sfera të gjuhësisë së sotme shqiptare. Studimet leksikore-frazeologjike shqiptare bashkëkohore i detyrohen aq shumë veprimtarisë gjuhësore dhe botimeve shumëpërmasore të akad. Jani Thomait, saqë ne sot jo vetëm që mburremi dhe jemi shumë të privilegjuar që e kemi në radhët tona, por ky klasik i gjallë e i denjë i gjuhësisë sonë bashkëkohore mund të na përfaqësojë mirëfilli edhe në botën e studimeve gjuhësore, si brenda rajonit, ashtu edhe më gjerë.

Studiuesi i zellshëm Jani Thomai sot shënon një nga figurat më të shquara e më të rëndësishme të gjuhësisë shqiptare bashkëkohore që me veprën e vet të shtrirë në disa fusha të mendimit teorik e të zbatimit praktik të ideve e të pikëpamjeve gjuhësore ka bërë emër dhe famë të madhe. Gjuhësia shqiptare atij i detyrohet për shumëçka, sidomos për veprat madhore në fushë të leksikologjisë, frazeologjisë e semasiologjisë. Deri më tani nga dora e tij dolën më se 20 vepra rëndësiplota në fushë të teorisë e të praktikës gjuhësore. Nuk e themi këtë për të vënë në pah veprën e tij si sasi, po përkundrazi për të theksuar anën cilësore. Me veprat e akademik Jani Thomait dhe të kolegëve të tij pararendës e bashkëkohës gjuhësia shqiptare hodhi bazat e mirëfillta shkencore dhe dalëngadalë filloi të bëhet konkurrenente me arritjet e veta në fusha të

ndryshme të studimeve gjuhësore. Është puna vetëmohuese e akad. Janit me shokë që gjuhësia shqiptare sot të ketë fjalorin normativ të gjuhës shqipe, të ketë fjalorin frazeologjik të gjuhës shqipe, fjalorin sinonimik dhe shumë vepra të tjera bazike për gjuhën e për kulturën tonë.



Me gjithë ndihmesën e madhe që ka dhënë në trajtimin e temave dhe çështjeve të ndryshme në shumë fusha të gjuhësisë sonë, kryevepra e punës dhe angazhimeve studimore të akad. Jani Thomait ka qenë dhe mbetet leksikologjia dhe frazeologjia e gjuhës shqipe. Kështu që ai me të drejtë në panteonin e gjuhësisë sonë bashkëkohore i ka siguruar vetes një vend të rëndësishëm si leksikolog e frazeolog i përkushtuar.

Me këtë rast do të rrekemi të nxjerrim në pah shkurtimisht disa nga pikëpamjet dhe qëndrimet që e shquajnë mendimin shkencor të Jani Thomait lidhur me frazeologjinë e gjuhës shqipe. Edhe pse është e vështirë të ndash frazeologun nga leksikologu e nga gjuhëtari, megjithatë do të përpiqemi të sheshojmë vetëm disa nga të veçantat që e shquajnë figurën e tij si frazeolog.

Pikëpamjet dhe qëndrimet e akad. Janit sa u përket çështjeve që lidhen me shumë anë të njësive frazeologjike të gjuhës shqipe pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur në veprën monografike "Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe", të botuar në vitin 1981. Më vonë ato do

të rimerren e do të përditësohen në studimin “Frazeologjia e gjuhës shqipe” dhe “Trajtimi leksikografik i frazeologjisë” që vihen në ballë të “Fjalorit frazeologjik të gjuhës shqipe”, të botuar në vitin 1999 në Tiranë.

Ky studiues i zoti dhe i palodhshëm, në mbështetje të metodologjisë shkencore dhe të arritjeve e përvojave bashkëkohore që kanë shënuar studimet frazeologjike në përgjithësi, po sidomos nga njohja e gjerë dhe e drejtpërdrejtë e lëndës frazeologjike të gjuhës shqipe, ka arritur të japë shpjegime të pakundërshtueshme dhe të nxjerrë përfundime e përgjithësime të qëndrueshme për veçoritë thelbësore të togfjalëshave frazeologjike të gjuhës shqipe. Që nga përpjekjet e tij të para për studimin e frazeologjisë, prof. Jani Thomai shtroi para vetes si detyrë vendosjen e kornizave studimore shkencore për frazeologjinë shqipe. Këta objektiva ai i përmbledhi në studimin monografik “Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe”, ku ai shpjegon arsyet dhe synimet që e kanë shtyrë t’i hyjë shtjellimit të frazeologjisë si kategori e veçantë gjuhësore. Në përgjithësi këto angazhime kanë të bëjnë me dallimin e njësisë frazeologjike nga njësitë gjuhësore të afërta me të, pra të bëhet identifikimi i frazeologjizmave si njësi gjuhësore të dallueshme nga fjala dhe fjalia, pastaj me përcaktimin dhe përshkrimin e sistemit e të strukturës frazeologjike me të gjitha veçoritë gjuhësore, semantike, stilistike, shprehëse-emocionale etj., të tipareve e të dukurive e veçanta gjuhësore të njësive frazeologjike në përgjithësi, ose madje të ndiqet historia e të zbulohet formimi idiomatik i njësive frazeologjike të shqipes, kategorizimi, klasifikimi, lidhjet sistimore me njësitë e tjera si dhe të ndriçohen sa më shumë veçoritë e mëvetësishme të frazeologjisë shqipe, të formimit e të përdorimit etj.

Në kohën kur i hyri punës kërkimore dhe përsiatjeve lidhur me çështjet e leksikut e të frazeologjisë shqipe, në këtë fushë të studimeve gjuhësore shqiptare ai gjeti një gjendje rishtare dhe shumë pak të lëvruar, kurse në sferën e interesimit teorik dhe të arritjeve të trashëguara nga gjuhësia e përbotshme nuk kishte pikëpamje e qëndrime të njësuar e të qëndrueshme rreth problematikës në fjalë. Ndonëse me një përvojë jo aq të madhe në studimet gjuhësore, me monografinë “Çështje të frazeologjisë shqipe” (1981), të parën e këtij lloji në gjuhësinë tonë, studiuesi i shquar Jani Thomai do të vendosë bazat dhe do të përvijojë orientimet e studimeve të ardhshme në fushë të frazeologjisë në përgjithësi. Interpretimet, përgjithësimet dhe mendimet e shprehura rreth çështjeve mjaft të ndërlikuara e të larmishme të identifikimit, kufijve, modeleve, klasifikimit, funksioneve dhe të përdorimit e standardizimit të njësive frazeologjike mbeten edhe më tej pika referimi për studimet e mëtejshme frazeologjike.

Pikëpamjet, qëndrimet dhe interesimet e tij kanë të bëjnë në radhë të parë me frazeologjinë gjuhësore si kërkesë e zhvillimeve të mendimit teorik e praktik të kohës. Përveç kësaj, vendvendosja e frazeologjisë si disiplinë shkencore përcaktohet në fillim në kuadër të leksikologjisë, ndonëse më vonë (*Parathënia* e Fjalorit frazeologjik) ai përmend dhe përkrah qëndrimin e EURALEX-it se frazeologjia duhet të merret si një degë e veçantë gjuhësore dhe e barabartë me leksikologjinë e degët e tjera. Pikëpamja e këtillë edhe më parë mbrohej nga frazeologë të ndryshëm, por në kohë të fundit sikur është bërë qëndrim mbizotërues përcaktimi i frazeologjisë si një degë e veçantë e gjuhësisë që ka objektin e vet studimor, njësinë bazë dhe treguesit e tjerë të nevojshëm.

Një çështje tjetër që ka zënë vend qendror në qëndrimet e pikëpamjet gjuhësore në përgjithësi dhe në ato leksikore-frazeologjike në veçanti të studiuesit J. Thomai, është pikërisht përpjekja dhe mëtimi i përhershëm për normëzimin, për ngritjen në rrafshin e përgjithshëm të përdorimit gjuhësor të njësive frazeologjike dhe për pasurimin e shqipes standarde me vlerat dhe funksionet e shumta të tyre në rrafshin shënues dhe shprehës gjuhësor. Kurorë e gjitha këtyre gjakimeve dhe synimeve studimore teorike dhe praktike është vepra madhore “Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe” (1999), ku autori jo vetëm që shpërfaq pikëpamjet dhe qëndrimet e tij teorike, por ato edhe i zbaton dhe i funksionalizon konkretisht. Në qoftë se në gjuhë të tjera hartimi i fjalorëve të tillë bëhet nga komisione e redaksi me dhjetë e më shumë anëtarë, ne kemi fatin që kjo vepër ka dalë si fryt dhe cak i arritjeve të leksikologut e frazeologut, tashmë dhe frazeografit J.Thomai.

Siç e përmendëm edhe më parë, në parathënien e “Fjalorit frazeologjik të gjuhës shqipe” autori jep platformën e vlerave, arritjeve dhe përvojave të deritanishme që kanë shënuar studimet bashkëkohore në sferën e leksikologjisë e të frazeologjisë. Këtu ai arrin që në mënyrë mjeshtërore të përpunojë e të përshtatë pikëpamjet e qëndrimet e kohës rreth çështjeve të ndryshme të frazeologjisë në përgjithësi, duke i parë nga objektivi i ligjshmërive të funksionimit dhe të zhvillimit të strukturës e të sistemit frazeologjik të gjuhës shqipe. Është kjo një ndërmarrje që mund t’i dalë në krye vetëm një njohës i gjerë e i thellë i problematikës frazeologjike dhe i korpusit të paanë të frazeologjizmave e të njësive simotra a të afërta me to që funksionojnë sot në gjuhën tonë. Gjithmonë duke u nisur nga ajo që e karakterizon së afërmi frazeologjinë gjuhësore shqipe, prof. Jani Thomai ndërton pikëpamjet e veta dhe mban qëndrim të përcaktuar lidhur me dukuri e çështje të ndryshme ende të hapura të sistemit frazeologjik. Duke bërë analizën gjuhësore-strukturore të frazeologjisë, nga ana e tij me të drejtë theksohen tri aspektet themelore të identifikimit e të përkufizimit të njësive frazeologjike, pra **forma**, **kuptimi** a përmbajtja dhe **funksioni** a përdorimi në ligjërim i tyre. Së këtijmi, “njësia frazeologjike është, nga forma, një strukturë e hapur me dy ose më shumë leksema, nga përmbajtja me kuptim të njësuar, tërësor e të figurshëm dhe nga funksioni (ose nga kuptimi kategorial) barasvlerëse e fjalës në rrjedhën e ligjërimit”. (Fj. f. 7)

Edhe njësia frazeologjike pranohet se ka tiparet e një njësie gjuhësore që zhvillohet e funksionon si njësi me vlerë të dyfishtë: **nominative** e **ekspresive** (shënuese e shprehëse), duke e parë me të drejtë këtë të dytën si qëllim dhe më relevante. E përcaktuar si njësi gjuhësore, edhe njësia frazeologjike ka tiparet e veta kategoriale dalluese, siç janë: gjymtyrët përbërëse, kuptimi leksikor dhe kuptimet gramatikore. Ndërkaq, kjo nënvizohet nga ana e autorit me qëllim që të përcaktohen të veçantat e këtyre tipareve në përqasje me fjalën dhe me togfjalëshin, si dy nga njësitë gjuhësore më të afërta ose me të cilat kufizohet drejtpërdrejt frazeologjizmi. Duke marrë për bazë këto premisa, frazeologu J. Thomai paraqet pikëpamjet e veta rreth identitetit dhe kufijve të njësisë frazeologjike sipas metodës së përjashtimit, shumë e njohur dhe e përdorshme në kohën e sotme në studimet gjuhësore. Në këtë mënyrë ai shpërfaq gjithë atë që e karakterizon frazeologjinë nga e ashtuquajtura jofrazeologji, pa harruar edhe disa tipa kalimtarë. Më tutje, identitetin e njësive frazeologjike ai e lidh edhe me disa dukuri të tjera të sistemit frazeologjik,

që lidhen me formën, me përmbajtjen dhe me funksionin e tyre në gjuhë. Krahas këtyre çështjeve themelore, këtu autori trajton e shprehet edhe për sa i përket organizimit strukturor, raporteve të brendshme e të jashtme, mikrokontekstit frazeologjik, formës dhe ndërtimit të njësive frazeologjike, kushtëzimit të variacioneve frazeologjike, prejardhjes frazeologjike, shumëformësisë, sinonimisë, antonimisë e homonimisë frazeologjike, paradigmaticës e sintagmaticës së njësive frazeologjike, parimeve të organizimit gjymtyror (përcaktimi i gjymtyrës vatër të frazeologjizmit), pastaj konceptit të modelit në frazeologji së bashku me kriteret modeluese, vendosjes së normës në frazeologji e shumë probleme e mëdyshje që shoqërojnë studimet e sotme teorike në fushë të frazeologjisë. Këto dhe çështje të tjera që i shtrihen dhe për të cilat jep pikëpamjet dhe qëndrimet e veta mbështeten e arsyetohen me shembuj konkretë dhe sipas ligjshmërive të funksionimit e të zhvillimit të sistemit gjuhësor të shqipes së sotme. Me fjalë të tjera, pikërisht në qasjen dhe orientimin e tillë pragmatik qëndron ndihmesa shumë e madhe e akademik J. Thomait për thellimin, zhvillimin dhe ngritjen në një nivel të lartë të mendimit teorik në rrafshin e studimeve frazeologjike shqiptare dhe për zbatimin praktik të koncepteve të tilla në fushën frazeografike. Të gjitha idetë, pikëpamjet qëndrimet e përvojat e shumta që u përmendën gjejnë zbatim dhe brumosen në mënyrë shumë të suksesshme edhe në lëndën e pasur frazeologjike që përfshihet brenda fjalorit. Ç'është e vërteta konceptimi, përpilimi, drejtimi e redaktimi i fjalorëve është një tjetër specialitet i veçantë ku akademik Jani Thomai e ka dëshmuar veten sa e sa herë.

S'do mend se ndihmesat e akademik Jani Thomait në fushë të frazeologjisë gjuhësore shqiptare janë të shumanshme, të shumëvlershme dhe të përhershme. Ato kanë hapur hulli të reja dhe kanë përvijuar besnikërisht arritjet e sotme në fushë të gjuhësisë shqiptare, natyrisht duke ua lënë të hapur rrugën thellimeve të mëtejshme studimore.

Për studiuesit e ardhshëm që do t'i çojnë më tej studimet frazeologjike e frazeografike mbeten edhe shumë punë, që lidhen drejtpërdrejt me formën, përmbajtjen dhe funksionimin e njësive frazeologjike, me përcaktimin e faktorëve për formësimin semantik të tyre së bashku me procedimet e mënyrat frazeoformuese, me proceset që ndjekin zhvillimet semantike të frazeologjizmave (të cilat kanë për pasojë edhe shpërbërjen e njësive frazeologjike a defrazeologjizimin), pastaj për veçoritë stilistike dhe shndërrimet kontekstuale, prejardhjen e huazimet frazeologjike etj.

Si pikënisje dhe pikëmbështetje e sigurt për këto kërkime e thellime të studimeve frazeologjike do të shërbejnë pa dyshim edhe për shumë kohë pikërisht veprat kapitale gjuhësore të akad. J. Thomait.

Nuk mund të përfundoj fjalën time, pa përmendur edhe një element tjetër shumë të rëndësishëm që më ka lënë mbresa të pashlyeshme që në shkrimet e para që kam lexuar prej tij. Ashtu sikurse çdo krijues në fusha të tjera të veprimtarisë shoqërore, artistike etj., që ka synim parësor ndërtimin dhe zhvillimin e individualitetit të vet krijues dhe shprehës, pra të asaj fizionomie e gjedhe të gërshetimit të elementeve gjuhësore shprehëse që na bën ta njohim për nga stili sapo të kemi lexuar fjalitë e para, po kështu edhe shprehja gjuhësore e akademik Janit Thomait i ka veçantitë e saj që e dallojnë në pikëpamje metalinguistike dhe e shquajnë si një

përdorues i zhdërvjellët, i rafinuar dhe shumë i kujdesshëm i mjeteve gjuhësore. Thurja gjuhësore e tekstit u përmbahet me përkushtim treguesve thelbësorë që e bëjnë atë të jetë i mirëfilltë, i qartë, i ngjeshur, i rrjedhshëm, tërheqës dhe gjithmonë në përshtatje me atë që kumton.

I tillë është profesor Jani edhe kur flet edhe kur shkruan, edhe kur bisedon e këshillohesh me të. Këtë natyrë të personalitetit të tij prej studiuesi e autori veprash të shumta e gjejmë edhe te figura e tij njerëzore shumë e matur, serioze, e pakursyer, e këndshme, korrekte dhe, para së gjithash, e njerëzishme. Janë këto të gjitha cilësi e vlera morale njerëzore karakterizuese, të cilat mund të përmbliidhen shkurt me shprehjen **njeri zotni**, siç thuhet andej nga ne.

Dr. DHORI Q. QIRJAZI
Universiteti “Aristoteli”, Selanik

RRUGË TË ÇELURA E SHTIGJE TË PASHKELURA: I PARI FJALOR FRAZEOLGJIK BALLKANIK, HARTUAR NËN DREJTIMIN E AKAD. JANI THOMAI

I. FFB, frazeologjia komparative dhe gjuhësia ballkanike

Studimet për frazeologjinë, e sidomos frazeologjia komparative, kanë njohur zhvillim të kënaqshëm dhe janë bërë objekt tubimesh ndërkombëtare vetëm gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit (Συμεωνίδης 2000 : 101). Megjithatë, janë ende të rralla përpjekjet për hartim fjalorësh frazeologjikë krahasues të tri a më shumë gjuhëve. Kjo mangësi shpjegohet me faktin se ndërmarrja e veprave të tilla has në vështirësi komplekse, të karakterit teorik e praktik, duke filluar nga përcaktimi i kriterëve të hartimit e deri në gjetjen e stafit shkencërisht të aftë për t’ia dalë mbanë kësaj pune. Parë në këtë aspekt, mund të thuhet se hartuesit e F(jalorit) F(razeologjik) B(allkanik) (Tiranë 1999) patën guximin të çapiten në rrugë të çelura e shtigje të pashkelura e të na japin një vepër të cilën P. Asenova (2002 : 48) e cilëson si “shfaqje pa precedent” (явление без прецедент). Ky vlerësim dashamirës, i bërë në faqet e njërit prej teksteve bazë të gjuhësisë ballkanike të ditëve të sotme, nuk duket i rastit dhe as është fryt i “zemërgjerësisë” me të cilën J. Thomaj kërkon t’i avitemi “këtij guri të parë në frazeografinë ballkanike” (FFB : 9). FFB, me gjithë mangësitë që ka, dëshmon se studimet për frazeologjinë në Ballkan kanë ecur krah për krah me ato të vendeve të tjera evropiane. Madje, fakti që projekti lindi dhe u realizua në Shqipëri tregon për arritjet dhe nivelin e leksikologjisë e të leksikografisë, përkatësisht të frazeologjisë dhe të frazeografisë shqiptare. Ndërkaq, për mendimin tonë, FFB përveçse arritje është edhe një nxitje për diskutim të mëtejshëm të një sërë çështjesh ende të hapura të gjuhësisë ballkanike.

Titulli i veprës dhe shprehja “frazeografi ballkanike”, që cituam më sipër, lënë të kuptohet se hartuesit e saj besojnë në ekzistencën e konkordancave frazeologjike të gjuhëve ballkanike, lindja e të cilave shihet si rezultat i të njëjtave rrethana që çuan në krijimin e Bashkësisë Gjuhësore Ballkanike (BGB). Kjo duket qartë qysh në radhët e para të parathënies së shkruar nga J. Thomai, ku, veç të tjerash, thuhet se “... paralelet frazeologjike në gjuhët e Ballkanit, nga njëra anë, janë dëshmi e afri së tipologjike gjuhësore, me gjithë dallimet e mëdha ndërmjet shqipes, greqishtes e gjuhëve sllave (përfshijtur turqishten); nga ana tjetër, dëshmojnë afritë që u krijuan në bashkëjetesën e gjatë historike, përputhjet në mendësinë e psikologjinë popullore, ngjashmëritë etno-kulturore etj.” (f. 5). Fjalët e sapocituara shtrojnë pashmangërisht nevojën e shkoqitjes së shprehjeve “paralele frazeologjike” dhe “afri tipologjike”; përndryshe pohimi i f. 5, se “në frazeologji kjo afri është llogaritur deri në 400-500 njësi, por e vërteta është se e kalon dhjetëfishin” (nëvizimi yni, Dh.Q.), mbetet pezull dhe vihet në dyshim nga vetë lënda prej 5000 njësisë e FFB, analiza e të cilave tregon se një pjesë e konsiderueshme e tyre nuk paraqet afri tipologjike. Nga parathënia e FFB mësojmë gjithashtu se “Zgjidhjet teorike për këtë fjalor janë formuluar në studime që i kanë paraprirë atij, të cilat sigurojnë sistematikën në makrostrukturën

dhe mikrostrukturën e fjalorit” (f. 6), ndërsa më poshtë lexojmë se është përdorur literaturë shkencore frazeologjike e frazeografike “relativisht e mjaftueshme” (f. 9). Duke qenë se botimi i vitit 1999 nuk e ka përfshirë literaturën e përdorur, mangësi e cila shpresojmë të ndreqet në një botim të ri të FFB, na jepet e drejta të supozojmë se shtrati teorik dhe problematika e përgjithshme kanë qenë përvijuar qysh me shkrimin “Paralleles phraséologiques entre l’ albanais et les autres langues balkaniques” të autorëve Lloshi e Thomai (1966), për t’u pasuruar me botimin e monografisë për frazeologjinë shqipe të J. Thomait (1981), e për t’u kurorëzuar me daljen në dritë të Fjalorit Frazeologjik të Gjuhës Shqipe dhe të FFB (1999). Në artikullin e 1966, ribotuar në shqip më 1972, nga ku edhe citimet, Lloshi e Thomaj rreken të kërkojnë “analogjinë e ndryshueshmërinë jo të frazeologjizmave të veçantë të shqipes në krahasim me gjuhë të tjera të Ballkanit, por të tipave semantiko-strukturorë të tyre” (1972: 224, nënvizimi yni, Dh.Q.). Ata konstatojnë se “shqipja nuk gjen gjithnjë paralele të përgjithshme ballkanike, por gjen konkordanca të pjesshme herë me një gjuhë, herë me një tjetër” (1972 : 230) dhe se frazeologjizmat librorë duan veçuar mirë nga shprehjet frazeologjike të gjuhës së folur (1972 : 232). Pikërisht tek këta të fundit duhen kërkuar frazeologjizmat e përbashkët ballkanikë, të cilët, në masën që ekzistojnë, është mjaft e vështirë të përcaktohen me saktësi (1972 : 227).



Nga sa u cituan më sipër, vlen të theksohet se orientimi kah analogjitë dhe ndryshimet në nivelin e tipave semantiko-strukturorë të njësive frazeologjike është metodologjikisht i drejtë dhe shkencërisht i bazuar. Ai i bën jehonë idesë së formuluar së pari nga Kopitar-i më 1829, se në Ballkan “sundon vetëm një formë gjuhësore, por me tri lloje lënde gjuhësore (nga të cilat njëra është vendëse, ndërsa dy të tjerat kanë ardhur nga perëndimi dhe nga lindja)” (cituar sipas Demiraj 1994 : 15). Të njëjtën ide e gjejmë më pas tek Papahagi (posaçërisht për njësitë frazeologjike, 1908 : 168) e te Sandfeld-i (1930). Duke u nisur nga fakti se njësitë frazeologjike përftohen më së shumti nga ngurtësimi i togfjalëshave të lirë (Demiraj 1994 : 198), pra bartin tiparet strukturore të sintagmave të gjuhëve përkatëse, ato, ndryshe nga huazimet leksikore, mund të karakterizohen si elementë që kontribuojnë në përvijimin e BGB (Schaller-i, 1975 : 172, i cilëson këta elementë si *sprachbundbildende*). Sipas klasifikimit që bën i njëjti autor për bashkëpërkimet e gjuhëve ballkanike në nivel leksikor (Schaller 1975 : 173), kur një njësi frazeologjike haset në tri a më shumë gjuhë ballkanike, kemi të bëjmë me konkordancë të shkallës së parë, ndërsa kur haset vetëm në dy gjuhë, kemi konkordancë të shkallës së dytë. Lidhur me këtë çështje, në parathënien e FFB gjejmë një formulim paksa të ndryshëm: “Thelbi i konceptit ‘ballkanizëm’ nuk është aq numri i gjuhëve, në të cilat gjendet njësia a dukuria gjuhësore, por burimi dhe procesi i ‘ballkanizimit’ të kësaj njësie a dukurie. ... Burimi, koha dhe mënyra e shtrirjes ndër disa gjuhë të Ballkanit duhen vlerësuar si kriterë ekuivalente për të cilësuar një njësi a një dukuri si ‘ballkanizëm’”. (f. 6). Le të shtojmë gjithashtu se, ndërsa ballkanizmat e nënsistemeve të tjera (fonetikë, morfologji, sintaksë) mund të vendohen dhe të numërohen relativisht lehtë, në nivel frazeologjik kjo punë është më e vështirë. Po kështu, të mbahet parasysh se elementet e përbashkëta hasen më tepër në dialekte e më pak në gjuhët standarde/letrare, krijimi i të cilave është karakterizuar shpesh prej prirjesh deballkanizuese (Tzitzilis 2000 : 13).

Nisur nga kompleksiteti dhe vështirësia e veçimit të specifikes së një gjuhe nga ballkanikja, dhe të ballkanikes nga e përgjithshmja (universalja), duke marrë parasysh gjithashtu “raportin dialektik të universales dhe specifikes në gjuhë” (Dobrovol’skij 1988 : 210), mund të themi se, pavarësisht formulimeve teorike të parathënies, FFB në këtë pikë është treguar mjaft i hapur e elastik, sepse, së pari, ka përfshirë gjuhë të cilat nuk konsiderohen pjesëtare të BGB (shih serbokroatishten) dhe, së dyti, u ka lënë hapësirë frazeologjizmave librorë, të cilët hasen edhe në gjuhë të tjera të Evropës e të botës. Është vendi të shënojmë këtu se gjuhësia ballkanike ka bërë prej kohësh dallimin mes *gjuhëve ballkanike* (nisur nga kriteri gjuhësor i pjesëmarrjes në BGB) dhe *gjuhëve të Ballkanit* (nisur nga kriteri gjeografik, d.m.th. i përdorimit të aksh gjuhe në territorin ballkanik, si p.sh. turqishtja) (Schaller 1975 : 29). FFB, pra, ka pasqyruar njësi frazeologjike që hasen edhe në *gjuhët e Ballkanit*, dhe jo aq njësi që hasen vetëm në *gjuhët ballkanike*. Ndërkaq, nuk duhet t’i shpëtojë vëmendjes sonë fakti që është lënë jashtë fjalorit një gjuhë si turqishtja, me kontribut të padiskutueshëm në krijimin e një shtrese leksikore dhe frazeologjike të përbashkët të gjuhëve ballkanike. Gjithashtu, nëse do të ndërmerrej hartimi i një fjalori frazeologjik që do të synonte pasqyrimin e të gjitha gjuhëve të hapësirës ballkanike, dy pjesëtare të tjera të BGB, arumanishtja dhe ciganishtja, do të duhej të zinin vendin që u takon në

këtë vepër. (Sllavomaqedonishtja është lënë jashtë fjalorit, ngaqë, siç shënohet në parathënien e FFB, f. 8, “në frazeologji, si produkt historik, popullor e i lashtë, nuk ka dallime thelbësore të mjaftueshme” mes saj e bullgarishtes, si pjesëtare “të të njëjtit grup gjuhësor sllav”).

Vendosja e frazeologjizmave të shqipes në krye të paradigmës që përmban ekuivalentet e plota a të pjesshme të tyre në bullgarisht, rumanisht, serbokroatisht dhe greqisht jep shkas për të shtruar pyetjen cila prej gjuhëve ballkanike duhej marrë si pikë referimi dhe a është kjo mënyra më e mirë e paraqitjes së lëndës. Paravendosja e shqipes përlligjet nga fakti se ideatori i FFB është specialisti më në zë në fushë të frazeologjisë dhe të frazeografisë së shqipes, por edhe sepse ai dhe pjesëtarët e tjerë të grupit hartues kanë për gjuhë amtare shqipen ose janë njohës të mirë të saj dhe të së paku njërës prej gjuhëve ballkanike. Me të njëjtën logjikë do të mund të vendosej në krye të paradigmës frazeologjike secila prej gjuhëve të tjera ballkanike. Për mendimin tonë, çështja duhet trajtuar në një këndvështrim tjetër. Cilado qoftë gjuha që merret si pikë referimi, ajo, për shkak të mëvetësisë së sistemit të vet frazeologjik, krijon asimetri dhe mangësi në pasqyrimin e shprehjeve frazeologjike të gjuhëve në shqyrtim. FFB ofron shembuj të shumtë asimetrisht të kësaj natyre.

Siç është vërejtur nga studiuesit, “nga pikëpamja semantike, njësitë frazeologjike të një gjuhe të caktuar kanë gjegjëset e tyre në shumicën e gjuhëve të botës. Nga pikëpamja strukturore, d.m.th për sa u përket elementeve leksikore që bëjnë pjesë në to, numri i shprehjeve korresponduese zvogëlohet ndjeshëm” (Tomici 1983 : 236). Prandaj, krahas fjalorit të bazuar mbi kriteret strukturore (siç është FFB) është e nevojshme të hartohet edhe një fjalor frazeologjik tematik apo analogjik, ku të renditen shprehje frazeologjike sinonimike brenda së njëjtës gjuhe (përfshi dhe dialektet / të folmet) dhe ndërmjet gjuhësh të ndryshme. Ideja është të nisemi nga përmbajtja për të arritur te forma; të zëmë fill nga fushat semantike bazë të veprimtarisë njerëzore (lindja, martesë, vdekja, durimi, zemërimi, mburrja, shkathtësia, zgjuarsia, dembelizmi, ngathtësia, zvarritja e punëve etj.) dhe mes “mozaikut” të përfutur të shohim në ç’shikallë konvergojnë dhe në ç’shikallë divergojnë gjuhët ballkanike në nivel frazeologjik, cilat prej tyre ndodhen më afër dhe cilat më larg për sa i përket ‘petkut’ gjuhësor të së njëjtës përmbajtje. Do të konstatojmë p.sh. që sema ‘zvarrit shumë një punë, nuk e mbaron kurrë, as e kryen as e lë’, në greqishten e re realizohet me shprehjen frazeologjike *ράβε ξήλωνε*, që gjen në shqip një ekuivalente të plotë si *qep e shqep*, por edhe sinonime të saj si *hiq e mos këput; shosh e sit e mos gatuaj; tund e mos shkund*, ndërtuar me folje në mënyrën urdhërore si në greqisht ashtu edhe në shqip.

Nga një vështrim i lëndës së FFB arrijmë të kuptojmë sa të koklavitura janë proceset e përfutimit të karakteristikave të përbashkëta në kuadër të specifikes së secilës gjuhe. Sa e vështirë është gjithashtu të kërkohet zanafilla e kësaj apo asaj frazeologjie në këtë apo atë gjuhe. Madje, në pamundësi të gjetjes së burimit, të përdorim termin “izoglosë frazeologjike”, siç propozon Symeonidis (Χιώτη 2010). Po marrim një shembull. Shprehja frazeologjike e gr. re *χάνω τον μούσουλα* dhe gjegjësjë shqipe e saj *humb pusullën* e kanë burimin –e para me gjasë, e dyta me siguri– tek shprehja turke *pusulayı şasırmak* ‘to loose one’s bearings; to be beëildered’, ku fjala *pusula*² rrjedh prej termit italian të detarisë *bussola* (Redhouse 1995). Arsye fonetike çuan në përfutimin e trajtës gr. *μούσουλας* [busulas] (*τον μούσουλα => τον μούσουλα [tobusula]*), gjë e

cila nuk ndodhi edhe në shqip. Nga ana tjetër, greqishtja bizantine kishte huazuar fjalën italiane *bussola* gjatë viteve të mesjetës (Ανδριώτης 1983). E njëjta gjë duhet të ketë ndodhur edhe me fjalën *busull* -a të shqipes, e cila në Fjalorin e Gjuhës Shqipe të vitit 1954 del në trajtën *busolë* – a. Fakti që shqipja letrare ka ruajtur krahas fjalës *busull* edhe huazimin turk. *pusullë* (<pusula¹ ‘note, short letter’) ka çuar në një lidhje të pamotivuar të kësaj me shprehjen *e humbi pusullën*, në të cilën ka gjetur strehë huazimi turk *pusullë* ‘busull’ i shqipes, përndryshe i dalë prej kohësh nga përdorimi dhe i paintegruar në shqipen letrare. Kjo është edhe arsyeja pse shprehja *e humbi pusullën* është pasqyruar bashkë me fjalën *pusullë* ‘copë letre e shkruar shpejt e shpejt’ në Fjalorin e Gjuhës Shqipe të vitit 2006. Duke marrë parasysh se në shqipen e folur haset edhe shprehja *e humbi busullën*, na jepet e drejta të flasim edhe për një huazim direkt të saj prej italishtes *perdere la bussola* (Kahane 1958 : 128) si dhe për një burim indirekt me ndërmjetësinë e turqishtes. Diçka e ngjashme duhet të ketë ndodhur edhe me greqishten. Është me interes të theksohet se, megjithë që shprehja e mësipërme ka (ri)hyrë në shqip e greqisht nëpërmjet turqishtes (Symeonidis 1997, ndërsa sipas Lloshit 1992, shqipja e mori nga greqishtja), ajo u inkadrua brenda një tipi strukturor të caktuar në të dy gjuhët (shih shq. *humb fillin / gjurmët / toruan / busullën / pusullën* dhe gr.re. *χάνω το νήμα / τα ίχνη / τον τορό/ τον μπούσουλα*) çka do të thotë se modeli pat ekzistuar qysh më parë dhe tani u pasurua me një hallkë të re.

Një rast të ngjashëm me atë çka ka ndodhur në shprehjen *humb pusullën* gjejmë edhe në shprehjet e shqipes bisedore [*bëhu*] *def që këtu!* ‘zhduku’ dhe *e bëri def (dikë)* (përçm.) ‘e zhduku, i dha duart’ (Fjalor 2006), si dhe *ντέφι να γίνει* ‘def të bëhet’, që përdoret kur pranojmë një kërkesë këmbëngulëse të tjetrit: *ντέφι να γίνει, θα σ’ το κάνω το χατίρι*. (ΛΚΝΕ 1998). Në të dy gjuhët, shprehjet e mësipërme, të ndërkallura në lemat *def* dhe *ντέφι* të fjalorëve përkatës, nuk kanë lidhje me fjalën turke *tef, def* ‘organ muzikor’, por me homonimin e saj *def²* ‘repulsion, refutation’ dhe me togfjalëshat foljorë *def’etmek* ‘1.to repel, push back, repulse, drive away. 2.to expel, eject. 3.lrnd. to refute) dhe *def’olmak* (1.to be removed, go away. 2.colloq. to clear out, to go. --! colloq. Off with you! Get out!’ (Redhouse 1995, Dizdari 2005 : 198). Po japim edhe një shembull tjetër. Te shprehja *llogje Kavaje* ‘fjalë të shumta e pa bukë’ e shqipes, po të pranojmë si burim të saj frazeologjinë *λόγια της καραβάνας* të gr. bizantine e moderne, prania e toponimit Kavajë bëhet më pak problematike, ngaqë shpjegohet bindshëm si një riinterpretim popullor i fjalës *καραβάνα* ‘karvan’, huazuar në greqisht nga arabishtja (Κουκουλές 1952 : 69 – 70).

II. Probleme të mikrostrukturës së FFB : ekuivalencat frazeologjike shqip-greqisht

Në vazhdim, me synimin për të parë më nga afër mikrostrukturën e FFB, do të ndalemi në pjesën shqip-greqisht të tij. Sikurse dihet, premisa e parë e hartimit të një fjalori të tillë është ekzistenca e fjalorëve frazeologjikë të gjuhëve ballkanike, por edhe e fjalorëve frazeologjikë dy- a më shumë gjuhësh, si edhe e studimeve të thelluara për frazeologjinë e secilës nga gjuhët e Ballkanit. Pasuria frazeologjike e shqipes u pasqyrua së pari në mënyrë të plotë e sistematike në Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe të vitit 1980, kurse Fjalori Frazeologjik i Gjuhës Shqipe i J. Thomait u botua në vitin 1999. Më 1998 botohen në Greqi dy fjalorë të greqishtes së sotme, Fjalori i J. Babinjiotis-it dhe Fjalori i Institutit të Studimeve Neohelenike, dy vepra që shënojnë një etapë të re të leksikografisë greke dhe që u kushtojnë hapësirë relativisht të gjerë shprehjeve

frazeologjike. Megjithatë, akoma edhe sot nuk disponojmë një fjalor të plotë të frazeologjizmave të greqishtes. Shënojmë gjithashtu se në fillimet e vitit 2010 u mbrojt në Universitetin e Selanikut disertacioni i koleges A. Chiotis (Χιώτη 2010), ku kemi një paraqitje sitematike të problematikës së kësaj fushe për greqishten dhe bëhet klasifikimi i frazeologjizmave në bazë kriteresh shkencore.

Në praktikën e hartimit të fjalorëve frazeologjikë rëndësi të dorës së parë ka problemi i gjetjes së ekuivalencave. Sipas studiuesve (Eismann 1989 : 86 – 87), nga krahasimi i bërë mbi bazën e katër kriterëve (leksiku, struktura, semantika, stili), rezultojnë katër tipe frazeologjizmesh: 1. Frazeologjizma ekuivalentë, me konkordancë të plotë në të gjitha nivelet. Këtu dallohen a) frazeologjizma ekuivalentë me konkordancë të plotë në të gjitha nivelet dhe kuptimet, dhe b) me konkordancë të plotë në së paku njërin nga kuptimet, dhe me mospërputhje në së paku njërin nga kuptimet. Gjithashtu, në nivel stilistik, mund të kemi a) ekuivalencë absolute, dhe b) ekuivalencë relative. 2. Frazeologjizma që nuk përputhen në nivel strukturor dhe semantik, dhe që mund të përkthehen vetëm duke u perifrazuar. 3. Frazeologjizma adekuatë, që përputhen në nivel semantik, por ndryshojnë në nivel leksikor dhe gramatikor. 4. Frazeologjizma strukturalisht identikë ose të përafërt, d.m.th homonimet ndërgjuhësore. Edhe Tomici (1983 : 237-241) duke përqasur njësitë frazeologjike sinonimike të gjuhëve sllave dhe josllave të Ballkanit arrin në një klasifikim të përafërt: 1. Frazeologjizma me semantikë identike, të shprehur me të njëjtat njësi leksikore 2. Frazeologjizma me semantikë të njëjtë në të gjitha gjuhët ballkanike, por me përbërës leksikorë që nuk përputhen plotësisht 3. Frazeologjizma me semantikë identike, por me përbërës leksikorë të ndryshëm 4. Frazeologjizma me semantikë identike, si dhe me dublete semantike brenda secilës nga gjuhët ballkanike.

Për sa i përket FFB, “*paralelet frazeologjike të plota* janë të shumta, por një pjesë e frazeologjisë mbetet për t’u dhënë në mikrostrukturën e fjalorit *me mënyra e mjete të tjera*”, të cilat, “në pajtim me *teorinë e ekuivalencës gjuhësore* dhe të *substitucionit*”, janë “a. *Struktura identike* (të tipit “kalk”) b. *Barasvlerës frazeologjikë semantiko-funksionalë*, por me temë semantike të ndryshme c. *Barasvlerës semantiko-funksionalë të figurshëm*, por *nën nivelin frazeologjik* ç. *Perifrazime* semantikisht të barasvlershme d. *Sinonime* njëfjalëshe”. (FFB 1999 : 7-8, nënvizimet janë tonat, Dh. Q.). Kjo do të thotë se mund të vendoset një koeficient ekuivalence (KE) me vlerë 1 për “paralelet frazeologjike të plota”, d.m.th kur kemi konkordancë të plotë në të katër nivelet, dhe me vlerë 0, në rastin e perifrazimeve dhe sinonimeve, të cilat cilësohen si “më pak të pëlqyeshme” (FFB, po aty). Midis vlerës maksimale dhe zero të KE krijohet një *continuum* ku përfshihen rastet a, b dhe c, nga të cilët: c ndodhet “nën nivelin frazeologjik”, b është njësi frazeologjike barasvlerëse “me temë semantike të ndryshme”, dhe a është kalk i njësisë frazeologjike të gjuhës që merret si pikë referimi (PR). Këtu lind pyetja nëse këto lloj kalkesh apo strukturash identike kanë tipare të njësisë frazeologjike (gjë që përjashtohet, se përndryshe do të kishim të bënim me paralele frazeologjike të plota) dhe në ç’skallë shprehja frazeologjike e kalkuar ruan dhe bart tek lexuesi kuptimin e shprehjes frazeologjike burimore, i cili, siç dihet, nuk është i njëjtë me shumën e kuptimeve të përbërësve leksikorë të saj. Pikërisht këtu ndodhet edhe thembra e Akilit e pjesës shqip-greqisht të FFB. Nisur nga natyra e frazeologjisë, përkthimi

fjalë për fjalë i një shprehjeje frazeologjike krijon vështirësi kuptimore, gjë që duket në rastin e shembujve që janë të kapshëm në zonat e kontaktit të gjuhëve, por që bëhen gjithnjë e më pa kuptim sa më shumë largohemi nga brezat e kontaktit. Kështu, shprehjet e mëposhtme të shënuara me asterisk përdoren edhe sot e kësaj dite në territoret e banuara nga pakica kombëtare greke në Shqipëri, mbase edhe në pika të tjera të Epirit ku greqishtja dhe shqipja kanë qenë në kontakt të vazhdueshëm, por ato tingëllojnë si të huaja për grekët që banojnë në qytetet e mëdha dhe gjithsesi larg zonës së Epirit. Po i rendisim siç janë edhe në FFB: *sot për sot* *σήμερα για σήμερα, *tani për tani* *τόρα για τόρα, *brenda për brenda* *μέσα για μέσα, *nuk pi ujë [diçka]* *δεν πίνει νερό, *s'më rrihet në një vend* *δε μου κάθεται σ' ένα τόπο, *s'i bëhet vonë* *δεν του πάει αργά, *jap zemër* *δίνω καρδιά, *marr zemër* *παίρνω καρδιά, *nuk ha shqip* *δεν τρώει αλβανικά, *më vjen keq* *μου' ρχεται κακά, etj. Duke u rrekur të kuptojmë pse dhe si arritën të zënë vend në FFB këto zgjidhje të pagoditura, gjëja më e thjeshtë do të ishte të lëshojmë një breshëri kritikash ndaj hartuesit të pjesës shqip-greqisht të fjalorit. Në të vërtetë, nuk kemi të bëjmë as me *lapsus linguae* as me *lapsus calami* e as me *mungesë profesionalizmi* të tij. Kemi të bëjmë thjesht me *pasojat e kontaktit intensiv dhe asimetrik të shqipes me greqishten* në territore ku folësit e këtyre dy gjuhëve takoheshin e takohen përditë e ku, qyshkur pakica kombëtare greke u përfshi në kufijtë politikë të shtetit shqiptar dhe mbeti e izoluar nga trangu amë për mbi gjysmë shekulli, shqipja ka qenë gjuhë dominante dhe ka lënë gjurmë të shumta në të folmet greke të trojeve në jug të Shqipërisë. Frazeologjia nuk mund të bënte përjashtim nga ky proces. Bartës i këtyre ndikimeve është edhe Dr. K. Qiriazati, hartues i pjesës greqisht të FFB, njohës i mirë i shqipes dhe banor për shumë vite i kryeqytetit shqiptar, zotërues aktiv i të folmes greke të zonës së Vurgut të Delvinës, kundruar në distancë i rrjedhave të greqishtes letrare dhe përdorues pasiv i saj. Rasti i tij jep shkas për të diskutuar teorikisht dhe praktikisht nëse janë të përshtatshëm këta lloj personash për të marrë përsipër punë të tilla, si dhe për të përvijuar karakteristikat e hartuesve të fjalorëve frazeologjikë dy- a më shumë gjuhësh.

Në këtë kuptim, jemi të mendjes se edhe pas gabimeve që konstatojmë duhen kërkuar shkaqet dhe mekanizmat gjuhësorë të lindjes së tyre. Duke iu rikthyer shembujve të dhënë më sipër, vërejmë f.v. se modeli i tipit *tani për tani* (ndajfolje + për + ndajfolje = strukturë ndajfoljore) haset më shpesh në shqip dhe rrallë në greqisht (shih *πέρα για πέρα* = tej për tej, por *μπέσα για μπέσα* = *besa besë* dhe jo **besë për besë*), gjë që do të thotë se në greqishten lokale ka depërtuar një model i shqipes, favorizuar edhe nga përdorimi i shpeshtë i ndajfoljeve dhe i ndërtimeve ndajfoljore.

Në vazhdim të shqyrtimit të mikrostrukturës së FFB, le të shohim zgjidhjet e dhëna për një numër frazeologjizmesh që përmbajnë fjalën *pikë*. Shënojmë paraprakisht se kjo fjalë (πίκα) nuk është e mbarë greqishtes, rrjedhimisht edhe njësitë frazeologjike ku haset kanë përdorim të kufizuar dialektor: 1. *Më ra pika* = Μου ήρθε (με χτύπησε) ο νταμπλάς (νταμπλάς) / (η πίκα). 2. *Të rëntë pika (një pikë)!* = Να σε βαρέσει (χτυπήσει) η πίκα, να σου έρθει ο νταμ(π)λάς!. 3. *Pika që s'i bie!* = Πίκα (νταμπλάς) που δεν τον χτυπάει (βαράει)!. 4. *Hoqi pikën e zezë.* = Τράβηξε τη μαύρη πίκα, τράβηξε της ελιάς τα φαρμάκια (τα κακά). 5. *Pikë e zezë!* = Μαύρη πίκα! Τι μας βρήκε! Τι δυστύχημα! Në të gjitha rastet e mësipërme duhej të gjendeshin shprehje ekuivalente

me shtrirje mbidialektore. Për shprehjen (4) p.sh. mund të përdorej τράβηξε του λιναριού τα πάθη. I njëjti kujdes duhej treguar edhe me shprehjet e natyrës librore. Operohet drejt me *pikë për pikë* = λεπτομερειακά, ένα προς ένα, γράμμα προς γράμμα, dhe jo *πίκα για πικά. Ndërkaq *vë pikat mbi i.* (libr.) = *βάζω πικά στο i në vend të Βάζω τα πράγματα στη θέση τους (alfabeti grek nuk përmban shkronjë i). Po kështu edhe për *I humbi pikët* = τις έχασε τις πίκες, një nga rastet e shumta ku dialektorja shfaqet në vend të mbarëgjuhësore. Për t'u shmangur kjo dobësi e përgjithshme e pjesës greqisht të FFB, është e nevojshme që në një ribotim të ardhshëm të tij të mbahet më mirë parasysh pasuria leksikore dhe frazeologjike e mbarë greqishtes e sidomos njësitë frazeologjike më të përdorura të gjuhës letrare. Në këtë mënyrë, për *Jemi paq* do të përdorej είμαστε πάτσι (=πατίσαμε) dhe jo *είμαστε πλυμένοι, sipas shprehjes *jemi të larë* të shqipës. Kujdes edhe me togfjalëshat e qëndrueshëm me origjinë librore të gr. re, për t'i dhënë në trajtën që përdoren e jo me përkthim të lirë: *Pagëzimi i zjarrit* libr. = Η βάφτιση (το βάπτισμα) της φωτιάς në vend të Το βάπτισμα του πυρός, *mollë e ndaluar* = μήλο απαγορευμένο në vend të απαγορευμένο μήλο, *fushë me mina* = πεδίο με νάρκες në vend të ναρκοπέδιο, *fole grerëzash* = φωλιά σφηκών në vend të σφηκοφωλιά etj., *fuçi baruti* = κάδος (βουτσί) με μπαρούτι, μπαρουταποθήκη (πυριτιδαποθήκη), ku varianti i fundit është më i përdoruri në gjuhën e shkruar etj.

Shtojmë se pikërisht ndryshimet në nivel fonetik, morfologjik dhe leksikor (shih p.sh. βάφτιση / βάπτισμα / βάπτισμα, φωτιάς / πυρός) përcaktojnë edhe regjistrat e përdorimit të shprehjeve apo togfjalëshave të qëndrueshëm me karakter libror a popullor. Edhe parametra të tjerë si topika e elementëve të njësisë frazeologjike gjatë kalimit nga njëra gjuhë në tjetrën (shih p.sh. *i zë dora* = του πιάνει το χέρι, por edhe πιάνει το χέρι του, *i u muar goja* = του πάρθηκε το στόμα në vend të μπερδεύτηκε/σκόνταψε η γλώσσα του), apo trajta gramatikore e tyre (*e ka zemrën flori* = έχει την καρδιά φλωρί/μάλαμα por edhe έχει καρδιά/ψυχή μάλαμα, *ka qjetur tenxherja kapakun* = έχει βρει ο τέντζερης (η κατσαρόλα) το καπάκι του (της) në vend të βρήκε η τέντζερη το καπάκι) paraqesin interes të madh dhe si të tilla meritojnë një studim të posaçëm që i kalon caqet e këtij shkrimi.

Lënda e renditur më lart vërteton edhe një herë se ekuivalencat e shprehjeve frazeologjike në dy a më shumë gjuhë nuk përftohen nga përkthimi fjalë për fjalë i tyre. Megjithatë, në kushte të caktuara, kur përgjithësohen fillimisht në brezin e kontaktit të gjuhëve, kalket frazeologjike bëhen pjesë e gjuhës së përditshme të personave bilingë dhe kanë prirjen të marrin një shtrirje më të gjerë, tej kufijve gjeografikë të zonës ku ndërkallen gjuhët. Ky ka qenë, me sa duket, edhe njëri nga mekanizmat e përfutimit të BGB, sidomos në zona ku kontaktonin më shumë se dy gjuhë ballkanike. Parë në këtë prizëm, paksa paradoksalisht, gabimet apo pasaktësitë e FFB për sa i përket gjetjes së ekuivalenteve frazeologjike, gjithsesi të palejueshme për një fjalor, përbëjnë fakte gjuhësore interesante për gjuhësinë ballkanike.

Prof. as. dr. HAMIT XHAFFERI
Universiteti i Evropës Juglindore – Tetovë, Maqedoni

LESIKU ETNOFOLKLORIK NË SHPREHJET FRAZELOGJIKE TË FJALORIT FRAZELOGJIK TË JANI THOMAIT

Akademik Jani Thomai, në **Fjalorin frazeologjik** të gjuhës shqipe, na shpie në fushën e gjërë të **pasurisë frazeologjike**, të cilën e ndeshim tek e folmja dhe thëniet **popullit shqiptar**, tek **letërsia** jonë **popullore** dhe **leksiku etnofolklorik**. Gjuha jonë, si gjithë gjuhët tjera, përfshin një burim të pashtershëm e të begatshëm të këtyre thënieve, të cilat formojnë vazhdimësinë e ruajtjes brez pas brezi të fjalorit të saj. Tërësia e fjalëve vazhdimisht rritet, përhapet e begatohet me **njësi** të **reja fjalësh**, që konsiderohen si arritje e zhvillimit, civilizimit dhe përparimit të përgjithshëm të popullit tonë. Në thelbin e këtij **fjalori** qëndrom mendimi i autorit se mund të shprehemi më lehtë dhe më saktë, nëse i njohim mirë **fjalët** që e përbëjnë **fjalorin**, **frazeologjinë** dhe **ngjyresën popullore**. Megjithatë, tërë **njësitë leksikore** të përfshira në të gjithë **fjalorët** e shqipes, madje në bisedat, kuvendimet e zakonshme të popullit, nuk ndeshim ndonjë frekuencë të barabartë veprimi a **shfrytëzimi**. Konsiderojmë se në **problematikën gjuhësore** të **Fjalorit frazeologjik** të profesor Thomait mund ta gjejnë veten: **linguistët, filologët, shkrimtarët, përkthyesit letrarë, publicistët, profesorët e gjuhës dhe të letërsisë, studentët** dhe gjithë të tjerët.

Gjatë shqyrtimit të tërësishëm të këtij **Fjalori**, kemi arritur të veçojmë **463 shprehje frazeologjike** që i takojnë **leksikut etnofolklorik**. Mu për këtë shkak, konsiderojmë se ky **Fjalor** ka mbështetje **shkencore** e **lëndore** dhe **përvetësimi** i tij paraqet **hallkën** e pazëvendësueshme në **procesin e mësimi** dhe **studimit** të **gjuhës** sonë. Për këtë arsye, duhet theksuar **leksiku dinamik** dhe ai i **plogët** i shprehjeve frazeologjike që i takojnë gjithashtu **leksikut etnofolklorik**. Shprehjet frazeologjike të formuara me fjalë të **plogëta** i ndeshim dhe në disa **këngë popullore**, siç bie fjala: **Babë pas babe sh. Brez pas brezi** - është **fjalë pasive** në shumë të **folme dialektore**, por shprehjet frazeologjike si këto përdoren dendur: - ***Këto troje an'e mbanë,/ Babë pas babe na i kanë lanë /Amanet të parët tanë*** (Folk.).(Thomai J., Tiranë, 1999: 87).

Tek **leksiku dinamik** – hyjnë dhe **njësitë leksikore** të gjuhës, që lidhen me një denduri shfrytëzimi. Ky burim i pashtershëm dhe i begatshëm i këtij **leksiku** s'ka përhapje dhe veprim të barabartë tek mbarë shqipfolësit. Përmasa dhe gjerësia e shfrytëzimit të tij, kushtëzohet thjesht nga veprimtaria e **fushës së mjeshtërive, zanateve** dhe **zejeve** që praktikojnë folësit dhe nivelin e zhvillimit dhe përparimit arsimor e qytetërues të tyre. Më **Fjalorin frazeologjik**, synohet të jepet fizionomia e **frazeologjizmave** si **segmente gjuhësore kombëtare** që i japin fjalës së folur saktësi, shprehësi, origjinalitet të veçantë dhe sugjestivitet të papërsëritur.

Profesor Thomai thekson se në **burimin** e pashtershëm e të begatshëm të **leksikut dinamik** nuk përfshihen veçse **fjalë** që dihen e përdoren, por këtu gjithashtu përfshihen një sërë **fjalësh** më **pak të dëgjuara**, sikundër janë variantet e të folmeve popullore, **profesionalizmat** dhe **fjalët e vjetëruara** (Thomaj J., Prishtinë, 1978: 12). Në këtë mënyrë, me përparimin

kulturor dhe arsimor të popullit tonë është përsosur edhe **leksiku**, mjaftë **fjalë janë vjetëruar** dhe nuk shfrytëzohen më. Të tilla janë **fjalët frazeologjike** që kanë dalë nga përdorimi, të cilat përdoren gjithnjë e më rrallë, mirëpo janë të shpeshta shprehjet e tyre: **Luan me arra** (dikush) e kalon kohën kot; **vret (numëron) miza; tund (luan) derën. Ka marrë nuse, që luan me arraq./ Nana e djalit i rrin përpara.** (Folk) (Thomai J., Tiranë, 1999: 79). Ndërsa janë krijuar e janë futur **fjalë të reja** si kërkesë e domosdoshme e shfaqjes së emërtimeve dhe koncepteve të **reja** shprehëse të shqipes, për **fenomene** dhe **forma të jetës bashkëkohore**, për **sende, vepra, pajisje moderne pune** të shoqërisë së sotme shqiptare.



Fjalët e leksikut dinamik kanë domethënie **kryesore** dhe përmbajtje kuptimore sekondare. Për të konstatuar ndryshimin midis konceptit **leksikor** dhe atij **metaforik** të **fjalës**, ndeshim **fjalë**, të cilat ngërthejnë një **përzierje shumëkuptimore**. Njësitë **leksikore** që janë të ngërthyera në **Fjalor** na imponojnë vetvetiu **ndjenjën**, se në një **pjesë** të konsiderueshme të të **folmeve popullore** nuk mungojnë edhe **shprehjet frazeologjike**, të cilat janë **përdorur** jo vetëm nga të **parët tanë**, por edhe nga të **gjithë shqiptarët** të cilët me **shekuj** kanë ekzistuar në **trojet** e tyre **etnike**. Ja ç'thotë kjo thënie apo shprehje popullore të cilën e ndeshim në fjalor: **Thyen**

arrat kot (dikush) flet gjëra pa vlerë e pa kuptim, thotë gjepura; (flet) **kot më kot**. - *T'u thaftë goja, që thyen arra kot ! Kush të shtyn, shejtani ?* (Thomai J., Tiranë, 1999: 80). Asht i fortë sh. **kockë e fortë**. - *Asht i fortë ai, s'ka çka i ban rrufa*. (Thomai J., Tiranë, 1999: 82).

Me ndryshimin e **mënyrës** së mëparshme të **jetës, vjetërohen dhe fjalët**, që shfrytëzohen dita-ditës më **rrallë**, gradualisht afrohen nga vetja dhe **shtresohen** në **leksikun e plogët** të të folmeve shqipe. Sot kuptimin parësor të **fjalës frazeologjike: E la në ahe** (dikë), rrallëkush e di nga **folësit e gjeneratës së re**, mirëpo **shprehjet frazeologjike** në **kuptimin** e la në mjerim, e braktisi kur ishte në vuajtje, - *Babë, nuk të lë dot në ahe. – Shko, o bir, shko, po nuk më gjen gjë mua*. (Folk.) (Thomai J., Tiranë, 1999: 199). Në **Fjalorin frazeologjik** të profesor **Thomait**, këtë mund ta **vrojtojmë** dhe ndjejmë në mënyrën më **autentiuke**, më për së afërmi, veçanërisht në të **folmen** e përditshmërisë së **qëmoçme të paraardhësve** tanë. Janë të qarta për të gjithë shqipfolësit, madje edhe prej më të vegjëlve. **Fjala ahur** sot shpesh përdoret edhe me kuptimin për **formalitët: E ka lënë ahur** (dikë) e trajton keq, nuk tregon asnjë kujdes për të; **ia hoqi fillin** (dikujt). Njerka shpirtkeqe nuk e donte çupën, ia kishte hequr fillin, si i thonë, e kishte lënë ahur; një here në ditë i jepte për të ngrënë. (Folk.). (Thomai J., Tiranë, 1999: 66).

Tek **leksiku i plogët** - me shndërrimin e **jetës**, fillojnë të zhbëhen **zejët e llojllojshme të punës së dorës**, e njëherazi me çrrënjosjen e tyre **vdesin** edhe **format e moçme** të trajtimit të **prodhimeve** të çdollojshme **agrarë e blegtorale**. Gjithashtu ndryshojnë edhe **kushtet e jetesës**, të **veshmbathjes**, njëkohësisht **zhduken** edhe një mori **fjalësh**, që **emërtonin lloje** të shumënduarshme të **veshmbathjes**, të **pajisjeve bujqësore e blegtorale**, të mjeteve e të **pajisjeve të ndërtimtarisë**, emërtimet për **bestytin** e **fytyra të mitologjisë** shqiptare etj. Sot një pjesë e mirë e shqipfolësve nuk e dinë kuptimin e mirëfilltë të **fjalës dheut**, por në ligjërimin e tyre përdorin **frazeologjizmat: E bukura e dheut** 1. *folk. Figurë e mitologjisë* shqiptare, të cilën e ndeshim në **përallat popullore shqiptare**, që përfytyrohet si një vajzë shumë e bukur, e mirë dhe e dashur; **E bukura e Jetës** 2. *Zool. Pikëlore. - Zhaba natën, kur vinin në odë të flinin, qiste lëkurën e na bahej e Bukura e Dheut. I bukuri i Dheut folk. Figurë e mitologjisë* shqiptare, të cilën e ndeshim në **përallat pëpullore shqiptare**, që përfytyrohet si një djalë shumë i bukur, i mirë dhe i dashur. - *Ti mos u trem, se gjarpëri nuk të ha, se ai nuk është gjarpër, po i Bukuri i Dheut*. (Thomai J., Tiranë, 1999: 147)

Është interesante paraqitja e mënyrës dhe nivelit të **jetesës dhe kulturës popullore**, që mbartin gjithashtu tiparet e hershmërisë **historike, siç** e ndeshim në disa rrethana të caktuara në **këngën popullore: (U bë) bark e shpinë** (me dikë) u lidh ngushtë me dikë, u bë mik me të; u bë një me dikë; **(është) bark e shpinë** (me dikë). - *Qe tre vjet, oj nanë që rri me të, / Bark e shpinë jam bo e s'un e la*. (Folk) (Thomai J., Tiranë, 1999: 99). Pjesa më e madhe e tyre buron nga vetë ekzistenca e **frymës shpirtërore dhe materiale** e popullit. Pra, **thelbi specifik i njësisë frazeologjike** gjendet te **folklori**, respektivisht – **kënga popullore: Ia kam bërë benë** (dikujt) jam betuar të ndëshkoj si duhet, kam vendosur t'i jap një mësim të mirë sapo të kem rastin. - *O bilbil ta bëra benë, / Në të gjetsha dot folenë, / Do ta marr të hedhe në lumë*. (Folk) (Thomai J., Tiranë, 1999: 108).

Prania gjithnjë e më tepër e **njesisve frazeologjike** tek **tradita dhe besimet** tonë **popullore**: **Mori shuplakën** (dikush) u shitua, u shkal (sipas besimeve popullore). - **Kishte pasë qenë një mbret e një mbreteshë e s'kishin vec një djlaë , që kishte marrë shuplakën.** (Thomai J., Tiranë, 1999: 971); te **emërtimet** e **bestytive, figurave, dokeve** dhe **zakoneve** të **botës mitologjike** shqiptare, të **bartura** ndër **shekuj** prej një **brezi** në tjetërin. Të këtilla janë shprehjet **frazeologjike** që i ndeshim tek **e drejta kanunore**: **Jap dorën** jap fjalën e besës, zotohem të zbatoj ose të plotësoj një marrëveshje, një premtim etj. **Të njohim shokun që kemi në krah dhe, kur japin dorën, të mos luajmë nga fjala, se besa është besë.** (Folk.). (Thomai J., Tiranë, 1999: 221). Në këtë mënyrë, leksiku i shqipes para së gjithash fuqizohet dhe begatohet, por në disa raste edhe zbehet, ngase mjaftë **fjalë** të **moçme** që dalin nga **shfrytëzimi** a **shërbimi** dhe plotësohen me **fjalë** e lokucione të **reja**, ndërsa një pjesë nga këto humbasin plotësisht duke mos ngelur asnjë tragë, përnjëherësh me shuarjen e **gjeneratave** që i patën përdorur, si për shembull: **Nuk ngrin as në akull** (dikush) është i fortë e trim i madh, nuk ka frikë nga asgjë. - **Musa nuk ngrinte as në akull dhe të tjerët i druheshin sa here u dilte përpara.** (Folk.). (Thomai J., Tiranë, 1999: 68). Sot kuptimi themelor i **fjalëve ngrin as në akull**, nuk njihet popthuaq prej askuj, por e ndeshim si shprehje **frazeologjike**. Mjaftë **glosa zonale** e **dialektore**, të **rralla** dhe të pakëta për nga **shfrytëzimi**, sot kanë mbetur me tipare të zbehta e të kufizuara, pa u përhapur në **gjuhë**: Frazeologjizma që i ndeshim ndër të folme dialektore, si: **Ku di derri këmborë!** Mospërf. Nuk merr vesh dikush nga një punë a nuk kupton dot përse bëhet fjalë; nuk di dikush të vlerësojë diçka të mirë; **ku di dhia ç'është tagjia! Nuk e prek nusen me dorë. / Ku di derri këmborë!** (Folk.). (Thomai J., Tiranë, 1999: 200). Në këtë mënyrë si zëvendësim i tyre krijohen pa arsye **leksema** mbi kuptimin e marrjes së **gjuhëve** të **huaja** ose **huazimit** të **fjalëve** të **gjuhëve** të tjera (Çabej E., Prishtinë, 1976: 102).

Meqenëse kemi të bëjmë me **leksikun etnofolklorik**, me këtë rast vërejmë se njësia më e madhe e tij ka **dalë** nga funksioni edhe në **gjuhën letrare**, gjithashtu në mjaftë variante nga gjuha popullore, që kohë më parë ishin vatra e krijimit dhe **kultivimit** të tyre, siç i ndeshim gjatë **betimit**: **I lëshoi (I qiti) be** (dikujt) iu lut me të madhe për diçka, iu përgjërua duke lidhur me be. - **Ti, nanë loke, qitu be, / Të mos qajnë ata për ne.** (Folk) (Thomai J., Tiranë, 1999: 108). Sidomos, kur e kemi parasyshë **plogëtinë** e **veçorisë** së **leksikut** në tërësi, mirëpo kësaj here në të shumtën e rasteve përballemi me **plogëtinë** e **lëmit** të **leksikut etnofolklorik**. Këto shprehje **frazeologjike** të **formuara me fjalë pasive** i ndeshim dhe në disa **këngë popullore**: **I bërtet së biji të dëgjojë e reja** (dikush) qorton e shan dikë që të marrë vesh dikush tjetër, i cili është fajtori i vërtetë; flet me nënkuptime e me të hedhur; **I bie pragut të dëgjoj dera. - I bërtet së bijës të dëgjoj e reja, / Moj nëno Nazike, s'të ka faj e veja.** (Folk) (Thomai J., Tiranë, 1999: 115). Ky **leksik** ka **emërtuar fusha** të shumëllojshme të **traditës** sonë **jetësore** nga lëmi i **etnografisë** dhe **folklorit**. Ndeshim terminologjinë dhe shprehjet **frazeologjike folklorike**: (e përcolli) **me një grusht miza (pleshta)** (dikë) e përcolli me fjalë e me premtime boshe, pa i mbaruar punën; (e përcolli) **me duar thatë (bosh).** - **Vjen djali në shtëpi të ndrikullës.. Ajo dhelapën e vjetër mbërriti me i ra mohit „kështu që nisi me një grusht miza tue ba gjysmën të marrë.** (Thomai J., Tiranë, 1999: 359). Reliktet e **leksikut etnofolklorik** do t'i ndeshim në

shprehjet frazeologjike të fjalorit të prof. Thomait: Prenë fjalën etnogr. Caktuan ditën kur do të bëhet martesë . - *U ba dy vjet goca e fejueme dhe kemi pre fjalën me krushkun që të dielën një javë t'i martojmë.* (Thomai J., Tiranë, 1999: 301).

Krahas **plogëzimit të leksikut origjinar** vendës, hasim edhe **plogëzimin e leksikut të huazuar**, që shfaq **ngjyrimet etnografike e folklorike** të një etape kohore të caktuar të emancipimit shqiptar. Dallimet për ngjyrimet të ndryshme kohore të një periudhe të caktuar historike: **Që kur është bërë bota** prej kohësh shumë të lashta; në kohë shumë të lashta. - *Thonë se, që kur është bërë bota, rronte në Hindi një plak magjistar i çuditshëm, që edhe gurin e bëntë flori.* (Thomai J., Tiranë, 1999: 129). **Plogëzimin e leksikut origjinar e vërejmë në këngën popullore: Gjeta belanë.** 1 (me dikë). U ngatërrova keq me dikë, më ndezi me të, nuk di si t'ia bëj; **më polli sherri; më polli djalli** thjesht ligj. 2. Më ra një hall i madh, e pësova; **më mbeti keq (m'u var) samari në bark; shkela mbi gjarprinj.** - *Hajde moj, që gjetsh belanë , /Ç'pate që na dogje fshanë !.* (Folk) (Thomai J., Tiranë, 1999: 110).

Plogëzimi i fjalëve burimore të gjuhës sonë - është rrjedhojë e një sërë rrethanash, që ndikojnë në **ndrydhjen**, kufizimin dhe **zbehjen** e saj. Rrethana të këtilla si zakonisht janë, vërshimi i **fjalëve të huaja (greke, sllave, turke, arabe, etj.)**, veçimi dhe mbyllja në vetvete e viseve **shqiptare, mungesa e shkrimit** të shqipes, ndikimi i **fjalëformimit të brendshëm** të saj, **krijimi dhe lindja** e termave, emërtimeve dhe **fjalëve të reja** (Halimi M., Gashi S., SSHF, IV-1974, Prishtinë, 1975: 110). Përderisa **komuniteti** ndryshon dhe zhvillohet gradualisht në përparimin dhe fuqizimin e tij, ndaj njëherësh me të nryshon edhe shqipja, **lindin fjalë të reja**, kurse **fjalët e moçme** nga fushat e ndryshme të **jetës dhe traditës sonë plogëzohen**, duke **dalur** nga veprimi a **shfrytëzimi**.

Plogëzimi i fjalëve të huazuara – është rrjedhojë e mënyrës së re të jetës dhe mjeteve të punës. Shqipja dhe shqiptarët gjatë historisë kanë qenë në kontakt të përhershëm me popujt e Ballkanit, Evropës, Azisë dhe me gjuhët e tyre, pa marrë parasysh se ishin në rolin e pushtuesit apo fqinjit me të cilët bashkëjetoi. Për këtë arsye, gjuha jonë nga këto gjuhë huazoi një fond të dukshëm leksikor, ku falë kërkimeve shkencore të albanologëve e të ballkanologëve, u vërejtën dhe u kategorizuan **huazimet**, që njihen gjer në ditët tona, sikurse janë: **huazimet e moçme dhe ato të reja greke, huazimet mesjetare bizantine, latine, romane, italiane, frënge, sllave, turke**, të cilat u pasqyruan në sfera të ndryshme të gjëllimit tonë. Duke qenë se këto **huazime** gjeten terren të përshtatshëm në shqipen, u shfrytëzuan shumë gjatë dhe u trupëzuan në ndërtimin dhe përbërjen e shqipes, u bënë produktive në **fushën e fjalëformimit** dhe iu nënshtruan skemës së gjuhës sonë. Duhet vënë në dukje se s'kemi të bëjmë me **barbarizma**, që mund të plotësohen sa është e mundur me fjalët vendase të gjuhës sonë, pasi kemi të bëjmë me huazime, që kanë bërë një jetë të gjatë me leksikun e gjuhës sonë, që konsiderohen si begati leksikore e saj. Porse, me mënyrën e jetës bashkëkohore, me zhdukjen e sistemeve të mëparshme shoqërore, edhe këto huazime kanë të njëjtin fat si edhe **fjalët autoktone**, atëherë u plogëzuan edhe një pjesë e mirë e leksikut të moçëm të huazuar **etnofolklorik** nga fusha të ndryshme të **jetës bujqësore e blegtorale**, në fushën e **emërtimit të enëve**, të **kuzhinës popullore**, të petkave që përdoren për t'u veshur: **mbulimi, mbështjellja, mbathja, ngjeshja**, ato të **higjienës**

personale, të **dokeve** e të **adeteve**, **rregullave** a **normave** të **mënyrës së jetesës**, të vendosura **historikisht** me **kanun**, të **botës mitologjike**, të **emërtimeve të llojeve** të nduarduarta të **armëve**, si për shembull: **E shkrep i dyfekun** (dikush) më në fund vendosi për diçka ose e bëri diçka; **ia bëri bam**. - *Lënesha jonë vithemëdha / E shkrep i dyfekun, na u martua / Me Dule qosen sa një hata*. (Folk.). (Thomai J., Tiranë, 1999: 246); të lëmit të **ndërtimtarisë** e **arkitekturës**, të **emërtimeve të sëmundjeve** të ndryshme, si: **U bë dërrasë** (dikush). 1. U lig e u dobësua shumë; **u bë petë; u bë dhogë**. 2. sh. **U bë dru** (dikush). Veremi e kishte vënë poshtë djalin dhe për një muaj u bë dërrasë. Si nëpër gjumë kërkonte princeshën. (Folk.). (Thomai J., Tiranë, 1999: 202). **Erdhi në fije**. 1. (dikush). U bë më mirë pas një sëmundjeje a pas një gjendjeje të vështirë, u përmirësua; **e mori veten; erdhi në vete**. 2. (diçka). U rregullua, ecën më mirë; **erdhi në vijë**. - *Prej gëzimi të fiktë i ka ra; / E me ujë Ymeri e ka lagë, / Prapë në fill Dylberja ka ardhë, / Përqaftë Ymerit i qenka kapë*. (folk.). (Thomai J., Tiranë, 1999: 288); të cilësive të **profesioneve** e **fushave** të ndryshme të **jetës** së një procesi të caktuar të **progresit historik** (Halimi M., Prishtinë, 1982: 204).

Përdorimi i **leksikut të plogët etnofolklorik** në **lokucionet** e ndryshme **frazologjike**. **Fjalët** fillimisht kanë **shfrytëzim** si **njësi të lira leksikore** nga njëra anë, mirëpo në të kundërtën ato kanë veprim a **shfrytëzim** të **konservuar** e të ngurtësuar në **lokucione** të ndryshme **frazologjike**. **Fjalët mplaken** dhe **dalin** nga veprimi a **shfrytëzimi**, gjë që tregon qartë se **plogëzohen**. Mirëpo, ato në të shumtën e rasteve mbeten si **lokucione** të pandryshueshme të shqipes, për ta bërë **kuptimin** e tyre parësor dhe kur **desemantizohen**, fitojnë **kuptime** të **reja figurative**.

Fjala në veprim a **shfrytëzim** të **lirë leksikor** ka **forcë** më të **vogël** qëndrese, ajo **humbet** bashkë me çrrënjosjen e **mjetit** ose **pajisjes** së **zanatit** të cilin e **emërton**. Për këtë arsye konstatohet se **fjala** si **njësi leksikore** e **ndarë** nga **shprehjet** e pandryshueshme u ngjasojnë **mjeteve** të pacaktuara e të pambështetura, që janë të **lëvizshme**, **jostabile**, e kështu edhe të paqëndrueshme ndaj të **huajsimit** e **plogëzimit** në **ligjërimin** e zakonshtëm të **folësve**. Ndërkaq, **shprehjet frazeologjike** si kompleks i **togjeve**, **thënieve** e **shprehjeve** të pandryshueshme të shqipes, janë të pashkëputshme nga ana **leksikore**, për të shfaqur një **kuptim** të plotë e të **figural**, ato kryejnë **funksionin** e një **fjale** a të një **fjalie** të vetme (Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, Prishtinë 1981: 501). Për këtë arsye, **fjala** në këto **shprehje** ka një **jetë** më të **gjatë**. Edhe atëherë kur **kuptimi** parësor i **fjalës** së **plogëzuar** **desemantizohet** e dobësohet, në **shprehjet frazeologjike** mbrohet **kuptimi** i saj **figural**. Kuptimi primar i kësaj **fjale implikon asociacione semantike figurative**, që shprehin ose përshkruajnë **veprime** e **ngjarje**, **gjendje eksploatimi**, **grabitjeje** e **vjedhje** dhe **gjendje varfërie**, etj. Si për shembull: **Mbeta fishek thjesht ligj**. 1. Mbeta pa një lek në xhep; mbeta pa gjë; **mbeta teneqe**. 2. Mbeta pa njeri, mbeta vetëm; **mbet kalli**. - *Një herë Nasradin efendiu kishte mbetur fishek, pa para dhe shkoi nën penxherenë e një çifuti të pasur*. (Thomai J., Tiranë, 1999: 352). **Karakteristikat** e përgjithshme të **strukturës** dhe **veçorive stilistike frazeologjike**, që i trajtoi **Jani Thomai**, shprehin **koloritin** e një **kohe** të caktuar **historike** të tyre dhe një **pasuri kombëtare** të veçant.

Është fakt se frazoma (Frazema është njësia më e vogël e frazeologjizmës), nuk është fjali, meqë nga aspekti ndërtimor nuk është tekst i mëvetësishëm, ajo dëshmon për lidhmërinë e fjalës dhe për dallimin e saj nga llojet me karakter fjalie, që kanë lidhje të forta e të pandryshueshme (Matesit J., Zagreb, 1982:VI (e parathënies), siç janë për shembull: **fjalët e urta: Ha (bren) çelikun (me dhëmbë)** (dikush) sh. **ha (bren) hekurin (me dhëmbë)** (dikush). *Një takëm që ishin dibranë, / Hajshin çelikun me dhambë.* (Folk.). U vesh me (në) çelik (dikush) sh. **u vesh me (në) hekur** (dikush). Nuk ka burrë ta mundë në log, është veshur me çelik e syrin e ka pishë. (Folk.). (Thomai J., Tiranë, 1999: 174); **shprehjet, e deri diku edhe lokucionet rrethanore, mallkimet, bekimet, urimet, dashuria**, siç bie fjala: **E shtiu (e futi, e vuri, e hodhi) në dorë.** 1. (diçka). U bë pronar i diçkaje, u bë zot i saj; e mori, e përvetësoi; e pushtoi. 2. (dikë). E bëri dikë (zakonisht një femër) që t'i jepet; **e bëri të tijën, e ka në xhep.** - **Kur më shkon ti udhës, moj, / Na shpërthen behari. Pa të shtënë në dorë, moj, / Nuk do më qasë varri.** (Folk.). (Thomai J., Tiranë, 1999: 230); **thëniet e lokucionet e ndryshme.** Një ndihmesë e veçantë në këtë drejtim, janë dhe një mori shembujsh të inkorporuar në fjalorin frazeologjik të profesor Thomait, të cilët ai i hetoi në folklorin shqiptar, në jetën tradicionale të popullit dhe në të drejtën kanunore të tij, duke i zgjedhur me mjeshtëri të rrallë mbijetojat e leksikut etnofolklorik nga proverbat, **fjalët e urta, gojëdhënat popullore, mallkimet**, si për shembull: **T'u mbyllë dera! Mallk. dhe shaka. u shofsh me gjithë sa ke! S'më dhe kalimera? Moj, t'u mbyttë dera!** (Folk.). (Thomai J., Tiranë, 1999: 196); **M'u bë derr** Mallk. (dikush a diçka) m'u mërzi shumë, m'u neverit; **nuk e shoh dot me sy. Kungulli i zier/ M'u bë derr./ Fara i mbiftë/ E iu bëftë ferrë.** (Folk.). (Thomai J., Tiranë, 1999: 199); **bekimet**, bie fjala: **I marr dorën** (dikujt). 1. E pyes dikë a i marr lejë për diçka. 2. E përshëndes dikë me mirënjohje; e përshëndes duke i puthur dorën. 3. E njoh mirë e di si të veprojë me të; **ia marr avullin.** - **Lahu, lahu dhandër, / Merri dorën babës, / Të të jap bekimin.** (Folk.) (Thomai J., Tiranë, 1999: 226); Sipas **gojëdhënave popullore**, sot në treva të ndryshme shqiptare ndeshin **figura të përallave popullore** me emrin: **Bilbil gjyzari**. 1. Figurë e përallave popullore; bilbil me zë shumë të bukur, që paraqitet sikur bën cudira. 2. Djalë që këndon bukur. - **O, more bilbi gjyzar,/Pse s'këndon si në behar.** (Thomai J., Tiranë, 1999: 115); **thëniet dhe shprehjet e ndryshme.**

Leksiku i huazuar që kishte hyrë në gjuhën tonë nga **gjuhët e huaja** me kalimin e kohës dhe shndërrimin e zhvillimeve jetësore në fshat e në qytet, filloi gjithashtu të plogëzohet edhe më shpejt sesa **leksiku burimor** i gjuhës sonë. **Fjalët** që **dikur** kishin një **denduri të madhe** veprimi a shfrytëzimi në të **folmen** e zakonshme, sikurse janë bie fjala: **alemi, bajat, bajrak, batall, beter, çati, çehrja, çengel, def, derman, dyfek, dynja, dyzen, gazep, kiameti, mësallë, zhaba** etj (Thomai J., Tiranë, 1999: 69, 88, 105, 106, 112, 125, 147, 175, 182, 189, 195, 199, 245, 247, 249, 331, 341). **Kuptimet** e tyre të vështuara **në kohën tonë janë të pakuptueshme** nga **gjeneratat e brezit të ri**, mirëpo **frazeologjizmat e ndërtuara** me këto **fjalë** janë të kuptueshme për **gjithkë** edhe në ditët tona, meqë veprimi a shfrytëzimi i tyre është **mjaft** i rëndomtë. **Lokucionet frazeologjike** kanë gjasa reale të jenë krijuar nga **leksiku original** i gjuhës sonë dhe nga **leksiku i huazuar** i saj. Domethënë një mori **fjalësh** të tjera nga **fusha e**

leksikut etnofolklorik, ose me zanafillë origjinare të gjuhës sonë, ose nga **leksiku i huazuar**, sikurse do t'i hetojmë pastaj, po **shfrytëzohen** ose **shërbejnë** dita-ditës nganjëherë, madje një **përbërës** tjetër është **plogëzuar tërësisht**, duket se **e hasim të ruajtur në lokucionet frazeologjike** dhe thëniet e tjera të shqipes. Bie fjala, **në kohën tonë pjesa** dërmuese e **gjeneratës së sotme** s'i kuptojnë fare përmbajtjet e **parme leksikore të fjalëve**: *ag, ahe, asqeri, ashk, azgan, beli, berihanë, borzilok, buçuk, caran, carka, cimb më cimb, cironkë, çadër, çetele, çirak, dushman, dylbere, efendiu, ferk, feta, fiqiri, gazepi, grosh, gjyzari, haberi, han, havale, izëm, kalem, kamxhik, kobure, kreshniku, mylazimnë, okë, seneja, sevda, takëm, tellall, topuz, usull, veremi, ymër, zevzek, zijosur, zhdëpi* (Thomai J., Tiranë, 1999: 66, 78, 80, 82, 83, 106, 111, 112, 115, 128, 142, 147, 158, 161, 174, 175, 177, 179, 202, 222, 223, 242, 247, 255, 286, 288, 293, 295, 315, 323, 331, 333, 335, 352). Sigurisht dhe mjaftë **fjalë** të tjera, të cilat paraqesin lloje formimesh të ndryshme të **frazologjizmave**, s'kemi patur mundësi t'i përfshijmë të gjitha në vështrimin tonë.

Fillimisht, në vazhdim pasi të japim lloje të ndryshme **frazologjizmesh** të krijuara me **fjalët** e sipërpërmendura, do paraqesim edhe domethëniet e **parme të fjalëve** të duhura si **njësi** të zakonshme **leksikore**. Rastis, që një pjesë e **fjalëve** të tilla të mos jenë të **plogëta** në gjithë shtratin gjuhësor, apo në mjaft mjedise të **të folmeve popullore** të veçuara me **përhapje gjeografike e periodike** të përgjithshme. Kujtojmë se trajtimi i tyre në **formë të ngurtësuar** në **frazologjizma** tregon për një trajtim të përgjithshëm të mbarë **variantëve të gjuhës popullore** në tërësi (Fjalori i fjalëve dhe shprehjeve popullore, Prishtinë 1982:299). Duhet thënë se mjaft prej këtyre **fjalëve** në **disa treva shqiptare** kanë **formë vepruese të gjallë**, ndërsa në më shumë mjedise të **variantëve të gjuhës popullore** gjenden në **formë të plogët**, që janë thjesht **frazologjizma** ose në **forma** të ndryshme të **ngurtësuar**. Kësisoj **fjala carani** pothuajse në gjithë trevat shqiptare si **njësi leksikore** shfrytëzohet shumë rrallë të cilën e hasim në formë të ngurtësuar **mallkimi: Iu shkimtë carani! Iu shoftë pragu! Dhe e kanë mallkue të tanë: "Iu shkimtë carani!"** Mandej kanë shkue një nga një. (Folk.). (Thomai J., Tiranë, 1999: 158).

Frazologjizmat si shfaqje gjuhësore, në mjaft rrethana janë të pandërrueshme. **Fjalët** mund të plotësohen si njësi të lira **leksikore**, por brenda në **frazologjizma zëvendësimi i fjalëve** është i pakuptimshëm, mirëpo mund të pasojë zëvendësimi i një **frazologjizme** me një tjetër. **Frazologjizmat** si mishërim **gjuhësor** kanë një përbërje të ngjeshur e të përgjithësuar, ku as nuk ke ç'të heqish as ç'të zgjerosh, ato nuk durojnë korrigjime, rikrijime e as ndërrime sistemore, por duhet lënë ashtu të pacenuara, duke i trajtuar besnikërisht e duke i kultivuar në **biseda** të çastit, në të folme të vetvetishme e në regjistrimet tona. Zëvendësimi i **fjalëve autoktone** me **fjalë të huazuara**, apo e kundërta me **fjalë shqipe** në brendi të **frazologjizmave**, jo vetëm që do të ishin të paqarta, por do të na dilnin qesharake e anakronike në komunikimet tona, qoftë gojore ose në të shkruar. Kështu gabime të rënda bëhen ngadonjëherë edhe nga intelektualët kur orvaten dhe kërkojnë t'i letrarizojnë **frazologjizmat**, edhe më tepër bëhen gabime kur shqipërues të pandërgjegjshëm përpiqen t'i përkthejnë **frazologjizmat** shqipe në gjuhë të huaja ose anasjelltas nga gjuhët e huaja në shqipe fjalë për fjale, duke iu shmangur qëllimit, idesë dhe kuptimit origjinal të gjuhës përkatëse. Meqë, siç u pa nga të dhënst e

prezantuar, duket fare qartë se **frazologjizmat** janë shfaqje me përbërje të qëndrueshme gjuhësore, ato pasqyrojnë koloritin e një kohe të caktuar historike, duke shfaqur cilësitë e profesioneve dhe botëkuptimet e një komuniteti përkatës, ato kësisoj janë konstrukte të ngrira gjuhësore, njëherë e përgjithëmonë, të cilat mund të dalin nga përdorimi, por nuk lejojnë zbërthime e ndërfutje **fjalësh** të **reja** në gjirin e tyre. Prandaj, kësisoj kanë mbijetuar deri më sot dhe për një kohë të gjatë do të mbeten edhe në të ardhmen gjurmët e **fjalëve** të **pasivizuara**, të cilat kanë dale nga përdorimi bashkë me objektet që kanë emërtuar.

Prof. as. dr. Mustafa IBRAHIMI
Universiteti i Evropës Juglindore – Tetovë, Maqedoni

FRAZEMAT SOMATIKE BAZUAR NË GJESTE DHE MIMIKË, SI BURIM I FRAZELOGJIZMAVE TË JANI THOMAIT

I. Frazemat somatike në Fjalorin frazeologjik të shqipes

Shprehjet frazeologjike përcaktojnë tiparet e një gjuhe dhe ruajnë më gjatë gjurmët e lashtësisë e të traditës që sjellin informata të pasura për botën, duke pasqyruar kështu lidhjen e gjuhës me historinë dhe kulturën e folësve të tij. Ata janë dëshmi e historisë së një populli të caktuar dhe mënyrën e kuptimit të botës që e rrethon.

Një nga veçoritë më karakteristike të gjuhës konsiderohet antropocentrizmi, i cili paraqet pikëpamje filozofike sipas të cilit njeriu konsiderohet si qendër e botës dhe qëllimi përfundimtar është zhvillimi i tij. Ky aspekt i gjuhës ka ndikim të madh në leksik, në kornizat e të cilit emrat që kanë të bëjnë me trupin e njeriut, përbëjnë një grup të madh. E gjithë kjo gjen zbatim në frazeologji. Komponentë përbërëse të shumë shprehjeve popullore janë pikërisht emrat e pjesëve të trupit të njeriut. Zakonisht shprehjet e tilla quhen si shprehje somatike ose somatizma. Shprehjet frazeologjike (nga gjuha greke soma-trup) janë shprehje me shumë kuptime të cilët në vete përmbajnë së paku një emër të një pjese të trupit të njeriut. Ky term është marrë nga filozofia dhe paraqet mënyrë e pikëpamjeve ku sendet, kafshët dhe dukuritë natyrore marrin tipare njeriu.

Tema për shprehjet frazeologjike somatike është mjaft e vjetër. Është shumë rëndë të gjendet gjuhë që nuk ka shprehje të tilla, andaj konsiderohen si universale të gjuhës. Sidomos është e pasur ajo frazeologji e cila në përbërjen e saj hyjnë emrat e organeve shqisore, me ndihmën e të cilave njeriu i njeh dhe shijon sendet që e rrethojnë, si – kryja, syri, veshi, hunda, gjuha, dora, zemra etj.

Edhe gjuha e shkruar dhe e folur shqipe në zhvillimin e saj shënon dhe përdor frazema të tilla somatike, të cilat dëshmojnë si tek autorët e vjetër të letërsisë sonë, ashtu edhe në gojën e popullit. E gjithë frazeologjia shqipe (e përgjithshme dhe dialektore) konsiderohet si ëmbëlsi e paçmueshme, e krijuar brez pas brezi nga populli, si një burim i pashtershëm i gjuhës shqipe. Studimet e shumta të profesor Thomait kontribuan që sot frazeologjia të vendoset në pozitë të rëndësishme, dhe konsiderohet si një nga qëllimet themelore të studimeve leksikologjike, duke marrë formën e shkencës së rëndësishme e të vazhdueshme. Profesor Thomai ka bërë disa grupe, klasifikime dhe ndarje të frazeologjisë.

Duke shqyrtuar si burim bazë materialin e **Fjalorit frazeologjik të gjuhës shqipe të Jani Thomait**, erdhëm në konkludim se frazeologjia e gjuhës sonë letrare është shumë e pasur me frazema të tilla somatike. Kriteri për mbledhjen e materialit për analizë ka qenë prezenca e një fjale emërtuese që paraqet somatizëm. Si burime bazë për këtë material na shërbeu *Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe të Jani Thomait*.

Renditja e njësive frazeologjike është bërë duke u mbështetur në “parimet teorike e kriteret e veçanta”. Ato janë vendosur sipas rendit alfabetik në bazë të fjalës shënjuese emërore, duke pasur parasysh që çdo njësi të jepet vetëm një herë. Kështu nga 51 komponentë somatike, korpusin e përbëjnë 2983 frazema: ashti (8) *balli* (28), *barku* (88), *beli* (1), *bërryli* (2), *brinjë* (16), *buza* (44), *bytha* (4), *damari* (5), *djersa* (1), *dora* (218), *dhëmbët* (45), *faqe* (30), *flokë* (8), *fyti* (22), *fytyra* (39), *gishti* (52), *gjaku* (105), *gjoksi* (12), *gjuha* (55), *gjuri* (12), *goja* (159), *gurmazi* (10), *grushti* (20), *hunda* (71), *këmbët* (146), *kocka* (14), *krahu* (33), *kryeja* (187), *kurrizi* (28), *lëkura* (62), *mendja* (286), *mishi* (28), *mustaqe* (7), *palcë* (6), *qafë* (75), *qerpik* (9), *qime* (50), *shpatulla* (31), *shpina* (35), *shpirti* (102), *syri* (278), *thembra* (1), *thoi* (37), *trupi* (1), *truri* (64), *turinjtë* (10), *veshi* (107), *zemra* (295), *zëri* (26), *zorët* (23).

II. Gjesti dhe mimika si karakteristike të somatizmave

1. Komunikimi joverbal

Rëndësinë e komunikimit joverbal dhe elementet e shumta jashtëgjuhësore të cilat ekzistojnë në procesin e komunikimit janë vërejtur që nga retorikët e lashtë. Teoria e parë e mirëfilltë për ekzistimin e gjuhës së gjestit ka qenë ajo e G.Batiste Vica i vitit 1725, kurse kthesë në këtë drejtim bëhet në vitin 1952, kur u botua libri i R.L. Birdëhistella *Introduction to Kinesics*, me të cilin themelohet *kinetologjia* si shkencë e kodit të gjestit, ndërsa termin *komunikimi joverbal* si term të ri shkencor e propozon fotografi E.Kees në librin e tij *Nonverbal communication*. (Pintarić 2002:14-15).

Pjesën kryesore të komunikimit joverbal e përbëjnë **gjestet** si gjuhë e trupit (lëvizja e dorës, këmbës, kryes, supit, trupit) dhe **mimika** si gjuhë e fytyrës (lëvizje e fytyrës dhe syve). Edhe gjesti edhe mimika janë përcjellës të situatës bisedore, ose si mjete të posaçme komunikuese, pra janë shenja të posaçme. Këta paraqesin lëvizje të çdo pjese të trupit duke nënvizuar bisedën për të forcuar ose zëvendësuar shprehjen.

Disa njësi të gjestit kanë vlera logjike të porosive gjuhësore (p.sh. lëvizja e kryes në formë pohuese), por në të shumtën e rasteve gjestin dhe mimikën e ndjek ligjërimi bisedor duke zbuluar gjendjen emocionale të folësit dhe qëndrimet e tij ndaj pjesëmarrësve tjerë të komunikimit dhe situatës në të cilën gjendet folësi.

1.1. Duke pasur parasysh vlerën pragmatike të gjestit dhe mimikës, nuk habit fakti se si pikë të përbashkët të tyre me mjetet gjuhësore të komunikimit e kanë pikërisht në frazeologji. Frazemat si njësi gjuhësore të cilat në të shumtën e rasteve kanë për detyrë të marrin vlerë komunikuese dhe informative të gjestit dhe mimikës, paraqesin një nga burimet kryesore të frazeologjisë.

1.2. Kur flasim për raportin e gjestit dhe mimikës nga njëra anë dhe frazemës nga ana tjetër, në përgjithësi kemi të bëjmë me raportin e mjeteve komunikuese gjuhësore dhe jogjuhësore.

Për lidhshmërinë e gjesteve me llojet e ndryshme të frazemave flet R.Volos, i cili dallon 3 grupe të frazemave me origjinë gjesti dhe mimike

1.3. Në vargun e problemeve e çështjeve të shumta lidhur me somatizmat, dhe një kënd pamjeje më të ngushtë, me komunikimin joverbal, kemi zgjedhur si objekt i kësaj kumtese ata somatizma shqipe që janë me origjinë gjesti dhe mimike që i gjejmë në mbeturinat semantike frazeologjike dhe që bazohet në supozimin se gjesti dhe mimika janë pjesë të pakapërcyeshme të çdo ligjërimi të përditshëm të afërt për çdo bashkëbisedues.

2. Frazemat me burim gjesti dhe mimike që përmbajnë somatizma

Numri më i madh i frazemave me burim gjesti dhe mimike në përbërjen e saj leksikore si komponent përmban një ose më shumë somatizma me ndihmën e të cilëve krijohet imazh të lëvizjeve të caktuara mimike, në bazë të të cilave vijmë deri te kuptimi frazeologjik.

2.1. Një numër të madh të frazemave të tilla janë të pranishme edhe në fjalorin frazeologjik të shqipes të Jani Thomait, që bazohet në gjestet dhe lëvizjet e mimikës, kuptimi i tyre lidhet me gjendjen dhe ndjenjat e brendshme të njeriut. Në prapavijën e frazemave të tilla tregohen lëvizjet e ndonjë pjesë të trupit, fytyrës ose syve, andaj të gjitha frazemat e këtij lloji në përbërjen e vet si komponentë përmbajnë një ose më shumë somatizma.

2.1.1. Meqë shprehjet e fytyrës janë treguesi më i mirë i gjendjes dhe ndjenjave të njeriut, nuk habit fakti se numri më i madh i këtij lloji të frazemave janë të organizuar rreth somatizmave që kanë të bëjnë me *fytyrën*.

2.1.1.1 Besimi se sytë janë pasqyrë e shpirtit të njeriut vjen në shprehje edhe tek frazemat me burim gjesti dhe mimike të cilët në përbërjen e saj si komponentë përmbajnë leksemën sy. Janë regjistruar 20 frazema të tilla. P.sh. në frazemën *fërkoj sytë* shpreh habi kur sheh dikë e diçka që nuk e priste. Kurse në atë *shëtitë sytë* shprehet vendosmëria e personit që shëtit andej – këndej pa u përqendruar diku.

2.1.1.2. Një frazëmë bazohet në përshkrimin e lëvizjes së muskujve të fytyrës, kurse në përbërjen e vet përmbajnë somatizmin *mustaqe*. Frazema *i janë varur mustaqet* me kuptimin ‘është turpëruar’ bazohet në mbetjen semantike që tregon lëvizje specifike të muskujve të fytyrës e me këtë edhe të *mustaqeve*.

2.1.1.3. Në përbërjen e disa frazemave gjejmë somatizmat që lidhen me gojën (10) dhe buzët (4). Në frazemën *i vari buzët një pëllëmbë* ‘shprehet pakënaqësia për diçka’, që tregohet nëpërmjet shprehjes së fytyrës. Përbërja semantike e frazemes *mbeti me gojë hapur* bazohet në pamjen e fytyrës karakteristike për habinë e madhe, dhe në këtë mënyrë vijmë deri te kuptimi frazeologjik ‘mbeti shumë i habitur’.

2.1.1.4. Disa frazema me burim gjesti dhe mimike e gjejmë në lëvizjen e dhëmbëve (6 frazema). Deri te kuptimi ‘mbledh të gjitha fuqitë për të kryer një punë a për të përballuar një gjendje të vështirë’ përdoret frazemi *shtrëngoju dhëmbët*.

2.1.2. Te një numër i madh që shprehin gjendje dhe ndjenja të brendshme bazuar në gjepte që bëjnë lëvizjet e duarve ose pjesëve të duarve (grushti, gishti), vetëm një pjesë prej tyre në përbërjen e vet si komponentë përmbajnë somatizmat *dorë, grusht ose gisht* të tjerët janë të organizuar rreth somatizmave tjerë, të cilat në aspektin semantik gjatë lëvizjes së duarve janë në pozicion pasiv.

2.1.2.1. Vetë somatizmi dorë (16 frazema) paraqitet në disa frazema me origjinë gjesti dhe

mimike. Frazema *I fërkonte duart* përdoret në kuptimin ‘kënaqet, i bëhet qejfi kur sheh në gjendje të keqe një njeri që nuk e do, pret t’i shohë të keqen’, gjejmë sjelljen e një personi në çastin kur është nervoz, është në pritje etj.

2.1.2.2. Në disa frazema të këtij lloji gjesti, në prapavijë përshkruhen lëvizjet e gishtave, kurse në përbërjen e tyre gjejmë somatizmin gishti (10). Në frazemën *ia bëj me gisht* me kuptimin ‘i bëj shenjë të afrohet, të largohet, të hesht etj.’, gjejmë pamjen e njeriut i cili urdhëron prerazi për diçka.

2.1.2.3. Një pjesë të frazemave që në prapavijë janë gjestet që fitohen nga lëvizja e duarve në përbërjen e saj përmbajnë somatizma, por ato kanë të bëjnë me dorën e cila gjatë lëvizjes është në pozicion pasiv. Tek ta gjejmë somatizmat: mjekër, mustaqe, krye dhe flokë.

2.1.3. Një pjesë e frazemave me prejardhje gjesti që tregojnë gjendje dhe ndjenja të caktuara njerëzore bazohet në gjestet që krijohen me lëvizjen e kryes (17 frazema).

2.1.3.1. Vetë somatizmin krye e gjejmë në disa frazema të tillë. Në prapavijën e frazemes *shtrëngoi kokën me duar* me kuptimin ‘jam në hall të madh e nuk di ç’të bëj’, gjejmë pamjen e njeriut kur ai është tepër i menduar për shkak dëshpërimit, por mund të jetë edhe situata e papritur ose ka qenë dëshmitar. Në frazemën *i vuri gishtin kokës* që përdoret në kuptimin ‘u përpoq të kuptoj mirë diçka’, ka të bëjë me personin i cili përmbahet për një veprim.

2.1.3.2. Në kuptime të njëjtë frazeologjike vijmë edhe me frazemat të organizuar rreth somatizmave ballë dhe hundë.

Tek frazema hundë (6 frazema), njësia frazeologjike merr konotim negativ *ngriti hundët* ‘me kuptimin u hidhërua’, kemi pamjen e një njeriu i cili e ngre hundën, dhe në këtë mënyrë vjen deri te gjendja jonatyrore të kryes, andaj këto frazema kanë konotim negativ dhe vijmë deri te personi kryelartë dhe mendjemadh.

2.1.4. Në përbërjen e frazemave gjejmë gjeste që lidhen me supet, si shenjë e pa përcaktimit. Fjala është për frazemën *uli/ngriti supët* që përdoret me kuptimin /të pajtohesh me situatën e dhënë. Përgjigjet edhe frazoma *Mblodhi krahët* që përdoret me kuptimin 1. tregoi me lëvizje të supeve se nuk di gjë për diçka ose nuk e kupton diçka dhe 2. U çudit për diçka që ka ndodhur. *E bija e plakut dhe e plakës u fejua e u martue. Askush nuk mblodhi krahët*

2.2. Përveç frazemave të ashtuquajtura **unë-gjeste**, në frazeologjinë shqipe ekzistojnë edhe numër të njëjtë frazemash me prejardhje gjesti dhe mimike që tregojnë raportin e personit tjetër, të ashtuquajtur **ai-gjeste**.

2.2.1. Gjatë komunikimit tek bashkëbiseduesi më tepër i vërejmë shprehjet e fytyrës, andaj nuk habit fakti se numri më i madh i këtij lloji është i organizuar rreth somatizmit sy.

2.2.1.1. Një frazëmë tek të cila deri te kuptimi frazeologjik vijmë nëpërmjet shprehjes së fytyrës si bazë e ka somatizmin dhëmbë (6). Bëhet fjalë për pamjen e njeriut duke shtrënguar dhëmbët, si në frazemën *tregoi dhëmbët*, me kuptimin ‘i kundërshtohet dikujt’. Te frazema *kruan dhëmbët*, me kuptimin ‘nuk ka të hajë, s’ka futur gjë në gojë’, gjejmë personin i cili duron dhembjet (padrejtësinë).

Mos e bëj si ajo gjinkalla, që në behar këndonte dhe në dimër kruante dhëmbët, se s’kish vënë gjë mënjane për të ngrënë. (Folk.)

2.2.2. Një pjesë e frazemave që janë krijuar me gjestet që tregojnë raportin ndaj personit tjetër lidhet me somatizmin këmbë (7 frazema), gjegjësisht në përbërjen e tyre gjejmë lëvizje të ndryshme të këmbës. Frazema *i vuri këmbën* me kuptimin ‘e përzuri, e dëboi, e shkelmoi’ ka pamjen e vurjes së këmbës me qëllim ta rrëzojë ose ta pengojë në ecje.

2.2.3. Tek një pjesë e frazemave bazuar në ai-gjestet në prapavijën e saj kanë fotografinë e gjestit që përbëjnë lëvizjen e dorës ose pjesëve të dorës.

2.2.3.1. Në disa frazema të tilla këtë e përbënë vetë somatizmi dorë (16 frazema). Frazemi *e pret me duar hapur* me kuptimin ‘e pret miqësisht, me dëshirë’, bazohet në gjestin e hapjes së duarve gjatë takimit me dikë. Te frazemi *ia bën me dorë* me kuptimin ‘e ka kapërcyer një hall a ka dalë i fituar dhe s’ia ka më nevojën dikujt’

2.2.3.2. Frazemat që krijohen nga gjesti që bëhet me lëvizjen e dorës ose pjesëve të dorës, janë të organizuar rreth somatizmave gisht (10) dhe grusht (6). Frazema *ja drejtoi gishtin dikujt* me kuptimin ‘e akuzoi dikë’, ose *Shtrëngon grushtet* me kuptimin ‘mbledh forcat a përgatitet për t’u ndeshur me dikë, për një punim që kërkon guxim’.

2.2.4. Gjestet që krijohen me lëvizjen e kryes gjejmë edhe në pjesën e frazemave bazuar në ai-gjeste, andaj në përbërjen e saj si një nga komponentët gjejmë somatizmin krye. Shembull *se ktheu as kryen, uli kryen*

2.2.5. Për t’iu përkulur dikujt sipas qëndrimit të trupit gjejmë edhe te frazema në të cilën si strukturë paraqitet somatizmi qafë, e cila në variantet tjera frazeologjike mund të zëvendësohet me somatizmat shpinë ose *thyesi qafën*

2.2.6. Në dy frazema bazuar në ai-gjeste si komponentë gjejmë somatizmin shpinë. Në frazemen *ia ktheu shpinën* gjejmë kuptimin ‘nuk i ndihmon më’.

2.3. Frazema bazuar në mimikë

Në strukturën e këtyre frazemave gjejmë somatizmat: pëllëmbë, gjoks, krah apo dorë.

Në frazemen *pështyn duart* e përdorim me kuptimin ‘të fillosh seriozisht me punë’. Në përbërjen leksikore të frazemes *dorën në zemër* me kuptimin ‘të flasësh sinqerisht, drejt’ gjejmë somatizmat dorë dhe zemër. Frazemi *ti biesh me grusht tavolinës* përdoret në kuptimin ‘ti kundërshtohesh me vendosmëri dikujt’

2.4. Disa frazema shqipe me përmbajtje gjesti dhe mimike bazohen në të ashtuquajturën gjeste për ta shkyçur fjalën duke qenë të aftë vetë ta përcjellin informatën. Edhe këto frazema në përbërjen e vet kanë somatizma. P.sh. *tregoi gishtin poshtë, tregoi gishtin lartë*

2.5. Tek frazema *ia shtrinë/zgjat dorën* gjejmë një nga gjestet rituale, që përdoret në situata të caktuara. Si bartëse e traditës kjo frazomë përdoret kryesisht për të përshëndetur, gjatë njoftimit, por në kuadër të frazemave përjeton edhe përhapje tjera semantike.

3. Frazemat me burim gjesti dhe mimike që nuk përmbajnë somatizma

Për dallim frazemave me origjinë gjesti dhe mimike të cilët në përbërjen e tyre si komponentë përmbajnë një ose më shumë somatizma, një numër shumë të vogël të frazemave të tilla përshkruajnë ndonjë gjest, por duke mos përfshi somatizëm si komponentë në përbërjen e saj. Shumica e frazemave të këtij lloji bazohen në gjestet rituale që janë tregues të traditave dhe botëkuptimeve të caktuara. P.sh. *e hodhi dorzën, e hodhi kapelën lartë, përveshi mangët* etj.

4. Përfundim

1. Nga numri i përgjithshëm i njësive frazeologjike që janë të përfshira në Fjalorin frazeologjik të gjuhës shqipe të Jani Thomait, më të shumta janë shprehjet frazeologjike somatike me **2983** paraqitje nga **51** emra bazë. Nëse i paraqesim me përqindje, këto shprehje frazeologjike janë të pranishme me 28%, gjë që përputhet me mendimin e R.Vajntraub (1975), i cili thekson se frazeologjizmat somatike paraqesin një shtresë e konsiderueshme (prej rreth 30 %) nga përbërja frazeologjike të çdo gjuhe. Sipas funksionit që e kanë në fjali, më të shumta janë frazemat somatike me komponentën : *zemër* (295), *mendje* (286), *sy* (278), *dorë* (218), *krye* (187), *gojë* (159) etj. Kurse përfaqësim më të vogël kanë fjalësit e emrave somatike: *beli*, *thembra* dhe *trupi* (1); *bërryli* (2); *damari* (5), *flokët* (8) etj.

Se pse disa emra të veçantë të pjesëve të trupit të njeriut në frazeologjizmat somatike kanë përfaqësim më të madh, studiuesi F.Çermak e paraqet faktorin e rastësisë. Bëhet fjalë për paaftësinë e të shpjeguarit, pse një pjesë e trupit të njeriut paraqitet në shumë shprehje në llogari të një pjese tjetër, i cili më rrallë ose aspak nuk përfaqësohet. (Për shembull me komponentin **zemër** kemi zbuluar 295 shprehje frazeologjike, ndërkaq me komponentët **beli**, **thembra** dhe **trupi** vetëm me nga një njësi frazeologjike).

2. Në këtë punim janë analizuar edhe 139 ose 4.7 % të frazemave të përgjithshme somatike të gjuhës shqipe me origjinë gjesti dhe mimike të gjetur në Fjalorin frazeologjik të gjuhës shqipe të Jani Thomait. Këto të dhëna mund të konsiderohen si dëshmi për rëndësinë e gjestit dhe mimikës si burim i frazeologjisë. Numrin më të madh të frazemave të tilla (25 % e të gjithë frazemave me origjinë gjesti dhe mimike) bazohen në të ashtuquajturën unë-gjeste të cilët shprehin gjendjen dhe ndjenjat e brendshme të njeriut, më tutje vijnë gjestet dhe mimika që shprehin raportin me një person tjetër, në të ashtuquajturën ai-gjeste (18 % nga frazemat e përgjithshme me origjinë gjesti dhe mimike). Në korpusin e frazeologjizmave të gjuhës shqipe janë të përfshira, edhe pse më pak, edhe frazemat bazuar në gjestet të cilat në komunikim shërbejnë si mjet për përforcimin plotësues të shprehjes, në gjestet të cilët në mënyrë të pavarur e përcjellin informacionin, në gjestet me të cilët i jepet një karakteristikë të caktuar personit tjetër, në gjestet që shërbejnë për shkyçjen e ligjërit si dhe gjesteve rituale.

Meqë në prapavijën e frazemave me origjinë gjesti e mimike tregojnë lëvizje të ndonjë pjese të trupit, fytyrës ose syve, nuk habit fakti se numri më i madh i frazemave të tilla (83% e të gjithë frazemave me origjinë gjesti dhe mimike) në përbërjen e vet si komponentë përfshinë një ose më shumë somatizma. Një numër shumë të vogël të tyre si komponentë nuk përmbajnë somatizma dhe gjestin e përshkruajnë me mjete tjera leksikore.

Dr. PËRPARIM FAKAJ
Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë

AKADEMIK JANI THOMAI PËR BALLKANIZMAT NË FUSHËN E FRAZELOGJISË

Akademik Jani Thomai është ndër përfaqësuesit më të shquar të gjuhësisë shqiptare me një veprimtari të gjerë shkencore. Ndhimesa e këtij personaliteti shkencor e gjuhëtari në fushën e albanologjisë është përmasore dhe e vlerësuar si brenda ashtu dhe jashtë Shqipërisë. Për gati 50 vjet rresht energjitë e tij s’ kanë reshtur së përkushtuari shumë çështjeve të gjuhës shqipe, e veçanërisht leksikologjisë e leksikografisë. Në lëmë të studimeve leksikologjike një vend të veçantë zë trajtimi i frazeologjisë, si disiplinë leksikologjike dhe një prej fushave themelore e më të hershme të kërkimeve të tij shkencore, e cila paraqet një problem të veçantë studimor jo vetëm në gjuhësinë shqiptare. Qysh në vitet e tij rinore e të fillimit të punës së tij kërkimore në fushën e gjuhësisë, ai u bë i mirënjohur si specialist i frazeologjisë e i semasiologjisë.

Frazeologjia, kjo pasuri kaq e begatë e gjuhës, barasvlerës e fjalëve, pasuri e mëvetësishme dhe e pazëvendësueshme e saj, ia zgjeron mundësitë shprehëse-emocionale gjuhës. Ajo si një nga elementët më të rëndësishëm që përcaktojnë tiparet e një gjuhe dhe që ruajnë më gjatë gjurmët e mëvetësisë e të traditës, ka tërhequr vëmendjen e studiuesve shqiptarë e të huaj. Krijimi dhe përdorimi i saj tregon mundësitë e pakufizuara të gjuhës për të plotësuar me mjetet e veta të gjitha funksionet komunikative dhe mundëson përballimin e kërkesave të shoqërisë e të zhvillimit në rritje për njësi leksikore e semantike. Kjo fushë studimore është bërë prej akademik Jani Thomait objekt trajtimi në shumë punime. Këto punime e kanë vënë fushën e frazeologjisë mbi një bazë studimore shkencore të shëndoshë e duke sjellë kështu një sërë ndihmesash të rëndësishme vetiake. Ato kanë krijuar sot një pamje të mirëfilltë shkencore të materialit frazeologjik dhe të çështjeve e problemeve që lidhen me të. Përvoja e tij e kërkimeve shkencore në këtë fushë nis me një numër të madh artikujsh studimorë shkencorë e kurorëzohet me botimin e monografisë “Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe” ku autori trajton në mënyrë të hollësishme problemet që lidhen me frazeologjinë, duke vazhduar në vitin 1999 me botimin e “Fjalorit frazeologjik të gjuhës shqipe”, i cili është një vepër cilësore, vëllimore, por e pajisur dhe me një parathënie studimore që është në kuptimin e vërtetë të fjalës, një punim i mirëfilltë shkencor, ku pasqyrohen edhe konceptet bashkëkohore për frazeologjinë e për frazeografinë. E rëndësishme është konceptimi i tij për njësinë frazeologjike si njësi e lindur “në radhë të parë si shenjë emërtuese, jo e thjeshtë, me një specifikë të caktuar në marrëdhëniet semantike e funksionale. Specifike është, p.sh., që njësia frazeologjike nuk lind si shënues e drejtpërdrejtë e sendit, e veprimit etj., por si shënues e ndërmjetuar, “simbolike”, nëpërmjet një tropi gjuhësor”^[1]

Objekt i kumtesës sonë është ndihmesa e akademik Jani Thomait mbi bashkëpërkimet e gjuhës shqipe dhe gjuhëve të tjera të Ballkanit në fushën e frazeologjisë ose siç emërtohen ndryshe

ballkanizmat frazeologjike. Marrëdhëniet shumëshekullore midis popujve të Gadishullit Ballkanik kanë bërë që edhe në gjuhët e tyre të zhvillohen e të përhapen disa fakte e dukuri gjuhësore të përbashkëta, që njihen me termin ballkanizma.

Me studimin e këtyre dukurive të përbashkëta të gjuhëve të Ballkanit janë marrë shumë studiues. I pari dijetar, që vuri në dukje disa nga këto dukuri të përbashkëta, ishte gjuhëtari sloven B.J.Kopitar, i cili tërhoqi vëmendjen mbi përkimet gjuhësore ballkanike, treguesit gramatikorë, duke thënë se “ në gjuhën rumune, bullgare dhe shqipe sundon vetëm një formë gjuhësore, por me tri lloje lënde gjuhësore”. Pas tij ndihmesë të çmuar dhanë F.Miklosiçi,G.Meyer, Ēigand etj. Por sintezën e parë serioze të tipareve të përbashkëta gjuhësore ballkanike në fushën e fonetikës, të morfologjisë, të sintaksës, të leksikut dhe të frazeologjisë e ka bërë Kristian Sandfeld më 1930 në veprën e tij” Gjuhësia ballkanike”[\[2\]](#), botuar së pari në danisht e më pas në frëngjisht. Sandfeldi merr në shqyrtim jo vetëm bashkëpërkime të përgjithshme ose të pjesshme midis gjuhëve ballkanike sidomos në fushën e fjalorit dhe të gramatikës, por edhe huazimet e ndryshme leksikore.[\[3\]](#) Një zhvillim më të fuqishëm morën kërkimet për këto dukuri me krijimin e Shoqatës së Studimeve të Evropës Juglindore e me kongreset e rregullta të organizuara prej saj. Kontributit të shumë gjuhëtarëve për çështjen e ballkanizmave i shtohet dhe ai i akademik Jani Thomait për ballkanizmat në fushën e frazeologjisë.Që në vitet '60 të shekullit të kaluar studiuesit Jani Thomai e Xhevat Lloshi vunë në dukje se këto përkime janë më të shumta në frazeologjitë që ndërtohen mbi bazën e emrave që shënojnë pjesë dhe organe të trupit të njeriut.[\[4\]](#)Botimi në vitin 1999 i Fjalorit Frazeologjik Ballkanik ku një meritë të veçantë ka akademik J.Thomai si udhëheqës shkencor i kësaj pune, flet për ndihmesën e tij shumë të çmuar në fushën e ballkanistikës. Me këtë vepër ai shfaqet para nesh edhe si ballkanolog.

Për akademik Jani Thomain krijimin e këtyre bashkëpërkimeve e ka favorizuar bashkëjetesa e popujve të Gadishullit Ballkanik për një kohë të gjatë pranë njëri-tjetrit duke krijuar edhe lidhje të shumanshme gjuhësore. Këto lidhje janë studiuar në rrafsh të ndryshme, si në leksik e frazeologji,fonetikë e morfologji, sintaksë etj.Popujt e trevës ballkanike kanë shumë pika takimi në historinë e tyre, fate të përbashkëta historike e sidomos sundimi i gjatë romak, bizantin e turk mbi këto vende ka luajtur një rol të madh në përhapjen e dukurive të përbashkëta.Po kështu te këta popuj vihet re një mentalitet pak a shumë i njëjtë, gjera të përbashkëta në organizimin e jetesës, në konstitucionin shpirtëror, në doke e zakone të lindjes, martesës e të vdekjes. Kushtet natyrore të përbashkëta, pozicioni gjeografik i vendeve ballkanike si urë ndërlidhëse midis Evropës dhe Azisë së Vogël, terreni malor, kullotat e shumta alpine e të të gjitha llojeve, që kanë një bimësi mjaft të larmishme, me pyje madhështorë, me shumë varietete drufrutorësh, me të njëjta lloje kafshësh të egra e të buta, kanë shërbyer si bazë që të ketë ngjashmëri midis gjuhëve ballkanike edhe në fushën e frazeologjisë.

Pra,burimin e dukurive të përbashkëta ai e lidh krahas ndikimit të faktorëve të tjerë edhe me faktorët jashtëgjuhësorë, si ata gjeo-historikë, psikologjikë, etno-kulturorë, mitologjikë etj., të

cilëve u njeh një rol të veçantë në këtë drejtim. Ndërsa nga njëra anë paralelet frazeologjike në gjuhët e Ballkanit tregojnë për afritë tipologjike gjuhësore, me gjithë dallimet e mëdha ndërmjet shqipes, greqishtes e gjuhëve sllave si degë më vete brenda familjes indoevropiane, dhe nga ana tjetër këto shprehje frazeologjike që ndeshen në këto gjuhë janë fryt i një mendësie të përbashkët të popujve ballkanas, e kushtëzuar kjo nga rrethanat e ngjashme historike, në të cilat ata kanë jetuar, si dhe nga marrëdhëniet e ndërsjellta midis tyre. Studiuesit këto bashkëpërkime e paralelizma të përfutuara i shohin si rezultante të evolucionit të gjatë historik të gjuhëve ballkanike.

Që nga Sandfeldi, e më pas, Papahagli, E.Çabej etj. është pohuar ekzistenca e “bashkësisë gjuhësore ballkanike”, e krijuar në një trevë historikisht të lashtë të bashkëjetesës së popujve, pra, që i kanë shtuar afritë gjuhësore tipologjike edhe me ndikime të ndërsjellta.

Qysh gjatë punimeve të Kongresit I Ndërkombëtar të Rrethit Gjuhësor të Pragës, që u mbajt në Hagë më 1926, gjuhëtari i shquar N.S.Trubeckoi u ndal edhe në dallimin midis “grupit gjuhësor” dhe “familjes gjuhësore”. Ai theksonte se “ çdo bashkësi gjuhësh të lidhura reciprokisht nga një numër i rëndësishëm bashkëpërkimesh merr emrin “ grup gjuhësor”[\[5\]](#)

Këtë tezë të Trubeckoit e zhvilloi më tej gjuhëtari tjetër i “Rrethit të Pragës”, R.Jakobsoni. Sipas Trubeckoit dhe Jakobsonit disa gjuhë mund të konsiderohen si pjesë përbërëse të një “lidhje gjuhësore”, në rast se ato;1) bëjnë pjesë në një familje gjuhësore; 2)nga pikëpamja tokësore duhet të jenë fqinje; 3) për shkak të ndikimeve të ndërsjellta duhet të kenë zhvilluar trajta të përbashkëta sidomos në fushën e fonetikës dhe të morfosintaksës.[\[6\]](#)

Ky është një klasifikim mjaft i rëndësishëm i gjuhëve në rastet kur bashkekzistenca historike dhe përzierjet e popullsive kanë dhënë mjaft tipare të përbashkëta për gjuhë gjenetike të largëta e tipologjike të ndryshme.Në këtë mënyrë, flitet për **lidhje ballkanike**, ku gjuhë si: shqipja, greqishtja, rumanishtja, serbishtja e bullgarishtja shfaqin midis tyre përkime strukturore mjaft interesante, si: mënyra e formimit të së ardhmes, zëvendësimi i paskajores burimore me të tashmen e dëftores, prapavendosja e nyjës shquese etj.

Akademik Jani Thomai duke u ndalur për afritë gjuhësore në këtë fushë të gjuhësisë në parathënien e Fjalorit Frazeologjik Ballkanik thekson se “ në frazeologji kjo afri është llogaritur deri në 400- 500 njësi, por e vërteta është se e kalon dhjetëfishin”[\[7\]](#)

Këtë mendim ai e argumenton me fakte, pasi në këtë Fjalor të hartuar me grup autorësh nën drejtimin e tij, numri i njësive frazeologjike të afërta në gjuhët ballkanike arrin në 5000 njësi. Kështu Fjalori jo vetëm përfaqëson arritjen më të madhe në këtë fushë, por ka zgjidhur teorikisht e praktikisht shumë çështje e duke plotësuar kërkesat për një fjalor frazeologjik shumëgjuhësh në kushtet e mungesës së një fjalori të tillë nxjerr në pah paralelet frazeologjike të shqipes me gjuhët e tjera të Ballkanit.

Bashkësia gjuhësore ballkanike e krijuar në një truall të lashtë të bashkëjetesës së disa popujve indoevropianë, pasqyrohet në frazeologji me paralele frazeologjike të njëjta a të ngjashme, sepse midis gjuhëve mund të kemi përputhje kuptimesh, por jo strukturash ku i njëjti kuptim shprehet me struktura të ndryshme. Sic e thamë edhe më lart, studimi i çështjes së shprehjeve frazeologjike të përbashkëta të gjuhëve ballkanike është bërë objekt nga shumë gjuhëtarë. Vlen të përmendet ndihmesa në këtë fushë e shumë studiuesve që nga Sandfeldi, Papahaghi, Çabej, Semionidhi, J.Thomai, Xh. LLoshi, Schaller, Bnafi etj. Po kështu gjuhëtari grek Asimaqis Fliaturas ka trajtuar izoglosat frazeologjike midis shqipes dhe greqishtes me bazë pjesët dhe organet e trupit të njeriut. Nisur nga numri i njësive frazeologjike që janë të njëjta nga ndërtimi dhe nga kuptimi, afritë më të mëdha të shqipes janë me greqishten e pastaj me rumanishten, që flet edhe për hershmëri marrëdhëniesh me këto gjuhë.

Duke studiuar me kujdes këtë material të gjerë frazeologjik që ka shërbyer si bazë për hartimin e Fjalorit Frazeologjik Ballkanik, akademik Jani Thomai konkordancat e shqipes me gjuhë të Ballkanit dhe ndërmjet vetë gjuhëve të Ballkanit në fushën e frazeologjisë nuk i sheh si përputhje njësisht të veçuara dhe të rastit, por si paralele tipash, llojesh, kategorish.

Për vetë konceptin “ballkanizëm” ai shprehet se “thelbi i konceptit “ballkanizëm” nuk është aq numri i gjuhëve, në të cilat gjendet njësia a dukuria gjuhësore, por burimi dhe procesi i “ballkanizimit” të kësaj njësie a dukurie”^[8] Ky koncept nuk është i njëjlojtë për të gjitha nënsistemet e gjuhës, sepse në fushën e leksikut ballkanizmat krijohen ndryshe nga ata të fushës së fonetikës dhe morfologjisë. Nuk mund të merren si ballkanizma fjalë të tilla, si: klasë, adet, xhaxha etj. edhe pse gjenden në tri a më shumë gjuhë të Ballkanit.

Sipas realitetit historiko-social e gjuhësor ai dallon katër shtresa paralelesh frazeologjike:

a. Ballkanizma frazeologjike , të krijuar historikisht nga bashkëjetesa brenda këtij trualli gjuhësor.

b. Paralele frazeologjike për shkak të tipologjisë gjuhësore, të krijuara në mënyrë të pavarur; kjo përbën shtresën më të gjerë.

c. Huazimet e ndërsjellta ndërmjet gjuhëve të Ballkanit, që zakonisht gjenden në 2-3 gjuhë , pra janë të kufizuara nga pikëpamja e arealies gjuhësore.

d. Huazimet nga gjuhë jashtëballkanike (nga turqishtja ose nga gjuhët neolatine), që janë më të shtrira ndër gjuhët ballkanike, por më pakta si numër.

Në Fjalorin Frazeologjik Ballkanik vihet re se tipi më i përhapur i shprehjeve frazeologjike në gjuhët e Ballkanit është ai që është përfutur nëpërmjet shndërrimit të togfjalëshit të lirë në togfjalësh frazeologjik. Ky fenomen është i shpeshtë në gjuhën shqipe, por edhe në shumë gjuhë të tjera indoevropiane (si në italishte, anglishte, frëngjishte, greqishte, rumanishte etj.)

përgjithësisht pranohet dhe është argumentuar se njësia frazeologjike është formuar nga shndërrimi figurativ i një togfjalëshi të lirë (në këtë lloj lidhje shpërfaqet edhe lidhja togfjalësh i lire/togfjalësh i qëndrueshëm).

Prandaj edhe në gjuhët e Ballkanit ky është tipi më i zakonshëm dhe më i pasur, në të cilin shqipja gjen analogjitë e saj me gjuhët ballkanike. Megjithatë kjo dukuri nuk është thjesht ballkanike, por ka një shtrirje më të gjerë duke e kaluar këtë truall gjuhësor. Atë e hasim edhe në gjuhë të tjera jashtë Ballkanit.P.sh:

Shqip: më ha kurrizi (shpina)

Rumanisht: te mănicsă pinarea

Bullgarisht:яде те търба

Greqisht: σέ τρώη ή ράχη σου

Origjina e përbashkët indoeuropiane shpjegon analogjitë në procesin e formimit të togfjalëshave frazeologjike të këtij tipi.Duke u ndalur në shpjegimin e prejardhjes së tyre, akademik Jani Thomai pranon dy mundësi formimi:

a.Frazeologjizma të formuar brendapërbrenda gjuhëve në mënyrë të pavarur e paralelisht me gjuhët e tjera;

b.Frazeologjizma të formuar në një gjuhë në përputhje me modelin tjetër, si kalke frazeologjike.

Analogjia tipologjike mbetet me vlerë edhe atëherë, kur ndonjë nga gjymtyrët e frazeologjizmit të shqipes ka si korresponduese të vetën një fjalë me kuptim tjetër leksikor në paralelin e vet frazeologjik të gjuhës që merret për krahasim.P.sh. mbaj sëpatën nën gunë =bul. Държа камък за пазухои

Duke u mbështetur në gjymtyrën drejtuese, e cila ndihmon në motivimin e njësisë frazeologjike, gjejmë paralele midis gjuhëve ballkanike te njësitë emërore, foljore, mbiemërore dhe ndajfoljore. Në këta togfjalësha gjymtyra emërore emërton zakonisht një gjymtyrë të trupit të njeriut dhe kuptimi frazeologjik, që kushtëzohet nga konteksti, i takon gjithë togfjalëshit.Në Fjalorin Frazeologjik Ballkanik ka mjaft njësi të tilla që rrisin fondin e përbashkët të frazeologjizmave të këtyre gjuhëve.Ballkanizmat frazeologjike me gjymtyrë drejtuese një organ të trupit të njeriut zënë vendin më të madh në gjuhët ballkanike. Vlen të përmendim se me fjalën zemër si organi më i rëndësishëm i organizmit të njeriut në Fjalorin Frazeologjik Ballkanik gjejmë 92 njësi frazeologjike të përbashkëta. Si të tilla përmendim:*S'më bën zemra; ma copëtoi zemrën; më doli nga zemra; m'u dogj zemra; m'u drodh zemra; më dhemb(ther) zemra; i fali*

zembrën; iu ftoh zemra; e fut në zemër; i grabiti zembrën; ma gjeti zembrën; me gjysëm zemre; i jap zemër; më iku zemra; i këndon zemra; më plasi zemra etj.

Originaliteti kombëtar i secilit popull shprehet në frazeologjizmat gjuhësorë jo vetëm me anë të strukturës origjinale të tyre, të natyrës së komponentëve, të mënyrës e mjetit lidhës etj., por edhe me pikënisjen origjinale, që shërben si semantemë për kuptimin e frazeologjizmit. I njëjti kuptim frazeologjik realizohet në gjuhë të ndryshme me mënyra e mjete të ndryshme. P.sh. : (I shkon) *si shala gomarit*; bul. *Si zilja dërrit ose si laraskës këmbora etj.*

Paralele frazeologjike gjen shqipja me gjuhët e tjera të Ballkanit edhe për ato frazeologjizma që janë formuar nën ndikimin e modeleve të huaja, si elemente të gjuhës së shkruar. P.sh.: bën përshtypje; ve në votë, rum. A pune la vot, bullg. Поставям на Гласуване, serbokr. Staviti na glasanje

Në punimin tonë jemi ndalur vecanërisht te ato paralele frazeologjike ku lëvizja kuptimore është realizuar me metaforë, krahasim dhe hiperbolë. Edhe te këto njësi gjuhët shfaqin shumë përbashkësi. Midis gjuhëve të Ballkanit gjejmë shumë njësi frazeologjike të krijuara me metaforë, pasi metafora mbetet mjeti kryesor për krijimin e njësive frazeologjike . Duke i parë njësitë nga lloji i metaforës që realizon shndërrimin figurativ të togfjalëshit të lirë në togfjalësh frazeologjik, si ballkanizma frazeologjike të tillë dalin:

a. Njësi frazeologjike me metaforë foljore të cilat për nga numri përbëjnë shumicën, si të tilla përmendim: *iu bë ferrë; ia bëri jetën ferr; më ngriu gjaku; etj.*

Më ngriu gjaku=

bulg. Смразявасе кръвта <вжилите> [някому]

gr. Μον πυ ά ωσε (κοηκε) το

b. Njësi frazeologjike me metaforë emërore, p.sh: *ahur bagëtish; dushk për gogla; kërcu përmbi samar etj.*

Ahur bagëtish=

bul. Свинска кочина

gr. Στάβλος (αΧούπί) ζώω

rum. *Casă murdară, grajd*

sr_kr. *Svinjska staja, prljavi dom*

c. Njësi frazeologjike mbiemërore, p.sh: *fare e keqe; fare e mire; me zemër të bardhë etj.*

Farë e keqe=

bul. Дяволски сој; Лош човек

gr. Κακιά Φάρα. Κακιά σπορά

rum. *Soi ráu*

sr-kr. *Lošeg soja, loš covek*

Duke u mbështetur në gjymtyrën që shërben si bazë për metaforizim, që shfaqet si temë motivuese në ngjizjen e njësisë së sapokrijuar apo në lindjen e figurshmërisë njësisive të përbashkëta frazeologjike midis gjuhëve ballkanike mund t'u bëjmë këtë klasifikim:

a. Grupi i njësive frazeologjike të motivuara nga një metaforë që lidhet **me kafshë** që kanë një tipar fizik që bie në sy. Të tilla kemi gjetur, p.sh: *u bë derr; u bë bishë; etj.*

U bëra derr=

bul. [Отегчавам Се, Дотяга ми] Досмърт

gr. Εγίνα γουροῦνι

rum. *A muri de plictiseală*

sr-kr. *Osećati dosadu*

b. Grupi i njësive frazeologjike të motivuara nga një metaforë nga **bota sendore**. Edhe këtu larmia e sendeve që kanë një anë a një tipar të spikatur është jashtëzakonisht e madhe. Sa për ilustrim do të përmendim: *u bë dyllë; u bë kërrabë; u bë daulle etj.*

U bë dyllë=

bul. < Лицето му > стана на восък

gr. Έγινε κερί (στο πρόσωπο)

rum. *A se face galben ca ceara*

sr-kr. *Bledeti kao vosak*

c. Grupi i njësive frazeologjike të motivuara nga një metaforë nga **bota e shpendëve**. P.sh.: *u bë bilbil*; (është) *zog pa pupla*; *e ka gojën bilbil etj.*

U bë bilbil =

bul. Ставам ангел (ангелче)

gr. Έγίνε αηδονί, έγίνε λουλούδι

rum. *S-a dat pe brazdă*

sr-kr-.*Postati dobar kao andeo*

d. Grupi i njësive frazeologjike të motivuara nga një metaforë nga **bota e insekteve**. P.sh.: *m'u bë plesht*; *zgjua bletësh*; *m'u bë rriqër etj.*

M'u bë plesht=

bul. [Лепна ми се] като конска мѣха

gr. Mou έγινε ΨύλλοS (στ 'αυτι)

rum. *A se tine scai de cineva*

sr-kr. *Praviti od buhe slona*

Paralele frazeologjike midis gjuhëve gjejmë edhe te njësitë e krijuara **me krahasim**, sepse krahasimi është një nga tri rrugët (që kemi marrë në shqyrtim) për shndërrimin figurativ të një togfjalëshi të lirë (a të një sintagme të paktën me dy gjymtyrë emërtuese). Në të folurit e përditshëm ne ndeshim, në situata ligjërimore të larmishme e në folës të panumërt, në qindra e qindra përdorime të krahasimit. Në Fjalorin Frazeologjik Ballkanik gjejmë mjaft njësi frazeologjike të krijuara me krahasim ku shqipja gjen analogji me gjuhët e tjera të Ballkanit. Të tërheqin vëmendjen në Fjalor njësitë frazeologjike me **lidhëzën si**. P.sh: *si boshti para furkës*; *si fanti spathi*; *si bariu pa bagëti*; *si bora në maj etj.*

Si boshti para furkës =

Bul. [Бързам] като пуле пред майка си

gr. Βυάινει σαν το στειλιάρι (μπροστά)

rum. *A apuca cu gura inainte, a nu-si astpta*

rindul la vorba

sr-kr. *Ne biti od reda, ne zna kao je red I običaj*

Hiperbola është një tjetër mjet i rëndësishëm mbi të cilin ngrihet motivimi i shumë njësive frazeologjike. Edhe te ky tip njësish shqipja gjen analogji me gjuhë të tjera të Ballkanit. Njësitë e krijuara me hiperbolë nga ana numerike janë më pak, krahasuar me njësitë e krijuara me metaforë dhe krahasim. P.sh.: *e bën mizën buall; e bën priftin (dhespotin) me barrë; etj.*

E bën mizën (pleshtin) buall =

bul. Правя от мухат слон; Правя от Бълхата

Бивол (слон)

gr. Κανεί τη μύγα βουβάλί, κάνει την

τρίχα τρία

rum. *A face din tintar armasar*

sr-kr. *Činiti od muhe konja , praviti od buheslona*

Shqipja gjen analogji me gjuhë të tjera të Ballkanit edhe me frazeologjizmat që formohen me anë të përsëritjes së një fjale, ose me bashkimin e dy fjalëve semantikisht korrelative (sinonime ose antonime) ndërmjet fjalëve shërbyese. Në ndonjë gjuhë të Ballkanit ato ndërtohen edhe pa ndihmën e fjalëve shërbyese. P. sh.:

Ditë për ditë = rum. Zi cu zi, gr. μέρα μέ τή μέρα, bullg. от ден на ден, serbokr. dana da dan

Për akademik J.Thomain fusha e analogjive të përbashkëta shprehet më tepër tek pikënisja e ndërtimit semantic të frazeologjizmave gjuhësorë dhe proverbave, gjëzave etj., ku në shumicën e rasteve shërben po ai nocion, po ajo ide në popuj të ndryshëm të Ballkanit.

Si përfundim, mund të themi se kontributit të shumë gjuhëtarëve për dukuritë e përbashkëta ballkanike të parashtruara që nga Kopitari, Sandfeldi, Papahaghi, Çabej, Demiraj etj., i shtohet dhe ai i akademik Jani Thomait për ballkanizmat në fushën e frazeologjisë. Fjalori Frazeologjik Ballkanik jo vetëm është i pari në llojin e vet dhe plotëson një kërkesë të hershme të gjuhësisë shqiptare, por edhe përbën një kontribut të çmuar të tij në fushën e ballkanistikës.

FALËNDERIM NGA AKAD. JANI THOMAI

I nderuar prefekti i Qarkut të Korçës, zoti Andrea Mano!

I nderuar rektori i Universitetit “Fan S. Noli”, Korçë, profesor Gjergji Mero!

Të nderuar profesorë, studiues, pedagogë e pjesëmarrës!

Miq e të ftuar të pranishëm në këtë veprimtari!

Në raste të tilla kaq të gëzueshme, sikundër ndodhem unë sot, shumëkush e nis përshëndetjen a falënderimin me shprehjen “jam shumë i emocionuar”. Dhe kjo është e natyrshme si për këdo, edhe për mua. Por mua më shqetëson edhe më shumë diçka tjetër, gjendem ngushtë e në vështirësi a i gjej ose a ka vërtet fjalë që ta shprehin plotësisht e me forcën e meritueshme ndjenjën e mirënjohjes e falënderimin tim për gjithë ju, që u mbledhët këtu për të më nderuar me këtë veprimtari dhe për të shprehur vlerësimet për punën time gjithsesi modeste. Gjuha është më e varfër se zemra. Prandaj falënderimet e mia dalin nga thellësia e zemrës!

Falënderoj nga zemra Universitetin “Fan S. Noli” si nismëtar dhe gjithë ata që u morën me punët e lodhshme të organizimit të kësaj veprimtarie kaq të bukur e prekëse.

Falënderoj nga zemra gjithë ata që folën në këtë veprimtari dhe thanë për mua e për krijimtarinë time shkencore aq fjalë të mira, vërtet emocionuese.

Ju falënderoj nga zemra të gjithë ju që morët pjesë në këtë veprimtari duke më dhënë nga vetja kaq kohë e durim për të më nderuar. Çastet e bukura që kam kaluar këtu me ju do të mbeten të paharrueshme.

Do të falënderoj nga zemra edhe Korçën, këtë qytet të kulturuar e kulturëdashës, që gjithnjë, sikundër është shquar vetë, i ka çmuar vlerat e arsimit, të kulturës, të shkencës e të arteve në rrafsh kombëtar.

Konferenca shkencore për mua qe mjaft e pasur e cilësore, çka tregon punën serioze të kumtuesve e mendimin e tyre për të gjykuar shkencërisht studimet në fushën e gjuhësisë dhe për të sjellë secili ndihmesat e vyera vetjake. Uroj që t’i meritoj e t’i përligj vlerësimet tuaja!

Është pranuar në parim që në krijimtarinë letrare e artistike duhen 90% talent e 10% punë, kurse në krijimtarinë shkencore duhen 90% punë e 10% prirje a talent. Puna dhe vetëm puna këmbëngulëse, e përqendruar e me përkushtim është forca më kryesore për gjurmime e studime shkencore të



suksesshme e cilësore. Siç thotë një i ditur, puna është bashkëpunëtorja më besnike, që nuk të tradhton kurrë.

Por mund të them se unë kam pasur edhe fat në jetë e në rrugëtimin shkencor:

E arrita një moshë që më ka dhënë kohë të kënaqshme, që të mos them të mjaftueshme, prej rreth 50 vjetësh në fushën e shkencës gjuhësore.

Fat ka qenë edhe formimi im arsimor e shkencor me personalitetet më të shquara shkencore të kohës, profesorët më në zë, si Eqrem Çabej, Aleks Buda, Mahir Domi, Shaban Demiraj, Dhimitër Shuteriqi, Selman Riza, Androkli Kostallari, Stefanaq Pollo, Stefan Prifti, Jup Kastrati, Kolë Ashta, Simon Rrota, Muzafer Xhaxhiu, Vehbi Bala, Mark Gurakuqi, Hasan Dume, Bedri Dede e shumë të tjerë, që kanë brumosur gjithë brezin tim e disa breza të tjerë, na kanë mbajtur për dore në udhën e gjatë e të vështirë të shkencës dhe na kanë shenjuar horizontin ku mund e ku duhet të mbërrijmë. Ne, nxënësit e tyre, jemi përpjekur të përfitojmë sa më shumë nga pasuria e mendimit të tyre shkencor dhe të ndjekim rrugën që na treguan. Shumë prej tyre me themelimin e Akademisë së Shkencave u zgjodhën anëtarë të saj. Mirënjohja për atë brez shkencëtarësh të nivelit evropian nuk do të fashitet kurrë.

Mendoj se nuk duhet harruar që krijimtaria shkencore në fushat tona, nëpërmjet shumë rrjedhave dhe në përmasa e forma të ndryshme, ushqen gjithashtu përmbajtjen e shkollës, drejtpërdrejt në lëndët e gjuhës e të letërsisë dhe tërthorazi në të gjitha lëndët përmes gjuhës së teksteve përkatëse. Vetë gjuha e teksteve dhe ligjërimi i mësuesve e i pedagogëve të çdo fushe ndikojnë fuqishëm në përvetësimin e standardit gjuhësor dhe në edukimin e kulturës së gjuhës të nxënësve e të studentëve.

Unë u jam mirënjohës gjithashtu kolegëve të mi të punës në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë e përgjithësisht në ish-institucionet e shkencave shoqërore albanologjike të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, si dhe të Fakultetit të Historisë e të Filologjisë të Universitetit të Tiranës, për bashkëpunimin me përfitim të ndërsjellë, për mbështetjen, përkrahjen e nxitjen me shumë dashamirësi.

U jam mirënjohës gjithë ish-studentëve të mi të 50 viteve si pedagog (natyrisht jo vetëm të mi), që kanë qenë laborator i provës për dijet e mija e që sot më gëzojnë pa masë me sukseset e arritura në çdo veprimtari e kudo ku punojnë. Jeta e puna ime do të ishin të mangëta pa këtë mjedis shkencor e shoqëror. Do të shtoj që respekti që tregojnë për mua më zgjat jetën e më shton fuqitë për më tutje. Kjo veprimtari që u zhvillua këtu me rastin e përvjetorit të 75-të të lindjes sime është kurora e nderit që po më jepni, një çmim shumë i lartë që ma mbush zemrën plot.

Në këto raste zakonisht nga jubilar i presin të japë edhe ndonjë këshillë për më të rinjtë. Veç fjalës “punë” nuk do të shtoja gjë tjetër. Dhe, përmbi arritjet e deritashme në gjuhësinë shqipe, ka shumë punë për të bërë në të gjitha fushat, me mjete e metoda bashkëkohore, sidomos në fushën e leksikologjisë, të semasiologjisë, të leksikografisë, të stilistikës linguistike dhe të pragmatikës. Veçanërisht semantika leksikore është e pafundme, gjithnjë në lëvizje dhe lojë e bukur e fjalëve, vetë magjia e fjalës në krijimtarinë e shkrimtarëve, të përkthyesve, të publicistëve etj., por edhe në ligjërimin e secilit që mëton për një të shprehur të pasur, të qartë, të saktë, tërheqës e me ndikim të fuqishëm. Në fushë të leksikografisë po përmend veçmas tri vepra më parësore e me lidhje më të ngushtë me shkollën: hartimi i një fjalori shpjegues i mirëfilltë shkollor, që të përfshijë gjithë leksikun e teksteve mësimore nga klasa e parë e deri te klasa e fundit e shkollës së mesme; hartimi i një fjalori shpjegues sa më i plotë i termave të gjuhësisë, po aq i rëndësishëm e po aq i kërkuar për shkollën; hartimi i një fjalori enciklopedik letrar, i cili, duke u vënë në duar të nxënësve e të studentëve, do ta ndryshonte e do ta shkarkonte përmbajtjen e teksteve mësimore të letërsisë nga të dhënat e thjeshta të informacionit shkencor e biografik. Këto vepra mund të ishin projekte shkencore të çdo studiuesi a grupi studiuesish, por edhe të Ministrisë së Arsimit e të Shkencës, si pjesë e kurrikulave shkollore.

Duke e mbyllur këtu, ju shpreh të gjithëve edhe një herë mirënjohjen time më të thellë dhe urimin e përzemërt që të keni jetë të gjatë, të shëndetshme, të frytshme në çdo fushë e në çdo detyrë dhe shumë e shumë vite të mbara e të gëzueshme familjarisht. Më lejoni t’u shpreh një falënderim të veçantë, emër për emër, gjithë atyre që kanë ardhur nga jashtë Korçës e nga jashtë Shqipërisë, me rrugë të gjata e të lodhshme për të marrë pjesë në këtë veprimtari.

Përsëri mirënjohje për Universitetin e Korçës, që na mblodhi të gjithë këtu!

Ju faleminderit!